AKADEMIA E SHKENCAVE E RPS TË SHQIPERISE
INSTITUTI I HISTORISE

VIRON KOKA

RRYMAT E MENDIMIT POLITIKO-SHOQËROR NË SHQIPËRI

NË VITET 30 TË SHEKULLIT XX

TIRANË, 1985

HYRJE

Në monografinë që po i paraqesim publikut të gjerë dhe shkencor, e cila është frut i një pune mjaftvjeçare, kemi trajtuar rrymat e mendimit politiko-shoqëror në Shqipëri në vitet 30 të shekullit XX.

Këtë temë historike e kemi bërë objekt studimi për një sërë arsyesh.

Historia e çdo periudhe, siç dihet, është tërësia e proceseve dhe e dukurive të saj, e marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore, e ngjarjeve politike, e ideologjisë dhe kulturës. Historiografia jonë e re e ndriçuar nga metodologjia marksiste-leniniste, si dhe nga mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha, është munduar që për çdo periudhë të krijojë një kuadër tërësor, të japë një tablo të plotë e reale të ngjarjeve e proceseve historike. Ajo është përpjekur jo vetëm të plotësojë boshllëqet e trashëguara nga historiografia e vjetër, por edhe të zgjerojë gjithnjë e më shumë objektin e sferën e studimeve dhe të depërtojë gjithnjë më thellë në historinë e gjallë të popullit tonë.

Ideologjia dhe mendimi politiko-shoqëror si pjesë me rëndësi e saj, siç na mëson marksizëm-leninizmi, ka një rol të rëndësishëm e aktiv në jetën shoqërore. Ajo, kur u shërben klasave përparimtare dhe kur materializohet në veprimtarinë praktike të masave, të lëvizjeve revolucionare, fiton

një forcë të konsiderueshme dhe bëhet një faktor me peshë i përparimit shoqëror.

Në kohët e reja dhe moderne si kudo edhe në Shqipëri, roli i ideologjisë, sidomos i asaj revolucionare e përparimtare, është rritur gjithnjë e më shumë. Kjo vërteton fjalët e Frederik Engelsit, i cili thoshte se «ka kaluar koha e sulmeve të befasishme, e revolucioneve që bëheshin nga një pakicë e vogël e ndërgjegjshme, e cila qëndronte në krye të masave të pandërgjegjshme»[1]*. Tashti për të kryer me sukses revolucionin apo edhe një luftë të zakonshme revolucionare, duhej të bëheshin të ndërgjegjshme masat popullore për këtë detyrë, duhej të pajiseshin ato me ideologjinë revolucionare.*

Ideologjia përparimtare e revolucionare në vendin tonë që nga koha e Rilindjes sonë Kombëtare deri në ditët e sotme, ka fituar përmasa gjithnjë më të mëdha dhe një rol gjithnjë më aktiv. Ajo arriti majat më të larta në ideologjinë marksiste-leniniste të Partisë sonë e në mësimet e shokut Enver Hoxha, ideologji e cila me forcën e saj titanike, koherencën e kthjelltësinë e mendimit shkencor, aftësinë e saj krijuese dhe për të bërë për vete masat, për të vënë në lëvizje një popull e një komb të tërë, mundi të shembë botën e vjetër të mbajtur në shekuj mbi themelet e shfrytëzimit të popullit e të shtypjes kombëtare dhe të krijojë një botë krejt të re pa shfrytëzim, rendin socialist të lulëzuar. Ideologjia jonë marksiste-leniniste trashëgoi dhe përvetësoi gjithçka të mirë e të vyer të mendimit e kulturës sonë përparimtare. Në këtë trashëgimi hyn edhe mendimi politiko-shoqëror revolucionar i viteve 30-të.

Shqipëria e viteve 30 me gjithë prapambetjen ekonomiko-shoqërore e gjendjen e rëndë politike, nuk qëndroi në vend numëro. Falë ligjeve objektive historike dhe luftës revolucionare të popullit e të përfaqësuesve më të mirë të tij, u bënë përparime si kudo edhe në fushën e ideologjisë e të kulturës.

Zhvillimi i mendimit, i ideologjisë, nuk është proces i qetë linear, as një përfundim i thjeshtë i zhvillimit kulturor eruditiv, por lidhet drejtpërdrejtë me jetën ekonomike, shoqërore e politike dhe me luftën e klasave.

Kështu në mendimin politiko-shoqëror të periudhës janë pasqyruar të gjitha dukuritë themelore të jetës së kësaj periudhe dhe lufta e të kundërtave. Forcimi i luftës së klasave pas sigurimit të pavarësisë, i dha një impuls të fuqishëm ideologjisë e mendimit politiko-shoqëror. Që në gjysmën e parë

1) K. Marks — F. Engels. *Vepra të zgjedhura.* Tiranë, 1975, vëllimi 1, f. 130.

të viteve 20 u dukën dy korrente të forta, të vëna njëri kundrejt tjetrit: ai i demokracisë dhe ai i reaksionit. Hendekun midis tyre e thelluan edhe më shumë Revolucioni i Qershorit 1924 dhe lufta e klasave që vazhdoi më pas.

Në gjysmën e dytë të viteve 20 e sidomos në vitet 30, kur forcat politiko-shoqërore iu kundërvunë më tepër njëra-tjetrës, mendimi politiko-shoqëror fitoi një përmbajtje më të pasur, më të larmishme dhe luajti një rol akoma më aktiv.

Dalja në skenën historike të Shqipërisë e lëvizjes dhe e ideologjisë komuniste që ishte rrjedhojë e forcimit të luftës së klasave u bë faktor me rëndësi i përparimit. Kjo ideologji fermentoi gjithë mendimin përparimtar të kohës dhe forcoi luftën ideologjike.

Idetë komuniste, idetë më revolucionare e më militante të kohës, lindën mbi bazën e kushteve të reja objektive që u krijuan në Shqipëri, sidomos mbi bazën e zgjerimit të lëvizjes punëtore, të rritjes së ndërgjegjes së klasës punëtore e të luftës së saj. Ato dolën në një periudhë kur kundërthëniet ekonomiko-shoqërore e politike në vend u acaruan shumë.

Këto ide hynë në lëvizjet e ndryshme revolucionare të kohës dhe e ngritën luftën për demokracinë në një shkallë më të lartë. Komunistët, falë orientimeve të drejta të Ali Kelmendit me shokë, nuk u morën thjesht me spekullime teorike e nuk qëndruan në pozita vrojtuese, por u përpoqën që në fillim që idetë e tyre t'i vënë në jetë, t'i përhapin në masat e t'i materializojnë në luftën klasore.

Natyrisht, në kushtet e mungesës së Partisë Komuniste, si përpunimi i ideve, i teorisë revolucionare, ashtu edhe materializimi i tyre në jetë kishte mjaft boshllëqe e kufizime. Megjithatë, organizatat komuniste në këtë kohë ishin organizatat me idetë më të përparuara e me veprimin më të shëndoshë revolucionar.

Në vitet 30 pati një zhvillim të mëtejshëm edhe mendimi politiko-shoqëror demokratik si brenda në Shqipëri, ashtu dhe në mërgim. Ky mendim u pasurua mjaft. Ai ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të ideve komuniste dhe u gërshetua me to.

Në të u pasqyruan detyrat themelore të shndërrimit demokratik të vendit. Në qoftë se më parë, në fillim të viteve 20, në ideologjinë demokratike të kohës ndikonte ideologjia borgjeze përparimtare, tashti, në kushtet e përhapjes së ideve komuniste, ideologjia demokratike u shkëput nga ndikimi i borgjezisë, e cila ishte tashmë në pozitë reaksionare dhe u radikalizua më tej duke shprehur aspiratat e fshatarëve, punëtorëve, zanatçijve e punonjësve të tjerë.

Ideologjia komuniste e demokratike pasqyroi jo vetëm

kushtet e brendshme dhe aspiratat e masave popullore, por edhe lidhjet e takimet e lëvizjeve revolucionare shqiptare me lëvizjet dhe idetë revolucionare të Evropës. Revolucionarët shqiptarë, duke u mbështetur fuqimisht në truallin kombëtar, nuk lanë pa studiuar e pa përvetësuar idetë e shëndosha revolucionare e komuniste të vendeve të tjera.

Në këtë dhënie e marrje reciproke idesh midis revolucionarëve të vendeve të ndryshme, personalitete revolucionare të Evropës, sidomos të Kominternit, në vlerësimet e tyre mbi gjendjen në Shqipëri dhe luftën e popullit shqiptar u mbështetën në vlerësimet dhe idetë e revolucionarëve shqiptarë, të cilët i njihnin më mirë se kushdo gjendjen e problemet e vendit të tyre.

Në këtë periudhë edhe klasat e pasura, me anë të ideologëve të tyre bënë përpjekje të shumta për zhvillimin e mëtejshëm e rafinimin e mendimit të tyre politiko-shoqëror. Ato ishin madje shumë më të favorizuara në këtë drejtim, sepse kishin të gjitha mjetet ekonomike, politike e ideologjike në duart e tyre. Këto përpjekje gjetën pasqyrim në pasurimin e këtij mendimi dhe në daljen në skenë të rrymave të reja të mendimit politiko-shoqëror që nuk kishin ekzistuar më parë në vendin tonë.

Rryma më e vjetër reaksionare që vazhdoi të ekzistonte dhe në këto vite, ishte rryma klerikale. Rrymat e tjera si ajo zogiste, «neoshqiptare», e «diktaturës së ndritur» ishin rryma të reja që lindën në kushtet e regjimit monarkik zogist. Këto rryma kishin mjaft gjëra të përbashkëta, por edhe veçoritë e tyre. Ato të gjitha së bashku u përkujdesën për të bërë apologjinë e rendit çifligaro-borgjez dhe për të luftuar lëvizjet e ideologjinë revolucionare, për të mënjanuar çdo shndërrim revolucionar që rrezikonte rendin në fuqi.

Por ato, duke pasqyruar pozitat e dobëta të klasave të tyre, ashtu siç ka thënë shoku Enver Hoxha, ishin shumë të ndikuara nga rrymat ideologjike e kulturore reaksionare të jashtme, nga shkollat sociologjike e filozofike perëndimore[2]*. Kështu, ata bënë një transplantim mekanicist të ideve të huaja në truallin shqiptar. Grupet sunduese çifligaro-borgjeze i pasqyruan idetë dhe interesat e tyre me anë të ideologjisë zogiste.*

Grupe të veçanta të borgjezisë shqiptare, e cila tashmë në përgjithësi si klasë kishte kaluar në pozita reaksionare e antidemokratike, krijuan rryma të mendimit politiko-shoqëror, të cilat synonin krahas mbrojtjes së rendit çifligaro-borgjez edhe mbrojtjen e interesave të borgjezisë për zhvillimin e ngadalshëm e pa tronditje të marrëdhënieve kapitaliste, për forcimin e pozitave politike të kësaj klase dhe fitoren e mënyrës borgjeze të jetesës në të gjitha fushat.

2) Enver Hoxha. *Raporte e fjalime 1965-1966.* Tiranë, 1971, f. 365.

Idetë borgjeze kishin vulën e kompromisit të klasës borgjeze me atë çifligare dhe një karakter të hapur ose të maskuar antidemokratik. Mungesa e lirive demokratike, prapambetja e përgjithshme arsimore e kulturore, mungesa e partive dhe organizatave politike, censura drakoniane, ndikuan negativisht mbi zhvillimin e mendimit politiko-shoqëror të kohës.

Në këto rrethana, mendimi politiko-shoqëror ishte i thërmuar e mbante vulën e një farë spontaneiteti. Nuk ekzistonin sisteme monolite e koherente idesh e pikëpamjesh dhe as shkolla e tendenca në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Megjithatë në morinë e ideve e pikëpamjeve që qarkulluan në atë kohë, kemi mundur të përcaktojmë disa rryma kryesore me një farë fizionomie të tyre dhe këto i kemi analizuar me hollësi në monografi. Edhe vetë ideologjia revolucionare, e cila kishte më shumë koherencë e kohezion, ende nuk ishte një sistem i plotë e i përpunuar mirë pikëpamjesh. Këtë mundi ta bëjë më vonë vetëm Partia Komuniste Shqiptare, e cila u mbështet rigorozisht mbi marksizëm-leninizmin dhe përpunoi një program shkencor revolucionar në përputhje me kushtet historike të vendit.

Mendimi politiko-shoqëror i periudhës pati si tribunë kryesore organet e ndryshme të shtypit të përditshëm e periodik. Shtypi në Shqipëri, që nga koha e Rilindjes kishte tradita të shëndosha dhe u zhvillua mjaft me gjithë situatat e rënda e vështirësitë. Ai ndikoi jo pak në luftën politiko-shoqërore të vendit. Shtypi e gjallëroi mjaft jetën mendore në vitet 30-të. Është e kuptueshme që kjo jetë mendore kufizohej në rrethet e ngushta intelektuale po të kemi parasysh faktin që pjesa dërrmuese e popullsisë ishte analfabete. Por edhe kjo kishte rëndësinë e vet.

Idetë përparimtare e revolucionare, në fillim bëjnë për vete përfaqësuesit më të mirë të klasave revolucionare e pastaj i hapin rrugën vetes nëpërmjet tyre për te masat më të gjera. Shtypi reaksionar në këtë kohë ishte zotërues. Kjo i përgjigjej plotësisht rregullave të funksionimit të superstrukturës sunduese. Por lufta ideologjike midis tij dhe shtypit demokratik dhe depërtimi i ideve përparimtare në vetë shtypin reaksionar, ishte një dëshmi e faktit që progresi bënte të veten edhe në fushën e mendimit dhe që monopoli ideologjik i klasave sunduese nuk ishte absolut.

Duke pasur si busull në trajtimin tonë marksizëm-leninizmin dhe mësimet e Partisë e të shokut Enver Hoxha që kanë një vlerë të madhe për shkencën historike e shkencat e tjera, kemi mundur të sqarojmë një sërë problemesh themelore që

lidhen me temën tonë. Gjatë ripunimit të disertacionit, janë pasur parasysh edhe porositë shumë të çmuara të shokut Enver Hoxha për shkencën historike në fjalimin e mbajtur në Sekretariat të KQ të PPSh më 9 maj të vitit 1983.

Në monografi është përqendruar vëmendja në zgjidhjen e disa çështjeve kryesore:

1) Është studiuar dhe analizuar me vëmendje ai komponent me rëndësi i superstrukturës ideologjike të kohës, siç është mendimi politiko-shoqëror. Kjo pjesë e superstrukturës është parë nën prizmin materialist-dialektik e klasor duke u evidentuar si elementi superstrukturor i klasave sunduese ashtu dhe ai i klasave revolucionare.

2) Nëpërmjet analizës së superstrukturës ideologjike të klasave sunduese, jemi munduar të nxjerrim në pah rolin e saj reaksionar për përforcimin e rendit çifligaro-borgjez, për përligjjen dhe forcimin e shtypjes e shfrytëzimit të masave popullore. Këtë pjesë të superstrukturës e kemi shqyrtuar në lidhje të ngushtë me marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore të vendit, regjimin politik dhe krizën e rëndë që po kalonte rendi në fuqi.

3) Këtu kemi shtjelluar të gjitha rrymat e mendimit politiko-shoqëror reaksionar duke demaskuar si rrymat e hapura apologjiste, si ajo zogiste e klerikale, ashtu edhe rrymat borgjeze të maskuara me demagogji e me një farë petku pseudopërparimtar. Larmia e këtyre rrymave është shpjeguar jo vetëm me interesat klasore e preokupacionet e klasave sunduese për të pasur monopolin absolut ideologjik në shoqëri por edhe me interesat partikulariste të klasave e grupeve reaksionare.

4) Një rëndësi e veçantë i është kushtuar demaskimit të fesë dhe ideologjisë reaksionare politiko-shoqërore klerikale, e cila ka luajtur një rol shumë negativ si në rrafshin kombëtar, ashtu dhe në atë shoqëror.

5) Në monografi jemi përpjekur të zbulojmë jo vetëm rrënjët social-klasore të ideologjisë reaksionare, bazën e tyre objektive, por edhe lidhjet gnoseologjike e të birërisë me ideologjinë reaksionare perëndimore, prirjen e saj për kopjimin e shkollave e sistemeve reaksionare ideologjike të Perëndimit.

6) Një vëmendje kryesore i është kushtuar sidomos mendimit politiko-shoqëror komunist e demokratik në Shqipëri që përbënte platformën e klasave revolucionare të shoqërisë shqiptare.

Ideologjia komuniste, e cila ishte në fillimet e saj, është parë si ideologjia e klasës së re punëtore shqiptare e në të njëjtën kohë si shprehëse e aspiratave demokratike të mbarë popullit shqiptar. Idetë komuniste janë parë në evolucionin e tyre, në rrafshin ekonomik, politik e shoqëror. Ato janë vlerësuar si ide militante të lidhura me lëvizjet e praktikën revolucionare.

Këtu janë zbuluar edhe dobësitë e boshllëqet e kësaj ideologjie, gjithashtu është vënë në dukje lufta e komunistëve më të mirë kundër pikëpamjeve trockiste e arqiomarksiste në lëvizjen komuniste.

Ideologjia komuniste është konsideruar jo vetëm si një faktor me rëndësi në luftën për demokracinë, por edhe si një premisë pozitive në të mirë të krijimit të Partisë Komuniste Shqiptare më vonë. Krahas saj në monografi është analizuar në mënyrë të hollësishme mendimi politiko-shoqëror demokratik-revolucionar brenda vendit si një mendim që ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të ideve komuniste dhe që shprehte aspiratat demokratike të popullit.

Këtu është shpjeguar qëndrimi kritik e militant i ideologjisë demokratike ndaj rendit ekonomiko-shoqëror e regjimit politik, demaskimi që i bëhej prej saj klasave reaksionare e politikës së tyre, vlerësimi i rolit të klasave revolucionare, si fshatarësia e klasa punëtore, si dhe lufta për shndërrimin demokratik të vendit.

7) Në monografi është trajtuar gjerësisht edhe ideologjia demokratike e Komitetit të Çlirimit Nacional në mërgim. Kjo ishte rryma më e përparuar dhe më përfaqësuese e emigracionit. Idetë demokratike të kësaj organizate ishin të gërshetuara me idetë komuniste. Nëpërmjet analizës së ideve është vlerësuar ndihmesa e rëndësishme e ideologëve të KÇN për përpunimin dhe propagandimin e teorisë revolucionare në shërbim të revolucionit popullor. Këtu jemi munduar të tregojmë sesi revolucionarët e KÇN demaskuan me forcë e në mënyrë të argumentuar rendin çifligaro-borgjez e regjimin zogist, imperializmin e shovinizmin dhe analizuan me pjekuri luftën e klasave dhe perspektivën e zhvillimit revolucionar të Shqipërisë. Një meritë e shquar e tyre është trajtimi i hollësishëm dhe i drejtë për kohën, i problemit të fshatarësisë. Krahas anëve pozitive, janë vënë në dukje edhe kufizimet ideore të organizatës, dhe të elementeve të veçantë. Një dobësi e rëndësishme e KÇN ishte sidomos mospërputhja e ideologjisë revolucionare të saj me veprimtarinë e dobët praktike revolucionare.

Në problematikën e çështjeve politiko-shoqërore të studiuara kemi përfshirë pikëpamjet e rrymave të ndryshme mbi rendin ekonomiko-shoqëror, mbi shoqërinë dhe kombin, mbi çështjen e progresit si dhe rrugët e tij, mbi klasat dhe luftën e klasave, mbi shtetin e regjimin politik, mbi luftën politike, mbi ideologjinë, kulturën etj.

Duke u marrë kryesisht me idetë politiko-shoqërore që janë objekt i temës, natyrisht kemi lënë jashtë studimit çë-

shtje të tjera që lidhen me ideologjinë. Këto mund të trajtohen në studime më vete.

Baza kryesore mbështetëse e studimit tonë, sikurse e çdo studimi të historiografisë sonë, është ideologjia marksiste-leniniste, mësimet e Partisë e të shokut Enver Hoxha. Idetë shumë të rëndësishme të klasikëve të marksizëm-leninizmit, K. Marksit, F. Engelsit, V.I. Leninit, J.V. Stalinit mbi ideologjinë dhe sferat e saj të ndryshme, mbi burimet e saj, mbi rolin e zhvillimin e saj sidomos në kohët moderne, mbi natyrën thellësisht klasore dhe rolin aktiv të ideve, mbi rrymat e ndryshme të mendimit, mbi rolin e madh përparimtar të ideologjisë revolucionare, sidomos asaj komuniste, të gjitha këto na kanë shërbyer si udhërrëfyes në fushën tonë të studimit.

Në mënyrë të veçantë, busull drejtuese kemi pasur idetë e shquara marksiste-leniniste të shokut Enver Hoxha për këto çështje. Në veprat e ndryshme të shokut Enver Hoxha, duke filluar nga vepra e tij madhore e kohëve të fundit «Kur lindi Partia» (Kujtime), është dhënë një kuadër i qartë e bindës i periudhës që analizojmë, është analizuar thellë me argumente shkencore historike, nën prizmin e materializmit dialektik e historik, periudha e regjimit zogist. Në këto vepra kemi gjetur ide shumë të rëndësishme mbi gjendjen ekonomiko-shoqërore e politike të vendit, mbi klasat e luftën e klasave, mbi regjimin e politikën e tij antipopullore e antikombëtare, mbi ideologjinë e kohës, përmbajtjen dhe nuancat e saj, burimet e saj social-klasore e gnoseologjike. Shoku Enver na ka dhënë një tablo të qartë e plot vërtetësi të ideologjisë revolucionare, komuniste e demokratike. Aty tregohet sesi lindi ideologjia komuniste, në çfarë kushtesh objektive ekonomiko-shoqërore e politike, interesat e cilave forca përfaqësonte; tregohen faktorët subjektivë që ndikuan në lindjen e saj, evolucioni i ideologjisë komuniste, pikëpamjet e ndryshme në lëvizjen komuniste e përparimtare, lufta e të kundërtave në fushën e ideve.

Shoku Enver ka argumentuar rolin aktiv të ideve, sidomos atyre komuniste, duke kritikuar materializmin ekonomik që predikon fatalizmin. Një ndihmë e rëndësishme për studimin tonë janë idetë e shquara të shokut Enver Hoxha mbi rolin e klasave revolucionare të kësaj periudhe, të klasës punëtore e fshatarësisë. Në mënyrë të veçantë studimi i thellë i tij mbi «Kryengritjen fshatare të Shqipërisë së Mesme (1914-1915)» na ka hapur horizont të gjerë për të vlerësuar pikëpamjet e ndryshme mbi fshatarësinë, sidomos ato të Komitetit të Çlirimit Nacional.

Edhe idetë marksiste-leniniste të shokut Enver mbi fenë

dhe klerin, mbi rolin reaksionar të tyre në këtë periudhë janë po ashtu një mbështetje e fortë për studimin tonë.

Autori i kësaj monografie është mbështetur gjithashtu në literaturën tonë historike marksiste-leniniste për problemet ideologjike të kohës. Kështu, një bazë e mirë ka qenë teksti i «Historisë së PPSh» i ribotuar në vitin 1982, në të cilin vlerësohet ideologjia revolucionare e periudhës, kryesisht ajo komuniste.

Si mbështetje teorike e burimore kanë shërbyer edhe materialet e broshurat e botuara nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, në të cilat trajtohen çështjet e lëvizjes komuniste shqiptare dhe të luftës kundër reaksionit zogist e imperializmit fashist gjithashtu figurat e shquara të komunistëve si Ali Kelmendi me shokë dhe pikëpamjet e tyre.

Këtu janë shfrytëzuar edhe një sërë librash të tjerë mbi personalitetet revolucionare të kohës. Për vlerësimin e dukurive të letërsisë e kulturës përparimtare të viteve 30, autori i studimit është mbështetur edhe në Historinë e Letërsisë Shqipe dhe në një sërë monografish letrare.

Në literaturën e botuar nga autorët e ndryshëm janë analizuar vetëm idetë revolucionare e përparimtare, ndërsa rrymat e ndryshme reaksionare nuk janë bërë objekt studimi të veçantë. Autori i kësaj monografie në vitet e fundit është marrë me një sërë çështjesh të mendimit politiko-shoqëror dhe ka shtjelluar në disa artikuj studimi, një sërë rrymash reaksionare dhe përparimtare. Kështu, në trajtë fillestare u hodhën prej tij disa mendime mbi ideologjinë e klerit reaksionar, mbi «neoshqiptarizmën», ideologjinë e «diktaturës së ndritur», mbi pikëpamjet e gazetës revolucionare «Liria kombëtare», të revistës demokratike «Bota e re», mbi problemin e emancipimit të gruas në vitet 30 etj.

Kohët e fundit prej tij u botua dhe një studim mbi problemin sesi i ka parë Komiteti i Çlirimit Nacional çështjen agrare në Shqipëri dhe luftën e fshatarësisë për tokën dhe për çlirimin shoqëror të saj.

Bibliografia e periudhës së regjimit zogist ka qenë e pakët. Megjithatë, ajo është parë me vëmendje dhe në mënyrë kritike. Në këtë literaturë dallohej jo për nga volumi, por nga pesha dhe rëndësia e saj, literatura revolucionare e botuar nga Komiteti i Çlirimit Nacional në formën e dy broshurave ku bëhej një analizë e shëndoshë e gjendjes ekonomike, shoqërore e politike të Shqipërisë dhe e luftës së popullit shqiptar për të drejtat e tij demokratike.

Burim kryesor e me rëndësi ku jemi mbështetur për studimin e rrymave të mendimit politiko-shoqëror, është shtypi i periudhës. Ky, siç thamë më lart, ka qenë relativisht

i pasur dhe ka shërbyer si tribunë kryesore e ideve të forcave të ndryshme.

Për të pasur një përfytyrim të qartë mbi idetë e periudhës, e kemi shfrytëzuar të gjithë shtypin e kohës. Por natyrisht jemi përqendruar në rrymat kryesore më përfaqësuese të mendimit, të cilat kishin si tribunë disa organe të caktuara. Kështu që edhe në referimet e citimet, nuk e kemi sjellë të gjithë shtypin e kohës, ndërsa në bibliografi i kemi rreshtuar të gjitha organet.

Idetë dhe mendimet që kanë qenë përsëritje e mendimeve e pikëpamjeve të rrymave kryesore, nuk e kemi parë të arsyeshme t'i citojmë.

Krahas bibliografisë, kemi shfrytëzuar edhe një farë dokumentacioni historik. Ky dokumentacion ka qenë i pakët. Kryesisht kemi shfrytëzuar dokumentacionin arkivor lidhur me pikëpamjet e klerit reaksionar katolik të shprehura në materialet sekrete e në bisedat e fshehta me zyrtarët fashistë, gjithashtu një farë materiali dokumentar që hedh dritë mbi idetë revolucionare, demokratike e komuniste.

Si përfundim, mund të themi se monografia e paraqitur është një përpjekje modeste për të sintetizuar e për të dhënë në një mënyrë më të plotë idetë politiko-shoqërore të periudhës, për të hedhur dritë disi mbi luftën ideologjike në Shqipëri në këto vite, e cila ishte pjesë përbërëse e luftës klasore që zhvillohej në të gjitha fushat. Studimet e tjera në të ardhmen për problemet e ndryshme ideologjike të kohës, do ta plotësojnë kuadrin akoma më mirë.

Me këtë rast e shoh të nevojshme të shpreh falenderimet e mia, mirënjohjen ndaj të gjithë kolegëve të shokëve të Sektorit të Historisë së Re dhe të Sotme, të cilët me vërejtjet e sugjerimet e tyre gjatë diskutimeve të pjesëve të veçanta dhe të monografisë në tërësi kanë ndihmuar mjaft për trajtimin sa më të mirë të temës.

Në mënyrë të veçantë duhet të falenderoj shokët recenzentë të disertacionit, të cilët bënë një punë serioze e të kujdesshme dhe me vërejtjet konkrete më dhanë mundësinë të ngre nivelin e studimit.

Mirënjohja ime u drejtohet edhe institucioneve shkencore, si: Bibliotekës Kombëtare, Bibliotekës së Institutit të Historisë, Arkivi Qendror të PPSh dhe Arkivit Qendror Shtetëror, të cilët më dhanë mundësinë të shfrytëzoj materialet e nevojshme për temën.

Pasi libri të botohet do të pres me kënaqësi ndihmën dhe gjykimin e masave të gjera të lexuesve, që janë gjykatësi më i mirë e më objektiv.

Autori

KREU I

RRYMA ZOGISTE

Klasat sunduese të Shqipërisë, të përbëra prej bejlerëve çifligarë dhe borgjezisë së madhe reaksionare, në vitet e reaksionit zogist, sidomos në periudhën monarkike, u përpoqën ta forcojnë sundimin e tyre jo vetëm në sferën ekonomike dhe politike, por edhe në atë ideologjike. Nëpërmjet ideologëve të vet ata krijuan ideologjinë e tyre sunduese, të cilën e veshën me rroben e nacionalizmit borgjez dhe ia përshtatën interesave të tyre e të regjimit zogist. Kjo ishte ideologjia zogiste, një nga ideologjitë më reaksionare të kohës që përshkohej tejendanë nga fryma antidemokratike. Ishte përhapëse e kultit monarkik, e frymës apologjike, mbrojtëse e rendit çifligaro-borgjez dhe përligjëse e shtypjes dhe e shfrytëzimit të masave popullore. Dalja në skenë e rrymës zogiste pasqyronte ndryshimet që ndodhen në Shqipëri në këtë periudhë dhe prirjen e klasave sunduese për forcimin e reaksionit në të gjitha drejtimet.

Në radhë të parë ajo ishte rrjedhim i shndërrimit të regjimit politik zogist nga regjim republikan në monarkik. Monarkia ishte një krijesë politike që iu imponua popullit me dhunë dhe me ndihmën e imperializmit italian. Ajo shënoi forcimin e diktaturës reaksionare dhe të shtypjes sociale

e kombëtare. Një regjim i tillë ngjalli që në fillim urrejtjen e kundërshtimin e popullit, sidomos të rretheve demokratike e revolucionare. Në periudhën monarkike lëmshi i kundërthënieve ekonomike, shoqërore e politike u ngatërrua gjithnjë e më shumë. Kriza ekonomike e politike e Shqipërisë e sidomos e regjimit u bë tepër e rëndë. Lufta klasore e masave popullore kundër rendit çifligaro-borgjez dhe regjimit erdhi duke u forcuar. Klasat e pasura nuk mund ta qetësonin gjendjen vetëm me anë të dhunës, terrorit policor. Atyre u duhej edhe një ideologji me anën e së çilës të bënin për vete opinionin publik. Në këtë periudhë krijimi i saj fitoi rëndësi të dorës së parë. Kjo u bë akoma më e ngutshme për arsye se në Shqipëri filluan të përhapen idetë revolucionare.

Ndërtesa e kalbur e monarkisë kishte nevojë të zbukurohej nga jashtë që të binte sa më pak në sy kalbëzimi i saj. Forcimi i politikës antidemokratike dhe antikombëtare duhej të përligjej në sy të popullit. Regjimi zogist, në kushtet e mungesës së partive dhe organizatave politike, të përqendrimit të mjeteve të propagandës e ideologjisë në duart e veta, si edhe të ushtrimit të censurës së rreptë nga ana e tij., u mundua të krijonte një farë monopoli ideologjik, por nuk arriti të kishte monopolin absolut. Me gjithë ndihmën e përkrahjen që patën idetë zogiste edhe nga idetë e rrymave të tjera reaksionare, ato nuk mundën të zotërojnë në mënyrë absolute. Atyre u qëndruan përballë si rrjedhim i ashpërsimit gjithnjë e më të madh të luftës së klasave, idetë demokratike dhe komuniste.

Idetë zogiste, ashtu si idetë e rrymave të tjera reaksionare, nuk mbështeteshin në ndonjë doktrinë të caktuar e të përpunuar mirë, nuk kishin ndonjë bosht. Ato ishin ide të shpërndara, të shprehura në gazeta, revista dhe në disa botime të apologjetëve të regjimit. Tribunë e këtyre ideve u bë sidomos shtypi i përditshëm, gazetat «Besa», «Drita», «Djersa e popullit», «Vatra», «Ora», «Gazeta e Korçës», «Dielli», revista «Java» etj. Organi kryesor ishte sidomos gazeta «Besa» që u tregua një mbrojtëse e zellshme e regjimit dhe e klasave sunduese. «Besa» u bë edhe si një farë qendre organizuese e përfaqësuesve me influencë të klikës zogiste. Këta të fundit u quajtën «besaxhinj». «Besaxhinjtë» jo vetëm u jepnin tonin ideve zogiste dhe ndërhynin me prepotencë në çdo diskutim e polemikë, por edhe kurdisnin makinacione e prapaskena politike. Grupi «Besa» kishte fituar në këto kohë emrin e një grupi politik.

Pas gazetarëve që shkruanin në «Besa» e gjetkë dhe që kërkonin të manipulonin opinionin publik, fshiheshin krerët e reaksionit zogist. Rreth regjimit u grumbulluan edhe disa

panegjirikë e hartues biografish të mbretit si dhe botimesh të sukseseve të arritura gjoja nën monarkinë, si Terenc Toçi, Teki Selenica etj. Këta i dogjën atij temjan dhe i thurën ditirambe.

Rryma zogiste kishte në pamje të parë një karakter kontradiktor. Nga njera anë ajo paraqitej si tendencë nacionaliste, në anën tjetër përligjte politikën e nënshtrimit të Shqipërisë nga ana e Italisë. Por, po të shikohet thellë, këto ishin dy anë të së njëjtës medalje. Nacionalizmi borgjez donte të maskonte e përligjte politikën antidemokratike, e cila në këto vite përputhej plotësisht me politikën antikombëtare të regjimit.

Në analizën e kësaj rryme do të përqendrohemi në disa çështje kryesore politike e shoqërore. Do të mundohemi të sqarojmë se cilat ishin shqetësimet themelore të ideologjisë zogiste, si pasqyroheshin në prizmin e saj interesat dhe veprimtaria e klasave të pasura në këtë periudhë historike.

1. APOLOGJIA E SUNDIMIT MONARKIK

Një nga detyrat kryesore të saj ishte mbrojtja dhe zbukurimi i monarkisë. Klika zogiste që erdhi në fuqi me anë të kundërrevolucionit dhe kryesisht me ndihmën e huaj, në fillim nuk guxoi ta shtrojë problemin e monarkisë, por diktaturën e saj terroriste e veshi me petkun e republikës. Në atë kohë propaganda zogiste bëri zhurmë rreth «triumfit të legalitetit» dhe u mundua ta bindë popullin se reaksioni çifligaro-borgjez, rivendosi gjoja pushtetin e ligjshëm të likuiduar në mënyrë të paligjshme nga Revolucioni i Qershorit i vitit 1924. Nën maskën e Republikës dhe të «legalitetit» për vite me radhë në vend u ndoq një politikë dhune e terrori kundër popullit e lëvizjeve demokratike dhe u përgatit terreni për shndërrimin e republikës në monarki.

Në ditët e përgatitjes së këtij shndërrimi, të inskenimit të kësaj tragjikomedie siç u quajt nga elementët përparimtarë të kohës (për faktin sesi u përgatit dhe pasojat që pati për vendin), propoganda zogiste, për të maskuar dhunën, deshi të krijojë opinionin se ishte gjoja dëshira e popullit ajo që po e detyronte regjimin të bëjë një shndërrim të tillë[1]. Kur shpallja e monarkisë u bë fakt i kryer, maskarada propagandistike zogolliane arriti një pikë kulmore. Në shtyp

1) «Gazeta e Korçës». 21 gusht 1928, f. 1.

u pohua se «Shqipëria hyri në një rrugë të re, në rrugën e saj natyrore» dhe se mbretëria zogiste ishte një rimëkëmbje në një shkallë më të lartë e mbretërive të lashta[2]. Që prej kësaj kohe përhapja e kultit monarkik mori përpjesëtime gjithnjë e më të mëdha. Si çdo prirje monarkike, edhe rryma zogiste u mundua të gjejë argumente «logjike», «historike», «psikologjike», për të vërtetuar domosdoshmërinë e regjimit monarkik dhe karakterin kinse progresiv të tij.

Një nga arsyetimet kryesore të saj thoshte se forma monarkike e regjimit kishte epërsi ndaj formës republikane. Kjo e fundit konsiderohej në përgjithësi e papërshtatshme për popujt, sepse favorizonte gjoja prirjet «anarqike» e antishqiptare dhe pengonte vendosjen e rregullit në shoqëri. Regjimet autoritare e sidomos ato monarkike ishin më të parapëlqyeshme, sepse ndihmonin në zhdukjen e anarkisë dhe në sigurimin e qetësisë e të përparimit. Këtë pikëpamje e mbrojti ndër të tjerë edhe Faik Konica, kryeredaktori i «Diellit» të Amerikës, i cili në një polemikë me Fan S. Nolin u shpreh në të mirë të regjimit monarkik, duke sjellë si arsye faktin që nën regjimin republikan «kryengritjet ishin të shpeshta»[3]. Noli iu përgjegj mbrojtësit të interesave të çifligarëve se një «komision» ishte në gjendje ta «rregullonte» më mirë Shqipërinë sesa një person «sado i mirë që të jetë»[4].

Dikush sofistikonte se në teori dukej sikur forma republikane garantonte lirinë e përparimin, kurse në realitet nuk ishte ashtu. Lirinë më të madhe e siguronte monarkia. Pozita gjeografike dhe ekspozimi ndaj ndikimeve të rrymave të huaja i kishte bërë kinse shqiptarët të fitonin ca vese dhe të mbaheshin si turbullues. «Prandaj ata s'mund të bënin pa një pushtet të fortë»[5].

Në këtë arsyetim bëhej e qartë se shndërrimi i republikës në monarki iu desh regjimit në radhë të parë për t'u prerë rrugën kryengritjeve antizogiste. Në realitet nuk ndodhi ashtu siç shpresohej, me gjithë masat parandaluese të tij. Frika e rrezikut «bolshevik» nuk i la asnjëherë të qeta klasat sunduese. Ato i turbullonte gjithnjë «fantoma e Bashkimit»[5/1] apo rreziku i përsëritjes së një revolucioni të ri. Prandaj i vetmi mjet për përballimin e tij ishte monarkia[6]. Monarkisë i vishej merita e likuidimit të këtij rreziku të madh për rendin çifligaro-borgjez, e vendosjes së paqes klasore, dhe e qetësisë shembullore në vend. Për një paqe të tillë dhe një stabilitet politik Shqipëria gjoja kishte shumë nevojë si shtet i ri që ishte[7]. Klasat e pasura në këtë periudhë, për të rregulluar punët e tyre, për të shfrytëzuar më lehtë popullin, e shtruan si kërkesë themelore çështjen e qetësisë së brendshme të vendit dhe ishin të ndjeshme ndaj çdo turbullimi të saj.

Për të qenë konsekuentë në mohimin e formës republikane dhe për të provuar ligjësinë e kthesës monarkike, besaxhinjtë e zvogëluan rëndësinë e Republikës zogiste të viteve 1925-1928, duke thënë se ishte e papërshtatshme për t'u bërë ballë turbullirave të brendshme. Vetëm monarkia mund ta bashkonte popullin rreth regjimit dhe të zhdukte pasojat e partikularizmit.[8]

Krahas argumenteve «logjike», për përligjjen e monarkisë vinin ato «historiket». Themelimi i monarkisë lidhej me traditën, me të kaluarën e vendit. Mbretëria zogiste mbahej si trashëgimtare e natyrshme e mbretërive të lashta, në mënyrë të veçantë e asaj të Skënderbeut[9].

Biografi panegjirik i A. Zogut, Terenc Toçi, i cili ishte në të njëjtën kohë edhe agjent i Italisë fashiste, në veprën e tij biografike «Mbreti i shqiptarëve» kushtuar mbretit, të mbushur me lavdërime neveritëse e superlative të denja për liliputë, pohonte ndër të tjera se krijimi i mbretërisë zogiste ishte rrjedhim logjik e fatlum i zhvillimit shekullor të vendit[10].

A. Zogu, sipas lavdëruesve të tij, kishte ripërtëritur traditat legjendare të Pirros, të Lekës dhe të Skënderit[11]. A. Zogu arriti të krahasohej me Skënderbeun. Kalemxhinjtë e servilët e regjimit shkuan deri aty sa mbretit satrap e të urryer nga populli, përfaqësuesit tipik të çifligarëve prapanikë e tiranit të vërtetë, të aftë për intriga, terrorizma dhe vrasje, t'i vishnin virtytet e Skënderbeut të madh. Këto përpjekje qesharake për ta bërë liliputin gjigand i vuri në lojë revolucionari demokrat Fan S. Noli[12].

Për përligjjen e monarkisë silleshin edhe arsye «psikologjike». U tha se monarkia ishte forma që përputhej më tepër me mentalitetin dhe psikologjinë e popullit shqiptar, se populli na qenkej monarkist i bindur dhe nuk mund ta kuptonte qenien e tij pa monarkinë. Këtu nuk merrej parasysh

2) Po aty, 1 shtator 1928, f. 1.
3) «Dielli», 17 shkurt 1931, f. 4.
4) Po aty.
5) «Besa», 1 shtator 1932, f. 2.
5/1) Shënim: Është fjala për organizatën revolucionare «Bashkimi» që mori pjesë në Revolucionin e 1924.
6) «Besa», 19 shtator 1932, f. 1.

7) Po aty.
8) «Dielli», 10 tetor 1930.
9) «Gazeta e Korçës», 1 shtator 1928, f. 2.
10) T. Toçi. «Mbreti i shqiptarëve», 1937.
11) «Java», 27 qershor 1937, f. 3.
12) F.S. Noli. *Rron or rron dhe nuk vdes shqiptari* (Mbledhur dhe paraqitur nga P. Tako). Tiranë, 1976, f. 221-224, 256-257; «Liria kombëtare», 11 shtator 1928; «Republika», 4 dhjetor 1930; «Republika», 10 shtator 1931.

fakti që kanë vënë re edhe të huajt që populli shqiptar e ka patur mjaft të zhvilluar ndjenjën demokratike gjatë historisë së tij.

Ky arsyetim na kujton pohimet e ideologëve monarkistë të vendeve të tjera, në shekujt e përparshëm. Teza psikologjike e monarkisë ka qenë një tezë e njohur. Klasat reaksionare kanë kudo po ato shqetësime prandaj edhe shpikjet e tyre në mjaft raste përputhen.

Në fryrjen e kultit monarkik ndihmonte edhe propaganda lidhur me të ashtuquajturat reforma zogiste. Ideologët zogistë bënë shumë zhurmë rreth disa masave politike, administrative e ekonomike që mori qeveria zogiste në këtë periudhë për të kënaqur interesat e klasave çifligare e borgjeze dhe për të forcuar rendin çifligaro-borgjez. Të tilla ishin e ashtuquajtura reformë agrare zogiste, miratimi i kodeve civile, penale e tregtare etj. Ato kishin edhe synime demagogjike, që të krijonin përshtypjen në popull se në Shqipërinë e prapambetur e të varfër, punët po ndryshonin, se ajo gjoja po qytetërohej sipas modeleve të vendeve perëndimore.

Vepra më e rëndësishme ndërtimtare e regjimit mbahej krijimi dhe forcimi gjithnjë e më shumë i aparatit policor, i organeve të diktaturës reaksionare që kishin mundur sipas ideologëve zogistë të vendosnin «qetësinë shembullore» dhe të shtypnin «çdo lëvizje të brendshme»[13].

Ky aparat gjoja e kishte bërë jetën politike të qëndrueshme dhe kjo qëndrueshmëri përbënte «një nga karakteristikat më të çmueshme të regjimit zogist»[14]. Këtu dëshira merrej për realitet. Kjo tingëllonte paradoksale, po të kemi parasysh që një pohim i tillë bëhej pas kryengritjes së Fierit që, siç dihet, e tronditi mjaft regjimin dhe dëshmoi për kalbëzimin e tij.

Me një ton patetik, u deklarua se «përpara kombi ishte në buzë të varrit nga partirat» dhe «mbreti e shpëtoi atë»[15].

Zbukurimi i rolit të aparatit policor ishte një detyrë kryesore e shtypit zogist. Në mënyrë të veçantë e gjithë zell kjo bëhej pas shtypjes së lëvizjeve antizogiste. Kështu ndodhi pas shtypjes së Lëvizjes së Fierit dhe më vonë pas asaj të Delvinës. Dhe tamam pas këtyre turbullirave e tronditjeve, qarkullonte në shtyp ajo ide e përsëritur se mbretëria zogiste ishte mbretëria «e rregullit», se në të nuk mund të kishte vend për «aventura dhe aventurierë»...[16] Vetëm në epokën parazogiste «importoheshin nga jashtë zakone dhe siste-

13) «Besa», 26 nëntor 1935, f. 1.
14) Po aty.
15) «Drita», 12 shkurt 1937, f. 2.
16) «Java», 30 maj 1937, f. 3.

me të pakontrolluara», ndërsa tashti këtyre iu mbyllën dyert.[17]

Duke bërë fjalë për reformat që u përmendën më sipër, ideologët zogistë i ngritën në qiell ato reforma që kishin përmbushur gjoja aspiratat e popullit dhe mund të cilësoheshin si «reforma politike e shoqërore nga më të përparuarat»[18]. Edhe në qoftë se nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, vendi nuk kishte bërë hapa të rëndësishëm, thohin ata, nga pikëpamja politiko-shoqërore kishte ecur përpara. Pra, merita e regjimit qëndronte gjithë-gjithë në vendosjen e qetësisë dhe të «rregullit» (terrorit).

Nga këto pohime dilte në mënyrë të tërthortë se «reformat zogiste» nuk bënë ndonjë ndryshim në marrëdhëniet ekzistuese dhe popullin e lanë atje ku ishte, në prapambetje, varfëri e mjerim.

Pra, edhe pse gjendja ishte e tillë sa vetë gazetat zogiste ishin të detyruara ta pranonin në disa raste, kjo nuk i pengonte ato në euforinë e lavdërimeve monarkike të thoshin në mënyrë groteske se «Shqipëria kishte shumë vepra të mëdha për t'i treguar Evropës së qytetëruar», të cilat i kishte kryer brenda një kohe të shkurtër[19] dhe se ajo gjoja «paraqitej përpara botës me një maturitet politik....»[20].

Dhe «vepra» më e madhe e klikës zogiste në këtë kohë, po të gjykohej nga realiteti e jo nga fantazitë, ishte Shqipëria e prapambetur, me një popull të çfilitur e që nuk kishte bukë të hante.

Në arritjet e rëndësishme të regjimit rreshtohej edhe «doktrina zogiste», «doktrina e përparimit», siç e quante «Besa»[21]. E ashtuquajtura doktrinë e krijuar nga ideologët zogistë nuk ishte gjë tjetër veçse një amalgamë pikëpamjesh nacionaliste e panegjirike të palidhura e pa kurrfarë origjinaliteti. Në kultin monarkik një vend me rëndësi iu la lavdërimeve të pafund dhe idhulltarisë kushtuar mbretit Zog. I gjithë shtypi periodik dhe literatura zogiste është e mbushur me panegjirizma.

Terenc Toçi, Faik Konica e të tjerë e ngritën Zogun gjer në qiell duke trilluar gjëra fantastike e qesharake e duke pohuar se Shqipëria pa mbretin mund të rrokullisej në greminë. Por, populli e kuptonte dhe kishte bindje të plotë se ishin pikërisht mbreti dhe klika e tij ata që i shkaktuan gjithato fatkeqësi vendit dhe që po e rrokullisin në greminën e krizës e të agresionit fashist.

17) Po aty, 8 prill 1937, f. 4.
18) «Besa», 24 dhjetor 1933, f. 1.
19) «Java», 11 prill 1938.
20) «Drita», 28 nëntor 1937, f. 2.
21) «Besa», 7 korrik, 1931, f. 1.

Pas atentatit që iu bë A. Zogut në Vjenë, lakenjtë e regjimit për t'i ngritur moralin dhe për t'i bërë servilizma, nuk i kursyen ditirambet e lavdërimet. Në korin e lavdëruesve dëgjohej në mënyrë të veçantë zëri i Faik Konicës, i cili nga kontinenti tjetër arrinte në Shqipëri dhe bashkohej me zërat e tjerë. Faik Konica profetizoi se Shqipërinë mund ta kishte gjetur një fund apokaliptik sikur të kishte pësuar gjë mbreti në Vjenë[22].

Por populli shqiptar në këtë kohë mendonte ndryshe nga Konica. Ai dëshironte dhe luftonte që të shpëtonte nga ky tiran anadollak, nga ky Kaligulë, si dhe nga klasat çilfigaro-borgjeze që ishin mbështetja e tij.

Ideologët zogistë, krahas përpjekjeve për të zbukuruar monarkinë, u munduan të përligjin edhe institutet e tjera politike ekzistuese. Në këto institute, si: qeveria, parlamenti dhe administra zogiste, klasat çilfigare-borgjeze kishin pozita zotëruese. Shumë elementë nga radhët e tyre e gjetën më të leverdishëm sigurimin e të ardhurave nga postet shtetërore sesa nga pronat. Besaxhinjtë që përbënin aristokracinë e plutokracinë reaksionare kishin monopolin e pushtetit politik. Këta u përpoqën jo vetëm të ruajnë e të forcojnë pozitat me këtë pushtet, por edhe t'u krijojnë aureolë instituteve politike zogiste.

«Besaxhinjtë» ose «të vjetrit» siç u quajtën nga grupi borgjez i «të rinjve» që doli në skenë në këtë kohë, e mbrojtën regjimin në mënyrë tërësore. Ato mbrojtën si monarkinë, ashtu edhe institutet e tjera ndryshe nga «të rinjtë», të cilët kryesisht për demagogji e synime karrieriste lavdëruan monarkinë dhe kritikuan ashpër qeverinë e parlamentin para vitit 1935. Siç dihet, në vitin 1935, pas kryengritjes së Fierit, A. Zogu solli në fuqi qeverinë e ashtuquajtur liberale të Mehdi Frashërit, e cila premtoi reforma dhe liri, por prej tyre fare pak gjëra vuri në jetë. Kjo u bë për të fashitur pakënaqësinë e zemërimin popullor. Me këtë rast grupi i «të rinjve» që e kishte filluar luftën më parë, iu kundërvu «të vjetërve» dhe mori anën e qeverisë së re. Këtë do ta shpjegojmë me hollësi në një kapitull tjetër.

A. Zogut i interesoi në këtë moment një luftë e tillë ideologjike që krijonte përshtypjen e jashtme se në Shqipëri gjoja kishte liri mendimi.

«Të rinjtë», duke marrë anën e qeverisë së re e të monarkisë, kritikuan qeveritë e vjetra e parlamentin e përparshëm, si dhe në përgjithësi «të vjetrit», duke i quajtur ata si një aristokraci reaksionare orientale që kishte penguar zhvillimin e përparimin e vendit. Kjo i revoltoi «të vjetrit»

22) «Dielli», 24 shkurt 1931, f. 2.

të cilët akuzave të «të rinjve» iu përgjigjën me ashpërsi. Ata mbrojtën me zjarr tezën se të gjitha qeveritë çifligaro-borgjeze të përparshme përbëheshin nga persona me ideale kombëtare e përparimtare. Të tillë konsideroheshin edhe deputetët zogistë[23]. Këta ishin gjoja atdhetarë të kulluar që kishin punuar e sakrifikuar për Shqipërinë. Kjo u jepte të drejtë atyre të vetëquheshin «baballarë të kombit». Ata e kundërshtuan mendimin se qeveritë që ishin përpara qeverisë liberale të Mehdi Frashërit ishin qeveri tiranike. Gjatë periudhës zogiste pretendohej se asnjëherë vendi nuk ishte sunduar prej tiranëve. Politika e qeverisë, pohonin «besaxhinjtë», nuk duhej të vlerësohej sipas pikëpamjes vulgare e të ngushtë popullore që e gjykonte atë nga pozita e interesave materiale dhe që e ngarkonte me përgjegjësi për vuajtjet e popullit[24]. Populli gjoja nuk ishte në gjendje të kuptonte misionin e madh të saj dhe e kufizonte atë në «mbledhjen e taksave» dhe «sigurimin e rrogave të nëpunësve». «Është e vërtetë», thoshte Faik Konica, se në Shqipëri «kemi një guvernë» së cilës i mungojnë shumë gjëra, por këto mungesa i detyrohen jo aq formës monarkike sesa karakterit të popullit, i cili sipas tij kishte humbur vetitë e mira dhe «nuk kishte shkëndija idealizmi në shpirt»[25]

Në bazë të këtij arsyetimi sofistik që mbështetej më tepër në metodën introspektive të konstatimit të shterpësisë vetjake të idealeve dhe që këtë gjendje e projektonte tek të tjerët, popullit i atribuohej faji e përgjegjësia e sundimtarëve.

Në këtë mënyrë shkarkohej përgjegjësia e regjimit të bejlerëve dhe zbukurohej politika antikombëtare e tij.

Apologjetët zogistë e pranonin si gjë krejt normale dhunën e egër policore dhe mungesën e plotë të lirive demokratike. Kjo konsiderohej e domosdoshme për mbylljen e plagëve të dikurshme të luftës politike të «opozitës». Në Shqipërinë zogiste, sipas këtij arsyetimi, nuk duhej të ekzistonin parti, grupe politike e dukuri negative të luftës politike aq të përhapura në vendet e tjera. Ata hodhën poshtë pohimin e «të rinjve» se «të vjetrit» kishin siguruar në mënyrë të padrejtë monopolin e sundimit dhe duhej të hiqnin dorë nga ky sundim. Këtë sundim e konsideronin krejt normal e të merituar si «baballarë» të kombit që ishin e që kishin punuar kinse për Shqipërinë. Nuk pajtoheshin as me pikëpamjen e «të rinjve» se «oksidentalizimi» i vendit filloi kryesisht nga «të rinjtë» me ardhjen në fuqi të qeverisë së

23) «Besa», 28 mars 1935, f. 2; po aty 28 janar 1936, f. 1.
24) Po aty, 26 nëntor 1935, f. 2.
25) «Dielli», 22 gusht 1938.

Mehdi Frashërit. Ky «oksidentalizim» për mendimin e tyre, kishte filluar që kur u krijua regjimi zogist. Dhe merita për këtë thuhej se u takonte kryesisht atyre. Ç'kuptohej në të vërtetë me oksidentalizimin që në këtë periudhë u trumbetua aq shumë? Me këtë kuptohej zhvillimi borgjez, apo më mirë një mënyrë jetese e klasave të larta sipas modelit të vendeve perëndimore. Borgjezia shqiptare në këtë periudhë kishte bërë disa përparime në fushën ekonomike e të tjera, por ajo në përgjithësi ishte e dobët. Ajo kishte si objektiv zhvillimin kapitalist perëndimor, qytetërimin perëndimor. Por në të njejtën kohë e kishte frikë zhvillimin e shpejtë kapitalist me të gjitha dukuritë negative të tij, sidomos me luftën e ashpër klasore. Më mirë do të parapëlqente një zhvillim të ngadalshëm e të përmbajtur. Intelektualët borgjezë, shprehës të interesave të kësaj borgjezie, e kuptuan oksidentalizimin më tepër si një mënyrë të re borgjeze të jetesës e si një stil të ri të veprimtarisë më përparimtar nga ai ekzistues që cilësohej si oriental (feudal) e që përfaqësonte një jetë të mefshtë por ata nuk ishin për ndryshime thelbësore, prandaj «oksidentalizimi» i tyre u katandis thjesht në një modë perëndimore. Ky «oksidentalizim» u kuptua kryesisht si një lustër perëndimore që duhej t'u jepej kateve të larta të ndërtesës shoqërore e shtetërore. Natyrisht, me oksidentalizëm kuptohej edhe një farë ripërtëritje e aparatit shtetëror dhe e administratës, duke u bërë vend këtu më shumë, elementëve borgjezë me kulturë, si dhe një farë përhapjeje e kulturës perëndimore në vend.

Parullën e oksidentalizmit e përdorën edhe ideologët zogistë për demagogji duke dashur t'ia paraqitnin popullit regjimin zogist si regjim përparimtar.

Thelbi reaksionar i ideologjisë zogiste u shfaq sidomos në përligjien e shtypjes ekonomike dhe në mohimin e të drejtave dhe lirive demokratike të popullit. Populli konsiderohej prej saj si një turmë injorante e egër, pa ideale politike e shoqërore, e papjekur dhe e padenjë për të gëzuar të drejtat politike e qytetare. Sovraniteti popullor konsiderohej i parakohshëm dhe i papranueshëm për një popull gjoja të paformuar e me nivel të ulët kulturor.

«Sovraniteti buron në të vërtetë nga populli — shkruhej në «Besa» — por me konditë që populli të ndjejë në shpirtin e tij këtë fuqi supreme. Një popull që nuk e din dhe nuk e ndjen fuqinë e tij, nuk ka ide se ç'do me thënë sovraniteti buron nga populli dhe nuk e çmon fuqinë e vet. Grada e qytetërimit të një populli varet nga grada e rëndësisë që i jep fuqisë të tij ai popull»[26].

26) «Besa», 26 gusht 1935, f. 1.

Kjo ide e mohimit të vetëdijes politike e shoqërore të popullit e përsëritur nga shumë ideologë reaksionarë gjatë historisë, synonte të përligjte sundimin e klasave të pasura mbi popullin. Sipas kësaj logjike populli i papjekur politikisht nuk mund të vendoste për fatet e veta dhe nuk mund të qeveriste. Ai duhej të qeverisej e të sundohej prej të tjerëve. Populli trajtohej si një fëmijë i përjetshëm që kishte nevojë gjithnjë për tutorinë e klasave të larta, sepse pa këtë tutori ai mund të bënte hapa të gabuara. Dhe, çka ishte më paradoksale, këtu arrihej të bëhej një pohim i tillë se ky popull pavetëdije, gjoja me ndërgjegje e kishte jetërsuar sovranitetin e vet duke ia kaluar atë monarkisë që ta ushtronte në favor të tij.

Edhe shtypja e kryengritjes së Fierit nga qeveria e A. Zogut sipas logjikës kazuistike të ideologëve zogistë, ishte një shprehje e sovranitetit popullor[27]. Populli në këtë rast lejoi gjoja të shtypej lëvizja e tij demokratike gjithnjë për të mirën e vet. Kështu arsyetonin apologjetët e diktaturës. Nga përshkrimet e tyre dhe ngjyra trëndafil me të cilën zbukurohej diktatura, krijohej përshtypja se populli jetonte mirë nën diktaturën, se ai nuk e ndiente trysninë e saj më shumë se sa trysninë e ajrit. Por kur kjo logjikë ngecte në lëvizjet antizogiste që dështmonin të kundërtën, atëhere kërkohej të dilej nga situata me pohimin aspak bindës se këtu kishin gisht intrigat dhe elementët shkatërrimtarë. Gazeta «Vatra», duke polemizuar në gazetën «Arbëria», kërkoi që të mos përdorej emri diktaturë, sepse gjoja nuk ekzistonte diktatura në Shqipëri. Ideologëve të «Vatrës» e të tjerëve u pëlqenin eufemizmat. Ata kishin prirje që gjërat e shëmtuara t'i quanin me emra të bukur.

2. NACIONALIZMI BORGJEZ PËRBALLË LUFTËS SË KLASAVE

Klasat sunduese ishin të interesuara në këtë periudhë të krijonin krahas kultit monarkik edhe kultin nacionalist borgjez të bashkimit kombëtar të të gjithë popullit që duhej t'i kundërvihej luftës së klasave. Përpunimi i ideologjisë së nacionalizmit borgjezë filloi që gjatë luftës për pavarësi, por në atë kohë ai kishte përmbajtje përparimtare patriotike dhe parulla e bashkimit për luftën kundër të huajve ishte e drejtë. Në periudhën pas pavarësisë sidomos gjatë regjimit zogist, kjo parullë fitoi një përmbajtje reaksionare. Ajo ishte

27) «Besa», 26 gusht 1935, f. 1.

një kurth kundër popullit, një mjet për sabotimin e luftës. së tij revolucionare. Ideologët reaksionarë e paraqitën nacionalizmin borgjez si patriotizëm në mënyrë që të pranohej e të përqafohej nga i gjithë populli. Thelbi i nacionalizmit borgjez është pajtimi i interesave klasore, bashkëpunimi klasor. Klasat sunduese dhe ideologët e tyre i bënë thirrje të shpeshta popullit në këtë kohë që të mos shikonte interesat «materiale» e vetjake, por interesat e përgjithshme të atdheut dhe për sigurimin e tyre të bashkëpunonte me to. Në fakt ato që i morën nëpër këmbë interesat e atdheut për qëllimet e tyre egoiste, ishin pikërisht këto klasa.

Klasat e pasura shpresuan se pas stabilizimit pak a shumë të pozitës politike të Shqipërisë në arenën ndërkombëtare, mund të arrihej të stabilizohej edhe situata shoqërore dhe të vendosej një paqe e qëndrueshme klasore. Mendohej se po të kultivohej në popull nacionalizmi borgjez, gjithçka do të shkonte mbarë. Por, puna nuk ishte kaq e thjeshtë, sepse kushtet kishin ndryshuar dhe lufta klasore ishte në rritje. Antagonizmi shoqëror po merrte përmasa gjithnjë më të më dha. Dëshira për sigurimin e qëndrueshmërisë në mënyrë që të forcohej shfrytëzimi dhe sundimi politik, merrej për realitet. Nacionalizmi borgjez, ashtu si edhe forca e pushtetit politik mbivlerësoheshin. Dukuritë e luftës klasore dhe faktorët ekonomikë e shoqërorë nënvleftësoheshin. Kjo vinte edhe nga pikëpamja idealiste që rolin primar ia atribuonte ideve, faktorëve shpirtërorë dhe që krijonte iluzionin se të gjitha situatat mund të ndryshoheshin me anë të ideve. Lufta e klasave konsiderohej si diçka sporadike e pa bazë për kushtet e Shqipërisë. Gjendja dhe zhvillimi gjykoheshin nga pikëpamja e romanticizmit reaksionar dhe besohej se mund të kthehej përsëri koha e përparshme e të rikrijohej bashkimi i dikurshëm.

Ideologët zogistë e konsideruan «paqen e brendshme» dhe «paqen ndërkombëtare», si «konditë të parë për t'iu përveshur punës» për të përmbushur interesat e klasave në fuqi[28].

Bashkimi kombëtar, herë paraqitej si diçka e arritur, herë si një aspiratë për t'u përmbushur. Në rastin e parë kemi të bëjmë me një iluzion optik, me një mirazh. Por më shumë ishte mendimi se duheshin shumë përpjekje për t'u arritur. Ndeshja me realitetin dhe konstatimi i kundërthënieve të ashpra linin pak vend për eufori. U përmendën një sërë «argumentesh» e arsyesh për mundësinë e sigurimit të bashkimit kombëtar.

Faktori kryesor që bënte të mundur përmbushjen e tij

28) «Drita», 29 gusht 1937, f. 2.

ishte gjoja ekzistenca e interesave të përbashkëta të të gjitha klasave, përqëndrimi i tyre në fokusin e atdheut.

Mbi interesat e veçanta të klasave, grupeve dhe individëve duhej të qëndronin interesat e larta të atdheut. U tha se parulla e çdo shqiptari duhej të ishte «Atdheu mbi të gjitha»[29].

Në shtetin nacionalist të gjithë njerëzit ishin njësoj pavarësisht nga prejardhja shoqërore. Ata ishin gjoja nënshtetas me të drejta të barabarta dhe asnjë klasë nuk kishte të drejtë të ushtronte diktaturën mbi të tjerat[30].

Kështu ishte me fjalë, por në realitet ishte krejt ndryshe. Në mënyrë demagogjike pohohej se nga shkalla e përqendrimit dhe bashkërenditjes së interesave e veprimeve varej edhe «lumturia e njerëzve». Ky përqendrim gjoja gjente shprehjen më të lartë në shtetin, i cili sipas kësaj pikëpamjeje qëndronte mbi klasat dhe shprehte interesat e të gjithëve[31].

Pamjen e jashtme të shtetit si një institut më vete, gjoja në rolin e arbitrit të drejtë e kanë shfrytëzuar gjithnjë klasat sunduese. Edhe regjimet më tiranike i kanë paraqitur mizoritë e kryera kundër popullit si akte të drejtësisë, për hir të së mirës së përgjithshme.

Bashkimi kombëtar duhej të mbështetej jo vetëm në interesat e përbashkëta, por edhe në kulturën dhe ideologjinë e përbashkët[32]. Demagogjia nacionaliste kishte akoma më shumë sukses kur përdorte kulturën si mjet të bashkimit. Njerëzit e kishin më lehtë të dallonin kundërthëniet ekonomiko-shoqërore dhe mungesën e unitetit të interesave, por e kishin më të vështirë të dallonin ndryshimet në sferën e kulturës. Kultura dhe traditat u dukeshin si të përbashkëta për të gjitha klasat. Ideologët zogistë për çështjen e bashkimit iu referuan edhe traditave të së kaluarës. Me këto tradita kanë spekuluar shumë rryma reaksionare në Shqipëri. Vetë mbreti iu drejtua popullit me rastin e 25-vjetorit të pavarësisë: «Mos harro se zbresim prej ilirëve, prej një race kreshnike, e cila ka lënë gjurmë të pashlyera në histori»[33]. Në këtë mesazh shprehej demagogjia nacionaliste dhe hipokrizia e tij. Vetëm kur vishej me rolin e demagogut, mbreti kujtohej për prejardhjen ilire, por jo kur bënte pazarllëqe në dëm të kombit. Në festat kombëtare, euforia e traditave dhe e patriotizmit fryhej në maksimum, dilte jashtë brigjeve.

29) «Gazeta e Korçës», 28 nëntor 1937, f. 2.
30) «Java», 4 prill 1937, f. 3.
31) Po aty.
32) «Gazeta e Korçës», 28 nëntor 1937, f. 2.
33) Po aty.

Por, kjo nuk arriti ta mashtronte popullin, të cilin gjendja e rëndë dhe politike antipopullore e antikombëtare e klasave reaksionare e bënte esëll.

Faktorët e bashkimit kombëtar mendohej se ishin të «shumtë»: gjuha e përbashkët, zakonet e përbashkëta, qytetërimi i përbashkët si dhe ideali i përbashkët i mbështetur mbi një ideologji të vetme[34].

Kjo ideologji e vetme që duhej të siguronte bashkimin, ishte ideologjia zogiste.

Në këto rrethana kur ekzistonin gjoja mjaft gjëra të përbashkëta, kundërthëniet klasore dhe lufta klasore nuk duhej të ekzistonin. Ideologët zogistë nuk e mohonin ekzistencën e klasave në Shqipëri, por mendonin se ndarja në klasa nuk ishte e asaj natyre siç e paraqisnin revolucionarët. Kjo ndarje gjoja nuk kishte karakter shoqëror, por bazohej mbi zhvillimin natyror. Klasat ishin më tepër disa kategori shoqërore që rridhnin nga diferencimi i aftësive natyrore të njerëzve. Ato përbëheshin nga «punëtorët» dhe «dembelët», «të aftët» dhe të «të paaftët»[35]. Sipas kësaj skeme në kategorinë e «punëtorëve» dhe «të aftëve» hynin shfrytëzuesit, të cilët gjoja çdo gjë e kishin fituar me zotësi dhe punë. Të tjerët grupoheshin në kategorinë e dytë. Klasa të tilla duhej të ekzistonin përjetësisht. Kundrejt një pabarazie të tillë që ishte krijuar prej vetë natyrës, askush nuk kishte të drejtë të revoltohej. Ky ishte një shtrembërim i hapur i realitetit, një përmbysje e plotë e vlerave duke vënë në krye të hierarkisë së tyre shfrytëzimin, të cilit i ishte dhënë emri punë, aftësi.

Ky status social nuk ishte statik dhe i ngurtësuar. Ai karakterizohej nga mobiliteti (lëvizshmëria) që donte të thoshte se në klasën e «të aftëve» dhe «punëtorëve» hynin gjithnjë elementë të rinj. Kushdo që fitonte aftësi e zotësi kishte mundësi të pasurohej.

Pabarazia në këtë rrafsh e forconte mobilitetin nga poshtë lart. Një gjë e tillë nuk favorizonte gjoja përçarjen dhe luftën e klasave. Megjithatë, rreziku i lindjes së rrymave ekstremiste e anarqike nuk përjashtohej. Ky rridhte kinse ngaqë vendi gjeografikisht ishte i ekspozuar ndaj ndikimeve të huaja. Këto ndikime gjenin terren në popull e sidomos në rininë, të cilët për arsye të ndërgjegjes kombëtare të paformuar përqafonin idetë e huaja. Pra, sipas kësaj logjike, lufta e klasave dhe lëvizjet revolucionare gjoja nxiteshin nga idetë e «importuara nga jashtë»[36]. Ky ishte

34) Po aty, 7 gusht 1937, f. 2.
35) «Djersa e popullit», 25 nëntor 1934, f. 1.
36) «Drita», 4 shkurt 1937, f. 2.

një iluzion optik që e shtrembëronte realitetin. Më tej arsyetohej se Shqipëria si një «vend i vogël dhe i vobegtë», nuk pajtohej me luftën e klasave, duke mos u marrë parasysh ai fakti që varfëria dhe pasuria janë pole me ngarkesë të kundërt, ose bazë e antagonizmit shoqëror[37].

Motivet e luftës së brendshme shoqërore e të lëvizjeve kërkoheshin në ambiciet e ngatërresat e individëve të veçantë. E gjithë lufta për demokracinë paraqitej si një lodër e pasioneve individuale[38]. Në këtë frymë u shpjeguan edhe lëvizjet antizogiste si ajo e Fierit e të tjera.

Përpara se të shpërthente kryengritja e Fierit, iu bë thirrje popullit që të mos lejohej të përsëriteshin kryengritjet e viteve 1914 dhe 1924 dhe «të luhej» me «fatin e atdheut». U tha se Shqipëria si një shtet i ri kishte nevojë për «stabilitet politik e qetësi shembullore»[39]. Gjithnjë, interesi egoist klasor paraqitej si interes i përgjithshëm. Thirrja në mënyrë të veçantë iu drejtua intelektualëve, të cilët thuhej se ishin «të përçarë» dhe «nuk kishin prirje për bashkëveprim»[40]. Pjesa më e mirë e intelektualëve u hodh në lëvizjen revolucionare dhe kjo e shqetësonte regjimin. Intelektualët kishin në dorë një armë të fuqishme, atë të ndikimit me idetë e tyre në popullin. Edhe ministri i Arsimit Faik Shatku iu drejtua rinisë shkollore, kësaj rinie të zjarrtë që kishte përqafuar idetë përparimtare e komuniste siç vërteton gjerësisht dokumentacioni i kohës dhe ishte hedhur në luftë kundër regjimit, që t'i braktiste këto ide dhe të bashkëpunonte me regjimin.

Kur populli shpërtheu në greva e demonstrata që udhëhiqeshin nga komunistët, të cilat e tronditën regjimin e dëshmuan për kalbëzimin e tij, nga ana e ideologjisë zogiste pati një valë të shfrenuar, histerike të propagandës antikomuniste.

Demonstrata e Bukës në Korçë e 26 shkurtit 1936, ky manifestim i shquar politik nën udhëheqjen e komunistëve, që ngriti gjithë popullin e qytetit në luftën kundër regjimit, u prit me zemërim dhe urrejtje nga reaksioni. «Besaxhinjtë» e pasuesit e tyre u ngritën me tërbim kundër saj.

Në një kryeartikull të gazetës «Besa» shkruhej: «Protestojmë rreptësisht kundra këtyre demonstratave dhe manifestimeve që prishin atë qetësi shembullore, që ka mbretëruar prej vitesh në vendin tonë. Dëshirat popullore duhet

37) Po aty, 30 dhjetor 1936.
38) «Gazeta e Korçës», 25 maj 1937.
39) «Besa», 14 shkurt 1935, f. 1.
40) Po aty.

të shprehen paqësisht me anë të rrugës ligjore...»[41]. Kjo protestë u botua 3 ditë pas demonstratës.

«Besaxhinjtë» ishin të mendimit se shkaktarët kryesorë të saj ishin komunistët[42]. Ata i shqetësoi më shumë fakti se kjo mund të shërbente si një shkëndijë për shpërthime më të mëdha dhe se demonstrata të tilla mund të «bëheshin modë» në Shqipëri. Me këtë rast këtu u cilësuan fajtorë për prishjen e unitetit edhe «të rinjtë» me qeverinë «liberale» të M. Frashërit, të cilët me anë të polemikës që zhvilluan dhe të predikimeve «liberale», nxitën gjoja elementët revolucionarë të hidheshin në luftë të hapur. Ata kërkuan nga qeveria zogiste që t'u jepte fund veprimeve të tilla. Në të vërtetë idetë liberale të M. Frashërit me shokë synuan në mashtrimin e popullit dhe dobësimin e luftës së tij. Prandaj dhe A. Zogu e lejoi një polemikë të tillë.

«Besa» bënte thirrje që të vendosej terrori i egër policor dhe të zhdukej çdo prirje centrifugale.

Sidomos ajo këmbëngulte që të merreshin masa drakoniane kundër rrezikut komunist, të cilin e konsideronte jo të vogël. Këto duhej të shërbenin edhe si një farë parandalimi. Ajo ishte e mendimit se Qeveria, ngjarjet e Korçës nuk duhej t'i merrte si një episod të veçantë, por duhej të kërkonte rrënjët e thella të tyre dhe të merrte masat e duhura që manifestime të tilla të mos shpinin në një kryengritje revolucionare[43].

Krahas kësaj kërkohej që t'i jepej fund polemikës në shtyp, për arsye se «anarshia e gazetave» lindi rebelizmat e studentëve në Shkodër, Berat dhe në Korçë»[44]. Përveç tonit të ashpër, «Besa» përdori dhe demagogjinë. Prej saj shprehej habia se si studentët e Liceut të Korçës «simbol i nacionalizmës» shkuan e u bashkuan me punëtorët me të cilët nuk i lidhte asgjë[45]. Por studentët e Liceut ishin jo vetëm patriotë të vendit të tyre, por edhe revolucionarë që te punëtorët gjetën shokët e të njëjtit ideal në luftën kundër regjimit.

Zhurma antikomuniste dhe denigrimi i ideve dhe lëvizjeve revolucionare mori përpjesëtime të rëndësishme. Në këtë fushatë të tërbuar mori pjesë dhe gazeta «Dielli» e Faik Konicës. Faik Konica, ky përfaqësues i bejlerëve, mbrojtës i oxhakëve, armik i betuar i vegjëlisë (harbutëve), kishte alergji ndaj ideve e lëvizjeve përparimtare. Ai nuk mund ta duronte tronditjen sado pak të rendit çifligaro-

41) «Besa), 24 shkurt 1936, f. 1.
42) Po aty, 25 shkurt 1936, f. 1.
43) Po aty, 28 shkurt 1936, f. 1.
44) Po aty, 21 shkurt 1936, f. 1.
45) Po aty.

-borgjez, prishjen e qetësisë së «baballarëve të kombit»[46]. Faiku trumbetoi në organin e tij se kryengritjet ishin «shkatërrimi i Shqipërisë». Për të nuk kishte Shqipëri tjetër veç asaj të bejlerëve. Prandaj edhe shkatërrimi i bejlerëve njësohej me prishjen e Shqipërisë. Ishte një bej që hiqej si i qytetëruar, por që e urrente përparimin dhe sytë i mbante gjithnjë prapa, në mesjetë.

Në shtypin zogist qarkulluan gjithfarë shpifjesh kundër komunizmit të kopjuara nga propaganda e huaj borgjeze.

Ideologët zogistë herë u përpoqën t'ia bënin popullit atë gogol, herë e paraqitën si një krijesë artificiale që nuk i kishte rrënjët në vend dhe që ishte sjellë nga jashtë.

Ideologjia komuniste në përgjithësi cilësohej si një «utopi» që nuk mund të vihej në jetë, sepse vinte kinse në kundërshtim me natyrën njerëzore «nuk njihte lirinë vetjake, pasurinë e fituar me të drejtë»[47].

Në rendin shfrytëzues, sidomos atë borgjez, liria e shfrytëzimit ishte njësuar me atë të individit, dhe pasuria e krijuar me anë të shfrytëzimit e grabitjes paraqitej si pasuri e fituar me djersë. Ideologët reaksionarë kanë dashur të trembin me komunizmin jo vetëm pronarët e mëdhenj, por edhe masën e madhe të pronarëve të vegjël e të mesëm. Ata kanë dashur të fshehin të vërtetën që komunizmi është kundër pronës të mbështetur në shfrytëzim dhe jo kundër çdo prone. Në të njëjtën kohë janë munduar të fshehin edhe faktin që në rendin borgjez apo çifligaro-borgjez janë pronarët e mëdhenj, klasat e pasura, ato që u kanosen pronarëve të vegjël dhe i bëjnë të rrokullisen në varfëri e në mjerim.

Në pohimin e mësipërm nuk mungonte as koncepti se ideali komunist vinte në kundërshtim gjoja me natyrën njerëzore, e cila falsifikohej prej tyre dhe paraqitej si «homo economicus» borgjez.

Këtu u përhap edhe ideja se komunizmi nuk kishte truall në Shqipëri, për arsye se mungonte gjoja «proletariati industrial» dhe «kapitalistët e vërtetë», mungonin papunësia dhe «grindja midis kapitalit dhe punës»[48]. Punëtoria shqiptare, thuhej se nuk kishte probleme shqetësuese dhe me krijimin e zyrës së punës shfrytëzimi në Shqipëri do të zhdukej[49] (si në botën e përrallave). Ky është një version i njohur që ka qarkulluar mjaft në Perëndim midis ideologëve borgjezë e reformistë. Atje thuhej se gjoja lufta re-

46) «Dielli», 24 mars 1931.
47) «Drita», 25 dhjetor 1936, f. 1.
48) «Java», 18 prill 1938, f. 3.
49) Po aty.

volucionare është dukuri e vendeve të zhvilluara. Këtë e përvetësuan edhe ideologët tanë reaksionarë si dhe trockistët e arqeomarksistët. Në këtë pikëpamje shprehej iluzioni i këndshëm për reaksionarët se Shqipëria gjoja si një vend pronarësh (kryesisht të vegjël) par excellence dhe pa klasat moderne dhe antagonizmin modern, do të shpëtonte gjoja edhe prej dukurive të dëmshme që lidheshin me to.

Kjo ishte edhe një farë miopie, sepse këto dukuri nuk mungonin aspak dhe ishin të pranishme në vendin tonë.

Ideologët zogistë edhe pse u mohonin ideve komuniste bazën shoqërore, prap nuk përjashtonin mundësinë e përhapjes së tyre. Ato konsideroheshin të rrezikshme, sepse shfrytëzonin pakënaqësinë e «të mërziturve».

Në kuadrin e luftës kundër ideve dhe lëvizjes komuniste në Shqipëri, përfshihej edhe fushata e shpifjeve kundër komunizmit ndërkombëtar dhe vendit të parë socialist, Bashkimit Sovjetik.

Në shtypin zogist u botuan gjithfarë trillimesh e falsifikimesh të marra nga shtypi i huaj ku shtrembërohej realiteti i Bashkimit Sovjetik. Këto paraqiteshin si tregime të vërteta të njerëzve që gjoja sapo ishin kthyer nga Rusia Sovjetike.

Në shtypin zogist u hodh baltë edhe mbi luftën heroike antifashiste të popullit spanjoll dhe u mbrojtën forcat fashiste të gjeneralit Franko që në bashkëpunim me fashistët italianë e nazistët gjermanë iu vërsulën Spanjës republikane. Në ndonjë organ u shpreh gjithashtu kënaqësia që në Greqinë fqinje po merreshin një sërë masash për të likuiduar turbullirat komuniste, të cilat mund të shpinin në luftën qytetare[50].

Propagandën antikomuniste e nxiti jo vetëm regjimi satrap i A. Zogut, por edhe qeveria fashiste e Musolinit me anë të agjentëve të saj, të cilët e subvencionuan një pjesë të mirë të këtij shtypi.

3. LAVDËRIMI I ALEANCËS ITALO-SHQIPTARE DHE I FASHIZMIT ITALIAN.

Politika antikombëtare e qeverisë zogiste, kapitullimi i saj para imperializmit italian, u shprehën në sferën ideologjike në fushatën e gjerë propagandistike në të mirë të aleancës italo-shqiptare dhe regjimit fashist të Musolinit.

Kjo propagandë e tregoi regjimin zogist si një regjim

50 «Cirka», 16 gusht 1936, f. 115.

servil pa sedër kombëtare, si një regjim që mbahej në këmbë me lëmoshat e Italisë fashiste. Një propagandë të tillë ishte detyruar ta zhvillonte jo vetëm shtypi zyrtar, por edhe organet e tjera.

Propaganda në të mirë të fashizmit ndiqte para së gjithash qëllime të caktuara pragmatiste. Ajo donte të rriste kredinë e klikës zogiste tek Qeveria e Romës, në mënyrë që të merrte sa më shumë ndihma prej saj. Nga ana tjetër, me anë të saj kërkohej të kënaqeshin e të qetësoheshin disa qarqe reaksionare profashiste, si kleri katolik e të tjerë, gjithashtu të kundërpeshoheshin idetë përparimtare e revolucionare.

Kjo propagandë për vite me radhë ndihmoi në futjen e ideologjisë fashiste në Shqipëri dhe favorizoi agresionin ideologjik dhe ushtarak imperialist.

Përhapja e këtyre ideve ishte rezultat jo vetëm i çoroditjes së klasave sunduese në përgjithësi, por edhe i subvencionimit të organeve zogiste të shtypit nga organet zyrtare italiane si legata italiane, «Banka Kombëtare» dhe shoqëritë e ndryshme koncesionare[51]. Subvencionet u jepeshin gazetave me kusht që të shkruanin mirë për Italinë dhe të lavdëronin politikën e saj.

Regjimi zogist ndoqi politikën e «dyerve të hapura» si në rrafshin ekonomik e politik, ashtu edhe në atë ideologjik e kulturor.

Ideologët zogistë nga njera anë zhvilluan gjithë zhurmë propagandën nacionaliste dhe u paraqitën si mbrojtës të kombit (natyrisht duke e njësuar kombin me regjimin), nga ana tjetër e mbushën shtypin me elozhe e lavdërime për Italinë fashiste. Kalemxhinjtë e regjimit e kishin bërë si traditë sidomos në përvjetorët e traktateve italo-shqiptare t'i digjnin temjan aleancës me Italinë dhe t'i thurnin ditirambe.

Në kundërshtim të hapur me realitetin historik dhe në mënyrë groteske, «miqësia» italo-shqiptare mbahej si faktor themelor i zhvillimit të vendit dhe i sigurimit të pavarësisë. Kjo thuhej në një kohë kur depërtimi imperialist në Shqipëri po e shpinte vendin drejt katastrofës dhe humbjes së plotë të pavarësisë ekonomike e politike.

Në një konferencë që mbajti më 3 nëntor të vitit 1929, në klubin italian të Tiranës, Mehdi Frashëri, për të qetësuar opinionin publik që ishte tepër i pakënaqur nga politika imperialiste italiane kundrejt Shqipërisë, deklaroi se aleanca italo-shqiptare jo vetëm që nuk paraqiste asnjë rrezik për

51) I. Fishta. *Shtypi shqiptar dhe roli i tij gjatë regjimit të A. Zogut*, në: «Buletini Shkencor i Institutit të Lartë Pedagogjik të Shkodrës», 1971, nr. 1.

vendin, por përbënte garanci për pavarësinë e tij[52]. Kjo ishte si përgjigje ndaj opinioneve që qarkullonin në popull dhe në ndonjë rast edhe në shtypin borgjez se aleanca me Italinë po bëhej gjithnjë e më e padurueshme.

Kreut të fashizmit, Musolinit, iu atribuan qëllimet më të mira ndaj Shqipërisë dhe thuhej se me ardhjen e tij në fuqi, Italia zhvilloi një politikë të re ndaj vendit, politikën e respektimit dhe forcimit të sovranitetit kombëtar. Ky pohim ishte kopjuar nga shtypi italian, i cili politikën imperialiste të qeverisë së Musolinit mundohej ta zbukuronte.

«Dielli», megafoni i klikës zogiste dhe i qeverisë fashiste u vu në mbrojtje të politikës fashiste. Faik Konica shkruante se Musolini donte «ta shihte Shqipërinë të fortë e të përparuar»[52/1].

«Për ne shqiptarët, — shkruante ai në përvjetorin e marshimit mbi Romën, duke i bërë servilizma kreut të fashizmit, — Musolini është njeriu që u dha shkelmin dinakërive dhe vogëlsirave të një Giolitti ose të një Nitti dhe shtiri themelet e një politike të ndershme, të hapët, të lartë, e cila për të parën herë që nga vdekja e Skënderbeut e përfilli kombin shqiptar si komb, i bën vend në tryezën e popujve të qytetëruar dhe i siguron jo vetëm të marrët frymë, por edhe të nderuarit»[53].

Falsifikimi nën penën e Konicës, siç shihet, merrte përmasa jo të zakonshme. Ai ishte në gjendje që të zezën sterrë ta bënte krejt të bardhë. Ishte nga ata që gjithçka mund të shkruante në favor të atyre që e paguanin dhe që faktet i përdorte si plastelinë. Natyrisht, si Konica në mërgim pati edhe të tjerë që lavdëruan fashizmin. Lavdërimi i marrëdhënieve italo-shqiptare dhe i politikës së fashizmit nuk u ndërpre as në periudhën e tensionit dhe të krizës së tyre (1932-1934). Natyrisht, Qeveria zogiste në këtë periudhë lejoi të shkruhej edhe ndonjë kritikë në adresë të Italisë, me qëllim që të bëhej presion mbi «aleaten e madhe» që ta zgjidhte më shumë kuletën dhe ta lironte disi lakun që i kishte hedhur në qafë klikës në fuqi. Por edhe në këto rrethana e në këtë lodër të keqe, u bënë përpjekje që të krijohej së jashtmi përshtypja e mirë, duke ngritur e lavdëruar gjithnjë sipas traditës «miqësinë e madhe». Në këtë rast zhurma propagandistike synonte të maskonte dredhitë e klikës zogiste dhe gjendjen e rëndë të saj.

Në këto vite tendosjeje të marrëdhënieve, gazeta «Besa» shkruante si për ironi se aleanca e miqësia midis Italisë e

52) «Ora», 8 dhjetor 1929, f. 2.
52/1) «Dielli», 8 korrik 1930, f. 2.
53) Po aty, 28 tetor 1930, f. 2.

Shqipërisë nuk kishte «themele fantastike e misterioze», por të qarta e të shëndosha. Ishte «e vetmja aleancë evropiane e qartë dhe me një kuptim që e dinë gjithë bota»[54], thoshte ajo.

Dhe kjo thuhej në një kohë kur kriza në marrëdhëniet italo-shqiptare i afrohej apogjeut. Pra, ishte një aleancë «e qartë» e ujkut me delen, që rrethohej me mjergullën e dendur të prapaskenave politike dhe të propagandës.

Edhe gazeta «Dielli» pohonte në këtë kohë se ata që zhvillonin propagandë kundër Italisë dhe thoshin se ajo do të pushtonte Shqipërinë, kishin qëllim ta nxisnin popullin për të bërë kryengritje[55]. Faik Konica e kish bërë të tijën metodën e shantazhit, këtë shpikje të vjetër të shtypit anglez. Këtë metodë e përdori në të mirë të regjimit zogist dhe të Italisë.

Disa ditë përpara se Qeveria e Romës të dërgonte luftanijet në Durrës (qershor 1934), për ta detyruar klikën zogiste të kapitullonte, organet e shtypit zogist deklaruan me pompozitet se pa miqësinë me Italinë, Shqipëria do të rrezikohej nga fqinjët ballkanikë. Në fakt A. Zogu në këtë kohë bëri përpjekje të afrohej me fqinjët ballkanikë për t'u çliruar nga presioni italian. Pra, shkruhej e kundërta e asaj që veprohej.

Me kapërcimin e krizës në marrëdhëniet midis dy vendeve dhe përfundimin e marrëveshjeve të marsit 1936 që shënuan kthimin e plotë të Shqipërisë në gjysmëkoloni të Italisë, lavdërimet e miqësisë së «kthjellët» italo-shqiptare vërshuan si lumë.

Në ato ditë kur populli shqiptar dënoi ndërhyrjen e egër imperialiste dhe tradhtinë e klikës zogiste, duke pohuar që kjo e fundit po i humbiste vendit fitoret e arritura në Luftën e Vlorës, gazeta «Besa» pohoi në mënyrë qesharake se Musolini kishte në plan ta bënte Shqipërinë «një kopësht qytetërimi»[56]. Dhe ishte pikërisht «Besa» ajo që në këtë kohë u vërsul kundër masave popullore që u ngritën në demonstrata për të kërkuar të drejtat e tyre dhe i cilësoi ato si anarkike e shkatërrimtare. Pra, sipas «Besës» populli donte ta prishte Shqipërinë, ndërsa Italia ta lulëzonte. Kjo ishte një logjikë absurde e pragmatiste. Me këtë rast në shtyp u përmendën edhe «mosmarrëveshjet e vogla» që lindën përkohësisht midis dy vendeve e që u zhdukën gjoja si ato retë e pakta në qiellin e kthjellët «të miqësisë» pa lënë

54) «Besa», 10 janar 1933, f. 1.
55) «Dielli», 26 maj 1933, f. 1.
56) «Besa», 1936, 9 mars, f. 1.

asnjë gjurmë. Se sa i kthjellët ishte ky qiell «i miqësisë», e dëshmoi më vonë 7 prilli 1939.

Me porosi të A. Zogut, shtypi zogist lavdëroi politikën agresive të imperializmit italian dhe luftërat e tij grabitqare në Abisini e gjetkë. Organet reaksionare mburrën «triumfin e armëve italiane» në Abisini dhe pushtimin imperialist të këtij vendi e cilësuan si një vepër të madhe të gjenisë musoliniane. Klika dritëshkurtër e A. Zogut nuk mori parasysh faktin që një ditë rreziku i agresionit do t'i kanosej edhe Shqipërisë. Ai që tani po trokiste me fuqi në dyert e saj.

Me rastin e ardhjes së Kontit Çiano në Shqipëri për «vizitë» në prill të 1937, si dhe më vonë me rastin e martesës së mbretit Zog, për të shpejtuar agresionin kundër Shqipërisë, gazetat në përgjithësi u vunë në garë kush e kush të lavdëronte, më shumë «miqësinë e përjetëshme». Ato me zhurmën e tyre krijuan një perde tymi për të fshehur makinacionet e pazarllëqet kundër Shqipërisë. Edhe A. Zogu në mesazhin e tij drejtuar popullit me rastin e 25-vjetorit të pavarësisë, thoshte se «vepra e konsolidimit dhe e zhvillimit të shtetit shqiptar gjente në Italinë fashiste mike dhe aleate simpatinë më të madhe dhe pritjen më të sinqertë»[57]. Por, populli e kishte të qartë se në këtë përvjetor, politika antikombëtare e regjimit zogist e kishte afruar Shqipërinë më tepër se kurrë pranë greminës. Pas përfundimit të marrëveshjes së Munihut midis shteteve fashiste e fuqive perëndimore në shtator të 1938, që ishte një thikë në shpinë të Çekosllovakisë, si dhe të popujve të tjerë paqësorë e liridashës të Evropës, shtypi zyrtar mburri Musolinin se gjoja shpëtoi paqen në botë. Një nga autorët kryesorë të veprës kriminale të Munihut, paraqitej si engjëll shpëtimtar i njerëzimit.

Ideologët reaksionarë zogistë lavdëruan jo vetëm politikën agresive italiane, por edhe doktrinën fashiste.

Regjimi fashist u cilësua si një regjim pozitiv që kishte kryer reforma të mëdha shoqërore dhe që shërbente si një barrierë e pakapërcyeshme kundër rrezikut komunist.

Fashizmi merrej si një model që duhej të imitohej dhe të vihej në jetë[58]. Ky armik numër një i pavarësisë së Shqipërisë, shpallej si «feja e çdo atdhetari»[59].

Kjo dëshmonte për atë që klasat reaksionare mund të lidheshin me forcat më të errëta kur ishte fjala për t'i bërë

57) «Drita», 28 nëntor 1937, f. 1.
58) «Besa», 28 nëntor 1931.
59) Po aty.

ballë komunizmit. Për interesat e tyre klasore ato i sakrifikonin interesat e atdheut.

Në organet zogiste, u mor në mbrojtje edhe politika grabitqare ekonomike e imperializmit italian në Shqipëri. Veprimtaria shfrytëzuese e instituteve ekonomike e financiare italiane si «Banka Kombëtare», «SVEA», «Banka e Napolit» dhe shoqëritë e ndryshme koncesionare, këto shushunja që thithnin pa mëshirë gjakun e popullit, u cilësuan si pozitive e mirëbërëse për vendin. Ato kontribuan gjoja në forcimin e pavarësisë ekonomike.

Sipas ideologëve zogistë, shoqëritë koncesionare italiane ndihmuan në zhvillimin ekonomik të vendit, krijuan klasën punëtore shqiptare, si dhe marrëdhëniet e «qytetëruara» midis punës e kapitalit duke zëvendësuar marrëdhëniet patriarkale që ekzistonin më parë.[60].

4. MBROJTJA E MARRËDHËNIEVE EKONOMIKE-SHOQËRORE ÇIFLIGARE-BORGJEZE

Vija apologjiste e pikëpamjeve zogiste përshkoi edhe konceptet mbi zhvillimin ekonomiko-shoqëror të vendit. Në të u shpreh qartë prirja e grupeve më reaksionare për mbrojtjen e marrëdhënieve ekonomike-shoqërore anakronike.

Në Shqipëri në këtë periudhë, pati disa përparime në drejtim të zhvillimit borgjez të vendit, në qytet e në fshat. Këto qenë të ngadalshme dhe prej tyre përfituan kryesisht klasat e pasura. Mbeturinat e feudalizmit ishin të forta dhe pengonin përparimin e vërtetë. Edhe depërtimi i kapitalit të huaj ishte një pengesë serioze për zhvillimin. Klasat sunduese nga njëra anë dëshironin të përfitonin nga zhvillimi borgjez, nga ana tjetër u ruheshin ndryshimeve të tilla që mund të kishin pasoja të padëshirueshme shoqërore. Ishin më tepër për një zhvillim kapitalist në rrugën prusiane. Regjimi zogist, si shprehës i interesave të këtyre klasave, u kujdes që të mos bëheshin korrektura të rëndësishme në marrëdhëniet ekonomike-shoqërore dhe të ruheshin pak a shumë pronat e bejlerëve çifligarë, mbeturinat e feudalizmit si dhe pozitat e kapitalit të huaj. Kjo i duhej për të ruajtur bazën e vjetër shoqërore të regjimit. Në të njëjtën kohë, zhvillimi në një farë mase i marrëdhënieve borgjeze dhe rritja e fitimeve të borgjezisë, e zgjeroi disi bazën ekzistuese të tij. Për ruajtjen e bazës së vjetër ekonomiko-shoqërore (të marrëdhënieve çifligaro-borgjeze), ishte e interesuar dhe

60) «Ora», 15 korrik 1930, f. 2.

Italia fashiste, e cila te prapambetja e vendit dhe reaksioni çifligaro-borgjez shikonte faktorët e favorshëm për përmbushjen e synimeve të saj.

Ideologët zogistë apo «të vjetrit», në përputhje me interesat e klasave sunduese, u shprehën kryesisht në të mirë të status-kuosë ekzistuese ekonomiko-shoqërore. Ata i kundërshtuan reformat shoqërore në të mirë të punonjësve. Në radhë të parë ishin për ruajtjen e pronës çifligare mbi tokën, të mbeturinave feudale dhe kundër çdo reforme agrare të vërtetë.

Çdo reformë agrare që mund të cënonte pronën çifligare konsiderohej si reformë «bolshevike».

Në shtypin zogist u lavdërua vetëm reforma agrare zogiste, e cila u cilësua si një nga veprat e mëdha të regjimit. Kjo shpjegohet me faktin që reforma në fjalë ishte një masë thjesht demagogjike për mashtrimin e fshatarësisë dhe nuk i ndryshoi marrëdhëniet në fshat. Çifligarët nuk donin as t'ia dëgjonin emrin reformës agrare demokratike dhe te reforma zogiste shikonin një mjet për mënjanimin e saj. Megjithatë, në fillim pati disa nga çifligarët që u shqetësuan edhe nga reforma zogiste. Prandaj u dhanë sqarime në parlament se «reforma agrare në shtetin tonë nuk bëhet me parime bolshevike, por me parime patriotike dhe bazohet sa të jetë e mundur në të drejtën»[61].

Në kohën kur rrethet përparimtare e demokratike dhe fshatarësia punonjëse shtronin me këmbëngulje çështjen e zbatimit të një reforme agrare të vërtetë dhe dëshironin që masa e madhe e fshatarëve pa tokë e me pak tokë të merrte tokë që të shpëtonte nga varfëria e mjerimi, rrethet reaksionare proçifligare iu kundërvunë këtyre kërkesave dhe deklaruan me bujë se zbatimi i reformës agrare në dëm të pronës çifligare do të çonte në «anarkinë bolshevike», në shkatërrimin e shoqërisë dhe të kombit.

Prona çilfigare u shpall e paprekshme në bazë të së drejtës çifligare që mbronte interesat ekonomike të kësaj klase. Për fshatarësinë e drejta e pronës ishte vetëm në letër. Çifligarët rrëmbyen me forcë tokat e fshatarëve, ndërsa tokat e tyre nuk lejuan të prekeshin. Gjatë viteve të regjimit zogist, arbitrariteti i klasës çifligare kundër fshatarësisë mori përpjesëtime të rëndësishme. Fshatarët u dëbuan nga tokat me anë të dhunës në bazë të tapive të falsifikuara nga çifligarët. Regjimi zogist mori anën e çifligarëve. Bashkë me regjimin, edhe apologjetët e tij i përkrahën çifligarët. Klasa çifligare, ndryshe nga ç'e tregonin faktet, u paraqit si altruiste e humanitare ndaj bujqve. Si

61) «Gazeta e Korçës», 9 prill 1930, f. 1.

dëshmi për këtë sillej reforma agrare zogiste, e cila e çliroi gjoja bujkun që vuante. Ai tani në qoftë se do të kishte dëshirë për punë dhe një bankë bujqësore, mund të përparonte mjaft[62].

Pronarët e tokave thuajse «e kuptuan rëndësinë e çështjes» dhe me dëshirën e tyre ua falën bujqve një të tretën e tokës pa shpërblim. Por e vërteta nuk ishte kështu. Reforma agrare zogiste nuk u vu në jetë dhe u sabotua nga klasa çifligare. Çifligarëve me një përjashtim të vogël, nuk iu prek toka. Kështu altruizmi i tyre ishte një produkt i fantazisë së «Besës» dhe organeve të tjera.

«Besa» kritikoi edhe disa anë negative të reformës. Sipas saj nxjerrja e ligjit që ndalonte pronarin t'i shiste apo t'i hipotekonte tokat e tij, para se të zbatohej reforma, shkaktoi «katastrofën e pronarit».[63]. Shqetësimi i «Besës» ishte i kotë, sepse ligji nuk u zbatua dhe pronarët bënë çfarë deshën me tokat e tyre, duke bërë shitje fiktive e makinacione të tjera.

Një anë tjetër negative e reformës konsiderohej ndikimi për të keq i saj në gjendjen e bujkut. Si pasojë e saj «bujku humbi përkrahjen e pronarit», mbeti pa ndihmë e nuk qe në gjendje të mbarështonte ekonominë e vet[64]. «Besa», hiqej sikur u qante hallin bujqëve, por bënte aluzion për tjetër gjë. Ajo u thoshte në mënyra të tërthorta bujqve që të mos pranonin të çliroheshin nga robëria çifligare. «Besa» edhe për këtë shqetësohej pa bazë, mbasi nga ky çlirim përfituan fare pak bujq.

Bujku, sipas saj, ishte një gjendje të punonte gjoja vetëm kur ndodhej në zgjedhën çifligare. Çifligari e detyronte të punonte mirë, ndërsa kur bëhej vetë pronar gjoja nuk punonte fare dhe kështu prodhimi degradohej[65]. Tek pikëpamjet e «Besës» nxirrte krye ideja e paternalizmit çifligar, sipas së cilës klasa çifligare konsiderohej tutore e bujkut dhe jo shtypëse e shfrytëzuese. Ajo gjoja kujdesej për të mirën e tij dhe të vendit. Bejlerët mbaheshin si elementi më pozitiv dhe më konstruktiv i kombit.

Këtë pikëpamje e mbrojti me zjarr edhe Faik Konica. Ai i adhuronte bejlerët dhe urrente pa masë fshatarësinë. Lëvizjet fshatare nuk i duronte sidomos kur drejtoheshin kundër pronës çifligare. Në kohën kur çifligari Maliq Frashëri dëboi fshatarët nga toka e tyre, Faiku dënoi me ashpërsi qëndresën fshatare kundër dhunës çifligare.

Lidhur me këtë ai shkroi në gazetën «Dielli»: «Bujqit

62) «Besa», 31 maj 1932, f. 1.
63) «Besa», 14 korrik 1931, f. 1.
64) Po aty, 17 tetor 1931, f. 1.
65) Po aty, 25 prill 1932, f. 2.

e Goricës u inkurajuan nga ca armiq të brendshëm të cilët u përpoqën për copëtimin e Shqipërisë dhe vanë me shpresë që t'i zaptojnë me forcë pasuritë e shqiptarëve...»[66].

Luftën e drejtë të fshatarëve goricarë, mbrojtësi i bejlerëve e dënonte si «metodë bolshevike».

Ideologët reaksionarë të drejtën e pronësisë mbi tokën e lidhnin me të drejtën natyrore. Ata thoshin se e «drejta e pronësisë ka lindur njëkohësisht dhe së bashku me njerinë e me shtetin, aq sa, siç ishte e pakuptueshme ekzistenca e njeriut pa shtetin, ashtu dhe është e pakuptueshme pa të drejtën e pronësisë»[67].

Ithtarët e së drejtës natyrore kishin mendimin se si prona private, ashtu edhe shteti lindën së bashku që në agimin e shoqërisë njerëzore dhe ishin atribute me rëndësi të saj. Në fakt ky ishte një shtrembërim, sepse ato lindën më vonë kur u krijua shoqëria me klasa dhe se në fillim nuk kishte as pronë private, as shtet. Por kjo teori u duhej për të përjetësuar pronën private dhe shfrytëzimin.

Prona tokësore konsiderohej jo vetëm si një faktor me rëndësi për sigurimin e interesave të elementit më konstruktiv të vendit, siç quheshin pronarët e pasur, dhe të bujqve, por edhe për ruajtjen e ekuilibrit shoqëror dhe sigurimin e interesave të vendit. Cenimi i pronës tokësore çonte gjoja në humbjen e këtij ekuilibri dhe në krizë Si dëshmi për këtë sillej kriza ekonomike në Shqipëri, e cila u shkaktua gjoja edhe nga zbatimi i reformës agrare[68]. Në këto pohime kishte edhe një farë inkoherence, sepse herë lavdërohej kjo reformë, e herë kritikohej.

Krahas klasës çifligare, u morën në mbrojtje edhe tregtarët spekulatorë, fajdexhinjtë dhe kapitalistët.

Gazeta «Djersa e popullit», emri i së cilës tingëllonte në mënyrë mjaft ironike, lavdëronte tregtarët spekulatorë që pasuroheshin në kurriz të popullit dhe thoshte se «klasa e tregtarëve ishte ajo që duhej të loste një rol me rëndësi në jetën ekonomike»[69].

Një rol i tillë me rëndësi u vishej edhe fajdexhinjve të pangopur e parazitë që me borxhet e tyre me kamatë të lartë, rritën pamasë varfërinë dhe mjerimin e punonjësve të qytetit e të fshatit. «Të vjetrit» e konsideruan moratoriumin e borxheve në të mirë të punonjësve që kërkonin rrethet demokratike si një «katastrofë» për zhvillimin ekonomik të vendit.

Masat kundër fajdexhinjve thuhej se do të dobësonin

66) «Dielli», 19 maj 1933, f. 2.
67) «Besa», 24 prill 1935, f. 3.
68) «Djersa e popullit», 28 nëntor 1934, f. 5.
69) Po aty.

kredinë e do të bënin që kapitalet të mos përdoreshin në vend, por të dilnin jashtë. Fajdexhinjtë mbaheshin si një «faktor i vlefshëm ekonomik» dhe pohohej se pa ata nuk mund të zhvillohej tregtia e nuk mund të përparonte ekonomia kombëtare[70].

Në të vërtetë ekzistenca e kapitalit kamatar dëshmonte për prapambetjen ekonomike të vendit. Ai ishte një kapital parazitar që nuk investohej e rritej gjithnjë duke grabitur masat punonjëse.

Ideologët reaksionarë nuk e pranuan faktin që mbi popullin shqiptar rëndonte shfrytëzimi i egër. Shfrytëzimi e padrejtësitë që mund të ndesheshin, konsideroheshin si diçka e rastit dhe aspak «organike» e sistemit; ato ishin rrjedhim i marrëdhënieve shoqërore «të padisiplinuara» dhe këto dukuri mund të zhdukeshin me ndërhyrjen e shtetit. Në Shqipëri gjoja nuk ekzistonte antagonizmi midis punës dhe kapitalit, por sundonte harmonia shoqërore. Në të kaluarën edhe ka ekzistuar ndonjë gjë e tillë, thoshin ata, por kjo nuk ka rrjedhur nga interesat klasore. Konflikti është shkaktuar nga elementët keqdashës[71]. Me një fjalë antagonizmi shoqëror nuk ishte diçka inherente e shoqërisë shqiptare, por një gjë e krijuar artificialisht nga faktorët subjektivë.

Një pjesë e mirë e përfaqësuesve të kësaj rryme ishte e prirur ta përligjte dhe ta zbukuronte prapambetjen ekonomiko-shoqërore të vendit. Ajo ishte e mendimit se Shqipëria duhej të mbetej në nivelin e një vendi bujqësor dhe nuk duhej të bënte përpjekje për t'u bërë një vend industrial, sepse gjoja nuk kishte kushte për një gjë të tillë[72]. Natyrisht, bujqësia sipas saj duhej të zhvillohej e të modernizohej. Por në të vërtetë edhe kjo premisë përjashtohej përderisa nuk shihej e nevojshme të bëheshin reforma të rëndësishme për të përmirësuar gjendjen e fshatarësisë.

Çdo hap që mund të bëhej në drejtim të industrializimit kapitalist thuhej se ishte i paracaktuar të dështonte, prandaj duhej inkurajuar vetëm zhvillimi i bujqësisë dhe blegtorisë.

«Shqipëria është dhe duhet të mbetet vetëm e vetëm një shtet bujqësor'[73]. Sipas një mbrojtësi të kësaj teze, vendi mund të mbahej fare mirë me prodhimet e tokës, me të cilat «mund të ushqeheshin 6 milion frymë». Për degët e tjera të ekonomisë duhej përkujdesur «tepër pak».

Nevoja e zhvillimit të njëanshëm (bujqësor) të ekonomisë «argumentohej» jo vetëm me mungesën e kushteve

70) «Drita», 8 prill 1937, f. 2; «Vatra», 6 qershor 1937, f. 2.
71) «Besa», 23 nëntor 1932, f. 1.
72) Po aty, 2 mars 1932, f. 1.
73) Po aty, 10 maj 1935, f. 1.

për industrinë, por edhe me faktin që populli gjoja kishte kërkesa të pakta. Zhvillimi industrial kundërshtohej edhe për shkak se ky do të krijonte një «pseudoqytetërim» me pasoja të rrezikshme për vendin. Këtu ishte fjala për pasojat e padëshirueshme ekonomiko-shoqërore e politike që do të sillte zhvillimi i shpejtë i kapitalizmit, si zhvillimi i klasës punëtore, forcimi i luftës së klasave e të tjera.

Pra, klasat çifligaro-borgjeze ishin për një zhvillim të ngadalshëm të kapitalizmit, dhe për ruajtjen e mbeturinave të feudalizmit. Ata thoshin se Shqipëria nuk mund të zhvillohej pa ndihmën e kapitalit të huaj e me forcat e veta. Me këtë përligjej edhe politika e dyerve të hapura e qeverisë zogiste ndaj vërshimit të kapitalit të huaj, e cila nuk u përkujdes për mbrojtjen e zhvillimin e industrisë së vendit.

Duke mos pasur besim në zhvillimin e vendit me forcat e brendshme, ideologët zogistë ishin për inkurajimin e lehtësimin e ndërhyrjes së kapitalit të huaj në Shqipëri.

Kishte nga ata që mendonin se kapitali i huaj duhej të investohej në Shqipëri jo në formë huaje akorduar Shqipërisë, por të hynte në formën e kapitalit industrial, bashkë me kapitalistin, sepse shqiptarët nuk ishin në gjendje ta përdornin atë. Kapitalistët e huaj cilësoheshin si mirëbërës e altruistë që gjoja bënin sakrifica për vendin tonë. Prandaj, ata kishin të drejtë edhe të fitonin[74]. Në bazë të kësaj pikëpamjeje shfrytëzimi i egër imperialist dhe grabitja që i bëhej vendit, ishin në të mirën e tij. Kjo përputhej plotësisht me atë që pohonin vetë fashistët italianë, me propagandën e tyre demagogjike.

Popullit i bëhej thirrje që të mos ankohej nga kapitalistët e huaj, sidomos ata italianë, por përkundrazi t'i duronte ata se kështu sigurohej përparimi. Qeverisë zogiste i thuhej që t'ua hapte dyert atyre në të dyja kanatet. Ndonjëri shprehu pakënaqësinë që kapitalet e huaj «nuk shikoheshin me sy të mirë» nga populli. Kjo cilësohej si shprehje e «ksenofobisë» se shqiptarëve që kujtojnë «sikur kapitali i huaj dhe teknikët e huaj duan të na zhveshin» dhe që «nuk mendojmë se s'kemi gjë për të zhveshur»[75]. Ky mbrojtës i kapitalistëve të huaj e shtrembëronte të vërtetën. Në dokumentet sekrete italiane thuhej hapur se synimi kryesor i Italisë fashiste ishte nxjerrja e fitimeve sa më të mëdha nga grabitja e pasurive të vendit dhe djersa e punëtorëve shqiptarë.

Autori i lartpërmendur nuk përjashtonte edhe mundësinë që kapitali i huaj në ndonjë rast të veçantë të kishte edhe «qëllime politike», porse «një qeveri e zgjuar dhe e kujdesshme lehtazi mund t'i bënte ballë kësaj», — argumentonte ai[76]. Një qeveri e tillë konsiderohej qeveria zogiste, sipas metodës së të bërit të të zezës të bardhë. Dhe ishte pikërisht kjo qeveri që e kishte lejuar kapitalin italian të bënte çfarë të donte, të krijonte një shtet brenda shtetit dhe t'i bënte varrin lirisë e pavarësisë së Shqipërisë.

Në vazhdën e këtij arsyetimi thuhej se vendet e pazhvilluara ekonomikisht si vendi i ynë, kishin nevojë më shumë se kushdo për kapitale të huaja[77]. Me ndihmën e tyre do të bëhej vlerësimi i burimeve ekonomike që nuk ishte në gjendje ta bënte kapitali i vendit.

Ksenofobia ndaj kapitalit të huaj konsiderohej rrjedhim i faktorit psikologjik. Kështu kishin qenë gjoja dikur edhe të tjerët në botë që e urrenin atë pa ndonjë arsye dhe pa bazë reale[78].

Problemi gjykohej nga pikëpamja e borgjezit komprador, i cili thotë: «Unë s'kam parë asnjë të keqe nga kapitali i huaj, përkundrazi, vetëm të mira. Ç'më duhet mua se ç'heqin të tjerët prej tij».

Një çështje tjetër që u trajtua gjerësisht në shtypin zogist ishte çështja e krizës së mprehtë ekonomike, Duke kërkuar arsyet e saj, ideologët reaksionarë u përpoqën ta shkarkonin përgjegjësinë për këtë nga sistemi çifligaro-borgjez dhe klasat reaksionare. Fajin kryesor ia hodhën nga njera anë krizës botërore, nga ana tjetër dhe më shumë popullit, «apathisë» e mungesës së dëshirës së tij për punë, injorancës etj.

Përmasat e krizës dhe forca e saj zvogëloheshin. Ata që vinin gishtin mbi plagët e krizës cilësoheshin si «pesimistë», që donin ta «dëftenin jetën të zezë» dhe ta «demoralizonin» popullin[79].

Sipas tyre, populli në çdo rast e për çdo gjë kërkonte t'ia hidhte fajin qeverisë. E tillë ishte gjoja «psikologjia e turmave» kudo në botë. Por qeveria nuk kishte asnjë përgjegjësi. Ajo përkundrazi kujdesej për shërimin e krizës[80]. Thuhej se qeveria nuk mund të bënte mrekullira. Ishte vetë populli ai që duhej të punonte më shumë dhe të derdhte energjitë e tij, në mënyrë që kriza të zhdukej[81]. Pra, ishte e qartë se në bazë të këtij arsyetimi, populli si gjithnjë

74) «Besa», 12 gusht 1931, f. 1.
75) Po aty, 14 nëntor 1931, f. 1.

76) Po aty.
77) «Java», 14 nëntor 1937, f. 5.
78) Po aty.
79) «Besa», 18 janar 1932, f. 1.
80) Po aty.
81) Po aty, 6 nëntor 1933, f. 1.

edhe këtë herë duhej të sakrifikohej për interesat e klasave të pasura. Pasojat e krizës, siç dihet, ranë mbi shpinën e tij.

Dikush u shpreh me një logjikë tipike prej beu se qeveria nuk kishte asnjë faj për gjendjen ekonomike të Shqipërisë përderisa ajo i «kishte dhënë direktiva» popullit që të punonte, ndërsa ai rrinte duarlidhur[82].

Në një kohë kur kriza në Shqipëri bënte kërdinë dhe kur uria, papunësia, varfëria e mjerimi kishin marrë përpjesëtime të mëdha,; kritikohej «pesimizmi» i tepruar dhe thuhej se bisedat për krizën ishin të kota, përderisa nuk kishte ndodhur asgjë prej saj dhe gjatë 3 vjetëve «asnjë s'ka vdekur»[83]. Por faktet tregonin të kundërtën. Zija e bukës shkaktoi dhe vdekje dhe këtë u detyrua ta pranonte vetë A. Zogu në një deklaratë të tij.

Përveç kësaj, raportet drejtuar nga qarqet Ministrisë së Brendshme, lajmëronin për raste vdekjeje për shkak të zisë së bukës dhe për një gjendje mjaft të rëndë.

Duke iu përgjigjur kërkesave të shumta që vinin nga qarqet për marrjen e masave të ngutshme për të zhdukur pasojat e rrezikshme të krizës, gazeta «Besa» thoshte se qeveria «nuk e shihte të nevojshme të merrte masa të jashtëzakonshme» përderisa gjendja nuk ishte kritike[84]

Përgjegjësia kryesore për krizën iu la masave punonjëse. Kështu, u theksua se arsyeja themelore e krizës ishte fakti që fshatarësi shqiptare kishte humbur interesin për bujqësinë, që ishte baza e ekonomisë dhe po e braktiste fshatin e tokën e po i drejtohej qytetit për të fituar me mënyra të tjera. Kjo rridhte gjoja nga që ajo ishte përtace, gjë që e kishte trashëguar nga e kaluara, nuk donte të punonte tokën, ishte e paditur dhe nuk zotëronte njohuritë e nevojshme për bujqësinë, gjithashtu kishte pasur një farë demoralizimi. Këtu kishte faj edhe qeveria që nuk i kishte krijuar fshatarit bindjen se punimi i tokës ishte baza e jetës ekonomike. Në këtë mënyrë, «urbanizmi» apo braktisja e parmendës, siç quhej emigrimi i fshatarëve në qytet, përbënte shkakun kryesor të krizës. Me këtë mënyrë shpjegimi maskohej arsyeja e vërtetë e braktisjes së tokave, gjendja e rëndë e krijuar për fshatarësinë nga shfrytëzimi i egër gjysmë-feudal, nga borxhet e shumta, nga zhvleftësimi i prodhimeve të tyre për shkak të krizës dhe makinacioneve të spekulatorëve. Legjenda e krijuar për parazitizmin e masave popullore, kishte për qëllim të fshihte parazitizmin e klasave sunduese dhe shthurjen e rendit çifligaro-borgjez.

82) «Gazeta e Korçës», 27 maj 1930, f. 2.
83) «Besa», 15 janar 1935, f. 1.
84) Po aty.

Edhe Faik Konica, duke mbështetur thëniet mbi natyrën përtace të popullit, shtonte se shqiptarët nuk e kishin zakon të merreshin me përmirësimin e jetës së tyre, por e harxhonin kohën për biseda politike dhe gjëra të kota. Pjesa dërrmuese e popullit, sipas Konicës, as që e donte punën fare dhe çdo gjë në Shqipëri, sipas shprehjes së tij, «pritej nga perëndia dhe guverna»[85].

Këtë tezë e mbështeti dhe ndonjë tjetër, i cili u mundua të provonte fajin e bujqve apatikë e që nuk punonin tokën dhe u referohej statistikave të Ministrisë së Ekonomisë mbi tokat e papunuara. Por ky shpjegim ishte larg së vërtetës.

Tokat kishin mbetur pa punuar jo për këtë arsye, por sepse çifligarët e mëdhenj, tregtarët e nëpunësit e lartë që zotëronin toka të shumta, duke shfrytëzuar fshatarësinë me metoda gjysmëfeudale e duke nxjerrë fitime me gjithfarë mënyrash, i kishin lënë tokat djerr ose i kishin kthyer në kullota, të cilat u sillnin të ardhura të konsiderueshme.

Populli bëhej fajtor jo vetëm për «përtacinë», por edhe për «vobeksinë» e tij. Kjo vobeksi, sipas një pikëpamjeje, bëhej shkak i «pakënaqësisë», «dëshpërimit», «mungesës së energjisë», që bëheshin për të një «kështilltar i keq» dhe një forcë shkatërrimtare[86].

Një arsye tjetër e krizës shpjegohej me zakonet e këqia të popullit, me harxhimet e tepruara për dasmat, gostitë etj., bile edhe me luksin. Shqiptari gjoja ndiqte luksin duke imituar modat e huaja. Varfëria dhe luksi, sipas kësaj logjike të çuditshme, ecnin bashkë te populli[87]. Është e vërtetë se varfëria e luksi bashkëjetonin në Shqipëri, por jo te populli. Varfëria sundonte në popull, ndërsa luksi në klasat e pasura. Këto ishin dy polet e kundërta të shoqërisë shqiptare, si të çdo shoqërie tjetër ku sundonte shfrytëzimi.

Populli në këtë periudhë nuk plotësonte nevojat më elementare dhe vuante për bukën e gojës. Ai ishte nga popujt më të varfër e më të shfrytëzuar të Evropës. Gazetat reaksionare e shtrembëruan të vërtetën deri në atë shkallë sa thoshin se prirja për luks e popullit shkaktoi edhe bilancin pasiv në tregtinë e jashtme dhe që të ndryshonte ky bilanc duhej të kufizohej dëshira e shqiptarëve për mallra të huaja. Me këtë logjikë ka mundësi që në sendet e luksit të jetë futur edhe misri që importonin tregtarët nga jashtë për të nxjerrë fitime nga populli i uritur në periudhat e zisë së bukës.

Kriza sipas ideologëve zogistë u shkaktua edhe nga ar-

85) «Dielli», 19 dhjetor 1930, f. 2.
86) «Gazeta e Korçës», 15 korrik 1936, f. 1.
87) «Ora», 4 janar 1932, f. 2.

sye të tjera. Këtu bënin pjesë edhe faktorët natyrorë. Kështu klima jo e përshtatshme ishte një faktor i krizës[88]. Gazeta «Besa» duke iu referuar sociologëve borgjezë që kishin bërë studime mbi krizën, për ta shkarkuar atë dhe pasojat e saj mbi masat, radhiste këtu edhe një sërë faktorësh psikologjikë, si: mungesa e nderit, demoralizimi shpirtëror etj. Por ne do të thoshim se në qoftë se faktorët moralë do të kishin peshë në këtë proces, atëherë çoroditja morale e klasave sunduese duhej të rëndonte shumë në peshore.

Një faktor tjetër me peshë që ndikoi shumë mbi krizën shqiptare, konsiderohej kriza botërore[89]. Kjo ishte e vërtetë, por ideologët reaksionarë e përdorën atë për të fshehur faktorët kryesorë të krizës që gjindeshin në rendin çifligaro-borgjez.

Është jashtë çdo dyshimi se kriza ekonomike botërore ndikoi mjaft negativisht, por arsyeja themelore qëndronte në marrëdhëniet çifligaro-borgjeze, në prapambetjen e thellë të vendit dhe shfrytëzimin e egër të popullit, në nënshtrimin gjysmëkolonial të Shqipërisë nga Italia fashiste.

Duke bërë krahasim midis krizës shqiptare dhe asaj të vendeve të tjera, dikush u shpreh se e para ishte më e lehtë dhe nuk pati pasoja aq të rënda si në vendet e tjera. Kjo shpjegohej me arsyen se Shqipëria, si vend thjesht bujqësor e pa pretendime të mëdha, e kishte më lehtë të zbatonte autarkinë dhe të mos varej kaq shumë nga tregjet, gjë që vendet industriale nuk mund ta bënin dot[90]. Por në fakt ishte e kundërta. Shqipëria, si shtojcë e tregut kapitalist botëror, si vend i varur krejt nga ky treg, i ndjeu shumë pasojat e krizës botërore dhe prodhimi i prodhuesve të vegjël, sidomos ai bujqësor e blegtoral, ngaqë s'mund të shitej në tregun e jashtëm për shkak të superprodhimit kapitalist, si dhe në tregun e brendshëm për shkak të rënies së fuqisë blerëse, «u bë batall» siç shkruante «Liria kombëtare». Në vetë gazetën «Besa» e gjetkë u pohua, në kundërshtim me pikëpamjen e mësipërme, se mbyllja e tregut të jashtëm krijoi për prodhuesit shqiptarë një gjendje të rëndë. Ideologët zogistë për të zvogëluar forcën e krizës, mohuan edhe ekzistencën e papunësisë, në një kohë kur statistikat zyrtare dëshmonin për një numër të madh të papunësh nëpër krahinat.

Për shpëtimin nga kriza kështilloheshin disa rrugëdalje. Në radhë të parë duhej t'i kushtohej vëmendje kryesore punimit të tokës në mënyrë që të likuidohej «urbanizmi»

88) «Dielli», 19 dhjetor 1930, f. 2.
89) «Besa», 2 maj 1935, f. 1.
90) Po aty, 18 tetor 1933, f. 1.

dhe të detyroheshin fshatarët, qoftë edhe me metodat e «rekrutimit në punë» të merreshin me bujqësinë. Përveç kësaj Shqipëria duhej të zbatonte sistemin autarkik të ekonomisë, të kufizonte në maksimum importin e sendeve nga jashtë, sidomos të «sendeve të luksit». Për shërimin e krizës duhej të kursehej sa më shumë, gjithashtu duhej të ndryshonte mentaliteti, të braktisej pesimizmi dhe demoralizimi që ishin pengesë për punën.

Të gjitha duhej të ndryshonin me përjashtim të kryesores, marrëdhëniet çifligaro-borgjeze dhe shfrytëzimi gjysmëfeudal duhej të mbeteshin në fuqi.

Pikërisht këtu qëndronte dhe arsyeja që kriza shqiptare ishte një krizë kronike e cila nuk i ndahej asnjëherë vendit.

5. PIKËPAMJET OBSKURANTISTE PËR ARSIMIN DHE KULTURËN.

Ideologët zogistë mbajtën qëndrim antidemokratik dhe obskurantist edhe ndaj arsimit e kulturës. Pikëpamjet e tyre në këtë fushë ishin gjithashtu ultrareaksionare. Ato shprehnin interesat dhe politikën e klasave sunduese, të cilat ishin kundër pajisjes së popullit me arsim e kulturë, në mënyrë që të frenohej progresi dhe të pengohej përhapja e ideve dhe lëvizjes revolucionare.

Forcat reaksionare ishin të interesuara t'i mbanin masat në errësirën e thellë të padijes, se kështu mund t'i shfrytëzonin dhe t'i sundonin më lehtë. Vetë mbreti Zog i deklaroi ministrit italian në Shqipëri Francesko Jakomonit në vitin 1937 se qeveria e tij nuk e shihte me leverdi zhvillimin ekonomik e kulturor të vendit, sepse përvoja e vendeve të zhvilluara tregonte se këto kishin mjaft telashe nga ky zhvillim dhe qetësia e tyre turbullohej shpesh nga luftërat e brendshme politike e shoqërore[91].

Pra, klika zogiste mendonte se, duke zhvilluar një politikë obskurantiste, do ta kishte më lehtë t'i bënte ballë luftës klasore.

Apologjetët e regjimit gjatë gjithë këtyre viteve, nuk bënë gjë tjetër veçse predikuan nevojën e kufizimit të arsimit e të kulturës për shkak të «superprodhimit intelektual» që gjoja i kanosej vendit. Kjo thuhej në një kohë kur

91) F. Jakomoni di San Savino. La politika dell'Italia in Albania, (Riccordi), 1965, f. 73-74.

pjesa dërmuese e popullsisë (85%) ishte analfabete, kur numri i shkollave, i kuadrove dhe i nxënësve ishte i kufizuar në maksimum dhe kur errësira e dendur e padijes kishte mbuluar jo vetëm fshatrat e malësitë, por edhe qytetet.

Zhurma mbi «superprodhimin intelektual» u dëgjua në qeveri e në parlament, në Ministrinë e Arsimit dhe në shtyp. Kambanave të alarmit u ranë sidomos deputetët reaksionarë në parlamentin zogist, si Fejzi Alizoti, Thoma Orolloga e të tjerë. Këta ankoheshin se shkollat e mesme të Shqipërisë gjoja nxirrnin çdo vit shumë kuadro, të cilat s'kishin ku të vendoseshin dhe mbeteshin pa punë duke shtuar radhët e «proletarëve intelektualë».

Fejzi Alizoti, nën pretekstin e shtimit të shkollave profesionale në dëm të shkollave klasike (gjimnazeve), në përputhje gjoja me kërkesat praktike të zhvillimit të vendit, kërkonte të pakësonte shkollat e mesme në përgjithësi, ashtu siç u pakësuan me masat që mori qeveria zogiste.

Kjo ide frymëzohej, përkrahej e nxitej edhe nga zyrtarët fashistë italianë që e kishin halë në sy shkollën shqipe dhe që donin ta fusnin atë nën ndikimin e tyre. Lidhur me këtë çështje ai deklaroi në parlament në verën e vitit 1935: «Sot në Shqipëri kemi tri gjimnaze dhe po të bëjmë një kalkyl, këto shkolla do të nxjerrin vazhdimisht për një kohë prej 10-15 vjetësh 500-600 kandidatë për nëpunësira e do të vijë një kohë si në Greqi që djelmt e shkollave të bëhen edhe çirak bakajsh. Unë me këtë program që asht sot, jam i bindun se këto pare që prishen për arsim shkojnë kot»[92].

Shqetësimi i Alizotit me shokë ishte i kuptueshëm, ata donin t'i kufizonin gjithnjë e më shumë mundësitë që bijtë e klasave të ulëta të arsimoheshin e të fitonin kulturë e, po të ishte e mundur, t'ua mbyllnin fare atyre dyert e shkollave; kulturën e konsideronin monopol të elitës së klasave sunduese dhe donin ta ruanin e ta forconin këtë monopol.

Në qoftë se bijtë e vegjëlisë do të fitonin kulturë, ata do t'i kuptonin shumë më mirë kushtet e mjerueshme të klasave nga rridhnin dhe do të luftonin kundër tyre. Këtë e vërtetonin qartë të rinjtë e të rejat e shkollave të mesme të Shqipërisë që ishin rreshtuar në radhët e lëvizjeve komuniste e përparimtare. Kjo gjë i trembte klasat sunduese. Këtë arsye themelore apologjetët e regjimit e maskuan me arsye të ndryshme ekonomike, teknike, e madje kulturore.

Deputeti Thoma Orolloga shprehu mendimin se kufizimi i shkollave të mesme duhej bërë gjoja edhe për një qëllim «pozitiv» e nevojë të ngutshme, për t'i përdorur shumat që

92) «Besa», 6 qershor 1935, f. 4.

shpenzoheshin për shkollat e mesme, për zhdukjen e analfabetizmit[93]. Ky ishte vetëm një pretekst, sepse regjimi, veç premtimeve, nuk bëri asgjë për zhdukjen e analfabetizmit i cili mbeti një plagë e hapur gjatë gjithë këtyre viteve e më pas.

«Besaxhinjtë» e thoshin hapur se «duheshin zbutur aspiratat pa vend që lindnin në shpirtin e të vegjëlve dhe të vobekëve, duhej zhdukur iluzioni i madh se kultura të jep në mënyrë të pagabueshme pasurinë dhe fuqinë»[94]. Kjo donte të thoshte se shtresave të ulëta, vegjëlisë s'kish ç'u duhej shkolla, kultura. Këto ishin për klasat e larta. Ato duhej ta siguronin jetesën e tyre me punën e rëndë të krahut.

Gazeta «Besa» shprehte shqetësimin se «superprodhimi kulturor» mund t'i hapte telashe regjimit duke bërë që «një grumbull parazitësh t'u vërsulen dyerve të Qeverisë për nëpunësira» dhe të braktisnin punët e krahut[95].

Natyrisht «Besën» nuk e shqetësonte fakti që braktisej prodhimi, por kishte frikë se mos depërtonin në aparatin shtetëror dhe në administratë elementë nga klasat e ulëta. Vendet në administratë e në aparatin shtetëror ishin privilegj i klasave sunduese.

Në regjimin zogist bijtë e popullit që arrinin me sakrifica të shumta të mbaronin shkollën dhe që kërkonin punë e punë nuk gjenin se rrugët e jetës kudo ishin të mbyllura, cilësoheshin edhe si parazitë. Regjimi i parazitëve kërkonte t'u vinte damkën e vet.

Superprodhimin intelektual ideologët e regjimit e paraqitën dukuri botërore, si rrjedhim të «çorganizimit të ekonomisë moderne» dhe «superprodhimit të punëtorëve»[96].

Ky arsyetim vinte në kundërshtim me arsyetimin e mëparshëm të tyre se Shqipëria nuk e njihte zhvillimin kapitalist.

Në vijim të këtyre ideve u shpreh gjithnjë mendimi se u kalua «nga një ekstrem në tjetrin» dhe u krijua «papunësia intelektuale», «ky problem i rëndë e i komplikuar»[97]. Shprehësit të kësaj pikëpamjeje nuk i dukej aspak normale që shkollat e mesme prodhonin «nga një taborr maturantësh».

Dhënia e alarmit mbi superprodhimin intelektual nga regjimi zogist bëri përshtypje të keqe në rrethet përparimtare dhe forcoi urrejtjen kundër tij. Qëndrimi i regjimit i binte ndesh aspiratave të zjarrta të popullit për arsim e

93) Po aty.
94) Po aty, 20 shkurt 1935, f. 1.
95) Po aty.
96) Po aty.
97) «Drita», 9 shkurt 1937.

kulturë dhe përpjekjeve të elementëve demokratë për t'i vënë në jetë ato. Këtë opinion të rretheve demokratike nuk e dobësuan as politika koniunkturale e klikës zogiste në vitet 1932-1933 e shkaktuar nga acarimi i përkohshëm i marrëdhënieve me Italinë që çoi në mbylljen e shkollave të huaja dhe fetare dhe shtetëzimin e shkollave private e fetare as propaganda demogogjike që i shoqëroi këto masa, e cila i paraqiste ato si forcim të shkollës kombëtare e laike. Më pas, regjimi i rihapi shkollat fetare dhe vazhdoi më tej politikën obskurantiste e antidemokratike. Duhet thënë se shtetëzimi i shkollave private u bë edhe nën presionin e rretheve demokratike të vendit.

Idetë reaksionare, në mbështetje të kësaj politike, u frymëzuan dhe u nxitën edhe nga zyrtarët fashistë në Shqipëri, të cilët gjithashtu ishin të interesuar që në vend të sundonte padija. Këta morën pjesë aktive në përpunimin e ideve dhe planeve për kufizimin e arsimit e të kulturës në Shqipëri.

Pikëpamjen reaksionare mbi pakësimin e shkollave të mesme dhe për krijimin e një elite të kulturuar nga klasat e pasura, e përpunoi me kujdes organizatori fashist i Ministrisë së Arsimit Sestilio Montaneli, i cili në këtë rast u përpoq të fuste ideologjinë dhe kulturën fashiste në shkollat e Shqipërisë[98]. Por, ky plan nuk u vu dot në jetë, sepse ndeshi në qëndresën burrërore të komunistëve dhe patriotëve shqiptarë. Shkollat e mesme u bënë ballë me trimëri fashistizimit, si dhe politikës obskurantiste të regjimit.

Në një kohë kur ndiqej një kurs i tillë i kufizimit të arsimit e kulturës, në shtyp bëhej zhurmë, nga ana tjetër, se regjimi zogist gjoja bëri reforma të mëdha në këtë fushë. Sidomos këtu u spekulua mjaft me masat që u morën në vitet 1932-1933 për qëllime politike gjatë acarimit të përkohshëm të marrëdhënieve me Italinë.

Aty u tha edhe se gjoja qeveria zogiste kishte hapur shkolla në gjithë vendin dhe po zhdukte analfabetizmin. Në fakt as njera nga këto pohime nuk përputhej me realitetin. Edhe ato pak shkolla që u hapën në Shqipëri, u hapën kryesisht me nismën dhe ndihmat e popullit. Masat popullore të qyteteve e të krahinave drejtonin vazhdimisht lutje në qeveri për hapjen e shkollave dhe ato mbeteshin pa përgjigje.

Në këto rrethana të padijes së përgjithshme e të thellë, në shtypin reaksionar shkruhej se Shqipëria po përparonte edhe nga pikëpamja kulturore «me hapa të shpejta», po «oksidentalizohej» dhe në një kohë të shkurtër «do të

98) *Historia e Shqipërisë*, vëll. III, Tiranë, 1984, f. 415-416.

barazohej me shtetet e mëdhenj». Ky zhvillim e përparim kulturor theksohej se «duhej të krijohej nga elita, pra jo nga populli, e cila duhej të bënte përpjekje të prodhonte sa më shumë vlera kulturore[99].

Në përfundim të shtjellimit të analizës së ideologjisë zogiste në vitet 30, e shohim të nevojshme të ritheksojmë se ajo ishte rryma që shprehu më mirë interesat e klasave sunduese e të regjimit, që u përputh me politikën zyrtare të qeverisë zogiste dhe madje ndikoi mbi të. Por duhet thënë se nuk ishte e vetmja rrymë reaksionare që shprehu interesat e klasave të pasura. Krahas saj edhe rrymat e tjera reaksionare dhanë ndihmesën e tyre në mbrojtjen e këtyre interesave. Të gjitha këto rryma, siç do të sqarojmë më poshtë, me gjithë nuancat e mospërputhjet, formuan një bllok të vetëm kur u shtrua çështja e mbrojtjes së rendit çifligaro-borgjez dhe e përballimit të lëvizjeve revolucionare.

99) «Drita», 15 janar 1938, f. 2.

KREU II

IDETË E «DIKTATURËS SË NDRITUR»

Në vitet 30-të krahas rrymës zogiste, e cila siç e shpjeguam, shprehte në mënyrën më të plotë interesat e klasave në fuqi, dolën në arenën e luftës ideologjike edhe disa rryma të tjera me ngjyrë borgjeze që përfaqësoheshin nga grupe intelektualësh borgjezë. Të tilla ishin ideologjia e «të rinjve» apo e «diktaturës së ndritur», si dhe ajo e «neoshqiptarizmës».

Këto shprehën interesat e borgjezisë, e cila në këtë periudhë bëri përparime në fushat ekonomike dhe politike dhe kërkonte të forconte më tej pozitat e saj përballë klasës së bejlerëve çifligarë që kishin ende peshë të ndjeshme në jetën e vendit e sidomos përballë lëvizjeve të masave popullore e të rretheve demokratike që i rrezikonin këto pozita.

Borgjezia shqiptare, siç e kemi theksuar, nuk ishte aq e fortë ekonomikisht dhe politikisht, sa ta mënjanonte klasën çifligare, e cila ishte bartëse e mbeturinave të feudalizmit që bëheshin pengesë për zhvillimin normal të marrëdhënieve borgjeze. Ajo nuk ishte në gjendje as t'i spastronte marrëdhëniet ekonomiko-shoqërore prej këtyre mbeturinave, as të krijonte një superstrukturë adekuatë borgjeze. Sido-

qoftë për një gjë të tillë aspironte dhe bënte ndonjë përpjekje. Kjo u shpreh edhe në ideologjinë borgjeze të kohës, në kritikat kundër «orientalizmit» (mbeturinave të sistemit feudal), në lavdërimin e sistemit borgjez perëndimor dhe marrjen e «qytetërimit» perëndimor si model për Shqipërinë.

Por, borgjezia e dobët parapëlqeu rrugën e zhvillimit të ngadalshëm kapitalist pa konflikte shoqërore. Në këtë rrugë kishte hyrë edhe ekonomia çifligare edhe pse ruante ende mbeturina të sistemit të vjetër. Borgjezia ishte për një farë kompromisi me çifligarët për të përballuar lëvizjet revolucionare, për të ruajtur statukuonë e rendit çifligaro-borgjez, stabilitetin shoqëror. Natyrisht lidhjet e kompromisi nuk i përjashtonin edhe kundërthëniet. Në kuadrin e këtij rendi dhe në përputhje me forcimin graudal të pozitave të veta ekonomiko-shoqërore, borgjezia u mundua të rriste ndikimin edhe në shtet, në qeverisjen e vendit, gjithashtu të bënte të mbizotëronte kultura e mentaliteti borgjez («oksidental»). Ajo kërkonte një ndarje më të drejtë të pushtetit me klasën çifligare. Kjo u pasqyrua edhe në ideologjinë e saj. Në këtë ideologji mbizotëroi më shumë ana politiko-kulturore e zhvillimit borgjez, sesa ajo ekonomike-shoqërore.

Regjimi zogist, nën presionin e borgjezisë, mori disa masa në të mirë të saj. Me këtë rast ai forcoi dhe bazën shoqërore të tij. Këto i paraqiti si masa «qytetëruese» për popullin dhe kombin. Vetë borgjezia shqiptare nëpërmjet ideologëve të saj, idetë dhe përpjekjet për plotësimin e aspiratave të veta i paraqiti si në të mirë të popullit e zhvillimit. Ideologjia borgjeze, pavarësisht nga disa kritika kundër «feudalizmit» dhe hedhjes së ideve të përgjithshme të përparimit e qytetërimit, në këtë kohë ishte një ideologji konservatore dhe antidemokratike. Ajo ishte kundër reformimit të bazave të rendit çifligaro-borgjez dhe kundër rendit demokratik. Konservatorizmi i saj u shpreh ndër të tjera në sigurimin e progresit me anë të kompromisit çifligaro-borgjez, me anë të konformizmit politik me regjimin si dhe me anë të zhvillimit të ideve, të evoluimit të mentalitetit. Megjithëqë rregulli e progresi viheshin pranë njeri-tjetrit, në fakt parapëlqehej rregulli ekzistues dhe progresi lihej në plan të dytë e nuk kuptohej si një progres i vërtetë. Borgjezia në këtë fazë i kishte braktisur idealet demokratike dhe ishte kthyer në përgjithësi në një klasë reaksionare. Ajo kishte frikë nga lëvizjet popullore e lufta e klasave, prandaj iu kundërvu ideve përparimtare e revolucionare dhe shndërrimeve të rëndësishme shoqërore. Në qoftë se në fillim të viteve 20-të ideologët përparimtarë të borgjezisë kërkuan të vendosej në Shqipëri rendi demokratiko-borgjez,

tashti ideologët borgjezë ishin kundër një gjëje të tillë. Karakteri konservator e reaksionar i ideologjisë borgjeze të këtyre viteve dëshmohej edhe nga ndikimet që pësoi ajo nga ideologjitë e huaja.

Rrymat borgjeze përqafuan kryesisht idetë e shkollave dhe sistemeve filozofike e sociologjike reaksionare perëndimore, duke përfshirë dhe ato fashiste. Kjo nuk ishte një gjë e rastit. Ajo tregonte se këto ide përputheshin me interesat e aspiratat e klasës borgjeze shqiptare.

Në këtë kapitull do të shqyrtojmë ideologjinë e «të rinjve» apo të «diktaturës së ndritur».

«Të rinjtë» u vetëquajtën kështu, siç e shpjeguam në kapitullin e parë, gjatë polemikës që zhvilluan me «të vjetrit» që përfaqësonin klasën çifligare dhe nëpunësit e lartë që rridhnin prej saj. Me anë të këtij emri dhe të pikëpamjeve që parashtruan në shtyp, këta ideologë borgjezë deshën të paraqiten përpara opinionit publik si një prirje përparimtare e qytetëruese që ishte gjoja në pozita diametralisht të kundërta me ato të «të vjetërve».

Në fillim u quajtën «neoshqiptarë» që ishte po e njëjta gjë. Më pas *neo-n* e shqipëruan në «të rinj» jo aq për arsye gjuhësore, sesa për t'u diferencuar nga neoshqiptarët e mirëfilltë, nga Branko Merxhani me shokë.

Pavarësisht nga veçoritë që kishin, thelbi i tyre ishte i njëjtë. Ideologjia borgjeze e «të rinjve» edhe pse iu kundërvu «të vjetërve» dhe zhvilloi një farë polemike me ta, synimin kryesor nuk e kishte këtu, por te kundërshtimi i idealeve dhe shndërrimeve demokratike. Me anë të luftës kundër «të vjetërve», borgjezia siç thamë donte të realizonte disa përfitime, por interesi themelor i saj ishte sigurimi i stabilitetit shoqëror përballë luftës së klasave, në mënyrë që të mbarështonte punët e veta. Po të kihet parasysh, kjo anë thelbësore, «të rinjtë» ishin po aq të vjetër sa edhe rryma e përparshme. Regjimit zogist i interesonte dalja në skenë e kësaj rryme të veshur me rroben përparimtare si dhe polemika që u zhvillua midis «të rinjve» e «të vjetërve». Ai deshi të krijohej përshtypia në popull se monarkia gjoja i hapte rrugë lirisë së mendimit e prirjeve përparimtare. Përveç kësaj, shpresohej që rrymat borgjeze të eklipsonin e të pengonin me zhurmën e tyre idetë përparimtare e revolucionare. A. Zogu, kritikat kundër «të vjetërve» deshi t'i përdorte edhe për të trembur disa çifligarë të panënshtruar që shfaqnin prirje separatiste. «Të rinjtë» i shtjelluan idetë e tyre në një sërë organesh si gazetat «Arbëria», «Rilindja e Arbërisë», «Vullneti i Arbërisë», revista «Iliria» etj.

Në këtë grup bënin pjesë Ismet Totoja, Nebil Çika, Mehmet Konica, Seit Qemali etj. Mehmet Konica dhe Nebil

Çika njiheshin si elementë që lidheshin me regjimin monarkik dhe që i kryenin shërbime klikës zogiste, ndërsa Seit Qemali e ndonjë tjetër si elementë profashistë.

«Të rinjtë» e filluan shtjellimin e ideve të tyre që pas shpalljes së monarkisë, me zhurmën propagandistike dhe sulmin kundër «të vjetërve». Ata pretenduan se ishin kundër forcave konservatore të shoqërisë shqiptare, kundër elementëve dhe mentalitetit «oriental» dhe për një shndërrim të gjithanshëm politiko-shoqëror e kulturor të vendit, për «oksidentalizimin» etj. Në këtë luftë duhej të drejtoheshin nga idetë e reja borgjeze. Modelin më të mirë të këtyre ideve dhe të rregullimit shoqëror «oksidental» e gjenin në sistemet politike dhe në doktrinat fashiste. Qysh në vitin 1929 «të rinjtë» deklaruan se ishin për një kritikë «leale» dhe të «sinqertë» brenda kuadrit të bashkëveprimit të intelektualëve me regjimin ekzistues[1]. U zotuan ta mënjanonin «oportunizmin dhe hipokrizinë» që mund të shpinte në «absolutizëm», por në fakt nuk vepruan ashtu, por ranë në konformizëm dhe bënë demagogji. Kritika e tyre ishte e përciptë, nuk i prekte bazat e rendit ekzistues dhe të regjimit politik. Që në fillim ata u mbrojtën nën strehën e monarkisë dhe bënë diferencimin midis saj dhe «të vjetërve» duke e cilësuar të parën si pozitive e përparimtare, ndërsa të dytët si reaksionarë, në një kohë kur monarkia shprehte në mënyrë të përqendruar gjithçka të vjetër, konservatore, reaksionare.

Ky dallim fliste për oportunizmin e tyre dhe për faktin se nuk kishin aspak ndërmend të bënin ndonjë shndërrim shoqëror, por vetëm të përmbushnin disa interesa e kërkesa të vogla partikulariste të klasës së vet.

Kritika e tyre kundër «të vjetërve» dhe zhurma demagogjike për qytetërimin e vendit u përputh edhe me premtimet e klikës zogiste për oksidentalizimin e Shqipërisë. Në shtyp pati një sërë replikash të ashpra kundër «administratës» shqiptare të përbërë prej «të vjetërve». Këta të fundit cilësoheshin si «trashëgimtarë» të Turqisë së vjetër, si elementë të korruptuar, prapanikë e të pazotë, që kishin krijuar administratën më të keqe në Evropë[2]. Me të tillë elementë thuhej se nuk mund të kishte përparim shoqëror, prandaj mbreti gjithë shpresën e kishte drejtuar kinse te «të rinjtë» me anën e të cilëve kërkonte ta oksidentalizonte Shqipërinë[3]. Pra, aluzioni ishte i qartë: në shtet duhej të tregohej parapëlqim për elementët borgjezë. Elementët çifligarë duhej të zhvendoseshin në plan të dytë. Kjo ishte

1) «Arbëria», 26 shtator 1929, f. 1.
2) Po aty, 8 maj 1930, f. 1.
3) Po aty.

një aspiratë që nuk përputhej me gjendjen. Regjimi zogist në përgjithësi paraqitej prej tyre i shëndoshë dhe sëmundja lokalizohej vetëm në «administratën orientale».

Nga kjo sëmundje thuhej se vuanin si qeveria ashtu edhe parlamenti, të cilët mund të shëroheshin me anë të një veprimi energjik e të bashkërenditur midis monarkisë dhe «të rinjve».

Monarkisë i visheshin atribute iluministe e qytetëruese, ndërsa «të vjetërve» tipare negative. Ndarja në «të rinj» e «të vjetër» paraqitej si një prirje e zhvillimit të përgjithshëm të shoqërisë njerëzore, ku e reja ishte në luftë me të vjetrën. Pra, «të rinjtë» mundoheshin të paraqiteshin si rrymë përparimtare.

Leva e Arkimedit e zhvillimit të shoqërisë shqiptare, mbaheshin idetë dhe morali borgjez. Me anë të tyre dhe jo me anë të luftës së klasave mund të zhdukeshin «lëngatat e sotme».

Kusht i rëndësishëm për «oksidentalizimin» e vendit konsiderohej krijimi dhe përhapja e ideologjisë së re nga elita e kulturuar, bashkimi i popullit nën flamurin e saj. Një kërkesë të tillë parashtruan edhe «neoshqiptarët». Por, ndryshe nga ata, «të rinjtë» pretenduan se krahas përhapjes së ideve do të zhvillonin me mbretin në krye edhe një veprimtari energjike praktike për pastrimin e «organizatës shtetërore» nga elementët «e vjetër» orientalë dhe për «oksidentalizimin» e saj. Kështu, ata thoshin se nuk do të mbylleshin në sferën e predikimit, por do të bashkonin mendimin me veprimin dhe do të ndërmerrnin një sërë reformash shoqërore e politike. Vëmendjen e tyre, siç thamë, e drejtuan te sfera politike, tek forcimi i pozitave të borgjezisë në aparatin shtetëror. Por edhe «të rinjtë», si përfaqësues të borgjezisë së dobët shqiptare, nuk i kaluan caqet e predikimit dhe nuk qenë të aftë për të zhvilluar ndonjë veprimtari energjike. Në këtë periudhë klasat dhe grupet e ndryshme reaksionare me gjithë epërsitë që kishin, nuk mundën të krijonin as parti dhe as organizata politike të tyret. Mungesa e tyre ua kufizonte mjaft sferën e veprimtarisë. Ideologët e politikanët borgjezë ishin njerëz të llafeve e të zhurmës, të paaftë për të vepruar, ashtu siç i cilësonte Ali Kelmendi.[4].

Duke theksuar domosdoshmërinë e zhvillimit të veprimtarisë politike, të cilën nuk e realizuan asnjëherë, «të rinjtë» u përpoqën ta paraqitnin politikën borgjeze si sferë të ideve të pastra, jashtë interesave të klasave e grupeve të ndryshme. Çdo klasë shfrytëzuese pra edhe borgjezia, politikën

4 Arkivi Qendror i PPSH. Raport i Ali Kelmendit drejtuar Kominternit, dt. 5.3.1932 dhe 14 dhjetor 1936.

e vet e paraqet të kulluar e në përputhje me interesat e të gjithë popullit. Kjo gjoja i kundërvihej politikës në kuptim të keq, me të cilën nënkuptohej veprimtaria kundër regjimit e klasave në fuqi, që cilësohej «lojë» pasionesh e interesash, e cila degjeneronte në luftën midis grupeve e individëve[5].

Në idetë e «të rinjve», të cilat u parashtruan gjatë polemikës me «të vjetrit», tehu kryesor i kritikës në fakt drejtohej kundër lëvizjeve e ideve përparimtare e revolucionare. «Të rinjtë» shprehën një sërë pikëpamjesh antidemokratike, të cilat u huajtën në një pjesë të mirë nga ideologjitë fashiste. Në qendër të tyre ishte ideja e «diktaturës së ndritur». Këto pikëpamje pohonin nevojën e vendosjes së një diktature fashiste në Shqipëri, të një sistemi totalitar, të edukimit të brezit të ri me frymën fashiste, likuidimit të luftës së klasave me metodat fashiste, si dhe krijimit të një elite sipas modelit fashist që do të sundonte mbi popullin[6]. Kjo elitë apo «klasë vepronjëse» siç e quanin ata, do të shërbente si shtylla vertebrale e regjimit[7]. Ideologjia fashiste dhe sistemi fashist duhej të bëheshin pjesë e pandarë e jetës kombëtare[8].

1. FRYMA ANTIDEMOKRATIKE E IDEVE TË «TË RINJVE»

Të gjitha këto ide të shtjelluara gjerësisht e që vishesin me rrobën e përparimit, që paraqiteshin sikur synonin të çrrënjosnin «frymën e vjetër», drejtoheshin në fakt kundër popullit dhe lëvizjeve demokratike. Për pikëpamjet fashiste të «të rinjve» do të flasim në mënyrë të veçantë. Në fillim e shohim të nevojshme të zbulojmë thelbin reaksionar e antidemokratik të kësaj ideologjie, qëndrimin e saj ndaj popullit dhe aspiratave të tij.

Edhe te kjo rrymë, mohimi i rolit të popullit dhe i të drejtave të tij ishte një tipar dallues. Karakteristikë e saj ishte ekzaltimi i kultit të heronjve dhe të elitës.

«Të rinjtë», ashtu si dhe grupet e tjera reaksionare, ushqyen përbuzje ndaj masave popullore, i konsideruan ato të paformuara nga pikëpamja e vetëdijes dhe kulturës, të paafta për të zhvilluar veprimtari politike e shoqërore dhe për t'u përfshirë në jetën kombëtare. Kriter themelor për

5) «Arbëria», 6 dhjetor 1936, f. 1.
6) Po aty, 6 dhjetor 1935, f. 1.
7) Po aty, 10 dhjetor 1930, f. 1.
8) Po aty, 4 shkurt 1936, f. 1.

një vlerësim të tillë merrej ndërgjegjja shoqërore, kultura. Masat punonjëse konsideroheshin pa ndërgjegje politike-shoqërore, e cila u atribuohej vetëm njerëzve të zgjedhur e me kulturë që ngriheshin mbi turmën dhe e drejtonin atë.

Ismet Totoja i ndante njerëzit në «njerëz që ndjejnë përgjegjësi dhe që nuk ndjejnë»[9].

Njerëzit që ndienin përgjegjësi për fatet e kombit, që ishin të pajisur me vetëdije të zhvilluar e me kulturë, bënin pjesë në elitën, ndërsa ata që nuk ndienin ishin shumica e popullit. Kjo ishte një pikëpamje e zakonshme idealiste e reaksionare që rolin e njerëzve në shoqëri e shpjegonte me idetë e kulturën dhe jo me kushtet e faktorët objektivë, me veprimtarinë materiale e shoqërore.

Nga kjo optikë rridhte gjithë ai përçmim i rolit të masave në histori dhe hipertrofizim dhe zmadhim i rolit të heronjve, të personaliteteve.

Njerëzit që «ndjenin përgjegjësi» sipas Ismet Totos, kishin «një kuptim të thellë të historisë», «shqetësoheshin për të ardhmen e kombit» dhe «vepronin gjithë jetën si misionarë», d.m.th. ishin të devotshëm ndaj idealit të tyre dhe interesave të përgjithshme, ndërsa pjesa e popullit që nuk ndiente kurrfarë përgjegjësie shoqërore, bënte gjoja një jetë thjesht biologjike, kujdesej vetëm për krodhen e bukës, mundohej t'i përshtatej situatës[10].

E përfshirë në skemën idealiste, historia varfërohej tej masës. Ajo paraqitet si e dalë e tëra nga koka e elitës, e figurave të shquara. Mohimi i veprimtarisë së gjerë materiale e shpirtërore të popullit që përbën themelin e historisë, ishte rezultat i lajthitjeve të metodës dhe i shikimit të popullit nga pozitat aristokratike të klasave sunduese.

Edhe këtu nuk ishin të pakta ndikimet e filozofëve reaksionarë të Perëndimit, si të Tomas Karlajlit, Frederik Niçes e të tjerë që heronjtë i bënin gjigandë me fuqi titanike që mund të kryenin mrekullira, ndërsa masat liliputë që hiqeshin zvarrë në marzhet e historisë dhe që vegjetonin e nuk zhvillonin ndonjë veprimtari të rëndësishme.

Nën ndikimin e këtyre pikëpamjeve, historia e Shqipërisë u trajtua si veprimtari e figurave dhe heronjve të shquar. Ideologët e kësaj rryme e reduktuan atë në disa periudha të pakta, si ajo e Skënderbeut, e Rilindjes e ndonjë tjetër, ndërsa të tjerat i konsideruan si njolla të bardha. Kështu, veprimtaria historike e parë nën këtë prizëm ishte tepër e zbehtë dhe e varfër[11]. Nga mohimi i rolit të popu-

9) «Illyria», 15 korrik 1934, f. 1.
10) Po aty.
11) «Vullneti i Arbërisë», 4 mars 1931, f. 1.

llit kalohej në mohimin e rolit dhe të vitalitetit të kombit.

Kombi shqiptar paraqitej me vitalitet të paktë. Ndonjëri shfaqi pikëpamjen se ai nuk ishte në gjendje t'u bënte ballë popujve përreth, gjoja me vitalitet të madh, dhe rrezikonte të zhdukej. Atë po e shtrëngonte gjithnjë e më fort me një lak të fuqishëm — thuhej këtu, — rrethi gjeopolitik i kombeve përreth. Dhe një ditë kombi shqiptar mund të asgjësohej edhe pa u kërcënuar prej ndonjë fuqie[12].

Kjo pikëpamje e kishte burimin në mohimin e aftësive historike të popullit shqiptar, si dhe në teoritë e gjeopolitikës fashiste. Disa «të rinj» u mbajtën ison ideologëve fashistë e imperialistë që mundoheshin të përligjnin politikën imperialiste dhe kolonizuese dhe që bënin thirrje për «Spazio vitale» apo «Lebensraum» dhe për nënshtrimin e popujve të tjerë, gjoja për t'i qytetëruar ata. Në kohën e agresionit fashist kundër Abisinisë «të rinjtë» e përligjën këtë agresion, si dhe agresionin imperialist në përgjithësi, duke arsyetuar se popujt e prapambetur e «primitivë», këta «grumbuj njerëzish» gjoja «pa ndërgjegje të fortë kombëtare» e që nuk ecnin në një hap me kohën, ishin të destinuar t'i nënshtroheshin «vullnetit» të kombeve më të forta me prirje për zmadhim dhe të gllabëroheshin prej tyre[13].

Për popujt «pa vitalitet» gjoja kishte vetëm një rrugë: t'i nënshtroheshin sundimit imperialist dhe kërbaçit të diktaturës fashiste. Kjo ide, e cila i referohej edhe Shqipërisë, ishte në të njëjtën kohë antidemokratike e antikombëtare. Në këtë mënyrë viheshin në dyshim si aftësia krijuese historike e popullit shqiptar, ashtu edhe e drejta e tij për të jetuar i lirë dhe i pavarur.

Masave popullore u mohoheshin të drejtat politike e qytetare. Këto kushtëzoheshin, siç u tha, me shkallën e vetëdijes, me rolin në shoqëri, me aftësinë gjoja për t'i përdorur ato. Edhe ky është një nga mitet që kanë krijuar klasat sunduese për të mbajtur popullin të shtypur e të nënshtruar. Thuhej se populli ishte i papjekur për të gëzuar liritë qytetare dhe mund t'i shpërdoronte ato. Kështu për shembull, liria e shtypit në Shqipëri duhej t'i sigurohej vetëm një pjese të vogël, që dinte ta përdorte atë. Kjo duhej t'u sigurohej atyre organeve që pajtoheshin me regjimin dhe që kishin si parim konformizmin. «Liria e shtypit, nuk është e drejtë natyrore e njeriut primitiv, por një fitim kulturor i njeriut të qytetëruar...»[14]. Shtypi duhej të ishte në duar,

12) «Arbëria», 14 janar 1936, f. 3.
13) Po aty, 7 maj 1936, f. 1.
14) Po aty, 1 prill 1930, f. 1.

të «njerëzve të zotë e të stërvitur», si dhe «të pastër e të kulluar», siç e konsideronin veten «të rinjtë»[15].

Në Shqipëri populli nuk duhej ta gëzonte as të drejtën e votës, të zgjidhej dhe të zgjidhte lirisht. Në vend nuk mund të organizoheshin zgjedhje të lira as për «gjashtëdhjetë vjet», meqenëse populli i paditur, i pakulturuar[16], mund ta përdorte gjoja për qëllime negative këtë të drejtë.

Zgjedhjet e lira do të ishin të frytshme vetëm në rast «se shtetasit do të kishin së paku diplomën e liceut» dhe do «të ishin njerëz në korent të punëve siç është një ministër, një deputet, e një gazetar»[16/1]. Pra, vetëm elita, shtresat e privilegjuara kishin të drejtë të vendosnin për fatet e popullit e të kombit.

2. «DIKTATURA E NDRITUR» — DIKTATURË FASHISTE

Mohimi i hapur i rolit të popullit dhe i të drejtave të tij dhe ngritja në qiell e rolit të heronjve dhe të elitës, lidhej ngushtë në ideologjinë e «të rinjve» me teorinë e «diktaturës së ndritur». Ideja e «diktaturës së ndritur» apo diktaturës fashiste zbulonte akoma më mirë thelbin antidemokratik e reaksionar të kësaj rryme.

«Të rinjtë» shprehën pikëpamjen se diktatura ekzistuese çifligaro-borgjeze duhej të shndërrohej në diktaturë fashiste apo «diktaturë të ndritur», siç quhej per eufemizëm. Për një shndërrim të tillë duhej mbështetur në përvojën e Gjermanisë naziste dhe të Italisë fashiste. Ky shndërrim do të kryhej brenda kuadrit të monarkisë dhe me ndihmën e mbretit.

Pavarësisht nga kritikat që iu drejtuan qeverisë dhe parlamentit, të cilat përbëheshin prej të vjetrish, siç thuhej, «të rinjtë» në përgjithësi e lavdëruan shtetin çifligar borgjez dhe bashkëpunimin e tyre me regjimin zogist e konsideruan si kusht të domosdoshëm për përmbushjen e programit të tyre[17].

Jo më pak se «të vjetrit» ata i thurën lavde triumfit të legalitetit e monarkisë, «reformave» të mbretit Zog. Monarkia edhe prej tyre u cilësua si bartëse e sovranitetit të popullit. Mbreti paraqitej si një monark «oksidental» që

15) Po aty, 28 nëntor 1935, f. 5.
16) Po aty, 5 shkurt 1937, f. 1.
16/1) Po aty.
17) Po aty, 26 shtator 1929, f. 1.

kujdesej për përparimin e vendit dhe kishte vendosur qetësinë shembullore në vend[18].

Vetë shteti, duke përjashtuar prej tij «të vjetrit» që konsideroheshin mish i huaj në të, shprehte sipas tyre vullnetin e përbashkët të popullit dhe lindte nga «homogjeniteti i kulturës, zakoneve, shpirtit dhe racës». Ky ishte një arsyetim sofistik e demagogjik, sepse «të vjetrit»[19] kishin peshë në regjimin zogist dhe i jepnin tonin politikës së tij. Shteti, sidomos forma diktatoriale e regjimit politik, pohohej në vazhdim të këtij arsyetimi, siguronte kinse interesat e të gjithë popullit dhe një zhvillim harmonik të shoqërisë e individit.

Njeriu në shtet, pavarësisht se cilës klasë i përkiste, ishte pjesë e tërësisë. Kjo ide ishte huajtur nga teoritë reaksionare që përpiqeshin të zbatonin konceptet biologjike mbi shtetin e shoqërinë që këto i njëson me organizmin e njeriut dhe që individët i krahasonin me gjymtyrët e trupit. Një teori të tillë e kishin bërë të tyre të gjitha rrymat reaksionare shqiptare.

Diktaturat moderne të tipit fashist lavdëroheshin duke u paraqitur si regjime politike që kishin bërë shumë për zhvillimin e shoqërisë, të kombit dhe individit. Ky ishte një shtrembërim i së vërtetës, një zbukurim i terrorit policor dhe shfrytëzimit të egër në regjimet fashiste.

Përpara se të arrihej te «diktatura e ndritur» që do të ishte forma më e përsosur e regjimit dhe ku frenat do t'i merrte elita borgjeze e edukuar me idetë fashiste, duhej të provoheshin disa forma kalimtare të qeverisjes. Një formë e tillë u konsiderua qeveria «liberale» e Mehdi Frashërit. «Të rinjtë» e paraqitën atë si qeveri të reformave e përparimit, që gjoja hapi një periudhë të re në zhvillimin e vendit, në oksidentalizimin e tij. Ardhja e saj në fuqi u shpall me bujë si fitore e ideologjisë së tyre, si përurimi i qeverisjes së njerëzve me kulturë etj. Lavdërimi i saj nga ithtarët e «diktaturës së ndritur» që ishin kundër demokracisë, nxirrte akoma më mirë në shesh pseudoliberalizmin e qeverisë dhe demagogjinë e klikës zogiste.

Qeveria e Mehdi Frashërit me gjithë premtimet për reforma dhe zhurmën e saj, nuk e përmirësoi aspak gjendjen e vendit dhe gjatë qeverisjes së saj, Shqipëria u robërua më shumë nga imperializmi italian dhe u zhyt më thellë në varfëri. Kur filluan të duken shenjat e dështimit të politikës së saj, «të rinjtë» e ndryshuan tonin euforik dhe krahas lavdërimeve bënë edhe ndonjë kritikë duke e stër-

18) Po aty, 9 tetor 1929, f. 2.
19) Po aty, 30 nëntor 1935, f. 1.

holluar demagogjinë e tyre. Ata e cilësuan qeverinë «liberale» si qeveri «tranzicioni» dhe «ekuilibri» që nuk mund të bënte pastrim rrënjësor në aparatin shtetëror, për të mos shkaktuar konflikt të ashpër midis «të rinjve» dhe «të vjetërve»[20].

Hëpërhë ajo duhej të shërbente si një urë kalimi midis tyre[21]. Qeveria «liberale», sipas tyre, s'mund të kryente shndërrime rrënjësore që parashikoheshin në programin e «të rinjve», sepse në administratën shtetërore ende kishte nga ata që kishin një dozë të konsiderueshme fryme «të vjetrish» dhe mungonte dinamizmi[22]. Misioni kryesor i «tranzicionit», i qeverisë së Mehdi Frashërit ishte të pengonte me të gjitha forcat kthimin e «të vjetërve» në fuqi. Ky pohim tingëllonte paradoksal në një kohë kur «të vjetrit» kishin frenat e pushtetit në duar.

Pengimi i «të vjetërve» për t'u kthyer në fuqi gjoja do të sigurohej më mirë me anë të fashistizimit të regjimit politik e të jetës së vendit[23]. Në këtë lodër fjalësh e sofizmash, bërthama racionale e së vërtetës ishte pohimi i prirjes së klasave sunduese për të forcuar më tej diktaturën reaksionare. Kjo nuk synonte as zhdukjen e «orientalizmit» siç thuhej, dhe as qytetërimin e vendit, por frenimin e zhdukjen e lëvizjeve revolucionare.

Qeveria e M. Frashërit u kritikua se «bëri shumë pak» për fashistizimin e vendit, për «disiplinimin dhe bashkërendimin e të gjitha fuqive dhe energjive kombëtare» në frymën totalitariste e fashiste[24]. Megjithatë asaj i njihej, një meritë me rëndësi dhe këtu «të rinjtë» u treguan të sinqertë, zbuluan thelbin e ideologjisë së tyre, i njihej merita që me anë të politikës demagogjike u përpoq të mënjanonte «gjakderdhjet dhe shkatërrimet që sjellin kryengritjet»[25]. Kjo përbënte një premisë të rëndësishme për ta çuar më tej punën e filluar nga «të rinjtë». Por, duhet thënë se qeveria «liberale» përdori kundër lëvizjeve popullore, jo vetëm kulaçin, por edhe kërbaçin. Masat e egra që u morën kundër demonstratave popullore dhe grevave të punëtorëve ishin dëshmi e kësaj.

«Të rinjtë», duke shfrytëzuar edhe përvojën e sistemeve fashiste, mendonin se ashtu si gjetkë edhe në Shqipëri, mund të përdorej demagogjia shoqërore për vendosjen e diktaturës

20) Po aty, 3 dhjetor 1935, f. 1.
21) Po aty, 4 dhjetor 1935, f. 1.
22) Po aty, 3 dhjetor 1935, f. 1.
23) Po aty, 22 dhjetor 1935, f. 1.
24) «Arbëria» 22 tetor 1936, f. 1.
25) Po aty, 5 korrik 1936, f. 1.

fashiste. Në këtë kuptim qeveria «liberale» ishte një formë kalimtare.

Por, siç dihet, as kjo qeveri dhe as qeveria që erdhi më pas nuk e mposhtën luftën popullore. Lufta e klasave në këtë periudhë u zhvillua më tej dhe lëvizja komuniste e demokratike morën përpjesëtime me rëndësi.

Në kushtet e përgatitjes së ndërrimit të kabineteve dhe të zëvendësimit të qeverisë «liberale» me qeverinë diktatoriale të Koço Kotës që e braktisi demagogjinë dhe zbatoi terrorin e hapur, «të rinjtë» u bënë mbrojtësit e regjimit dhe e përligjën këtë ndërrim. Forcimin e mëtejshëm të reaksionit politik e shpjeguan si një periudhë të re për zbatimin e ideve të tyre dhe si një hap të ri drejt «diktaturës së ndritur».

Që kur ishte në fuqi qeveria e M. Frashërit madje dhe më pas, këta mbrojtës të saj dhe të frymës së re «liberale» që gjoja solli me vete ajo, bënë apologjinë e regjimeve fashiste e të metodave të tyre dhe iu kundërvunë demokracisë. Ata ishin kundër regjimit demokratik, qoftë dhe në formën e demokracisë borgjeze. Ky lloj regjimi konsiderohej dukuri anakronike dhe e papërshtatshme për Shqipërinë, rrezikonte stabilitetin, «konsolidimin e fuqisë, të autoritetit e të drejtësisë» për të cilat vendi kishte nevojë «më fort se kurrë»[26]. Demokracia cilësohej si formë demagogjike dhe e dëmshme e qeverisjes, «si formë për t'i hedhur hi syve popullit»[27]. Kjo tezë ishte huajtur nga ideologët imperialistë, të cilët në kushtet e thellimit të krizës së kapitalizmit parapëlqenin regjimet fashiste. Një tezë e tillë gjeti përhapje edhe në rrethet reaksionare të Shqipërisë, të cilët që nga koha e Revolucionit të 1924-ës, nuk donin t'ia dëgjonin emrin demokracisë.

Nga arsenali i ideologjisë fashiste ishin marrë edhe «argumentet» me të cilat kërkohej të arsyetohej papërshtatshmëria e regjimit demokratik për vendin.

Këtu thuhej se në kushtet e reja historike të shek. XX, kur industria kishte filluar të zhvillohej me ritme të shpejta në shumë vende, sistemi demokratik gjoja shtonte kaosin shoqëror, mbillte përçarjen në çdo fushë dhe acaronte antagonizmat midis klasave e grupeve. Prandaj në këtë gjendje të ndërlikuar e të rrezikshme, diktatura ishte i vetmi shpëtim për popujt (kupto: klasat sunduese)[28]. Aluzioni ishte i qartë. Lufta revolucionare e proletariatit kundër sistemit kapitalist që sa vinte merrte përpjesëtime të dukshme në

26) Po aty, 26 korrik 1930, f. 3; 2 janar 1936, f. 3.
27) Po aty, 2 janar 1936, f. 3.
28) Po aty, 21 shkurt 1936, f. 1.

botë, përbënte një rrezik të madh për këtë sistem, prandaj duheshin ngritur diga kundër valëve përmbytëse të saj. Këto ishin diktaturat fashiste. Diktatura fashiste ishte për klasat sunduese një strehë ku mund të mbroheshin. Çoroditja dhe kalbëzimi i sistemit borgjez në fazën imperialiste, i vishej demokracisë. Në këtë arsyetim ngatërrohej shkaku me pasojën. Demokracia borgjeze gjoja nisej nga përfytyrimi liberal i sovranitetit të popullit. Ajo u kishte dhënë popujve liri e të drejta të tepruara, kishte dobësuar bashkimin, harmoninë, disiplinën dhe organizimin. Prandaj, ishte e nevojshme që kësaj çoroditjeje në botë t'i jepte fund fashizmi[29]. Te klasat sunduese të vendeve kapitaliste fashizmi krijoi një farë iluzioni për zhdukjen e kaosit e sigurimin e qetësisë. Në krijimin e tij ndikoi dhe propaganda fashiste.

Diktaturat fashiste shpalleshin nga «të rinjtë» jo vetëm si mjet i rëndësishëm i qetësisë dhe i rregullit, por edhe si e vetmja alternativë e përparimit dhe qytetërimit[30]. Karakteri i tyre përparimtar kërkohej të deduktohej nga e gjithë historia e përparshme. Në periudhat e diktaturave, njerëzimi sipas tyre kishte arritur lulëzimin më të madh. Kulmi i qytetërimit gjoja u arrit me vendosjen e diktaturave fashiste në Itali, Gjermani e gjetkë.

Duke përsëritur ato çka thoshin ideologët e regjimeve fashiste, «të rinjtë» pohonin se në një sërë vendesh përpara se të vendoseshin këto regjime, popujt ishin në buzë të «greminës», jetonin në «çorganizim të plotë, anarshi, mizerje, dëshpërim, mosdisiplinë»[31]. Me t'u vendosur këto regjime gjithçka ndryshoi dhe zhvillimi mori një rrugë tjetër. Diktaturat fashiste cilësoheshin «diktatura të ndritura» për të gjetur një lidhje birërie midis tyre dhe asaj që duhej të vendosej në Shqipëri, gjithashtu për të zbutur disi përshtypjen që ekzistonte për to në opinionin publik. Në shtyp pati dhe ndonjë polemikë që dukej si farsë. Gazeta «Arbëria» polemizoi me gazetën reaksionare «Vatra» duke e kritikuar këtë të fundit se gjoja parapëlqente regjimin demokratik. Të dyja organet mbronin regjimin reaksionar. Një polemikë e tillë ndiqte synime demagogjike.

Në euforinë e lavdërimit të diktaturës fashiste («të ndritur») u parashtruan një sërë idesh lidhur me mënyrën si do të organizohej ajo në Shqipëri dhe synimet e objektivat që do të arrinte.

«Diktatura e ndritur» duhej të formohej, siç thuhej, nga një elitë intelektuale me synime patriotike e përpa-

29) «Ilyria», 11 prill 1936, f. 1.
30) «Arbëria», 27 maj 1936, f. 1.
31) Po aty, 13 maj 1936, f. 1.

rimtare nga njerëz të aftë e të kulturuar, të pajisur me ideale, që duhej të derdhnin energjitë e tyre në shërbim të popullit e të kombit[32]. Kjo «klasë» vepruese intelektuale së bashku, me «diktatorin» që do të qëndronte në krye e që thuhej se do të ishte mbreti Zog, do të dilnin nga gjiri i popullit e do të shprehnin interesat e tij[33]. Ky zbukurim i diktaturës fashiste ishte i nevojshëm jo vetëm për atë arsye të kuptueshme e të thjeshtë, që gjithçka e shëmtuar në botë mundohet ta fshehë shëmtimin e saj, por edhe për faktin se për shqiptarët fashizmi nuk përbënte një dukuri të panjohur. Ata e njihnin prej kohësh atë dhe po i ndienin mirë në lëkurën e tyre pasojat e politikës së tij të egër imperialiste.

Ishte pikërisht kjo arsyeja që i shtyu «të rinjtë» t'i gjejnë diktaturës fashiste një emër më tërheqës e ta quajnë «diktatura e ndritur».

Përpara se «diktatura e ndritur» të bënte «reforma» në të gjitha fushat si premtohej, e ta reformonte shoqërinë ashtu siç do t'u interesonte klasave në fuqi që i shikonin me një farë zilie regjimet fashiste të Evropës, duhej të bëhej organizimi i saj sipas modeleve të vendeve të tjera. Në këtë organizim mendohej të merrej edhe përvoja e «aleates së madhe», por më shumë parapëlqehej përvoja e regjimit nazist.

«Të rinjtë» ndienin admirim për organizimin nazist në sferat e ndryshme, për frymën totalitariste të regjimit dhe ndikimin e ideologjisë së tij. Një gjë të përafërt do të dëshironin ta realizonin në Shqipëri duke e organizuar «ushtarakisht» «djalërinë» në qytete dhe në fshatra, dhe duke krijuar batalionet e «djalërisë shqiptare» që do t'u ngjanin batalioneve të sulmit në Gjermani[34]. Në këtë organizim ushtarak mendohej të përfshihej gjithë brezi i ri prej moshës 7-vjeçare deri në moshën 35-vjeçare. Në çdo fshat e qytet duhej të kishte një komandë drejtuese dhe një këshill të zgjedhur prej të rinjve. Në krye të gjithë kësaj strukture duhej të ishte «udhëheqësi» apo mbreti. Fjala «udhëheqës» theksohej jo pa qëllim, por në ngjashmëri me titullin e «fynrerit» të nazistëve. Në këtë frymë do të bëhej organizimi edhe në sferat e tjera. Siguristë këtu, siç thamë, do të shfrytëzohej edhe përvoja e Italisë fashiste.

Fashistizimi i brezit të ri u konsiderua faktor kryesor për vendosjen e diktaturës fashiste. Kjo u përputh edhe me synimet e zyrtarëve italianë në Shqipëri, të cilët pasi vendosën ndikimin e tyre në vend, u përpoqën të bënin fashistizimin e sferave të ndryshme, me anë të organizatorëve civilë e ushtarakë që u futën me aparatin shtetëror dhe që filluan t'i imponojnë regjimit zogist format e metodat e organizimit fashist. Një nga këto forma ishte edhe organizimi nga Alberto Pariani i organizatave paraushtarake të rinisë që drejtoheshin nga regjimi zogist. Në gjysmën e dytë të viteve 30, qeveria e Romës, duke nxituar të kryente agresionin kundër Shqipërisë, u përpoq të bënte edhe disa hapa të mëtejshëm për fashistizimin e vendit, sidomos të rinisë. Për këtë u ngarkuan organizatorët fashistë Xhovani Xhiro, Sestilio Montaneli etj.[35] Sestilio Montaneli u shpreh në këtë periudhë në një relacion drejtuar Romës se duhej të kryhej në një kohë të afërme «fashistizimi, italianizimi dhe shballkanizimi i popullit shqiptar»[36]. Por ky plan antishqiptar i imperializmit fashist ndeshi në qëndresën burrërore të popullit, sidomos të lëvizjes komuniste e përparimtare dhe nuk pati sukses. Në këtë situatë «të rinjtë» me projektet dhe idetë e tyre u erdhën në ndihmë zyrtarëve fashistë dhe u bënë përçues të qëllimeve të tyre. Mirëpo këta të fundit kishin nevojë jo vetëm për opinion, por edhe për veprimtari praktike. Prandaj, veç agjentëve të tyre që u përmendën më sipër, pak kohë pasi pushoi zhurma e «të rinjve», vunë në lëvizje edhe disa elementë aventurierë e të shthurur, si Vasil Alarupi me shokë, të cilët krijuan në Korçë sa për formë një organizatë fashiste që nuk zhvilloi ndonjë veprimtari dhe u demaskua nga komunistët.

«Të rinjtë» analizuan, krahas modeleve që do të merreshin për krijimin e «diktaturës së ndritur» në Shqipëri, edhe arsyet pse duhej kjo diktaturë. Ajo duhej para së gjithash për të likuiduar «lëvizjet e brendshme»[37]. Këto lëvizje, thuhej se mund të pengonin veprimtarinë e shtetit për kryerjen e «reformave qytetëruese». Organizimi totalitar nuk mund të lejonte gjoja «rebelizma e çdrejtime energjish dhe kundravajtje me interesat e teorive kombëtare» (kupto të regjimit)[38].

Pra, kujdesi kryesor ishte që të sigurohej qetësia aq e dëshiruar për klasat sunduese, të konsolidohej rendi ekonomiko-shoqëror e politik që ishin tronditur mjaft nga luftërat klasore e politike. Kjo i interesonte dhe borgjezisë shqiptare, e cila dëshironte që në kushte qetësie të rriste shfrytëzimin e punëtorëve dhe fitimet e saj. Ideologët e «diktaturës së ndritur» pohuan se kjo diktaturë do të bashkërendiste «energjitë e grupeve që përbënin shoqërinë, në më-

32) Po aty, 22 shkurt 1936, f. 1.
33) Po aty.
34) Po aty.

35) *Historia e Shqipërisë*, vëll. 3, f. 415, Tiranë, 1984.
36) *Po aty.*
37) «Arbëria», 24 shkurt 1936, f. 1.
38) Po aty, 3 mars 1936, f. 1.

nyrë që secila klasë shoqërore të arrinte një maksimum veprimi dhe zhvillimi pa vajtur në kundërshtim me të tjera klasa të shoqërisë dhe gjithmonë duke pasur për objektiv të mirën kolektive»[39]. Kjo donte të thoshte se duhej të krijohej sipas modelit të fashistëve italianë, një sistem korporativist fashist që të mënjanonte luftën e klasave dhe t'i hapte rrugë shfrytëzimit të popullit nga klasat e pasura. Rregullat e këtij organizimi shoqëror në të mirë të klasave sunduese paraqiteshin si «universale» e në përputhje me interesat e të gjithëve, si rregulla të bazuara gjoja mbi «kritere shkencorë» e që nuk pajtoheshin me «liritë anarqike»[40].

Popullit i premtohej në mënyrë demagogjike se edhe shpërndarja e pasurisë, në «diktaturën e ndritur» do të bëhej sipas këtyre «kritereve shkencore»[41]. Ajo gjoja nuk do të lejonte që një pjesë të jetonte në kurriz të tjetrës dhe të fryhej «në proporcione fantastike», ndërsa pjesa tjetër të varfërohej[42]. Synimi ishte që njerëzit të zotëronin aq pasuri, sa mund të kryenin funksionin shoqëror që kishin, dhe që shoqëria të ruante fizionominë e saj dhe klasat të mbeteshin në vendin e tyre[43]. Pra, pabarazia klasore nuk do të zhdukej dhe, si rrjedhim, shfrytëzimi do të mbetej në fuqi edhe pas zbatimit të «kritereve shkencore». Ajo që duhej të ndryshonte, sipas llogarive që bëheshin, ishte natyra e marrëdhënieve klasore. Mendohej që sistemi korporativist do të kishte fuqi të zbuste kundërthëniet klasore edhe në kushtet e ruajtjes së shfrytëzimit. Propaganda fashiste italiane i kishte bërë mjaft reklamë eksperimentit korporativist.

Duke përshkruar tablonë e harmonisë klasore që mendohej të krijohej «të rinjtë» futnin në klasa edhe kategori sociale si ato të profesioneve e zejeve. Kështu nocioni i klasës errësohej prej tyre jo pa qëllim, por në mënyrë që të maskohej antagonizmi dhe të provohej përputhja e interesave. «Diktatura e ndritur» thuhej me pompozitet se do të kryente reforma të rëndësishme dhe do të zbatonte një ritëm «të nxituar» në fushën e shndërrimeve shoqërore dhe brenda 10-15 vjetëve do të ndryshonte gjendjen në Shqipëri. Por konkretisht nuk thuhej se cilat ishin masat që duhej ta përmirësonin gjendjen e popullit. Thuhej vetëm në përgjithësi se do të zhvillohej ekonomia, bujqësia e shëndetësia e madje premtohej se do të zgjidhej çështja e bukës[44]. Por, si do të arriheshin këto nuk shpjegohej. Një gjë dilte shumë qartë, që vendosja e «diktaturës së ndritur» ose e regjimit fashist, siç thoshte Seit Qemali, ishte e ngutshme për elementët më reaksionarë e profashistë dhe diktohej nga ekzistenca e rrezikut komunist. Kishte vetëm një alternativë: ose diktaturë fashiste ose diktaturë komuniste. «Ata që nuk e duan Shqipërinë nën një diktaturë të djathtë, ta thonë çiltaz që dëshirojnë të mëngjërtën. Të përpiqemi të ngjallim këtu tendencat mesatare që kanë vdekur gjetkë, është një mundim i kotë. Çdo solucion jashtë dy ekstremeve nuk ka stabilitet. Fati e solli të kemi në krye një prijës gjenial, i cili është i zoti të na çojë atje ku janë qytetërija dhe lumturia po qe se dhe ne i japim ato fuqi që u dhanë Musolinit, Hitlerit .... bashkëatdhetarët e tyre...»[45].

Pra, këtu shprehej qartë mendimi që diktatura zogiste të shndërrohej në diktaturë fashiste. Regjimi zogist edhe në këtë formë ishte një diktaturë mjaft e egër dhe kishte bërë jo pak për mbrojtjen e interesave të klasave sunduese. Por kjo diktaturë e urryer për popullin ishte tronditur prej lëvizjeve popullore e revolucionare dhe nuk ndiehej krejt e sigurt. Grupet më reaksionare, të shqetësuar nga «turbullirat» dhe për të forcuar pozitat e tyre, do të dëshironin më mirë një regjim fashist. Pikërisht këto grupe ndihmuan në përgatitjen e agresionit fashist dhe u lidhën me pushtuesin. Komunistët i demaskuan elementët ultrareaksionarë e fashistë si Seit Qemalin me shokë.

Komunisti Halim Xhelo i drejtohej nga Parisi me një letër të hapur demaskuese fashistit Seit Qemali, të cilit i kishte hyrë frika në palcë nga komunizmi dhe përpiqej bashkë me të tjerët të vendoste në Shqipëri regjimin fashist «të ekstremit të zi»[46]. Në këtë kohë edhe revista «Bota e re» e Korçës u shpreh kundër ideve të «diktaturës së ndritur» që i konsideroi të papajtueshme me interesat e popullit e të dëmshme për vendin[47].

Një punë të mirë për stigmatizimin e ideve fashiste bëri revista komuniste e Grupit të Korçës «Përpara», e cila vuri në dukje se këto ide shprehnin interesat e forcave më të

39) Po aty, 28 shkurt 1936, f. 1.
40) Po aty, 3 mars 1936, f. 1.
41) Po aty.
42) Po aty, 3 maj 1936, f. 1.
43) Po aty.

44) Po aty, 29 maj 1936. f. 1.
45) Po aty, 9 qershor 1936, f. 1.
46) H. Xhelo. *Ideolog e militant i shquar revolucionar*. Tiranë, 1975, f. 189.
47) «Bota e re», 30 tetor 1936, f. 16-18.

çoroditura, antipopullore e antikombëtare dhe të imperializmit italian[48].

Ky opinion antifashist dhe kritikat që qarkulluan ndaj «diktaturës së ndritur», dëshmonin për atë që fashizmi e nazizmi, në Shqipëri urreheshin. Sado që përpiqeshin «të rinjtë» e të tjerë të zbukuronin idetë fashiste, ato nuk mundën të përhapen në vend.

3. KRITIKAT KUNDËR LËVIZJES KOMUNISTE

«Të rinjtë», ashtu sikurse dhe «të vjetrit», shigjetat kryesore të kritikës së tyre i drejtuan kundër lëvizjeve revolucionare, sidomos kundër lëvizjes komuniste. Këtë synim kryesor e maskuan me anë të luftës kundër «të vjetërve» rreth së cilës bënë gjithë atë zhurmë.

Si të gjitha rrymat e tjera reaksionare, edhe ata, u shprehën kundër luftës së klasave dhe për arritjen e bashkimit kombëtar. Ndarja e shoqërisë në klasa, lufta e klasave dhe ajo politike u cilësuan si dukuri negative e jonormale që shkaktoheshin nga faktorë subjektivë të brendshëm e të jashtëm. Lufta e klasave, thuhej se mbillte anarkinë e demoralizimin në popull, çonte në humbjen e kotë të energjive dhe të vlerave morale të kombit[49].

Apologjetët e klasave sunduese në përgjithësi kishin prirje ta vizatonin atë me ngjyrat më të zymta, si mbretërinë e kaosit e të shkatërrimit.

Një qëndrim negativ mbahej sidomos ndaj veprimtarisë e luftës politike. Gjetkë, në vende të tjera, thuhej se lufta politike merrte forma të shëmtuara. Kurse në Shqipëri nuk kishte kushte për luftë të tillë dhe nuk duhej të ekzistonin as grupe dhe as parti sepse «elita ishte shumë e vogël dhe nuk mund të përçahej më dysh e më tresh»[50].

Lufta politike nënvleftësohej e mohohej, paraqitej si diçka që tek ne nuk lidhej me klasat e kundërthëniet klasore, por ishte kryesisht rezultat i kombinacioneve të një elite apo edhe të elementëve të veçantë që haheshin midis tyre për ambicie e interesa vetjake, ose që nxiteshin nga jashtë.

Në këtë pikëpamje mbi luftën e veprimtarinë politike pasqyroheshin jo vetëm interesi e dëshira e klasave në fuqi

48) Arkivi Qendror i PPSh. Fondi 1, dosja 7, Revista «Përpara», shtator, tetor, nëntor 1938.
49) «Arbëria», 1 janar 1936, f. 3.
50) Po aty, 4 prill 1936, f. 1.

për të mënjanuar konfliktet e tronditjet në rendin çifligaro-borgjez, por edhe ai fakt real që klasat reaksionare me gjithë epërsitë që kishin, nuk arritën atë shkallë pjekurie e organizimi sa të krijonin organizatat dhe partitë e tyre politike. Kjo papjekuri u pasqyrua dhe në mendimin politik. Politika shkëputej nga baza reale, shpjegohej me motive subjektive e voluntariste. Po kjo aspiratë për paqe klasore që shpinte në minimizimin e luftës politike, në anën tjetër çonte në hipertrofizimin e rolit të ideologjisë së klasave sunduese, së cilës i atribuohej mundësia e farkëtimit të solidaritetit shoqëror dhe e zhdukjes së luftës së klasave.

Problemi i bashkimit kombëtar, i cili duhej të realizohej me anë të edukimit të popullit me një ideologji që t'i bënte të gjithë për vete, merrte rëndësi të madhe. Këtu nuk do të ndalemi në arsyetimet dhe hollësitë e parashtruara prej «të rinjve» mbi domosdoshmërinë e «unitetit kombëtar» dhe mënyrën e arritjes së tij. Prej tyre u përdor po ajo demagogji nacionaliste borgjeze që u përdor dhe nga të tjerët për sigurimin e interesave të atdheut, të harmonisë shoqërore, të homogjenitetit të pikëpamjeve etj.

Nacionalizmi borgjez si dhe në rrymat e tjera njësohej me patriotizmin. Me anë të rrënjosjes së tij në popull, shpresohej që ai të binte në eufori, të harronte hallet dhe shqetësimet. Por në kushtet e rënda ekonomike, shoqërore e politike në të cilat ndodhej ai, kjo ishte një shpresë e kotë. As nacionalizmi borgjez i prodhuar në vend dhe as sistemi korporativist fashist që mendohej të sillej nga jashtë nuk mund ta zhduknin luftën e klasave që ishte një dukuri objektive, një forcë lëvizëse me rëndësi historike.

«Të rinjtë» shprehën se ishin për zhdukjen e «anarkisë së opinioneve» dhe për krijimin e një ideologjie të vetme për gjithë kombin[51]. Të gjitha klasat pa përjashtim, i gjithë populli duhej të kishin një pikëpamje. Por ekzistenca e luftës ideologjike e sidomos e ideologjisë revolucionare e kundërshtonte këtë ide.

Ismet Totoja ishte i mendimit se bashkimi i të gjithë popullit, do të bëhej i mundshëm jo vetëm kur të sigurohej paqja klasore, por edhe kur të likuidohej përçarja fetare dhe ndikimi i ideologjisë së klerit mbi popullin. Ai nga faqet e revistës «Iliria», si dhe me anë të një broshure që botoi në vitin 1934, polemizoi me klerin katolik për problemin e fesë[52]. Ismet Totoja mendonte se mund të zhdukej përçarja fetare dhe ndikimi i fesë në kushtet e rendit shfrytëzues çifligaro-borgjez, të cilin ai dhe të

51) «Illyria», 8 prill 1934, f. 1; «Arbëria», 18 prill 1936, f. 1.
52) I Toto. *Grindje me klerin*, 1934 (broshurë).

tjerë kërkonin ta ruanin e përforconin. Por kjo ishte e pamundur. Rendi shfrytëzues mbronte fenë dhe përçarjen fetare. Përveç kësaj «diktatura e ndritur» që kërkohej të krijohej, nuk mund të mos mbështetej në klerin reaksionar dhe fenë. Të gjitha diktaturat reaksionare janë mbështetur në to. Kështu që pikëpamja e Ismet Totos jo vetëm nuk përputhej me realitetin, por as me atë çka ai dëshironte ta realizonte në tërësi. Kleri reaksionar katolik ishte shumë i ndjeshëm ndaj kritikave dhe prepotent. Ai iu përgjigj me ashpërsi kritikave të I. Totos. Kleri nuk duronte asnjë kritikë, qoftë nga e majta apo e djathta, dhe as uljen e autoritetit të fesë. Ai u përgjigj siç e kishte zakon me fyerje dhe sofizma.

«Të rinjtë» në qendër të kritikës, siç thamë, vunë lëvizjen komuniste e revolucionare. Ata me po atë metodë të mohimit të kushteve të luftës së klasave deshën të mohojnë edhe truallin e lëvizjes komuniste. Ishin të mendimit se në përgjithësi në vendet e zhvilluara të Evropës, idetë e lëvizjet revolucionare ishin produkt i zhvillimit të deformuar të kapitalizmit.

Si rrjedhim i disa teprimeve të tij, në këto vende u shkaktuan gjoja shfrytëzimi i punëtorëve, lëvizja punëtore e komuniste. Kjo prirje pra nuk ishte një rregull, por një anomali. Sipas kësaj pikëpamjeje që nuk ishte origjinale, prirja «ekstremiste» e kapitalizmit që «mbronte kryesisht kapitalin» (sikur të ekzistonte edhe një prirje tjetër kapitaliste që mbronte punën), lindi prirjen ekstremiste komuniste, e cila «ka për qëllim të mbrojë vetëm proletariatin, duke shkelur në mënyrën më të egër kapitalin» që ishte bërë me kursim e sakrifica, si dhe kapitalistët[53].

«Të rinjtë» në këtë mënyrë mundoheshin ta zbukuronin shfrytëzimin kapitalist duke shpikur një variant të kapitalizmit «humanitar», «popullor», gjithashtu të shpjegonin arsyet pse lëvizjet revolucionare bëheshin gjoja të pamundura në truallin e këtij kapitalizmi. Kurse faktet tregonin se lufta e klasave ziente në vendet kapitaliste. Po të qe se ekzistonte ndonjë kapitalizëm humanitar, nuk do të kishte as luftë revolucionare.

«Të rinjtë» pohonin se në Shqipëri gjendja paraqitej ndryshe. Këtu mungonin kapitalistët e punëtorët dhe rrjedhimisht edhe lufta midis tyre.

Në Shqipëri thuhej se nuk ekzistonte një «lëvizje ose propagandë komuniste në ndonjë kuptim serioz»[54] dhe as

53) «Vullneti i Arbërisë», 6 shkurt 1931, f. 1.
54) «Arbëria», 10 maj 1936, f. 1.

një «organizatë ose parti politike e mbështetur mbi doktrinën komuniste»[55].

Idetë komuniste, sipas këtyre ideologëve, u shfaqën për herë të parë në Lëvizjen e Fierit dhe gjatë qeverisjes së Mehdi Frashërit, u fol shumë për to, por ato nuk duhej të shqetësonin njeri, sepse nuk kishin forcë dhe përhapje. Dhe kjo thuhej në një kohë kur idetë komuniste u përhapën në Shqipëri dhe patën ndikim në popull e sidomos në rininë. Këto ide madje u materializuan në një farë shkalle edhe në veprimtarinë revolucionare. «Të rinjtë» ndryshe nga «të vjetrit» mundoheshin t'i minimizonin ideologjinë dhe veprimtarinë komuniste e revolucionare shqiptare. Kështu, ata u shtirën se nuk u shqetësuan aq shumë nga «Demonstrata e bukës» në Korçë dhe të tjera, siç bënë «të vjetrit». Për mendimin e tyre këto ishin shpërthime që nuk lidheshin me idetë komuniste, por nxiteshin nga elementët ngatërrestarë. Ata profetizonin se gjoja edhe sikur e gjithë Evropa të bëhej komuniste, Shqipëria nuk mund të bëhej kurrë e tillë[56]. Por sulmet dhe kritikat e tyre kundër lëvizjes komuniste dhe «anarkisë së opinioneve», si dhe predikimet se «diktatura e ndritur» do t'u jepte fund «turbullirave e kryengritjeve», dëshmonin se edhe ky grup ideologjik reaksionar nuk qëndroi indiferent ndaj përhapjes së ideve dhe të luftës revolucionare. Madje «të rinjtë» bënë një luftë më të rafinuar e më të maskuar kundër lëvizjes revolucionare. Ata veshën lëkurën e kameleonit duke i atribuar vetes synime përparimtare e qytetëruese.

Idetë e «të rinjve» qarkulluan deri në fund të vitit 1936. Me zëvendësimin e kabinetit të Mehdi Frashërit me atë të K. Kotës, A. Zogu e pushoi edhe polemikën midis «të rinjve» e «të vjetërve». «Të rinjtë» e kryen misionin e tyre demagogjik në mbështetje të qeverisë e të regjimit. Në fazën e re klika zogiste parapëlqeu metodën e terrorit kundër lëvizjes revolucionare dhe luftës për demokracinë.

55) Po aty, 10 dhjetor 1936, f. 1.
56) Po aty, 19 maj 1936, f. 1.

KREU III

PIKËPAMJET E «NEOSHQIPTARIZMËS»

Një rrymë tjetër borgjeze e këtyre viteve, sikurse u përmend më parë, ishte «neoshqiptarizma». Ashtu si dhe ideologjia e «të rinjve», ajo ishte një ideologji e intelektualëve borgjezë që nuk pati shumë ithtarë. Themeluesi kryesor i saj ishte Branko Merxhani, një intelektual, i cili kishte kryer studimet jashtë vendit dhe ishte i pajisur me kulturën perëndimore sidomos me kulturën frënge.

«Neoshqiptarizma» lindi në fund të viteve 20 dhe u zhvillua më tej në vitet 30. Që në fillim u paraqit gjithë zhurmë, si një përpjekje e rëndësishme për krijimin e një filozofie e sociologjie shqiptare që nuk kishte gjoja karakter politik, madje si një doktrinë origjinale. Në të vërtetë, ajo ishte përçuese dhe përhapëse në Shqipëri e ideve reaksionare pozitiviste të Ogyst Kontit, Emil Dyrkheimit etj.

Transplantimi i pozitivizmit dhe i ndikimeve të tjera të huaja në vend u bë në ato rrethana kur, siç ka theksuar shoku Enver Hoxha, vendi ynë ishte «...me zhvillim shoqëror të prapambetur, me zhvillim arsimor e kulturor akoma me të ulët, të disniveluar në kulm, të ndikuar nga shumë rryma kulturore të jashtme...»[1].

1) Enver Hoxha. *Raporte e fjalime 1965-1966*, f. 365.

Ideologët borgjezë të kësaj periudhe ishin të prirur për kopjimin e pikëpamjeve filozofike e sociologjike reaksionare «oksidentale», të cilat menduan t'i zbatonin në kushtet e vendit. Ata i parashtruan ato në mënyrë eklektike. «Neoshqiptarizma» ishte ideologjia që iu drejtua, më shumë nga të gjitha, shkollave perëndimore. Shkolla më me autoritet për të ishte pozitivizmi, tek e cila u mbështet.

Filozofia e sociologjia pozitiviste kishin dalë në arenën e mendimit që në shekullin e kaluar. Themeluesi i tyre ishte sociologu frëng Ogyst Konti, i cili njihet edhe si krijuesi i parë i sociologjisë borgjeze. Sociologjia pozitiviste kontiste doli si reaksion kundër marksizmit dhe si një rrymë e re ideologjike e borgjezisë, e cila synonte të pajtonte kundërthëniet klasore midis proletariatit e borgjezisë, të sabotonte luftën e klasave që sa vinte e forcohej. Sistemin pozitivist kontist e bënë të tyren edhe filozofë e sociologë të vendeve të tjera borgjeze. Kështu rryma pozitiviste mori përhapje të gjerë në Evropë e në vende të tjera të botës. Por ajo nuk mundi t'i bëjë ballë marksizëm-leninizmit dhe luftës revolucionare në rritje. Kështu që në dhjetëvjeçarët e parë të shek. XX ndikimi i saj në vendet e zhvilluara u dobësua. Borgjezia krijoi rryma të reja në përshtatje me rrethanat e reja. Megjithatë në vendet e prapambetura ndikimi i pozitivizmit u ndie më vonë. Në disa vende të Evropës dhe të Amerikës Latine idetë pozitiviste kishin gjetur truall në vitet 20-30 të shek. tonë. Ato depërtuan edhe në Shqipëri me anë të «neoshqiptarizmës». Përhapja e pozitivizmit në vendet e prapambetura shpjegohet me faktin se ai për kushtet kur lindi (shek. XIX) krahas anës reaksionare (që ishte kryesore) që synonte në pajtimin e kontradiktave dhe forcimin e sistemit shfrytëzues borgjez, kishte dhe ndonjë anë përparimtare kur pohonte idetë e progresit të përhapjes së shkencës e kulturës, ide këto që drejtoheshin kundër mbeturinave të fuqishme të feudalizmit e ndikimit të fesë.

Ai shfrytëzoi edhe idetë racionaliste e përparimtare të Dekartit etj. Por në thelb ishte një sociologji reaksionare. Dishepujt e Kontit e forcuan më tej tendencën reaksionare të kësaj shkolle. «Neoshqiptarët» u ndikuan si nga Konti, ashtu edhe nga pasardhësit e tij, si Dyrkheimi e të tjerë. Ata siç thamë, i përzien rrymat e ndryshme duke vënë krahas pozitivizmit të Kontit, Dyrkheimit, Renanit etj. edhe filozofinë e jetës të Frederik Niçes, të Anri Bergsonit e të tjera. Branko Merxhani në këtë periudhë ndoqi me vëmendje arritjet e reja të filozofisë borgjeze dhe u entuziazmua nga filozofi spiritualist bashkëkohës i tij Anri Bergsoni, i cili ishte tepër në modë në Perëndim sidomos në Francë.

Ai mbante leksione të zjarrta në Sorbonë, ku me një stil të përpunuar e të rafinuar shtjellonte arritjet e fundit të idealizmit e të teologjisë së re që i duheshin aq shumë borgjezisë për të luftuar idetë përparimtare.

Po në këtë kohë në Francë jetoi dhe punoi edhe pozitivisti Levi Bruhl i cili nxori teorinë antishkencore se gjoja popujt primitivë e të pazhvilluar nuk e kishin të menduarit logjik. Kësaj teorie iu referua edhe Branko Merxhani. Levi Bruhl më vonë e braktisi vetë teorinë, se e pa që nuk kishte bazë, dhe u kundërshtua nga të dhënat e shkencës moderne. Një teori akoma më reaksionare ishte ajo e sociologut Gustav Lë Bon, i cili kishte shpikur sipas oreksit të borgjezisë se masat popullore ishin gjoja turma të egra, impulsive, me instinkte dhe pa logjikë.

Themeluesi i «neoshqiptarizmës» kishte një farë njohjeje edhe për strukturalistin Levi Stros, si dhe për një sërë sociologësh e filozofësh të tjerë. Kështu, «neoshqiptarizma», edhe pse pretendonte se ishte një sociologji shqiptare, nuk ishte gjë tjetër veçse një amalgamë idesh e pikëpamjesh të huaja të lidhura keq njera me tjetrën. Madje kishte raste kur midis ideve reaksionare të filozofëve e sociologëve imperialistë futeshin edhe disa ide të filozofëve përparimtarë të borgjezisë, si Dekartit e ndonjë tjetër. Eklektizmi «neoshqiptar» arriti deri aty sa të hiqej edhe ndonjë paralele midis pozitivizmit idealist e materializmit historik dhe të gjendeshin gjoja pika afrimi midis tyre.

Pikëpamjet «neoshqiptare» në përgjithësi kishin karakter idealist, spekulativ e elitarist. Ato synuan jo aq në afirmimin e progresit, siç thuhej, por kryesisht në forcimin e rendit ekzistues me anë të krijimit të solidaritetit shpirtëror (kulturor e moral) dhe zhdukjes së luftës klasore. Rryma «neoshqiptare» shpalli sa për formë apolitiçizmin borgjez si parim, në një kohë kur mbrojti realisht politikën e klasave sunduese dhe përligji teorikisht konformizmin politik. Ajo iu kundërvu përparimit të vërtetë revolucionar dhe parapëlqeu përparimin e ngadalshëm evolucionist borgjez. Pikëpamjet «neoshqiptare» u shfaqën për herë të parë në gazetën «Demokratia» të Gjirokastrës në vitin 1928[2]. Më pas ato u shtjelluan edhe në një sërë organesh të tjera si: «Neoshqiptarizma», «Minerva», «Iliria» e në mënyrë të veçantë në revistën «Përpjekja shqiptare» që ishte organ kryesor i «neoshqiptarëve».

Siç thamë, në këtë kohë edhe të tjerë u vetëquajtën «neoshqiptarë», por flamurin e «neoshqiptarizmës» e pretenduan Branko Merxhani dhe pasonjësit e tij.

2) «Demokratia», 8 dhjetor 1928.

Ideologët e saj e shpjeguan lindjen e «neoshqiptarizmës» me detyrat e reja historike që dilnin përpara elitës së shoqërisë shqiptare pas themelimit të monarkisë. Këto detyra nuk ishin as të karakterit ekonomik e shoqëror dhe as politik, por thjeshtë detyra kulturore. Pra, synimi kryesor ishte të zhvillohej vendi më tej në rrugën borgjeze me anë të kulturës.

Shpallja e monarkisë paraqitej si një kurorëzim i suksesshëm i shndërrimeve të rëndësishme sidomos në fushën politike. Me monarkinë zogiste gjoja u kurorëzuan pozitivisht të gjitha përpjekjet e shqiptarëve për pavarësi dhe për krijimin e forcimin e shtetit të tyre[3].

Monarkia konsiderohej baza mbi të cilën duhej mbështetur për të zhvilluar më tej veprimtarinë shoqërore (kulturore) për përparimin e qytetërimin e vendit. Pra, «neoshqiptarët» u bënë shprehës të interesave të borgjezisë, e cila parapëlqente qetësinë dhe rendin qoftë edhe në diktaturën zogiste, për të forcuar shkallë-shkallë pozitat e veta dhe për të përmbushur objektivat që i kishte vënë vetes.

Natyrisht, regjimi monarkik me politikën e tij antidemokratike dhe antikombëtare, me mosinteresimin për zhvillimin dhe kaosin që kishte krijuar në vend, me urrejtjen e kundërshtimin që kishte shkaktuar në masat e popullit, nuk i favorizonte si duhej stabilitetin e dëshiruar nga borgjezia dhe zhvillimin e marrëdhënieve borgjeze. Por në këto rrethana kjo klasë e dobët dhe e trembur nga lëvizjet popullore u pajtua me gjendjen. Natyrisht, pati nga borgjezia edhe grupe e elementë të pakënaqur nga regjimi që mbajtën qëndrim «opozitar». Por edhe këta e treguan veten të pafuqishëm.

Përfaqësuesit intelektualë borgjezë, shpresonin se evolucioni shoqëror i vendit në rrugën borgjeze sidomos zhvillimi me anë të kulturës do ta përmirësonte gjendjen në favor të saj, do ta forconte stabilitetin e rendit dhe do të krijonte kushte më optimale për klasën e tyre. Por këto ishin dëshira që nuk përputheshin me realitetin.

«Neoshqiptarët» duke parapëlqyer evolucionizmin e konformizmin ishin kundër çdo veprimtarie politike dhe veprimtarinë reformuese e «qytetëruese» e reduktuan në reformat kulturore, në zhvillimin e përhapjen e kulturës borgjeze. Parulla e njohur «neoshqiptare» ishte: «Politikë s'ka — vetëm kulturë». Këtu shprehej në radhë të parë prirja idealiste e hipertrofizimit të rolit të ideve dhe kulturës në shoqëri, nën ndikimin sidomos të pozitivizmit. Me anë të saj përligjej gjithashtu konformizmi politik i intelektualëve borgjezë, dëshira e tyre për ta ruajtur të patronditur rendin ekzistues. Si objekt kryesor imediat u konsiderua «krijimi i një jete mendore», si dhe «i principeve mbështetëse sociologjike të jetës kombëtare»[4]. Vetëm pasi të krijohej sociologjia «neoshqiptare» dhe të përhapeshin idetë e saj në njerëzit e rinj, mund të realizoheshin reformat e dëshiruara dhe të përparohej e të qytetërohej vendi. Meqenëse prapambetja e përgjithshme e tij e kishte burimin sipas tyre në zhvillimin e pakët kulturor, edhe përparimi duhej të sigurohej me anë të zhvillimit të kulturës, të shkencës dhe edukatës.

Pra, çështja ishte të krijohej një qytetërim i vërtetë shpirtëror borgjez dhe jo thjesht material. Deri në shpalljen e monarkisë thuhej se veprimtaria e zhvilluar kishte pasur karakter kryesisht politik, ndërsa pas shpalljes së saj filloi periudha e re e zhvillimit të një veprimtarie «të fuqishme mendore qytetëruese»[5]. Krijimi i një kulture borgjeze të zhvilluar që do të shërbente si faktor themelor i përparimit të vendit, mbahej si detyra kryesore e periudhës. Kjo detyrë duhej të zgjidhej në bashkëpunim me monarkinë. Ashtu si dhe «të rinjtë», edhe «neoshqiptarë» në mënyrë konformiste i atribuan regjimit reaksionar një mision qytetërues. Sipas tyre në këtë fazë nuk duhej të ndërmerrej asnjë përpjekje për ndryshimin e marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore e politike ekzistuese dhe të instituteve që u përgjigjeshin atyre, sepse gjendja e një shoqërie dhe përparimi i saj nuk varej prej tyre, por prej ideve, prej shkallës së zhvillimit të kulturës, prej mentalitetit të saj. Po të zhvillohej kultura dhe të ndryshonte mentaliteti, do të zgjidhej gjithçka si me magji dhe do të shëroheshin të gjitha plagët e trashëguara nga e kaluara. Marrëdhëniet dhe institutet mund të mbeteshin po ato dhe idetë mund ta ndryshonin krejt përmbajtjen e tyre. Kjo pikëpamje sofistike e «neoshqiptarëve», ishte një pikëpamje idealiste e reaksionare mbi shoqërinë.

1. METODA IDEALISTE E SHPJEGIMIT TË ZHVILLIMIT TË SHOQËRISË

«Neoshqiptarizma» pra, në shpjegimin e dukurive shoqërore dhe të zhvillimit historiko-shoqëror, u udhëhoq nga metoda idealiste. Ajo, duke kopjuar metodën pozitiviste,

3) Po aty.

4) Po aty.

5) Po aty, 7 mars 1931.

mori në radhë të parë prej saj atë ide që pohonte se zhvillimi historik kryhej me anë të ideve, kulturës dhe moralit që ishin përcaktuese, si dhe agnostiçizmin kontist që shtronte si detyrë vetëm konstatimin dhe shpjegimin empirik të dukurive, pa hyrë në thelbin e tyre, i cili gjoja nuk mund të zbulohej. Me këtë lidhej empirizmi dhe fenomenalizmi i theksuar, të cilët nuk lejonin të gjendeshin shkaqet e vërteta të dukurive e ngjarjeve historike-shoqërore dhe të formuloheshin ligjet e vërteta në bazë të strukturës së brendshme të tyre e të lidhjeve objektive reale. Pozitivizmi ndikoi edhe me konvencionalizmin e tij, që teorinë shkencore nuk e shihte si pasqyrim të realitetit e të ligjeve të tij, por thjesht si një strukturë e skemë logjike arbitrare dhe konvencionale. Ai ndikoi edhe me natyralizmin e vet, i cili zhvillimin e shoqërisë e shpjegonte në mënyrë mekaniciste me anë të ligjeve të shkencave të natyrës si ato të fizikës (teoria e statikës dhe e dinamikës), apo të biologjisë etj.

Nga kontizmi u mor skema idealiste, konvencionaliste e 3 fazave të zhvillimit të shoqërisë në bazë të së cilës në të gjitha vendet shoqëria kalonte nëpër tri faza: faza teologjike apo e fesë që përfshinte shoqërinë që nga kohët primitive deri në mesjetë e më pas kur sundoi feja, faza metafizike apo e ndikimit të filozofisë sidomos të materializmit, të cilin pozitivizmi e urrente më shumë se fenë, si dhe faza e fundit dhe më e larta, faza «pozitiviste» apo e lindjes dhe zhvillimit të sistemit borgjez, e cila duhej të arrinte kulmin gjoja me idetë dhe projektet e Ogyst Kontit. Pra, kjo ishte një lloj triade që zbukuronte, idealizonte dhe përjetësonte sistemin kapitalist.

«Neoshqiptarët» huajtën një sërë idesh edhe nga pozitivistët e tjerë, pasardhësit e Kontit. Kështu nga Dyrkheimi huajtën teorinë e tij të përfytyrimeve kolektive apo të psikologjisë shoqërore idealiste, e cila donte të krijonte në pamje të jashtme përshtypjen se ishte një risi dhe se merrte në konsideratë realitetin shoqëror, por që në fakt përfaqësonte një prirje idealiste.

Këtë iluzion optik te Dyrkheimi e krijonte fakti që këto dukuri psikologjike i mori në rrafshin kolektiv e në një plan të gjerë. Por «përfytyrimet kolektive» nuk pasqyronin marrëdhëniet reale dhe ishin një shtrembërim i tyre. Nga Dyrkheimi u mor edhe pikëpamja pluraliste që u pohua dhe nga të tjerë, e cila i kundërvihej monizmit materialist, sipas të cilës nuk kishte faktor të privilegjuar (material) që të përcaktonte zhvillimin e shoqërisë, por çdo faktor në kushte të caktuara e të veçanta mund të bëhej përcaktues. Një rol të tillë mund të kishin edhe faktorët shpirtërorë. Sipas kësaj pikëpamjeje nuk mund të kishte hierarki faktorësh dhe as

faktorë primarë e sekondarë. Kjo drejtohej kundër materializimit dialektik e historik.

Thamë më sipër sesi «neoshqiptarët» nuk lanë pa shfryzuar edhe teorinë e gabuar të Levi Bruhlit për mungesën e të menduarit logjik te njerëzit primitivë. Kjo teori iu desh atyre për të dalluar fazat e historisë sonë, fazën primitive paralogjike dhe për të vënë në dukje hapin e madh që do të bëhej gjoja nga pikëpamja e zhvillimit mendor e kulturor në fazën pozitiviste (borgjeze). Madje këtë fazë primitive e sollën deri në kohën e tyre. Për mbrojtjen e kultit të heronjve dhe të elitës dhe përçmimin e përbuzjen e rolit të masave në histori, u shfrytëzuan po ashtu teoritë reaksionare të Tomas Karlajlit, të Frederik Niçes e të tjerëve që ishin aq të përhapura në botën borgjeze. Këto ngrinin në qiell rolin e heronjve në histori, të cilët i bënin si gjysmë perëndi e farkëtues të progresit dhe mohonin rolin e masave. Masat paraqiteshin si një materie inerte që gjoja i bënte qëndresë zhvillimit historik.

Në themel të shpjegimit idealist të zhvillimit historik, qëndronte pikëpamja se zhvillimi i shoqërisë bëhej me anë të ideve, kulturës, shkencës, moralit dhe edukatës, pra me anë të faktorëve shpirtërorë. Jeta shpirtërore konsiderohej primare dhe sublime, ndërsa jeta materiale sekondare dhe vulgare.

Nga kjo pikëpamje subjektivja kishte epërsi mbi jetën objektive materiale dhe kjo e fundit ishte e përkohshme dhe kalimtare, ndërsa jeta subjektive e përjetshme dhe pa kufi. Këtu binte erë idealizmi dhe feje njëherazi. Branko Merxhani ishte i mendimit se idetë dhe sidomos idealet që ishin një formë më e lartë e tyre ishin «një gjë misterioze që gjendej kurdoherë jashtë lëndës dhe interesit»[6].

Pra, idetë nuk kishin as burim material dhe as përmbajtje klasore. Idetë e vërteta u përkisnin të gjitha klasave dhe të gjithë shoqërisë. Ato qëndronin mbi lëndën si një forcë e jashtme që vepronte mbi këtë të fundit.

Branko Merxhanit i pëlqente të përdorte frazën latine «Mens agitat molem» (Mendja vë në lëvizje lëndën). Me këtë donte të thoshte se lënda ishte diçka pasive dhe inerte dhe se nuk mund të vihej në lëvizje ndryshe veçse me anë të ideve. Edhe masa, populli, pa këto ide, konsiderohej po ashtu një lëndë inerte.

Roli primar i ideve në shoqëri e shtynte «neoshqiptarizmën» të përqafonte determinizmin shpirtëror (idealist) dhe ta mohonte determinizmin materialist.

Në bazë të këtij determinizmi faktori shpirtëror ishte

6) Po aty, 9 mars 1929, f. 3.

pothuaj absolut në përcaktimin e të gjitha dukurive të jetës shoqërore. Kështu niveli dhe gjendja e ideve përcaktonin dhe gjendjen e shoqërisë e të institucioneve shoqërore.

Arsyet e prapambetjes së Shqipërisë, të gjendjes së saj ekonomiko-shoqërore dhe të institucioneve të saj nuk duheshin kërkuar aspak në jetën lëndore të saj, në faktorët ekonomiko-shoqërorë, por në idetë dhe mentalitetin e shqiptarëve të kësaj periudhe. Shoqëria dhe institutet e saj nuk mund të ishin të rregulluara mirë përderisa në konceptet mbi to ekzistonte një kaos, i cili ishte rezultat i robërisë turke dhe i «një tronditjeje historike-shoqërore të pakapshme»[7].

Ky kaos ishte i theksuar «në gjuhën, në familjen, në idetë dhe tendencat shoqërore të njerëzve, ca më shumë në kuptimet mbi formën dhe esencën e instituteve shoqërore»[8]. Ishte, me një fjalë, një kaos idesh e konceptesh.

E gjithë vështirësia e problemit qëndronte në faktin se ky kaos duhej likuiduar në një kohë kur nuk njiheshin shkaqet e tij të vërteta dhe kur shkaku kryesor ishte një «tronditje historike-shoqërore e pakapshme» që tingëllonte si diçka mistike. «Neoshqiptarizma» nën shembullin e pozitivizmit nuk merrej me kërkimin e shkaqeve të thella, se kjo i dukej një punë e kotë dhe e papajtueshme me frymën e shkencës. Për atë, kryesore ishte që të ndryshoheshin idetë dhe mentaliteti dhe gjithçka do të shkonte mbarë. Në fakt asnjë shkencë dhe asnjë fushë e dijes nuk bën pa kërkimin e shkaqeve. Njeriu në çdo hap që bën në drejtim të njohjes e të dijes, i bën vetes këto dy pyetje të mëdha e bazale: pse? si? Ai është qenia që kërkon shkaqet. Ndërsa për pozitivistin është qenia që i mënjanon shkaqet, një qenie vrojtuese.

Duke i parë gjërat nën dritën e pikëpamjeve idealiste të Emil Durheimit e të tjerëve mbi «përfytyrimet kolektive», Branko Merxhani ishte i mendimit se pikërisht në idetë kolektive-shoqërore e jo në idetë individuale që krijonin kaos, e kishte burimin e vërtetë zhvillimi historik. Pra, duhej mënjanuar gjoja solipsizmi, të parët e botës nën prizmin vetiak (individual). Por, ky solipsizëm individual në fakt zëvendësohej me një solipsizëm tjetër, me atë të përfytyrimeve që ishte gjithashtu një konceptim idealist i shoqërisë. Mbi bazën e ideve kolektive gjoja krijohej shoqëria e vërtetë, institucionet e saj, bile dhe vetë kombi. Me një fjalë, nuk ishin «përfytyrimet kolektive» rezultat i marrëdhënieve reale shoqërore, por marrëdhëniet shoqërore

7) Po aty, 9 shkurt 1929
8) Po aty

ndërtoheshin në bazë të tyre. Ky ishte një iluzion optik idealist. Në këtë frymë e interpretoi ideologu «neoshqiptar» edhe thënien e Niçes se «çdo popull që të rrojë e të tregojë veten, më parë nga të gjitha duhet të organizojë kaosin në Unin e tij»[9]. Por, ideali i Niçes nuk ishte ideali «social» e «kolektiv», por ai i mbinjeriut, i individëve të etur për pushtet që sundojnë mbi masën «barbare» e «të nënshtruar».

Në fund të fundit edhe ky ideal niçean, ashtu si ai pozitivist ishte një ideal antidemokratik që synonte të forconte pozitat e klasave sunduese kundrejt klasave të shtypura.

Në shpjegimin idealist të dukurive shoqërore-historike, ideologu kryesor «neoshqiptar» nën ndikimin e Dyrkheimit, i kundërvuri monizmit materialist pluralizmin. Sipas tij faktori ekonomik nuk kishte ndonjë pozitë të privilegjuar në zhvillimin e shoqërisë, por ishte njësoj si të tjerët dhe ndikonte barabar me të tjerët mbi zhvillimin shoqëror. Dyrkhejmi me anë të pluralizmit të faktorëve shoqërorë synonte të mohonte materializmin dhe të pohonte idealizmin. Vetë pranimi i «përfytyrimeve kolektive» si burim i të gjitha fenomeneve shoqërore e vërtetonte këtë.

Edhe Branko Merxhani në këtë frymë u shpreh në revistën «Illyria» kur thoshte se «nuk janë vetëm iderat që influencojnë mbi fatin e një shoqërie, është edhe epoka, është edhe gjendja e re e sendeve, janë edhe konditat e reja të jetës dhe nevojat e saj. Dhe këto ushtrojnë një influencë misterioze mbi idetë dhe mbi dispozitat tona»[10].

Historia dhe zhvillimi i jetës reale mbulohej me vellon e të panjohurës dhe të misterit. Për arsye të agnostiçizmit dhe fenomenalizmit pozitivist që historinë e konsideronte si një rezervuar të mbushur me sende e dukuri pa lidhje kauzale, por me lidhje krejt të rastit, kërkimi i këtyre shkaqeve konsiderohej si një punë boshe dhe pa grat. Në këtë kaos të botës materiale pa lidhje kauzale, vetëm «përfytyrimet kolektive» mund të vinin një farë rregulli.

Pra, ky nuk ishte një rregull i brendshëm i botës, sepse asaj i mungonte gjoja një gjë e tillë, por një rregull dhe një ligjësi konvencionale e krijuar me anë të mendjes. Kështu, konvencionalizmi dhe mekanicizmi bëhej metodë e shpjegimit të dukurive shoqërore e historike.

Historia tek «neoshqiptarët» ishte shumë e thjeshtëzuar dhe pa kurrfarë ligjësie dhe dinamizmi. Ajo përbëhej nga

9) «Illyria», 18 prill 1936.
10) Po aty, 1 korrik 1934, f. 2.

3 elementë: nga koha, mjedisi gjeografik, grumbulli njerëzor. Të gjitha këto elementë lidheshin mekanikisht me anë të ideve.

«Neoshqiptarët» e kopjuan nga kontizmi dhe skemën mekaniciste mbi statikën dhe dinamikën e zhvillimit historik sipas së cilës në fillim dukuritë shoqërore duhen parë ashtu siç janë në gjendjen e tyre statike, duhen studiuar mirë e mirë, (por pa kërkuar shkaqet) duhen përpunuar idetë mbi këto dukuri dhe pastaj në fazën e zbatimit të këtyre ideve të kalohet në dinamikën sociale ose në kryerjen e reformave shoqërore që nuk prekin aspak strukturat shoqërore ekzistuese dhe institutet ekzistuese, por vetëm i përmirësojnë ato.

Zbatimi mekanicist i ligjeve të fizikës e në përgjithësi të natyrës në shoqëri kishte për qëllim mohimin e ligjeve të vërteta objektive të historisë dhe interpretimin e saj sipas dëshirës e në mënyrë voluntariste. Ai kishte për qëllim gjithashtu të mënjanonte evidentimin e proceseve revolucionare të zhvillimit të shoqërisë.

Branko Merxhani duke u mbështetur në pluralizmin idealist të Durkhejmit shikonte si faktor të zhvillimit të shoqërisë krahas faktorëve të tjerë edhe fenë, merita kryesore e së cilës qëndronte gjoja në bashkimin dhe disiplinimin e masave të popullit me anë të dogmave dhe të moralit fetar, si dhe në rritjen e energjisë së veprimit të grupeve dhe individëve. Kjo arrihej gjoja jo me anë të elementit racional, i cili mungonte te feja, por me anë të elementit mistik, i cili kishte forcë të madhe organizuese te masat primitive që nuk kishin të menduarit logjik, sipas teorisë së Levi Bruhlit e të tjerëve[11].

Në bazë të kësaj teze, zhvillimi dhe përparimi i popujve më shumë ishte favorizuar nga dogmat dhe mistiçizmi sesa nga racionalizmi. Dogmat gjoja frymëzonin besim dhe ndjenjën e sakrificës. Kjo ishte një mbrojtje e hapur e fesë dhe e obskurantizmit.

Në këtë mënyrë, irracionalizmi, sipas saj, në zhvillimin historik fitonte një farë epërsie mbi racionalizmin. Edhe ky koncept ishte po ashtu i rrënjosur në sociologjinë pozitiviste të Ogyst Kontit dhe të ndjekësve të tij, të cilët me gjithë kultin e arsyes e të shkencës duke luftuar materializmin, ranë shpeshherë në pozitat e spiritualizmit dhe të fesë. Dhe rrugë tjetër nuk kishte. Idealizmin një hap fare i vogël e ndan nga feja.

«Neoshqiptarët» e shikonin fenë si element të rëndësi-

11) «Demokratia», 9 mars 1929, f. 3.

shëm të kulturës e të zhvillimit pikërisht për forcën e saj mistike bashkuese e disiplinuese, për vënien nën fre të popullit.

2. KUNDËRVËNIA E INDIVIDIT SHOQËRISË. KULTI I HERONJVE DHE I ELITËS

Në pikëpamjet «neoshqiptare» ishte shumë i përhapur koncepti i njohur metafizik se individi dhe shoqëria janë dy gjëra me përmbajtje të ndryshme, të kundërta dhe të papajtueshme. Ky koncept ishte i huajtur nga pozitivizmi dhe në përgjithësi nga sociologjia idealiste. Individi ishte gjoja bartës i interesave materiale egoiste, i zhveshur nga idealet.

«Idealin, — shkruante Branko Merxhani, — mund ta kishte vetëm jeta shoqërore», por jo «jeta individuale që jepte vetëm përfitim material»[12].

Një kundërvënie e tillë, e cila përshkon rrymat idealiste, është antishkencore dhe antihumanitare. Kjo vjen nga moskuptimi i thelbit shoqëror të individit, i faktit që personaliteti njerëzor është pasqyrimi i tërësisë së marrëdhënieve shoqërore. Në këtë pikëpamje pasqyrohet edhe kontradikta e thellë midis individit e shoqërisë në rendin shfrytëzues dhe atomizimi e thërrmimi jashtë mase i kësaj shoqërie.

Individi i zakonshëm konsiderohej si egoist nga natyra, një atom i shkëputur krejt nga të tjerët, që nuk kishte kurrfarë ndjenje sociale dhe ideali, që jetonte vetëm për veten e vet e jo për shoqërinë. Kjo pikëpamje idealiste e aspak shkencore, absolutizonte kontradiktën e thellë që ekzistonte midis individit dhe shoqërisë në rendin shfrytëzues sidomos në rendin kapitalist.

Individi në të vërtetë nuk është aspak e kundërta e shoqërisë, por pjesë e pandarë e saj dhe bartës i marrëdhënieve shoqërore të caktuara, të një mënyre të caktuar të prodhimit. Ai është produkt i një rendi të caktuar ekonomiko-shoqëror e politik dhe pasqyrë e tij, që përqendron në personalitetin e vet thelbin e marrëdhënieve shoqërore-klasore të epokës.

Kjo kundërvënie e individit shoqërisë dhe papajtueshmëria midis tyre në përfytyrimin e sociologëve pozitivistë e idealistë shpjegohet jo vetëm me kontradiktën që ekziston midis tyre në realitetin konkret, por është gjithashtu rrjedhim i metodës idealiste që proceset e dukuritë shoqërore

12) Po aty.

i sheh si produkt të zhvillimit të ideve. Kështu, përderisa idetë pozitiviste janë ato që formojnë shoqërinë me ideale gjoja humanitare e altruiste, me idealet e përparimit e të qytetërimit, individi i paformuar me këto ide mbetet në sferën thjeshtë materiale e të egoizmit, në sferën e jetës primitive dhe të paqytetëruar.

«Neoshqiptarët» e shikonin individin e zakonshëm si antisocial për shkak se i mungonin «idealet kolektive» të atyre ideve sunduese që duhej të përqafoheshin nga të gjithë dhe që përfaqësonin gjoja interesat kombëtare. Kështu, idealisti dhe pozitivisti që synon të përmbushë solidaritetin shoqëror, nuk njeh ide e ideale të tjera veç atyre që duhet të bashkojnë të gjitha klasat e grupet, të gjithë shoqërinë e që në të vërtetë nuk i përkasin të gjithë popullit, por borgjezisë, e cila gjithnjë i njëson idealet dhe interesat e veta me ato të popullit.

Idetë e idealet reale të klasave të ulëta që janë produkt i interesave konkrete të tyre, përjashtohen nga sfera e ideve, e humanizmit dhe e kulturës dhe futen në sferën e vulgares, të materiales, në atë të egoizmit etj.

Branko Merxhani e të tjerë kishin mendimin se shoqëria shqiptare, e cila ende nuk ishte bërë shoqëri në kuptimin e vërtetë të fjalës, përbëhej nga një masë primitive individësh egoistë e pa ideale.

Te shqiptarët, në përgjithësi, thuhej se gjatë gjithë historisë, bile dhe aktualisht, nuk kanë ekzistuar idealet, konceptet e interesat shoqërore e kombëtare. Shqiptari gjoja është shqetësuar për interesat materiale e imediate dhe nuk ka pyetur për interesin e përgjithshëm[13]. Ai gjoja është treguar tepër individualist e antishoqëror.

Kjo pikëpamje idealiste e reaksionare e Branko Merxhanit u referohej ideve të Levi Bruhlit e Gustav Le Bonit, të cilët kishin zbuluar gjoja se masat primitive nuk kishin ideale shoqërore nuk kishin logjikë, por udhëhiqeshin nga instiktet e pasionet. Ato kishin gjoja një «ideal primitiv të ngushtë, të ultë sociologjikisht, protoplazmik» e madje paralogjik[14].

Teoritë reaksionare borgjeze mbi masat primitive të privuara nga logjika, nga idealet, të pajisura me instinkte e pasione të shfrenuara që mund t'u vihej fre vetëm me anë të mistiçizmit dhe fesë, i duheshin imperializmit për të përligjur sundimin kolonial mbi popujt e prapambetur e të varfër, si dhe për të mohuar rolin e masave popullore në histori dhe për të pohuar kultin e heronjve dhe të elitës.

13) «Illyria», 18 prill 1936, f. 1.
14) Po aty.

Këto teori u leverdisën edhe klasave reaksionare të Shqipërisë. Një pikëpamje denigruese për popullin shqiptar dhe për patriotizmin e tij të pastër shprehu edhe Vangjel Koça, i cili, siç duket, analizën e botës shqiptare e bëri me anë të metodës introspektive, d.m.th. duke i atribuar popullit atë boshllëk e mungesë idealesh që kishte ai dhe shokët e tij.

Ky ideolog me prirje fashiste që më vonë u hodh plotësisht në prehrin e fashizmit dhe tradhtoi interesat kombëtare, u vishte shqiptarëve mungesën e parimeve, të idealeve dhe të altruizmit dhe shpifte në mënyrën më të ulët kundër tyre duke thënë se gjoja ata e sakrifikonin idealin kombëtar dhe interesin e përgjithshëm për «krodhën e bukës»[15].

Vangjel Koça arriti deri aty, sa të bënte përgjithësimin se shqiptari gjatë historisë ishte shitur për para.

Kjo shpifje padyshim nuk i qëndronte të vërtetës historike. Historia na dëshmon për të kundërtën. Ata që e shitën vendin tek të huajt dhe që ishin zhveshur nga idealet patriotike ishin Vangjel Koça me shokë dhe klasat reaksionare, por jo populli trim e patriot i Shqipërisë, i cili në momentet më kritike, në kulmin e varfërisë e të mjerimit nuk i sakrifikoi kurrë interesat e atdheut, por i mbrojti ato me vetëmohim, vendosmëri e konsekuencë. Në qoftë se Shqipëria u qëndroi rrebesheve shekullore dhe ruajti etninë e qytetërimin e vet, kjo i detyrohej patriotizmit të kulluar të tij dhe të bijve të tij më të mirë.

Sipas përfaqësuesve të «neoshqiptarizmës» populli shqiptar i përbërë nga individë pa ideale dhe që preokupoheshin vetëm për interesat vetjake, ka qenë gjatë gjithë historisë një forcë pasive që nuk ka luajtur ndonjë rol të rëndësishëm. Kurorëzimi me sukses i luftërave për liri dhe pavarësi gjoja nuk ka qenë rezultat i përpjekjeve të gjithë popullit, por vetëm i personaliteteve të shquara me ideale të kulluara kombëtare e shoqërore.

Mohimi i rolit përparimtar historik të masave popullore i coi ata në varfërimin e historisë kombëtare deri në atë shkallë, sa të pranohej vetëm ekzistenca e dy periudhave me rëndësi të saj, ajo e Skënderbeut dhe e Rilindjes, duke u fshirë të gjitha të tjerat.

«Vetëm perioda e shkurtër e Skënderbeut përmbante fazën e një nacionalizme»[16]. Kjo periudhë u përsërit më vonë me Rilindjen e cila u kurorëzua me fitoren e lirisë e të pavarësisë jo në saje të idealit kolektiv, i cili mungoi kinse në popull, por në saje të «nacionalizmit» të «njerëzve të zgje-

15) Po aty. 11 mars 1934, f. 1.
16) «Demokratia», 21 qershor 1930, f. 3.

dhur», të patriotizmit të tyre të kulluar, gjithashtu falë kombinacioneve të politikës evropiane[17].

Ideologu reaksionar që dinte të bënte të bardhën të zezë, i shtrembëroi krejt faktet historike dhe rolin e popullit e bëri tabula rasa në një kohë kur ai shkëlqeu me gjithë forcën e tij.

Për Vangjel Koçën nuk ekzistonin luftërat e mëdha popullore të periudhës së Skënderbeut, të Rilindjes dhe aq më tepër të periudhave të tjera. Këto të gjitha ai i bëri të paqena.

Në bazë të arsyetimit të tij, tabloja e luftërave për liri e pavarësi të popullit shqiptar zbehej jashtë masës. Në këtë tablo dilnin në mënyrë të vetmuar disa figura historike që paraqiteshin si figura mitike shenjtorësh që kanë bërë mrekullira.

Përpjekjet për zgjimin, çlirimin kombëtar dhe krijimin e shtetit të pavarur nuk kanë qenë thjesht përpjekje individësh të ndriçuar nga idealet, siç pohohej prej tij[18], por përpjekje kolektive të masave të gjera popullore, të mbështetura fuqimisht në zhvillimin objektiv historik. Kundërvënia e popullit pasiv individëve aktivë e çudibërës është një tezë idealiste e reaksionare e njohur që ka për qëllim të mohojë rolin e popullit në histori dhe të fryjë kultin e personalitetit dhe të elitës. Këtë kult e frynte mjaft edhe pozitivizmi i Ogyst Kontit, në burimet e të cilit pinë «neoshqiptarët».

Në frymën idealiste e reaksionare pohohej se populli ishte një lëndë krejt amorfe, pa kurrfarë force krijuese (elan vital), si diçka pasive e vrojtuese[19].

Në këtë konceptim të shtrembër të rolit të masës, si lëndë pasive, dhe të individit, si shpirt krijues e aktiv, ka ndikuar mjaft edhe teoria idealiste shumë e përhapur në këtë kohë e filozofit reaksionar Anri Bergson mbi vrullin jetësor (elan vital) dhe evolucionin krijues (evolution creatrice).

Sipas kësaj pikëpamjeje që i kundërvinte materializmit irracionalizmin e mistiçizmin, krijimtaria e vërtetë historike shfaqej në formën më të plotë e më reale në veprimtarinë shpirtërore të individëve të shquar, të cilët i marrin shtytjet krijuese nga një shpirt mistik jashtë botës materiale. Vetëm këta individë ishin në gjendje ta çonin përpara rrotën e historisë.

Teorisë së Bergsonit, që borgjezia reaksionare e ngriti në qiell, Branko Merxhani i thurte lavde.

17) Po aty.
18) «Illyria», 7 shtator 1935, f. 4.
19) Po aty, 25 mars 1934, f. 1.

Ai këtë teori të «krijimit të papandehur» që mund të zbatohej sipas tij në natyrë dhe në shoqëri e quante si një shpikje të madhe që gjoja i shkundte njerëzit nga indiferenca e pesimizmi, i bënte të hiqnin dorë nga teoritë «e vjetëruara» evolucioniste të Spenserit dhe të besonin në forcën e vullnetit njerëzor, i cili sipas kësaj teorie ishte i pakufizuar[20]. Spiritualizmi bergsonian që ishte një fe e re e rafinuar që i duhej borgjezisë, paraqitej si diçka progresive. Ai në të vërtetë shpinte ujë në rrymën e «filozofisë së jetës» të Niçes, Kroçes, e të tjerë, që ekzaltonin forcën e shpirtit, të veprimtarisë krijuese shpirtërore individuale, të kultit të individit dhe elitës së kulturuar. Branko Merxhani, duke vazhduar ta mburrte bergsonizmin, e cilësoi «evolucionin krijues» të shpikur prej tij si «kryengritje krijonjëse» që kishte mundësi të pakufizuara; ndryshe nga evolucioni i lëndës së vdekur, «evolucioni krijues» shfaqte gjoja gjithnjë «forma të reja» «krijimesh të papandehura»[21].

Sipas Branko Merxhanit, bergsonizmi hapi horizonte pafund për veprimtarinë e individëve të shquar të pakufizuar nga bota materiale dhe masa si pjesë e saj, të cilët në saje të vrulleve shpirtërore të «papandehura» dhe irracionalizmit që i jepnin gjoja krahë mendimit dhe vullnetit, mund ta shpinin zhvillimin përpara me shpejtësi. Kështu, me anë të irracionalizmit bergsonian dhe voluntarizmit të kushtëzuar prej tij, individët dhe elita mund ta rrisnin akoma më shumë rolin e tyre. Pra, thelbi i të gjithë këtij arsyetimi ishte se zhvillimin e shoqërisë, e shpien përpara individët me idetë e tyre të kulluara e çudibërëse dhe jo masa inerte që përfaqëson materien pa jetë.

3. TEORIA E SOLIDARITETI SHOQËROR SI KUNDËRPESHË E PIKËPAMJES SË LUFTËS SË KLASAVE

Në sociologjinë pozitiviste, si dhe në pikëpamjet «neoshqiptare» të huajtura prej saj, problemi i solidariteti shoqëror dhe i mohimit të konflikteve shoqërore dhe luftës së klasave ishte një problem qendror dhe i një rëndësie të dorës së parë.

Doktrina pozitiviste kishte si synim kryesor të saj krijimin e një shoqërie borgjeze në të cilën duhej të sundonte në të gjitha sferat, si në fushën ekonomike-shoqërore, politike e kulturore, solidariteti shoqëror dhe duhej të zhdukej

20) Po aty, 14 shtator 1935, f. 5.
21) Po aty.

çdo shfaqje e luftës klasore. Pozitivizmi aspironte që idealet e tij të bashkëpunimit dhe të harmonisë klasore të ktheheshin në një fe që të përqafohej nga i gjithë populli. Ogyst Konti u përpoq të themelonte edhe kishën pozitiviste. Kjo utopi reaksionare e tij lidhej me faktin që kontradiktat dhe lufta e klasave në shoqërinë borgjeze po bëheshin gjithnjë më të ashpra dhe po e brenin nga brenda këtë sistem. Te proletariati dhe te luftërat e tij kundër kapitalizmit shihej një rrezik jo i vogël për ta. Ideologët borgjezë dëshirën e tyre për eliminimin e kontradiktave e të luftës dhe për të krijuar mundësinë, që rendi borgjez të zhvillohej pa tronditje, e morën për realitet. Ata menduan se me disa ide e projekte të mira shoqëria borgjeze mund të rregullohej e të stabilizohej.

Pozitivistët, sidomos Ogyst Konti, pohonin se lufta e klasave nuk ishte një prirje normale e zhvillimit shoqëror, por një dukuri e lindur nga disa rrethana të rastit dhe jo të domosdoshme.

Ogyst Konti thoshte se filozofia pozitiviste ishte e interesuar për ruajtjen e paqes së brendshme e të jashtme, sepse këtu shihte kushtin më të favorshëm për ripërtëritjen e vërtetë mendore e morale të shoqërisë[22].

Parulla e saj ishte «dashuria për princip, rregulli si bazë dhe progresi si qëllim»[23]. Kjo donte të thoshte se me anë të solidaritetit shoqëror dhe të zhdukjes së luftës së klasave do të mund të ruhej më mirë rendi borgjez dhe të zhvillohej në mënyrë të qetë e patronditje.

Progresi tek Konti, edhe pse ishte një term i preferuar, ishte e kundërta e çdo përparimi thelbësor dhe të vërtetë, e çdo ndryshimi revolucionar. Ai duhej të realizohej me anë të reformave borgjeze që, sipas Kontit, mund të kryheshin nga çdo regjim, mjaftonte që të ruhej rendi kapitalist.

Solidariteti shoqëror duhej të vihej në jetë me anë të doktrinës së re që do të reformonte idetë, edukatën e moralin, që do të eliminonte anarkinë e mendimeve e të ndjenjave, gjoja edhe individualizmin ekstrem, egoizmin dhe armiqësitë.

Progresi mendor që pretendohej të arrihej me anë të pozitivizmit, do të forconte gjoja dashurinë e njeriut për njeriun dhe duhej të zëvendësonte egoizmin me altruizmin. Altruizmi, pohonte Konti, duhej të bëhej universal. Ai duhej të kultivohej në mënyrë metodike sepse dashuria, sipas tij, ishte i vetmi element moral që bën të «mbizotërojë sosiabiliteti mbi individualizmin». Kështu Konti, në çështjen

22) A. Comte. *Cours de philosophie positive, 1839-1842.*
23 *Po aty.*

e krijimit të solidaritetit shoqëror, i jepte parësinë ndjenjave (afektit) ndaj racionales. Kjo e bëri atë ta shndërrojë pozitivizmin në fe dhe të ngrejë, siç thamë më sipër, edhe kishën e klerin pozitivist që u përpoqën ta përjetësojnë kapitalizmin.

Konti e krijoi edhe termin altruizëm si kundërpeshë ndaj egoizmit. Porse në kushtet e rendit shfrytëzues kapitalist, ku njeriu për njeriun është ujk, as mund të bëhej fjalë për altruizëm dhe as mund të zhdukej kontradikta midis altruizmit dhe egoizmit. Kjo mund të arrihej vetëm me përmbysjen e rendit shfrytëzues kapitalist.

E mbështetur në këtë shpjegim dhe në këto pikëpamje edhe «neoshqiptarizma» kishte mendimin se me anë të ideve, të kulturës, të moralit, edukatës bile edhe të fesë duhej në fund të fundit të sigurohej solidariteti shoqëror që konsiderohej si kusht sine qua non për krijimin e një shoqërie kombëtare. Shoqëria që ka solidaritet shoqëror, që ka unitet mendimi e veprimi, është një shoqëri ideale, e cila zhvillohet normalisht. Papajtueshmëria e interesave dhe lufta midis klasave, grupeve dhe individëve është një gjendje që nuk përputhet me solidaritetin e vërtetë dhe shoqërinë e zhvilluar. Edhe te «neoshqiptarët» në këtë pikëpamje u shpreh aspirata iluzore dhe interesi i borgjezisë për ta bërë më të qëndrueshëm rendin e ri borgjez në Shqipëri dhe për t'i krijuar mundësi të zhvillohej më tej.

Mbi bazën e kulturës, të zhvillimit të shkencës dhe edukatës, mendohej të krijoheshin gjoja idealet, të cilat shikoheshin si idetë më të kulluara e më të përsosura të nivelit social, që përjashtonin egoizmin dhe pohonin altruizmin dhe ndjenjën e detyrës.

«Ideali, — sipas Branko Merxhanit, — e kthente njeriun nga egoist në altruist»[24], sepse ai, sikurse është thënë dhe më parë, gjendej gjoja jashtë lëndës dhe interesit, kishte një natyrë mbiklasore.

Në çështjen e solidaritetit shoqëror, Branko Merxhani i referohej edhe pikëpamjes së Emil Dyrkheimit se idealet si një tip i lartë i «përfytyrimeve kolektive», ishin burim i të gjitha dukurive shoqërore dhe i zhvillimit shoqëror në tërësi.

Shoqëria nuk mund të konceptohej ndryshe veçse si «të bashkuarit e të shkririt e shpirtrave në një, të menduarit, të ndjerit e të punuarit njëlloj, vetëm qoftë të ndarit në punë . . .»[25].

Shoqëria duhej të kishte si tipar themelor «homogjeni-

24) «Demokratia», 9 mars 1929, f. 3.
25) «Illyria», 2 nëntor 1935, f. 5.

tetin», d.m.th. përputhjen e interesave dhe të idealeve. Çdo gjë që e dëmtonte dhe e prishte këtë «homogjenitet» nuk pajtohej me zhvillimin e shoqërisë. Një faktor tjetër social me rëndësi, gjithnjë sipas Dyrkheimit, ishte ndarja e punës. Ndarja e punës dhe solidariteti shoqëror duhej të shkonin krahas. Në fakt historikisht është provuar se ndarjet themelore të punës përputhen me ndarjen e shoqërisë në klasa e me lindjen e shfrytëzimit dhe përsosja e kësaj ndarjeje të punës është shoqëruar me përsosjen e strukturës klasore të shoqërisë dhe me zhvillimin e luftës së klasave. Pra, historia ka provuar të kundërtën e asaj që pohojnë pozitivistet se, gjoja, ndarja e punës dhe solidariteti shoqëror ecin krahas. Ajo mund të ndodhë vetëm me likuidimin e sistemit shfrytëzues.

Kështu, ishte iluzor mendimi se në shoqërinë borgjeze, e cila e përsosi ndarjen e punës, do të mund të sigurohej solidariteti shoqëror midis klasave. Antagonizmi i thellë klasor i kësaj shoqërie nuk lejonte as të mendohej një gjë e tillë. «Neoshqiptarët» besonin se grumbullimi i punëtorëve në ndërmarrjet e mëdha në sistemin kapitalist krijonte mundësinë që ideologjia borgjeze të përhapej më lehtë në ta dhe që klasa punëtore të jetonte në harmoni të plotë me kapitalistët[26]. Por në fakt kjo favorizoi të kundërtën, forcoi luftën klasore të punëtorëve.

Asnjë ideologji dhe asnjë doktrinë, sado e përsosur të jetë, nuk mund të bashkojë njerëzit me interesa antagoniste.

Branko Merxhani, duke iu referuar përsëri Dyrkheimit për këtë problem, thoshte se zhvillimi i shoqërisë i kushtohej dy faktorëve themelorë: rritjes së numrit të frymëve të popullsisë dhe «dendësimit të këtyre frymëve» në kuptimin e forcimit të lidhjeve midis tyre, d.m.th. të solidaritetit shoqëror[27].

Shoqëria, sipas kësaj pikëpamjeje, edhe sikur të mos rritej popullsia por të forcoheshin lidhjet midis njerëzve, të krijohej ndërgjegjja e përbashkët, mund të ecte gjithnjë përpara pa ndalesë, mund të realizonte progresin.

Kështu, sipas Branko Merxhanit, «Shoqëria ideale ishte ajo që kishte dhe frymë shumë dhe dendësi (solidaritet klasor — V.K.)», ndërsa «kombi ideal ishte kombi që fliste një gjuhë, që kishte një moral dhe që përdorte njësoj veglash»[28].

Shoqëria më e përsosur konsiderohej shoqëria borgjeze e zhvilluar në të cilën solidariteti klasor do të arrinte gjoja shkallën më të lartë dhe jeta shoqërore merrte kuptimin e

26) «Demokratia», 13 gusht 1932.
27) «Illyria», 2 nëntor 1935, f. 5.
28) Po aty.

saj të vërtetë, të veprimtarisë së individëve për të siguruar interesat e tërë shoqërisë. Pra, kjo ide ishte e njëjtë me atë që thoshte Konti se në shoqërinë borgjeze «pozitiviste» njerëzit do të jetojnë për të tjerët, d.m.th. do ta bëjnë gjithçka nga altruizmi dhe jo nga egoizmi.

«Neoshqiptarët», ashtu si dhe pozitivistët, synonin që me anë të «përfytyrimeve kolektive» të krijuara në bazë të doktrinës së tyre do të vendosnin «rregullin kolektiv» në shoqëri, i cili gjoja ndryshonte nga «rregulli shtetëror», duke qenë ky një produkt i ndërgjegjes, i kulturës dhe moralit dhe jo i forcës e i dhunës. Nga arsyetimet e Branko Merxhanit të ushqyera prej Dyrkheimit, rridhte se shoqëria shqiptare ndodhej në një fazë të ndërmjetme «në mes të qeverisjes qenësore të rregullit kolektiv dhe të një zgjidhjeje të dhënë që mbështetej mbi forcën. E para përfaqësonte shoqërinë, e dyta përfaqësonte shtetin»[29].

«Rregulli kolektiv» nuk do t'i bënte asnjë ndryshim sistemit shfrytëzues ekzistues, por vetëm do të përpiqej ta forconte atë, me anë të «ndjenjave kolektive» dhe solidaritetit shoqëror që do të krijohej mbi bazën e tyre.

Branko Merxhani e thoshte hapur se doktrina «neoshqiptare», ashtu si «të gjitha planet logjike, programet dhe projektligjet kishin për qëllim përmirësimin e këtij rregulli, perfeksionimin e funksioneve të tij dhe kapërcimin e tronditjeve, zotërimin e drejtësisë, të ligjeve të paqes. Jo shteti si shtet, po ndjenja shoqërore shtetërore është fuqia tundëse e çdo veprimi qenësor njerëzor»[30]. Pra, faktorët ideologjikë e moralë konsideroheshin si faktorë kryesorë për krijimin e një shoqërie të vërtetë, e cila përfytyrohej si një shoqëri borgjeze pa luftë klasash e që duhej të ndiqte rrugën e përparimit evolucionist.

Ideologu kryesor i «neoshqiptarizmës» pretendonte se në një shoqëri borgjeze të rregulluar mirë dhe pa konflikte ku do të sundonte «rregulli kolektiv», kryesore nuk do të ishte dhuna, rregullimi i punëve me anë të saj, por ndërgjegjja shoqërore, idealet kolektive, të cilat do të bënin që të funksiononte për mrekulli mekanizmi shoqëror. Por të gjitha këto ishin ide utopike që nuk mund të gjenin asnjë zbatim në shoqërinë borgjeze të mbarsur me kundërthënie të thella.

«Rregulli kolektiv», i cili nuk presupozonte aspak përmbysjen e rregullit të mëparshëm dhe as zhdukjen e shfrytëzimit por ruajtjen e stërhollimin e tij, ishte një dëshirë subjektive për ta bërë kapitalizmin më të pranueshëm për popullin e më të qëndrueshëm. Ai ishte në kushtet konkrete

29) Po aty, 18 mars 1934, f. 1.
30) Po aty.

të Shqipërisë një përpjekje për zbukurimin e rendit çifligaro-borgjez.

«Rregulli kolektiv» duhej të ishte një rezultat i bashkëveprimit të njerëzve të veprimit (udhëheqësve të shtetit e personaliteteve politike) dhe njerëzve të mendimit, intelektualëve. Pra, në majë të piramidës së «rregullit kolektiv» duhej të vendosej elita e klasave sunduese, e cila duhej të vepronte me shkathtësi për sigurimin e interesave të klasave të veta dhe nënshtrimin e masave popullore. Kjo ishte pak a shumë dhe skema e Kontit për organizimin e shoqërisë e të shtetit borgjez sipas doktrinës së tij. Ai thoshte se pushtetin ekonomik e politik duhet ta ushtronin kapitalistët, ndërsa pushtetin shpirtëror elita intelektuale.

Aspirata për «rregullin kolektiv» te «neoshqiptarët» mbështetej në interesin e borgjezisë shqiptare për zhvillimin e qetë e pa tronditje të marrëdhënieve kapitaliste në vend, për forcimin e pozitave të saj në shtet dhe për mënjanimin e lëvizjeve revolucionare.

4. KOMBI DHE ZHVILLIMI KOMBËTAR

Në pikëpamjet «neoshqiptare», sidomos në ato të Branko Merxhanit, një vend të dukshëm zinin pikëpamjet mbi kombin dhe zhvillimin e shoqërisë kombëtare. Në ideologjinë borgjeze shqiptare asgjëkundi ky problem nuk ishte trajtuar kaq gjerësisht, sa te ky ideolog i «neoshqiptarizmës», i cili e shqyrtoi atë nga pikëpamja e teorive të ndryshme borgjeze që ekzistonin mbi kombin, sidomos nga pikëpamja e ideve pozitiviste.

Borgjezia shqiptare në këtë kohë kishte interes për zhvillimin e kapitalizmit, dhe për ruajtjen e forcimin e shtetit borgjez si dhe të kulturës borgjeze kombëtare, por si një klasë e dobët nga pikëpamja ekonomike e politike, ajo u bëri mjaft lëshime forcave reaksionare të brendshme e të jashtme dhe nuk qe në gjendje të mbronte si duhej interesat e veta. Përveç kësaj, ajo ishte e interesuar që të zhvillohej e të përhapej gjithnjë e më shumë nacionalizmi borgjez, i cili duhej të forconte pozitat e saj brenda kombit dhe ndikimin e saj mbi popullin gjithashtu të mënjanoheshin kundërthëniet klasore dhe lufta e klasave. Pikëpamjet dhe teoritë mbi kombin të shprehura nga «neoshqiptarët» ishin reflekse të këtyre interesave e shqetësimeve të klasës borgjeze, si dhe të pozitës reale të saj.

Siç u përmend edhe më sipër, trajtimi i kombit dhe i

problemeve kombëtare bëhej nën prizmin e idealizmit. Kombi konsiderohej, në radhë të parë, produkt i faktorëve të jetës shpirtërore. Ai mbahej si rezultat i një kulture të zhvilluar, i ideve dhe moralit borgjez. Branko Merxhani pohonte se nuk pajtohej me «determinizmin lëndor» (materialist) në çështjen e kombit, ashtu si dhe në çështjet e tjera, që e shpjegonte kombin me kushtet e faktorët lëndorë dhe pranonte «determinizmin shpirtëror», të filozofit idealist frëng Ernest Renan e të tjerë që thoshin se «kombi është një shpirt, një parim shpirtëror»[31].

Por me «determinizmin lëndor» në çështjen kombëtare, Branko Merxhani kuptonte kryesisht ato teori të përhapura në vendet borgjeze pas Rilindjes evropiane dhe sidomos gjatë shek. XIX e më pas, që merrnin si faktorë kryesorë në shpjegimin e këtij problemi, racën, kushtet gjeografike, biologjike e të tjerë. Bashkë me to përzihej në mënyrë eklektike edhe materializmi marksist, që merrte për bazë faktorët ekonomiko-shoqërorë. Por shumë nga teoritë e mësipërme, të cilat ai i sillte si materialiste në shpjegimin e problemit kombëtar ishin teori reaksionare, raciste e imperialiste që ekzaltonin me anë të faktorëve biologjikë, gjeografikë etj., ekskluzivitetin e superioritetin e kombeve gjoja të pastra e të fuqishme dhe predikonin ekzistencën e kombeve e të kombësive inferiore.

Në «determinizmin shpirtëror», nga i cili anonte «neoshqiptarizmi», përfshiheshin ato doktrina, të cilat në trajtimin e kombit merrnin për bazë «gjuhën», «karakterin kombëtar», traditat dhe historinë kombëtare», «kulturën dhe qytetërimin» bile edhe «fenë»[32]. Edhe këtu ishin bashkuar konceptet idealiste mbi kombin dhe një sërë pikëpamjesh reaksionare sidomos ato që nën maskën e ekzaltimit të faktorëve shpirtërorë kombëtarë, të karakterit kombëtar, të traditave, donin të afirmonin nacionalizmin e shovinizmin dhe epërsinë e disa kombeve mbi të tjerat.

Branko Merxhani në shpjegimin e kombit merrte si pikënisje pikëpamjen pozitiviste të Ernest Renanit, i cili thoshte se «njeriu s'është skllav as i racës së tij, as i gjuhës së tij, as i fesë së tij, as i rrymës së lumenjve, as i zinxhirëve të maleve. Një grumbull i madh njerëzish i shëndoshë nga shpirti dhe i ngrohtë nga zemra, krijon një ndërgjegje morale që quhet komb»[33].

Me një fjalë kombi kuptohej në radhë të parë si diçka morale. Pikëpamja e Renanit i kundërvihej pikëpamjes natyraliste e nacionaliste gjermane, e cila e merrte kombin si

31) «Demokratia», 22 korrik 1933.
32) Po aty, 10 qershor 1933, f. 3.
33) Po aty, 22 korrik 1933, f. 3.

diçka të mbyllur, ekskluzive dhe absolute. Këtë pikëpamje gjermane e kishte krijuar filozofi Herder. Por Herderi nuk i përkiste determinizmit lëndor. Branko Merxhani u mbështet te Renani si për pozitën e vet idealiste, ashtu edhe pse dëshironte t'u largohej teorive raciste e shoviniste që kujtohej se i përkisnin vetëm «determinizmës lëndore». Por teoritë borgjeze mbi kombin qoftë dhe ato që mbështeten vetëm mbi faktorët shpirtërorë e kanë nacionalizmin e shovinizmin brenda, bile më të stërholluar e më të rrezikshëm. Kështu, ekzaltimi i karakterit kombëtar te Herderi e pasardhësit e tij që i përkisnin determinizmit shpirtëror, si diçka absolute dhe e papërsëritshme, ushqeu shumë teori nacionaliste e raciste. Branko Merxhani mori nga teoritë reaksionare, e pikërisht nga Bergsoni, pikëpamjen mbi karakterin kombëtar si thelbin e kombit[34]. Pranimi i ekzistencës së karakterit kombëtar si veçori dalluese psikologjike e çdo kombi ishte baras me pranimin e epërsisë apo inferioritetit racial, të pabarazisë kombëtare e të shtypjes kombëtare.

Nga njëra anë pranohej ekzistenca e karakterit ekskluziv kombëtar që ishte një pikëpamje nacionaliste e shoviniste, nga ana tjetër kundërshtoheshin teoritë raciste mbi kombin që pohonin se pa pastërti race nuk mund të kishte komb dhe që afirmonin mbi këtë bazë epërsinë e një populli mbi një tjetër.

Ideologu i «neoshqiptarizmës» nuk mund të pranonte tezën se kombi përcaktohej nga raca. Deri tani, thoshte ai, nuk ishte provuar që «trashëgimia» të ishte më e fortë se ndikimi i mjedisit shoqëror, i cili kuptohej si tërësia e faktorëve shpirtërorë. Mjedisi ishte gjithnjë përcaktues[35].

Në këtë arsyetim ai shkonte më tej dhe mundohej të shpjegonte sipas Renanit se, për shkak të zhvillimit të tregtisë dhe të luftërave, popujt u përzien aq shumë njeri me tjetrin, sa ishte e vështirë të thuhej se ata e ruanin të pandryshuar përbërjen e vet etnike gjatë gjithë zhvillimit të tyre.

Kështu, vetë shqiptarët, sipas Branko Merxhanit, nuk ishin të pastër e të papërzier nga ana etnike, por kishin ndjejet e tyre gjoja «gjak sllav, grek, turk, arab, çerkez, italian, frëng, gjerman etj.»[36]. Kjo përzierje «gjaku» kishte ndodhur gjatë historisë shumëshekullore të tyre. Për të problemi i racës as që duhej të ngatërrohej me çështjen kombëtare dhe kombi ishte thjesht produkt i kulturës dhe moralit, gjëra këto që nuk lidheshin me racën. Edhe pse nuk

34) Po aty.
35) Po aty, 17 qershor 1933.
36) «Illyria», 24 gusht 1935, f. 5.

mund të flitej për pastërti race, tërësia e faktorëve shpirtërorë vinte një vulë të caktuar mbi kombin dhe e bënte atë të dallohej nga një tjetër.

Ashtu si edhe Renanin e pozitivistë të tjerë, Branko Merxhanin e interesoi më shumë krijimi i solidaritetit shoqëror dhe pohimi i koncepteve elitariste.

Ai polemizoi me revistën katolike të Shkodrës «Hylli i Dritës» lidhur me çështjen e pastërtisë së racës në formimin e kombit. Kjo revistë kishte botuar në numrin 12 të saj, në dhjetor të vitit 1930, një artikull demagogjik e të shtjelluar me dinakëri jezuite me titull «A jemi shqiptarë apo do të bëhemi?», ku mbrohej me zjarr sa për sy e faqe të opinionit publik e për të maskuar prapaskenat kundër kombit, çështja e pastërtisë së racës shqiptare, e cila as i shqetësonte fare këta tartufë, duke u trajtuar problemi më tepër nga ana biologjike, sesa historike. Kjo ishte një përgjigje ndaj artikullit të botuar në revistën «Neoshqiptarizma»: «Problemi biologjik i racës sonë». Revista katolike me anë të ekzaltimit të nacionalizmit, mundohej të maskonte veprimtarinë antikombëtare e përçarëse që zhvillonte kryesisht në këtë periudhë. Kleri katolik kërkonte të paraqitej ndryshe nga ç'ishte në realitet, si mbrojtës i interesave kombëtare. Por, ai kishte synime partikulariste e antikombëtare, donte të afirmonte ekskluzivitetin e fesë katolike dhe t'ia kundërvinte besimin katolik besimeve të tjera.

Kundërpërgjigjja «neoshqiptare» e Branko Merxhanit ndaj tezave reaksionare të klerit katolik kishte po ashtu disa teza idealiste dhe antishkencore. Ajo e shikonte problemin nga pikëpamja biologjike dhe thoshte se «pa përzierje të gjakut nuk mund të kishte komb, racë, popull»[37]. Pra, përkrahësi i «determinizmit shpirtëror» shkiste në ato pikëpamje, të cilat u mundua t'i kundërshtonte.

Me këtë përzierje ai kishte parasysh zhdukjen e përçarjes fetare që ekzistonte në popullin shqiptar, e cila në fakt s'kishte të bënte aspak me faktorë biologjikë, por me faktorë shoqërorë, politikë dhe ideologjikë. Teza e «përçarjes biologjike», e pranuar nga Branko Merxhani, në të vërtetë i vinte në ndihmë klerit katolik, i cili kishte bindjen e thellë, dhe këtë nuk e kishte shfaqur publikisht por në mënyrë të fshehtë, se midis elementëve fetarë në Shqipëri, sidomos midis elementëve të krishterë e myslimanë, kishte dallime thelbësore dhe se gjoja vetëm elementi i krishterë përfaqësonte kombin e qytetërimin, ndërsa elementi mysliman ishte mish i huaj në trupin e kombit dhe një popullsi «aziatike» e regresive.

37) Po aty, 7 mars 1931, f. 5.

Kështu, ideologët e klerit reaksionar që paraqiteshin në revistën «Hylli i Dritës» me tezat pseudokombëtare të pastërtisë së racës, në realitet vepronin ndryshe, bluanin teza të tjera në kokë.

Por ideologu «neoshqiptar» në mënyrë inkonsekuente, si çdo ideolog borgjez, e kërkonte likuidimin e kësaj përçarjeje në kushtet e ruajtjes së fesë. Bile ai mendonte se feja mund të luante një rol pozitiv në disiplinimin e masave dhe krijimin e solidaritetit shoqëror.

Feja konsiderohej si komponent me rëndësi i kulturës, i jetës shpirtërore që përbënte përmbajtjen themelore të kombit. Në këtë arsyetim krijohej një farë alogjizmi dhe një paradoks i çuditshëm: edhe fetë duhet të ekzistonin, ndërsa përçarja fetare duhej të zhdukej. Si mund të ndodhte një gjë e tillë? Kjo kundërthënie mbetej e pazgjidhur.

Thamë se midis kombit dhe kulturës shpirtërore borgjeze të zhvilluar, «neoshqiptarizma» vinte shenjën e barazisë.

Sipas një përcaktimi të Branko Merxhanit, kombi ishte shprehja «më e përparuar, më e synkronizuar e idealizmës kolektive, personaliteti i së cilës nuk gjendej në trupat tona, po në shpirtërat tona»[38]. Ai ishte, pra, një bashkësi shoqërore pa përmbajtje klasore. Kurse në fakt kombi ka një përmbajtje të caktuar klasore dhe ajo është mjaft e rëndësishme. Ajo çka është e përgjithshme në një komb për të gjithë, nuk mund t'i eklipsojë aspak interesat klasore.

Në kombin, sipas traditës së filozofisë e sociologjisë borgjeze, duhej të përfshiheshin të gjitha sferat e ndërgjegjes shoqërore, si: «ndërgjegjja gjuhësore», fetare, morale, estetike, politike, ligjore dhe «ndërgjegjja ekonomike». Pra, kombi, sipas Branko Merxhanit, ishte vetëm sfera shpirtërore. Sfera materiale ekonomike-shoqërore përjashtohej prej tij dhe thuhej se i përkiste një kategorie tjetër, qytetërimit. Në të vërtetë, marrëdhëniet ekonomike-shoqërore dhe jeta materiale në përgjithësi janë baza e një kombi, faktori kryesor që përcakton natyrën e fizionominë e tij, si dhe zhvillimin e proceseve kombëtare.

Kurse te Brankoja pikënisja e pikëmbërritja ishte kultura. Përpjekjet fillestare, si dhe ato të mëvonshme për formimin e kombit shqiptar, duhej të gjykoheshin, sipas tij, nga faktorët e ndryshëm kulturorë që ishin të pranishëm në veprimtarinë kombëtare. Dhe që në fazën e parë të këtyre përpjekjeve, faktori kryesor ishte gjuha me anë të së cilës kërkohej të arrihej një «lulëzim i madh letrar»[39]. Pra, gjuha konsiderohej si mjeti kryesor i bashkimit të shqiptarëve si dhe boshti rreth të cilit sillej veprimtaria e gjithanshme kulturore e tyre[40].

38) «Demokratia», 7 mars 1931, f. 6.
39) Po aty, 11 shkurt 1933, f. 3.

Kështu, të gjitha problemet e lëvizjes kombëtare shqiptare, gjatë luftës për pavarësi, i gjithë programi i saj, u reduktua në problemin gjuhësor. Gjuha u konsiderua jo si një mjet politik, siç ishte në atë periudhë, por thjesht si një faktor semantiko-kulturor.

Lëvizjen kombëtare dhe vetë kombin «neoshqiptarët» i shikonin, pra, si një «solidaritet kulturor», i cili zëvendësoi gjoja «lidhjet fetare të botës së vjetër»[41].

Këtu është e nevojshme të bëjmë të qartë diçka me rëndësi. Kombi, në kuptimin e vërtetë të fjalës, për Branko Merxhanin nuk ishte formuar ende. Ai konsiderohej «solidaritet kulturor» e shoqëror i një shkalle të lartë. Rilindja dhe fazat e tjera që erdhën menjëherë pas saj, konsideroheshin faza përgatitore për krijimin e kombit, ose faza më të ulëta të «solidaritetit kulturor». Vetëm kur të zhvillohej dhe të përhapej gjerësisht kultura borgjeze, mund të krijohej sipas tij kombi i vërtetë shqiptar.

Ideja e krijimit të «solidaritetit kulturor» në vend të «solidaritetit fetar» që ekzistonte më parë ishte huajtur në fakt nga teoria e Ogyst Kontit mbi periodizimin e historisë në 3 etapa: në etapën e fesë, etapën metafizike, si dhe në etapën pozitiviste që përmendëm në fillim.

Në arsyetimet «neoshqiptare» mbi kombin ekzistonte një farë mospërputhjeje sipas pikëpamjes sonë. Nga njëra anë flitej për lëvizje kombëtare shqiptare gjatë Rilindjes dhe, më pas, nga ana tjetër thuhej se detyra e «intelektualëve ishte të kontribuonin që shoqëria shqiptare të kalonte me sukses nga forma shoqërore e tanishme në një formë shoqërore të re, d.m.th. nga populli në Nacion»[42].

Krijohej pra një përfytyrim i çuditshëm, sikur lëvizja kombëtare ekzistonte përpara kombit. Në fakt lëvizja kombëtare lind dhe zhvillohet në kushtet e kombit. Për «neoshqiptarët» lëvizja kombëtare ekzistonte edhe në kushtet e kombësisë apo të asaj faze të zhvillimit historik, po të shprehemi me termin e Branko Merxhanit, kur ende kishte «popull» e jo «nacion». Veç kësaj Branko Merxhani, duke u mbështetur në pozitivizmin, e kuptonte kombin e vërtetë si një fazë të lartë të solidaritetit kulturor dhe mendonte se kjo fazë ende nuk ishte arritur. Ajo duhej të përgatitej prej «neoshqiptarizmës», e cila do të përpunonte «idealet kolektive».

«Pa kulturë, — shkruante Branko Merxhani në revistën

40) Po aty, 27 gusht 1932, f. 3.
41) «Illyria», 26 tetor 1935, f. 5.
42) Po aty, 11 janar 1936, f. 1.

«Illyria», — nuk është e mundur të hidhet as edhe guri i parë i themelimit të nacionit. Nacion d.m.th. kulturë dhe kulturë d.m.th. nacion. Ata që nuk kuptojnë këtë gjë, jo vetëm s'e kanë kuptuar kuptimin e kulturës, por njëkohësisht mohojnë, pa dashur, pa ditur, edhe kuptimin e nacionit. Ata bëjnë një trazim midis kuptimit të fjalës kulturë dhe kuptimit të fjalës qytetërim»[43].

Kështu, midis kombit dhe kulturës vihej shenja e barazisë. Një rol i rëndësishëm në krijimin e kombit duhej t'i përkiste doktrinës «neoshqiptare» që duhej të ishte e vlefshme për të gjithë popullin. Kjo duhej të ishte një sintezë e «filozofisë kombëtare», «moralit kombëtar» dhe «edukatës kombëtare»[44]. Pa të, thuhej, se nuk mund të krijohej te shqiptarët «kuptimi i bashkëatdhetarizmës»[45], apo i ndjenjës kombëtare.

Ndjenja kombëtare, e cila qëndronte mbi atë të fisit dhe të fesë, mendohej se ende nuk ishte krijuar te shqiptarët. Për krijimin e saj ishte e nevojshme sociologjia[46]. Ky pohim vinte në kundërshtim me faktet historike. Populli shqiptar, në kohët e reja dhe moderne, me përpjekjet e tij heroike e të pareshtura për liri e pavarësi dhe me konsolidimin e shtetit kombëtar, ishte treguar i pjekur politikisht dhe me ndjenja të formuara kombëtare. Po të mos ishte kështu, Shqipëria do të ishte fshirë nga harta gjeografike. Kështu, teza e ideologut «neoshqiptar» nuk kishte asnjë bazë.

Branko Merxhani në frymën e pozitivizmit dhe në emër të të ashtuquajturit dinamizëm social, vuri në dyshim edhe rolin e traditave që janë një faktor me rëndësi për kombin. Ai, duke iu referuar Dyrkheimit, pohoi se fuqia e traditës ishte gjoja «fuqia e përtimit» dhe se «kombet u krijuan e bënë mrekullira, pikërisht sepse u larguan nga traditat e vjetra dhe morën elementë të rinj»[47].

Edhe «jeta kombëtare shqiptare», e cila ishte në formim e sipër, por nuk ishte krijuar ende, nuk mund të quhej «përfundim i një tok traditave e ndjenjave që çlirohen nga çfarëdo kritike e ndryshimi» po «përfundimi i një shkence shkatërronjëse», e cila kishte për detyrë të zgjidhte atë çka i duhej shoqërisë dhe të flakte tej të pavlefshmen[48].

Ideologu neoshqiptar «kishte mendimin se traditat janë përfundime të rastësishme të zhvillimit historik» dhe prandaj mund të pranohen vetëm si «simbole» në jetën e kombeve e mund të modifikohen sipas dëshirës. «Në qoftë se çdo komb duhet të ketë edhe një traditë, — pohonte ai në frymën e kozmopolitizmit borgjez, e madje në mënyrë sofistike, — atëhere duhet t'u japim të drejtë disa kombeve që të pranojnë si një traditë mospasjen e traditave»[49].

Teoritë reaksionare të Dyrkheimit dhe të tjerëve, mbi mohimin e rolit të traditave, ishin teori që kërkonin të përligjnin kozmopolitizmin borgjez, mohimin e lirisë e të pavarësisë së popujve, nënshtrimin dhe skllavërimin e vendeve të ndryshme nga shtetet imperialiste.

Këto teori Branko Merxhanit iu dukën origjinale dhe i përfshiu në doktrinën «neoshqiptare». Ai nuk qe në gjendje të kuptonte se traditat nuk ishin aspak diçka e sipërfaqshme dhe e rastit në histori, nuk ishin «simbole», por rezultat i një zhvillimi të thellë e të gjatë, ishin produkte të proceseve të rëndësishme ekonomike-shoqërore, etnike, politike e kulturore. Në këtë kuptim, jo të gjitha traditat ishin «forca e përtimit» dhe pengesë për zhvillimin historik. Të tilla ishin vetëm traditat reaksionare, negative, të cilat në kushtet e reja historike bëheshin të panevojshme.

Përveç tyre ekzistonin edhe tradita pozitive historike, ky thesar shumë i çmuar i popullit, i zhvillimit e përparimit. Traditat pozitive janë shkallë të progresit.

Branko Merxhani, në arsyetimet e veta, ngatërronte prirjen pozitive për ruajtjen e traditave të shëndosha kombëtare me nacionalizimin dhe shovinizmin. Ai vinte shenjën e barazisë midis ruajtjes me xhelozi të traditave kombëtare nga ana e popujve dhe mistifikimit të tyre nga ideologët e ndryshëm, shikonte një farë ekzaltimi nacionalist, madje një farë rreziku të përligjjes së qëllimeve pushtuese ndaj popujve të tjerë. Por, nacionalizmi e shovinizmi kanë rrënjë të tjera. Ata janë produkt i sistemeve shfrytëzuese, i ideologjisë dhe i politikës së klasave reaksionare.

Traditat pozitive, duke u forcuar e pasuruar gjithnjë e më shumë, forcojnë ndërgjegjen kombëtare të një populli, e cila bëhet jo vetëm faktor i përparimit të kombit, por edhe barrierë kundër synimeve grabitqare të shteteve imperialiste e shoviniste. Pikërisht këto tradita kanë qënë një nga arsyet që shqiptarët në shekuj u kanë bërë ballë armiqve të tërbuar dhe të rrezikshëm.

Edhe vetë Branko Merxhani donte që ndërgjegjja kombëtare të shërbente si një mbrojtje kundër rrezikut të jashtëm dhe mendonte se në atë vend ku ndërgjegjja kombëtare

43) Po aty.
44) Po aty, 26 tetor 1935, f. 5.
45) Po aty, 14 mars 1936, f. 2.
46) Po aty.
47) Po aty, 17 dhjetor 1935, f. 5.
48) Po aty.
49) «Demokratia», 29 korrik 1933, f. 3.

ishte e formuar, përjashtohej rreziku i kolonizimit të huaj[50]. Por kjo ndërgjegje duhej të mbështetej mbi traditat e jo mbi mohimin e tyre, siç thuhej.

Ideologu neoshqiptar ishte për ruajtjen e pavarësisë kombëtare dhe forcimin e ndërgjegjes kombëtare. Por ai, si ideolog borgjez, mbajti një qëndrim jo të vendosur në çështjen kombëtare dhe kishte mjaft inkonsekuenca. Një inkonsekuencë tjetër, veç asaj që u përmend, ishte edhe kjo: nga njëra anë bëhej aluzion për rrezikun që i kanosej Shqipërisë nga jashtë dhe kërkohej të forcohej ndërgjegjja kombëtare në mënyrë që të mbrohej pavarësia, nga ana tjetër mbahej një qëndrim konformist e lavdërohej regjimi zogist i cili ndiqte një politikë antikombëtare.

Edhe këtu pasqyrohej pozita e borgjezisë kombëtare, e cila shqetësohej nga humbja graduale e pavarësisë së vendit, por u tregua pasive kishte frikë nga lëvizjet e brendshme dhe u shqetësua më tepër për fatet e rendit çifligaro-borgjez.

Kështu, lavdërimi i regjimit nga «neoshqiptarët» ishte në përputhje me interesat e saj për sigurimin e rendit.

5. PIKËPAMJET MBI POLITIKËN, SHTETIN DHE REGJIMIN EKZISTUES

«Neoshqiptarizma» proforma e shpalli veten si një rrymë apolitike, trumbetoi se nuk do të përzihej në veprimtarinë politike dhe do të qëndronte larg saj. Bile ajo mbajti qëndrim ndaj rrymës «së të rinjve» apo të «diktaturës së ndritur» që gjoja ishte përzierë në sferën e politikës.

«Neoshqiptarizma» pohonte se, duke qenë gjoja ideologji e pastër, nuk mund të pajtohej me politikën, e cila mbahej si shprehje e «kompromisit» dhe e «pajtimit me realitetin».

Kjo pikëpamje e kishte burimin tek ai mendim i trashëguar nga koha e Rilindjes evropiane mbi politikën si një instrument, si një art që përdoret për qëllimet egoiste e interesat e njerëzve të veçantë, si diçka negative, si një makinacion «makiavelik». Pra, politika kishte një kuptim përbuzës.

Branko Merxhani ishte i mendimit se midis kulturës dhe politikës ngrihej një mur kinez, se ato gjoja ishin të papajtueshme me njëra tjetrën. Kështu, në revistën kryesore dhe më me autoritet të «neoshqiptarizmës», «Përpjekja shqiptare», ai deklaronte: «Këto të dyja (politika dhe kultura — V.K.) janë të ndara si në përmbajtje dhe në qëllime. Kombet që dinë mirë t'i ndajnë këto përparojnë më shumë. Atje ku kultura përzihet me politikën, ajo e humbet kuptimin e saj»[51]. Kjo ishte vetëm në teori, sepse në praktikë asnjë klasë, grup dhe individ nuk i ndante këto. Vetë «neoshqiptarët» që e pretenduan një gjë të tillë, bënin demagogji ose donin të adoptoheshin në mënyrë oportuniste në kushtet e monarkisë. Është e vërtetë se kultura dhe politika nuk kanë përmbajtje të njëjtë. Por për çdo klasë, ato në shkallë të fundit konvergojnë në të njëjtin fokus interesash.

Branko Merxhani, duke e pasur të qartë se në këtë shekull tepër politik askush nuk mund të besonte në mënyrë aq naive për apoliticizmin e një tendence, u mundua të dallonte politikën e vërtetë, politikën e mirë nga politika e keqe. Politika e mirë gjoja drejtohej nga mendimi, nga kultura, nga idetë e ndritura. Kjo gjoja i vinte vetes qëllime të larta historike dhe i shërbente shoqërisë dhe përparimit të saj[52]. Politika e keqe ishte politika e zhvilluar nga njerëzit e paditur, inkompetentë e me synime të pandershme. Prandaj kultura duhej të ndahej nga një politikë e tillë dhe nuk duhej të lihej të binte në duart e nëpunësve diletantë në çështjet e kulturës e të infektuar me politikë, ashtu sikurse edhe politika nuk duhej të lihej në duart e mehmurëve «orientalë». Pra edhe këtu ngrihej ajo tezë që parashtruan «të rinjtë» se në shtet e në administratë duhej të kishte njerëz me kulturë nga rrethet e borgjezisë. Por, ndryshe nga «të rinjtë», të cilët kërkonin që kjo të vihej në jetë menjëherë, «neoshqiptarët» mendonin se më parë duhej të kryheshin reforma kulturore dhe duhej të zhvillohej kultura borgjeze e pastaj të zhvillohej veprimtaria politike sipas teorisë pozitiviste.

Për këtë propozoheshin një sërë masash, si: përhapja e kulturës në vend, ngritja e muzeve bibliotekave, arkivave, etj. dhe zhvillimi i veprimtarisë shkencore[53]. Të gjitha këto duhej të bëheshin në kuadrin e regjimit antidemokratik dhe obskurantist zogist.

«Vetëm kur të kemi një përgatitje të vërtetë mendore, — thuhej në «Përpjekja shqiptare», — mund të hidhemi në sheshin e politikës për të zbatuar mendimet tona të kodifikuara. Vetëm atëhere do të jemi të sigurtë se do t'ia arrijmë qëllimit»[54].

Pra, në fazën e tanishme, sipas këtij arsyetimi, nuk duhej marrë me politikë, por vetëm me kulturë. Në realitet

50) «Illyria», 28 nëntor 1935, f. 2.

51) «Përpjekja shqiptare», nëntor 1936, f. 169-170.
52) Po aty, f. 65-68.
53) Po aty, f. 70-71.
54) Po aty, shtator 1937, nr. 11-12, f. 207-208.

nuk u veprua kështu. «Neoshqiptarët» që në fillim u solidarizuan me regjimin monarkik zogist dhe përfaqësuesit kryesorë të tij me mbretin Zog në krye, i cilësuan si «njerëz të veprimit», të cilët, krahas «njerëzve të mendimit» (neoshqiptarëve) dhe në bashkëpunim me ta, do të ndërtonin, të «ardhmen e Shqipërisë»[55].

Ekzistenca e shtetit çifligar-borgjez u përligj edhe nga pikëpamja sociologjike. U tha se shteti «përbënte përmbledhjen e personalitetit moral, shkencor, artistik, fetar dhe juridik të një turme njerëzore»[56]. Ai paraqitej si një instrument mbiklasor për disiplinimin e turmave dhe «fuqi dhe grusht për të ushtruar vullnetin e vet mbi dispozitat egoistike të individëve»[57].

Branko Merxhani e cilësoi regjimin monarkik si një regjim «pozitiv» që kishte detyrë të luftonte kundër «tendencave antishoqërore» dhe «ta ngrente shoqërinë në nivelin e kulturës dhe të qytetërimit»[58]. Ky gjoja i vuri baza të shëndosha lirisë e pavarësisë dhe filloi nga modernizimi i aparatit shtetëror[59]. Politika antidemokratike e antikombëtare e regjimit zogist në këtë mënyrë zbukurohej.

Bashkërenditja e veprimit të elitës intelektuale me regjimin monarkik kishte për qëllim, pra, si përsosjen e «organizmës» shtetërore në drejtim të një borgjezimi më të madh të saj, ashtu edhe krijimin e një «shoqërie pozitiviste» (kapitaliste) mbi bazën e «rregullit kolektiv» (paqes klasore). Në rastin e parë neoshqiptarët donin me sa dukej të krijonin një monarki «iluministe» borgjeze, e cila t'i përshtatej shoqërisë borgjeze më të përparuar që do të krijohej.

Shteti reaksionar çifligaro-borgjez me perspektivë gjoja për t'u modernizuar, paraqitej si një «demokraci e re» dhe organet e tij paraqiteshin si organe të mbështetura në sovranitetin popullor. Statuti kombëtar, i cili gjoja do të përsosej më tej, do t'i siguronte popullit të drejtën e zgjedhjeve, si dhe të drejtën të «vinte në dorë» të gjitha «institutet politike»[60]. Por kjo thuhej sa për formë, sepse në anën tjetër pohohej se populli nuk ishte pjekur politikisht dhe të drejtën e zgjedhjeve duhej ta gëzonte në mënyrë të diferencuar sipas shkallës së zhvillimit të rrethinave (krahinave). Mbreti konsiderohej si një autoritet i lartë që qëndronte

55) «Demokratia», 22 dhjetor 1928, f. 2; 23 mars 1929, f. 2.
56) Po aty, 1 janar 1929, f. 5.
57) Po aty, 8 janar 1929, f. 5.
58) Po aty, 1 janar 1929, f. 5.
59) «Vullneti i popullit», 28 nëntor 1930, f. 3.
60) «Përpjekja shqiptare», nëntor 1936, f. 68.

«përmbi korrentet», ndërsa parlamenti si një organ që mund të dilte nga populli dhe ta përfaqësonte atë.

Duke iu përgjigjur kritikës së revistës përparimtare të Korçës «Bota e re», e cila theksonte se «neoshqiptarizma» u bë flamuri ideologjik i diktaturës së «ndritur», Branko Merxhani vinte në dukje se «neoshqiptarët» nuk kishin asgjë të përbashkët me partizanët e «diktaturës së ndritur» dhe se ata ishin për një «nacionalizëm sintetik» dhe për një «demokraci të disiplinuar», e cila do të ishte në gjendje të vinte në jetë «nacionalizmin sintetik» (borgjez) apo ideologjinë kombëtare «neoshqiptare». Në të njëjtën kohë, «neoshqiptarët» u shprehën kundër pikëpamjeve «theokratike, anarshiste dhe bolshevike»[61]. Në fakt «Bota e re» kishte të drejtë. Pavarësisht nga terminologjia «diktaturë e ndritur» ose «demokraci e disiplinuar» dhe nga fakti që termin e parë e përdorën «të rinjtë» dhe të dytën «neoshqiptarët», në thelb të dy grupet ishin për diktaturë dhe shpreheshin në të mirë të regjimit monarkik, të cilin kërkonin ta modifikonin disi në interes të borgjezisë.

Në «demokracinë e disiplinuar«, thoshte Branko Merxhani, nuk duhej të kishte vend për ideologji të tjera qofshin këto «fashiste», «bolshevike», «liberale» dhe «absolutiste» dhe duheshin marrë të gjitha masat që Shqipëria të mos pësonte fatin e vendeve të tjera, të mos tronditej nga kryengritjet[62].

Por, ndërsa thuhej kjo, ndaj ideologjive të përmendura nuk mbahej një qëndrim i njëjtë. Idetë komuniste sulmoheshin e konsideroheshin si të dëmshme, ndërsa idetë dhe sistemi fashist lavdëroheshin. Këto nuk u lavdëruan vetëm nga Vangjel Koça, i cili ishte agjent i fashizmit, por edhe nga Branko Merxhani, i cili me këtë qëndrim konformist erdhi në kundërshtim me kërkesën e tij për forcimin e ndërgjegjes kombëtare.

«Neoshqiptarët», ashtu sikurse edhe të «rinjtë», e pritën me entuziazëm qeverinë «liberale» të Mehdi Frashërit që ishte më tepër një krijesë e klikës zogiste, në kushtet e krizës së thellë politike dhe ekonomike-shoqërore të rendit çifligaro-borgjez dhe të forcimit të luftës popullore kundër tij. Ata e cilësuan këtë si një ngjarje me rëndësi historike dhe një etapë të re në zhvillimin politik të Shqipërisë.

Qeveria e Mehdi Frashërit konsiderohej si një hap i madh përpara drejt përmbushjes së «unitetit kombëtar» dhe krijimit në shoqëri të një «atmosfere armonike dhe të sinqertë» drejt «forcimit të kontakteve midis pushtetit dhe popullit»[63]. Pra, kërkohej të krijohej përshtypja se po afronte

61) Po aty, f. 174-176.
62) Po aty, f. 175, 176.
63) «Illyria», 26 tetor 1935, f. 1.

dita të vendosej paqja klasore dhe të triumfonte demokracia borgjeze e «disiplinuar». Por vendosja e paqes klasore, me gjithë shpresat «neoshqiptare», mund të shtyhej deri në kalendat greke, sepse luftërat revolucionare në këtë periudhë nuk dëshmonin aspak se mund të arrihej një gjë e tillë.

Edhe demokracia e disiplinuar synonte të forconte pozitat e borgjezisë dhe të regjimit. «Neoshqiptarët» ua mohuan masave popullore të drejtat demokratike, duke pohuar, ashtu si të tjerët, se ato ishin të pazhvilluara e të papjekura për të gëzuar këto të drejta.

Kështu, ata u shprehën kundër zbatimit të sistemit elektoral demokratik në Shqipëri, për shkak të zhvillimit të pakët të popullit shqiptar. Zgjedhjet e përgjithshme mund të viheshin në veprim vetëm në disa krahina të zhvilluara, si: «Gjirokastra, Vlora, Korça, Durrësi, Shkodra etj.», ndërsa në krahinat e tjera të mbahej sistemi i vjetër i zgjedhjeve me zgjedhës të dytë[64]. Zbatimi i parimeve demokratike ishte i panevojshëm sipas «neoshqiptarëve» edhe për faktin se, sipas tyre, çdo regjim mund të ishte i mirë dhe mund të përmbushte aspiratat e popullit po të drejtohej nga njerëz «idealistë» dhe të pajisur me kulturë. Pra, kujdesi për popullin duhej t'i lihej qeverisë borgjeze dhe nuk ishte e domosdoshme që ai të vendoste vetë për fatet e tij. Pra, ajo çka u tha se populli në të ardhmen do të «vinte në dorë institutet politike» ishte një mashtrim.

Shumë-shumë për një kohë të ardhshme kërkohej zbatimi i metodave të demokracisë perëndimore[65]. Ndër «neoshqiptarët» pati edhe elementë, si Vangjel Koça e ndonjë tjetër, që lavdëruan regjimin fashist të Musolinit dhe e konsideruan atë si një nga themelet e «qytetërimit», si një «rilindje të katërt mesdhetare»[66].

Këta në shkrimet e tyre në «Demokratia», miratuan politikën antikombëtare të regjimit zogist dhe atë të nënshtrimit të vendit nga imperializmi italian. Propaganda profashiste e gazetës u diktua jo vetëm nga pozita e Vangjel Koçës me shokë, por edhe nga orientimet që kishte dhënë klika zogiste për të lavdëruar Italinë, si dhe nga subvensionet që iu lidhën «Demokratisë» nga italianët.

Lavdëruesit e fashizmit i atribuan atij meritën që gjoja likuidoi anarkinë në vendin e vet dhe kalbëzimin shoqëror të shkaktuar nga demokracia dhe krijoi kushtet për ngritjen e shteteve kombëtare moderne në Evropë. Thuhej se fashizmi kishte kryer vepra madhështore[67].

64) «Demokratia», 16 nëntor 1929, f. 1.
65) «Illyria», 1 shkurt 1936, f. 1-2.
66) «Demokratia», 28 tetor 1932, f. 1.
67) Po aty.

Sipas Vangjel Koçës e shokëve të tij, për të mënjanuar «tendencat katastrofike» të «liberalizmës» dhe të «bolshevizmës», duhej ngritur edhe në Shqipëri një sistem i afërt me sistemin fashist korporativist, në mënyrë që të «harmonizoheshin» interesat klasore e të mënjanoheshin kryengritjet revolucionare[68].

Populli shqiptar, në radhë të parë rinia shqiptare, duhej të organizoheshin sipas sistemit musolinian[69]. Kështu, përfaqësuesit e klasave më reaksionare, shpëtimin nga «bolshevizmi» (komunizmi) e gjenin te fashizmi. Nga kjo pikëpamje grupi i Vangjel Koçës brenda «neoshqiptarizmës» afrohej me rrymën e «diktaturës së ndritur».

Branko Merxhani, ndryshe nga Vangjel Koça e disa të tjerë, nuk ishte për vendosjen e sistemit fashist në Shqipëri dhe e kuptoi rrezikun që vinte nga Italia, megjithëqë nuk e shprehu hapur atë. Ai qëndroi pak a shumë në pozitat patriotike borgjeze dhe kur vendi u pushtua nga Italia, u largua në mërgim.

Por ai, si ideolog borgjez, nuk ishte konsekuent. Edhe pse nuk e miratonte regjimin fashist për Shqipërinë, shkroi në mënyrë konformiste në «Demokratia» disa artikuj në të cilët fashizmi paraqitej si një ideologji e sistem që drejtohej kryesisht kundër kapitalizmit[70]. Kjo tezë e huajtur nga propaganda borgjeze e shtrembëronte të vërtetën mbi fashizmin. Fashizmi ishte diktaturë e hapur terroriste e borgjezisë imperialiste. Ai kishte si suprema lex, shtimin e fitimeve të borgjezisë në kurriz të popujve të tjerë dhe të vetë popullit italian. Fashistët deshën të mashtrojnë popujt duke pohuar në mënyrë demagogjike se ishin kundër kapitalizmit.

Në shkallë të fundit Brankoja e gjente sistemin fashist të papërshtatshëm për vendin tonë nën pretekstin se ai ishte i përshtatshëm gjoja vetëm për strukturat sociale «gjysmëkapitaliste», por jo për strukturat kapitaliste të vendeve të zhvilluara dhe as për strukturat jokapitaliste si e Shqipërisë[71].

Pavarësisht nga konceptimi i gabuar i problemit, i cili nuk i përgjigjej realitetit, rëndësi ka fakti që me anë të argumentimit «teorik» të tij Branko Merxhani nuk e shihte të arsyeshme që në Shqipëri të vendosej regjimi fashist. Dhe kjo lidhej me pozitën e tij, të cilën sapo e vumë në dukje.

Në kërkim të modeleve politike të përshtatshme për vendin, «neoshqiptarët» u ndalën edhe te regjimi borgjez i Turqisë së re, të themeluar nga Mustafa Qemali. Reformat e

68) Po aty.
69) Po aty, 7 nëntor 1936, f. 1.
70) «Minerva», korrik 1935, f. 2.
71) Po aty.

kryera nga Qemal Ataturku tërhoqën mjaft vëmendjen e intelektualëve shqiptarë. Në shtypin e kohës u shkrua me simpati për eksperimentin turk dhe për reformat qytetëruese që u zbatuan atje, të cilat e hodhën Turqinë nga mesjeta në kohën e re dhe e përfshinë në familjen e popujve të qytetëruar të Evropës.

Një pjesë e mirë e intelektualëve borgjezë, duke përfshirë edhe «neoshqiptarët» ishin të mendimit se përvoja e Turqisë së re ishte e përshtatshme për Shqipërinë dhe mund të vihej në jetë. Branko Merxhani vuri në dukje një gjë thelbësore e me rëndësi se qemalizmi «ishte një rebelim kundër kolonizimit en bloc», një luftë çlirimtare kundër Fuqive të Mëdha[72]. Pra, te qemalizmi vlerësohej ajo çka ishte kryesore, fitimi i lirisë dhe i pavarësisë së vendit. Me këtë bëhej aluzion që edhe Shqipëria duhej të mbetej e lirë dhe e pavarur dhe duhej të përballonte rreziqet e jashtme që mund t'u kanoseshin.

Një farë lavdërimi qemalizmit u mundua t'i bënte edhe Vangjel Koça me gjithë parapëlqimin që kishte për regjimin fashist. Por këtë ai e përdori në mënyrë dhelparake e jezuite për të ngritur në qiell akoma më shumë fashizmin. Arsyetimi i tij ishte i tillë: qemalizmi i përshtatej më shumë natyrës e psikologjisë së shqiptarëve sesa fashizmi. Fashizmi ishte gjoja një sistem me ideale të larta e universale për të cilën shqiptari ende nuk ishte pjekur e nuk kishte arritur shkallën e duhur të zhvillimit[73]. Me këtë ai kërkonte të maskonte qëndrimin e tij profashist. Por kur fashistët e pushtuan Shqipërinë dhe Vangjel Koça u vu hapur në shërbim të regjimit të pushtimit, ai u mundua të argumentonte se ky regjim ishte gjoja më i përshtatshmi për vendin. Pra, për Vangjel Koçën e ndonjë tjetër duhej, siç dukej, agresioni fashist qe vendi të piqej për këtë regjim. Pavarësisht nga ndonjë prirje profashiste, «neoshqiptarizma» në përgjithësi anonte nga diktatura borgjeze e zakonshme dhe mendonte se regjimi zogist me ndonjë modifikim në të mirë të borgjezisë ishte i përshtatshëm për vendin.

6. «STATIKA», «DINAMIKA» DHE PROBLEMI I ZHVILLIMIT BORGJEZ NË SHOQËRINË SHQIPTARE

Thamë se problemi kryesor për «neoshqiptarët», ashtu sikurse për pozitivizmin në përgjithësi, ishte ai i sigurimit

72) Po aty.
73) «Demokratia», 25 janar 1930.

të rendit me anë të solidaritetit shoqëror dhe të shtetit borgjez.

Çështja e progresit vinte në plan të dytë dhe progresi merrej si një evolucion i zakonshëm borgjez. Kjo lidhej me teorinë mekaniciste të statikës e dinamikës që ishte kopjuar nga fizika.

Ky lloj progresi që duhej të mbështetej mbi zhvillimin kulturor i kundërvihej përparimit të shpejtë revolucionar të shoqërisë. «Neoshqiptarët», ashtu sikurse dhe pozitivistët, e kishin në gojë fjalën progres, por ai konceptohej prej tyre si një zhvillim tepër i ngadalshëm që përjashtonte çdo ndryshim thelbësor e të rëndësishëm të marrëdhënieve shoqërore dhe parakuptonte ruajtjen e statuskuo-së sociale. Pra, progresi pozitivist ishte antipodi i progresit të vërtetë.

Në bazë të teorisë së mësipërme, marrëdhëniet dhe institutet shoqërore duheshin parë në gjendjen e tyre statike, në gjendje të palëvizshme. Në këtë gjendje duhej të studioheshin, të shqyrtoheshin në mënyrë që të njiheshin ato dhe të arrihej në përfundime të sakta sociologjike e filozofike.

Në këtë fazë nuk do të hetoheshin as shkaqet e lindjes dhe të zhvillimit të tyre, të cilat nuk mund të njiheshin, dhe as kundërthëniet që përjashtoheshin. Ato vetëm do të përshkruheshin e sistemoheshin në mënyrë empirike e sempliste. Të gjitha dukuritë do të shikoheshin nën prizmin e kulturës dhe do të grupoheshin në skema e struktura të krijuara në mënyrë konvencionale. Kjo metodë të kujton atë që përdorin strukturalistët, të cilët me anë të skemave e strukturave të shpikura errësojnë përmbajtjen e vërtetë të marrëdhënieve dhe fshehin kundërthëniet klasore.

«Neoshqiptarët» pohonin se, pasi të përfundonte faza e njohjes dhe e shqyrtimit të shoqërisë në gjendjen e saj statike, atëherë do të fillonte faza e re e dinamikës, faza e kryerjes së ndryshimeve apo reformave shoqërore në bazë të përfundimeve dhe njohurive të nxjerra nga studimi. Në fakt, dinamika shoqërore me parullën e progresit, ishte një evolucionizëm nga më të zakonshmit, një reformizëm borgjez më shumë në letër sesa në praktikë.

Branko Merxhani kishte mendimin se plagët e shoqërisë shqiptare ishin të panjohura për «neoshqiptarët», prandaj ata nuk mund të merreshin me shërimin e tyre dhe nuk mund të parashikonin të ardhmen, sepse kjo gjoja nuk ishte detyrë e tyre, por e «profetëve»[74]. «Neoshqiptarët» kishin për detyrë vetëm të konstatonin ngjarjet, të «ndriçonin veprimin» e njerëzve dhe të «zbutnin pasionet» e tyre. Por

74) «Përpjekja shqiptare», janar-mars 1939, nr. 25-27, f. 9.

lindte pyetja: Si mund të ndriçohej veprimi për shërimin e plagëve kur nuk njiheshin ato? «Neoshqiptarizma» as vetë nuk e kishte të qartë sesi mund të shërohen sëmundjet e padiagnostikuara. Në një kohë kur plagët e shoqërisë shqiptare ishin aq të shumta dhe të dukshme (të natyrës ekonomike, shoqërore, politike etj.), pohohej në mënyrë agnostiçiste se ato ishin të panjohura, se gjoja nuk diheshin arsyet e vërteta të tyre dhe se ishte e kotë të kërkoheshin.

Kryesorja, sipas Branko Merxhanit, ishte që të konstatoheshin ngjarjet pa hyrë në thellësi, në thelbin e tyre, në mënyrë që të mos nxiteshin dhe bile të shuheshin kundërthëniet shoqërore e prirjet revolucionare, «të zbuteshin pasionet», siç shprehej ideologu «neoshqiptar», të krijohej bindja se rendi çifligaro-borgjez nuk vuante nga ndonjë sëmundje e rëndë.

Te «neoshqiptarët», ashtu sikurse edhe te pozitivistët, koncepti i progresit shkonte krahas konceptit të rendit, të rregullit, të ruajtjes së tij. Progresi mund të sigurohej nga çdo regjim.

Ata mendonin se shoqëria shqiptare kishte marrë rrugën e zhvillimit borgjez dhe drejt kësaj rruge po ecte gjithnjë përpara, megjithëqë me një «ngadalësi» shumë të madhe[75].

Sipas Branko Merxhanit, ky zhvillim normal borgjez «dhe pa trazira d.m.th. pa tronditje shoqërore» ishte në përputhje me «strukturën» bujqësore borgjeze (borgjezi e vogël) të Shqipërisë, së cilës i mungonte gjoja industria dhe proletariati. Edhe me këtë strukturë ekonomike-sociale të prapambetur, gjysmëkapitaliste, mund të arriheshin objektivat kapitaliste, mjaftonte që të mënjanoheshin «trazirat shoqërore» dhe të pajtoheshin interesat klasore. Feudalizmi thuhej se «ndodhej në shkatërrim e sipër» dhe vendi po ecte «drejt një demokracie, hem si një organizim kulturor, hem si një organizim ekonomik»[76].

Nga ky shpjegim i mësipërm dalin disa çështje që kërkojnë një farë sqarimi. Së pari, duhet thënë se në pohimet e Brankos lidhur me zhvillimin e vendit kishte një farë pështjellimi. Ai herë e cilësonte vendin si gjysmëkapitalist, herë thoshte se kishte natyrë jokapitaliste. Zhvillimin e dobët të kapitalizmit në Shqipëri e konsideronte zhvillim normal, për arsye se sipas tij në këtë fazë kundërthëniet klasore nuk ishin aq të ashpra si në fazën e kapitalizmit të zhvilluar. Ai dhe të tjerë kishin pikëpamjen jo të saktë se në Shqipëri në këtë kohë mungonin dy klasat kryesore antagoniste të shoqërisë borgjeze. Në fakt ato ishin të pranishme

75) «Përpjekja shqiptare», dhjetor 1936, f. 176.
76) Po aty, f. 176-177.

dhe lufta midis tyre sa vinte po forcohej. Shqipëria, edhe pse kishte një nivel të ulët borgjez, nuk u shpëtoi «trazirave shoqërore» të këtij sistemi. Pohimi se vendi kishte strukturë «gjysmëkapitaliste» bujqësore borgjeze (borgjezi e vogël), «pa industri e proletariat» ishte konfuz dhe pa bazë.

Nga ana tjetër, pa bazë ishte edhe paraqitja e marrëdhënieve borgjeze në të gjitha fushat si marrëdhënie me karakter «demokratik».

Kusht me rëndësi për zhvillimin normal të marrëdhënieve borgjeze, konsiderohej zgjidhja e problemit agrar. Sigurisht, «neoshqiptarët» nuk ishin për një zgjidhje radikale të kësaj çështjeje, po për një zgjidhje liberale borgjeze, e cila të mos injoronte interesat e pronarëve dhe, nga ana tjetër, t'i hapte rrugën edhe zhvillimit të kapitalizmit në bujqësi.

Ata i kundërshtuan kërkesat e elementëve revolucionarë e demokratë për një zgjidhje me themel të çështjes agrare dhe me anë të dhunës.

«Çështja agrare, — sipas tyre, — nuk duhej të zgjidhej si në Rusinë bolshevike, po si në vendet e tjera të qytetëruara, d.m.th. pa trazira, pa kryengritje, po me përhapjen graduale dhe me zbatimin sistematik të planeve reformonjëse»[77].

Mendimi i tyre ishte që zhvillimi kapitalist në bujqësi, si dhe në përgjithësi, të ndiqte «rrugën prusiane», të mos i cenonte thellë marrëdhëniet ekzistuese dhe strukturën klasore. Ata lavdëruan «përpjekjet» e regjimit, i cili gjoja «kishte bërë shumë për bujkun», si dhe reformën agrare zogiste si një reformë progresive me rëndësi që do t'ia ndryshonte gjoja faqen bujqësisë dhe do të përmirësonte gjendjen e fshatarësisë.

Ideologët «neoshqiptarë» prekën edhe problemin e krizës së thellë që po kalonte vendi. Kjo, sipas tyre, kishte më tepër shkaqe shpirtërore sesa ekonomike dhe ishte rrjedhim «i ndryshimit mendor» që kishte vendi nga «bota e qytetëruar»[78].

Ata erdhën në përfundimin se në Shqipëri nuk mund të ndryshohej gjendja me reforma ekonomike-shoqërore, por vetëm me përpjekjet mendore të elitës së zgjedhur, e cila në fazën e dinamikës duhej të ndryshonte mentalitetin e njerëzve për t'i pajisur ata me një ideologji dhe edukatë të re. Për të shkundur «letargjinë mendore» dhe për të gjallëruar jetën intelektuale, e panë të nevojshme të nxirrnin një revistë me anë të së cilës të përhapnin idetë e veta.

77) «Demokratia», 22 dhjetor 1928, f. 2.
78) Po aty, 27 shtator 1930, f. 3-4.

Kjo ishte revista «Përpjekja shqiptare», revista më me autoritet e «neoshqiptarizmës», e cila filloi të botohet në vitin 1937 dhe pati jetë deri në fillim të vitit 1939. «Përpjekja shqiptare» ndikoi mjaft në rrethet e intelektualëve borgjezë. Në të u botua një material i pasur për kohën për çështjet filozofike, sociologjike, politike e kulturore. Aty u përzien në mënyrë eklektike pikëpamjet e shkollave reaksionare dhe midis tyre depërtuan edhe disa ide materialiste e përparimtare si ato të Dekartit e të ndonjë tjetri. Lidhur me metodën racionaliste të Dekartit u botuan disa shkrime. Në revistë u botuan, krahas kritikave kundër ideve dhe lëvizjes komuniste shqiptare, edhe disa shkrime të elementëve përparimtarë. Kjo vinte ngaqë organet e asaj periudhe nuk kishin një platformë rigorozisht të përcaktuar. Përveç kësaj, organet reaksionare të kohës, nuk mundën t'ua mbyllin dyert hermetikisht ideve përparimtare, të cilat depërtuan kudo. Vetëm organet reaksionare klerikale nuk pranonin asnjë ide të huaj për ideologjinë e tyre.

«Përpjekja shqiptare» zhvilloi një sërë polemikash, në mënyrë të veçantë me elementët përparimtarë e revolucionarë. Ajo mundohej të rivalizonte edhe me revistat katolike me të cilat zhvilloi gjithashtu një farë polemike.

«Neoshqiptarët» i bënë thirrje elitës borgjeze që të zhvillonte edhe veprimtari të tjera kulturore. Ata ishin të mendimit se si burim themelor i kulturës borgjeze duhej të shërbenin shkollat e huaja filozofike e sociologjike, por nuk duhej të injorohej edhe fondi kombëtar «popullor». Madje, ata bënin thirrje në frymën e një farë populizmi që intelektualët të futeshin në popull, të grumbullonin atje materialin e nevojshëm, thesarin e popullit dhe ta përpunonin atë sipas teorive e pikëpamjeve «të përparuara» të oksidentit.

Kështu kultura borgjeze «neoshqiptare» duhej të sintetizonte vlerat kulturore të «oksidentit» me ato të vendit. Vetëm atëherë nacionalizmi borgjez «sintetik» mund të kishte një vlerë të plotë dhe mund të siguronte përparimin e duhur.

«Neoshqiptarët» kërkuan gjithashtu kryerjen e një reforme arsimore që do të krijonte kushtet për përhapjen në popull të kulturës borgjeze «neoshqiptare». Kjo paraqitej si një kërkesë për shkollë popullore por ajo nuk mund të përmbushej si për arsye të ideve elitariste të tyre ashtu edhe të kushteve të papërshtatshme të kohës[79].

«Neoshqiptarët» një reformë të tillë e pritnin nga regjimi zogist që ishte kundër kësaj shkolle. Ai duke shpikur rrezikun e superprodhimit intelektual, e kufizoi mjaft arsimin në Shqipëri. Përveç kësaj «neoshqiptarët» nuk e shtruan këtë

79) Po aty, 25 janar 1930.

si detyrë të ngutshme, por e lanë për më vonë pasi të krijohej elita e kulturuar, pasi të përsosej shtresa ekzistuese intelektuale dhe të krijohej doktrina «neoshqiptare». Në këtë mënyrë zgjidhja e kësaj detyre shtyhej deri në kalendat greke.

Çështja nëse roli «edukativ e reformonjës» i shkollës nuk çmohej në Shqipëri sa duhej, nuk shpjegohej me faktin që në vend kishte pak «njerëz të vërtetë të mendimit», siç thoshin «neoshqiptarët», por me faktin që klasat sunduese dhe regjimi reaksionar zogist ishin të interesuar të ndiqnin një politikë antidemokratike dhe obskurantiste në fushën e arsimit e të kulturës, në mënyrë që ta mbanin popullin në errësirën e padijes dhe të nënshtruar.

Pra, e keqja nuk mund të çrrënjosej me anë të krijimit të një elite të kulturuar[80], por duke e ndryshuar në themel gjendjen ekzistuese dhe duke vendosur në vend demokracinë popullore. Por kjo ishte jashtë konceptimit të ideologjisë borgjeze.

7. QËNDRIMI NDAJ IDEVE KOMUNISTE DHE LËVIZJES REVOLUCIONARE SHQIPTARE

Ideologët «neoshqiptarë» gjatë shtjellimit të pikëpamjeve të tyre, u morën edhe me kritikën kundër ideve dhe lëvizjes komuniste shqiptare.

Ata arritën deri aty sa në mënyrë tendencioze të kritikonin edhe teorinë marksiste-leniniste në përgjithësi. Në gjykimin e tyre nuk kishte ndonjë gjë origjinale. Pohimet e tyre për këtë çështje ishin përsëritje e mendimeve të njohura të ideologëve të huaj borgjezë, të cilët janë përpjekur të shtrembërojnë edhe të denigrojnë doktrinën marksiste.

Marksizmit i atribuohej në mënyrë falsifikuese tendenca e materializmit vulgar, e absolutizimit të faktorit ekonomik dhe e nënvleftësimit të faktorëve të tjerë çka nuk pajtohej aspak me frymën e tij. Kjo akuzë e njohur e pabazë i ishte bërë marksizmit edhe nga ideologët e ndryshëm borgjezë. Këtë shtrembërim të frymës së tij e pat hedhur poshtë e demaskuar vetë Frederik Engelsi në kohën e vet[81]. Sipas «neoshqiptarizmës» doktrina materialiste marksiste gjoja në këtë hipertrofizim të rolit të faktorit ekonomik kishte thembrën e Akilit.

Pranimi i karakterit primar të faktorit ekonomik dhe

80) «Minerva», 20 tetor 1933, f. 3.

81) K. Marks — F. Engels. *Vepra të zgjedhura*, vëll. II, f. 544-546 (Letër e F. Engelsit drejtuar V. Borgiusit, Londër, 25 janar 1894).

mbështetja e determinizmit materialist mbi faktorët materialë ekonomikë, ishte gjoja baras me mohimin e faktorëve shpirtërorë ose me reduktimin e faktorëve dhe fenomeneve jomateriale në «hije fenomene si hija e njeriut, që nuk ndikonin mbi njeriun». Në fakt marksizmi nuk e thotë një gjë të tillë. Ai as e hipertrofizon rëndësinë e faktorit ekonomik dhe as e mohon rëndësinë e faktorëve të tjerë dhe nuk i kthen fenomenet shoqërore jo ekonomike në «hije fenomene». Pranimi i karakterit primar të faktorit material nuk është baras me mohimin e rëndësisë së faktorëve të tjerë. Pranimi i këtij demiurgu objektiv dhe aspak fiktiv të realitetit social-historik e fuqizon dhe e shton më shumë rëndësinë e faktorëve të tjerë. Marksizmi nuk e absolutizon rolin përcaktues të faktorit ekonomik dhe pohon hapur se edhe faktorë të tjerë, ideologjikë e politikë në momente të caktuara mund të luajnë rol përcaktues. Ata përcaktohen në shkallë të fundit nga faktorët ekonomikë dhe si faktorë më vete kanë mjaft liri e pavarësi, kanë ndikim të madh mbi faktorët ekonomikë e mbi njëri-tjetrin.

Monizmit materialist, të cilin për këto arsye e konsideronte të kufizuar, Branko Merxhani, i kundërvinte pluralizmin idealist të Emil Dyrkheimit e të tjerëve, të cilët pranonin ekzistencën në të njëjtën kohë të shumë faktorëve që përcaktojnë zhvillimin historiko-shoqëror. Pra, si të tillë konsideroheshin, në radhë të parë, faktorët shpirtërorë. Ky vizion pluralist i botës u përhap mjaft në filozofinë e sociologjinë e idealiste borgjeze.

Sipas Branko Merxhanit faktori ekonomik, siç e përmendëm në fillim të kapitullit, «s'kishte ndonjë pozitë të privilegjuar» në mes të faktorëve të tjerë dhe ashtu si «fenomenet shoqërore të tjera mund të bëheshin shkak të fenomeneve ekonomike», «edhe fenomenet ekonomike mund të bëheshin shkak të fenomeneve shoqërore të tjera»[82] Kështu, në bazë të determinizmit idealist, të gjithë faktorët socialë ishin të barabartë dhe duhej të viheshin në një rrafsh për nga rëndësia dhe forca e veprimit. Por Branko Merxhani, duke e diferencuar marksizmin nga dyrkheinizmi dhe duke e konsideruar të parin të gabuar në thelb dhe të dytin të vërtetë, gjente midis tyre gjoja edhe ndonjë afërsi. Kështu, për të që të dyja prirjet pranonin se «lëvizjet shoqërore ishin rrjedhje e shkaqeve natyrore dhe se kaq problemet e jetës si dhe problemet e shpirtit u shtroheshin ligjeve natyrore»[83].

Pra, materializmi me pozitivizmin idealist paskëshin të përbashkët, sipas këtij arsyetimi, pranimin e shkaqeve «natyrore» në zhvillimin e shoqërisë. Në fakt kjo nuk ishte e saktë. Sociologjia e Dyrkheimit ishte idealizëm puro dhe s'kishte asgjë të përbashkët me materializmin marksist. Teoria e tij e «përfytyrimeve kolektive» nuk pasqyronte aspak botën materiale, por vetëm dukuritë subjektive psikologjike që nuk ishin pasqyrim i realitetit. Kjo ishte diametralisht e kundërt me frymën e marksizmit.

Branko Merxhani ishte tepër eklektik e kontradiktor në vlerësimin e metodës materialiste marksiste. Herë thoshte se kjo ishte «një metodë e shkencës pozitive», një «metodë shkencore e kthjellët për studimin e fenomenit shoqëror» që «fenomenin shoqëror e merr si një fenomen ekonomik dhe shpjegon lëvizjet historike të shoqërisë njerëzore brenda vijave të një lëvizjeje ekonomike të përgjithshme, e cila s'ka asnjë dyshim se është një nga burimet më me rëndësi të zhvillimeve historike, por një kohë e sipër edhe një nga shkaqet më kryesore të ndryshimeve shoqërore... është një nga bazat më të shëndosha mbi të cilat, mund të mbështetet edhe historia shkencore ose një histori me të vërtetë shkencore, një histori jo përrallë, jo myth»[84], herë pohohej se pranimi nga marksizmi i «ekskluzivitetit të faktorit ekonomik» e bënte gjoja atë «të çalë e të paplotësuar, hem si teori përgjithësisht, hem si praktikë posaçërisht, sidomos për vendin tonë»[85]. Pra, ai me gjykimet e tij notonte në ujërat e kundërthënieve dhe të antinomive që e bënin arsyetimin të paqendrueshëm dhe aspak bindës.

Pasi deshi të provonte të metat e boshllëqet e marksizmit në përgjithësi, ideologu neoshqiptar u mor edhe me kritikën e ideve dhe të lëvizjes komuniste shqiptare. Edhe këtu nuk mund të thuhet se krijoi ndonjë gjë origjinale.

Duke bërë fjalë për lëvizjen komuniste në Shqipëri, ideologu i «neoshqiptarizmës» e mohoi ekzistencën e një lëvizjeje të tillë. Ai thoshte se nuk kishte kushte «ekonomike dhe shoqërore» të përshtatshme për të, nuk kishte gjoja «zhvillim industrial» dhe «luftë klasash»[86], Ishte, pra, ajo teza e njohur e përmendur dhe nga të tjerë.

Idetë komuniste, sipas tij, ishin rrjedhim i faktorëve psikologjikë, i një «nervoziteti latent» që rridhte gjoja nga mosha e re, i «ambicjeve pa fre të Sturm und Drangut», siç shprehej ai, i një psikoze kalimtare të zemërimit që edhe pse shtohej dita-ditës, po të merreshin masa shëruese nga regjimi mund të zhdukej[87]. Komunizmi ishte gjoja thjeshtë

82) «Demokratia», 30 korrik 1932, f. 3.
83) «Illyria», 19 tetor 1935, f. 5.

84) Po aty, 12 tetor 1935, f. 5.
85) «Përpjekja shqiptare», dhjetor 1936, f. 180.
86) «Illyria», 12 tetor 1935, f. 5; «Përpjekja shqiptare», janar-mars 1939, nr. 25-27, f. 66-67.
87) «Illyria», 12 tetor 1935, f. 3.

një dukuri e përkohshme psikologjike që shpjegohej me temperamentin e moshës së re. Ishte më tepër një ekzaltim i natyrave «romantike» dhe ëndërronjëse. Pra, ashtu sikurse nuk kërkoheshin të njiheshin arsyet e plagëve të shoqërisë shqiptare, ashtu injoroheshin edhe rrënjët e vërteta të lëvizjes komuniste e revolucionare.

«Neoshqiptarët» këtë psikozë të zemërimit me prirje për t'u përhapur mundoheshin ta argumentonin me teoritë reaksionare të Gustav Lë Bonit mbi «psikologjinë e turmave». Sipas këtyre teorive, turma karakterizohej nga egërsia, zemërimi, violenca, mungesa e arsyetimit. Ajo merrte shkëndijë gjoja për një gjë të vogël dhe shpërthente në pasione të egra e të papërmbajtura.

«Neoshqiptarët» e kështillonin qeverinë reaksionare zogiste që të studionte psikologjinë e turmave të zemëruara, ashtu siç bënin gjoja edhe qeveritë e tjera, në mënyrë që të merrte disa masa për të parandaluar ose ndaluar zemërimin e lëvizjet e tyre.

Kjo tregonte se pakënaqësia dhe revolta e masave nuk kishin përfshirë disa elementë të veçantë, sikurse thuhej, dhe nuk ishin dukuri sporadike, por kishin përfshirë shtresa të gjera të popullit.

Një arsye tjetër, me anën e së cilës Branko Merxhani shpjegonte përhapjen e ideve komuniste në Shqipëri, sipas tij ishte dhe fakti, që qeveritë që kishin ardhur në fuqi nuk ishin të pajisura me përvojën e duhur dhe nuk i jepnin rëndësi faktorit psikologjik. Të paktën 50 për qind të mjerimeve shoqërore mund të ishin parandaluar sikur këto qeveri të ishin përgatitur më mirë për të përballuar me sukses zemërimet shoqërore[88].

Në fazën që po kalonte shoqëria shqiptare, arsyetonte ai më tej për të treguar se nuk kishte bazë për luftë klasash në Shqipëri, problemet kryesore ishin problemet e «statikës» që kishin për qëllim formimin e idealeve kolektive, pra problemet e një «karakteri moral e psykosintetik». Disa nga vështirësitë dhe anomalitë që rridhnin nga kjo fazë kishin, sipas tij, më tepër një karakter «shtetëror», sesa «shoqëror». Ç'donte të thoshte kjo? Kjo donte të thoshte se këto anomali nuk e kishin burimin e tyre në rendin ekonomiko-shoqëror ekzistues, në kontradiktat e thella të tij, por vetëm në disa dukuri të tilla teknike e kulturore që lidheshin me aparatin shtetëror-administrativ, me mungesën e elementëve të përgatitur mirë dhe të aftë për të drejtuar këtë aparat. Po të likuidoheshin këto anomali të vogla, nuk do të kishte vend aspak për ide e lëvizje komuniste dhe të gjitha «për-

88) Po aty, f. 5.

pjekjet do të zhvilloheshin brenda kornizave thjeshtë nacionaliste e demokratike»[89].

Branko Merxhani, duke marrë pozën e filozofit dhe të sociologut, thoshte se ekonomia politike marksiste nuk kishte të drejtë kur pohonte se pasuritë kombëtare në kushtet e kapitalizmit ishin grumbulluar në duar të pakicës. Kjo kërkohej të vërtetohej me anë të shifrave pa bazë të marra nga shtypi borgjez. Përveç kësaj, thuhej se në kapitalizëm industria e madhe nuk e shkatërronte industrinë e vogël dhe mëditjet e punëtorëve nuk pësonin ndonjë rënie në krahasim me rritjen e fitimeve të kapitalistëve. Ideologu neoshqiptar, ashtu si dhe të tjerë, u përpoq të mbronte gjithashtu tezën se idetë komuniste në Shqipëri ishin të importuara nga jashtë[90].

Edhe Vangjel Koça, po ashtu, u mundua të shpjegonte shkaqet e përhapjes së ideve komuniste në Shqipëri dhe kështillonte sesi duhej të luftoheshin këto. Ky agjent i fashizmit ishte shqetësuar që në Shqipëri po ndiheshin «efektet e përleshjes kuq e bardhë» dhe që idetë komuniste po përhapeshin në gjithë vendin. Por dhe ai shpresonte se «sëmundja nuk ishte akoma e madhe dhe nuk kishte zënë akoma rrënjë», «ajo ndodhej në fazën e klloçitjes sentimentale», prandaj «nuk ishte i zorshëm dhe bari për shërimin e sëmundjes»[91]. Ai shpjegonte një sërë rastesh sesi mund të përhapeshin idetë komuniste tek njerëzit, sidomos te të rinjtë. Ato përhapeshin, gjoja, në radhë të parë te studentët që studionin në vendet e huaja dhe shikonin «mizerjen» e atjeshme, ndikoheshin nga idetë komuniste të atij vendi. Idetë komuniste bënin për vete gjithashtu të rinjtë që ishin të etur për ideale dhe që duke kërkuar e duke mos gjetur të tjera, ndaleshin tek ideologjia komuniste, e cila i bënte për vete. Një burim tjetër i ideve komuniste, sipas tij, ishin «klasat shoqërore që vuanin nga mizerja», të cilat, duke mos pasur as kafshatën e bukës, ndikoheshin prej këtyre ideve.

«Kategoria e tretë, — thoshte ky ideolog reaksionar, — d.m.th. kategoria popullore, është me të vërtetë shumë e rrezikshme, se mund të bëhet shesh për mbjellje të mikrobit komunist dhe për eksperimente të rrezikshme»[92].

Siç shihet, «neoshqiptari» profashist kishte mundur t'i zbulonte shkaqet e përhapjes së ideve komuniste në Shqipëri në varfërinë e mjerimin e masave popullore dhe jo në fak-

89) Po aty.
90) «Përpjekja shqiptare», mars 1937, f. 183-200.
91) Po aty, prill 1937, nr. 7.
92) Po aty, f. 1-3.

torët thjesht psikologjikë si Branko Merxhani. Tabloja e «klasave shoqërore që vuanin nga mizerja» ishte e gjallë dhe atë e dallonte dhe i verbri. Mjerimi dhe varfëria, shtypja dhe shfrytëzimi kontradiktat dhe lufta e klasave nuk mund të mos lindnin idetë revolucionare dhe luftën revolucionare. Ky korrelacion faktesh e dukurish ishte i dukshëm dhe i pakamufluar. Vangjel Koça propozonte edhe mjetet sesi duhej të luftoheshin idetë komuniste ose më mirë se si duhej të parandaloheshin. Për këtë ai mendonte para së gjithash që «djalërisë» t'i krijoheshin kushte të mira, «t'i hapej rruga e jetës» dhe «t'i jepej mundësia të pajisej me idealet kombëtare». Kjo kërkonte, sipas tij, në të njëjtën kohë edhe «përtërirjen» e elitës ose «klasës drejtonjëse». Djalëria duhej të organizohej si në Italinë fashiste dhe në Gjermaninë naziste. Ai propozonte gjithashtu si një mjet të rëndësishëm «që të luftohej mizerja ekonomike e shoqërore me një politikë të përshtatshme»[93].

Të gjitha këto propozime ishin propozime prej demagogësh e farisenjsh. Ato nuk i hynin në punë regjimit çifligaro-borgjez. Klasat sunduese nuk kishin ndërmend të likuidonin «mizerjen», sepse ekzistenca e tyre mbështetej mbi mjerimin popullor. I vetmi mjet efikas që mund të përdornin kundër ideve revolucionare ishte dhuna, kërbaçi. «Neoshqiptarët» me qëndrimin e tyre i erdhën në ndihmë regjimit në luftën kundër ideve komuniste, u treguan shërbëtorë të tij dhe kundërshtarë të lëvizjes revolucionare.

Ideologjia «neoshqiptare» me teoritë e saj antidemokratike të kopjuara nga shkollat e huaja reaksionare, që mbronin rendin çifligaro-borgjez e monarkinë dhe luftonin kundër çdo shndërrimi revolucionar e përparimi të vërtetë, u prit me kritika të ashpra nga opinioni demokratik i vendit.

Elementët revolucionarë e përparimtarë, sidomos komunistët, mbajtën qëndrim ndaj kësaj ideologjie që kërkonte të maskohej me traza përparimtare e që i shërbente reaksionit. Një nga revistat demokratike më me autoritet të kohës, siç ishte «Bota e Re» e Korçës, e cila ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të komunistëve, shkroi një sërë artikujsh kritikë kundër rrymave reaksionare borgjeze «neoshqiptare» dhe të «të rinjve», ashtu sikurse dhe kundër ideologjisë reaksionare në përgjithësi.

«Bota e re» demaskoi pseudonacionalizmin dhe pseudoliberalizmin e ideologjisë borgjeze.

«Flamurin e nacionalizmës shqiptare, — shkruante revista, — e kanë rrëmbyer tani ca njerëz që nuk janë aspak në lartësinë e rolit që duan të lozin si udhërrëfyes të rinisë

93) Po aty, f. 6-7.

shqiptare»[94]. Ajo kritikoi pikëpamjet antidemokratike të Branko Merxhanit me shokë, spekulimet e tyre filozofike në shërbim të një elite të zgjedhur e të reaksionit, injorimin prej tyre të halleve të popullit[95].

Këto kritika do t'i analizojmë më hollësisht në kapitullin mbi idetë demokratike të periudhës. Qëndrimi kritik e kundërshtues që mbajti shtypi përparimtar e revolucionar ndaj «neoshqiptarizmës» dëshmonte për karakterin antidemokratik të saj, si dhe për pjekurinë e elementëve revolucionarë, të cilët nuk u mashtruan nga frazat «liberale» dhe as nga «erudicioni» i mbledhur andej-këndej prej neoshqiptarëve. Komunistët dhe elementët demokratë i bënë qëndresë transplantimit të ideve reaksionare pozitiviste në Shqipëri, ashtu sikurse u bënë qëndresë edhe të gjitha ideve të tjera të markave «oksidentale e fashiste».

94) «Bota e re», nr. 12, 30 shtator 1936, f. 1-2.
95) Po aty, nr. 14, 30 tetor 1936, f. 16-17.

KREU IV

PIKËPAMJET POLITIKE-SHOQËRORE TË KLERIT REAKSIONAR

Një nga rrymat më reaksionare të viteve '30-të ishte ajo e klerit. Pikëpamjet politike-shoqërore të tij, në mënyrë të veçantë ato të klerit katolik, kishin një karakter të theksuar antidemokratik e antikombëtar. Në këtë kapitull do të përpiqemi t'i shtjellojmë me hollësi këto pikëpamje. Në objektiv të studimit tonë nuk përfshihet ideologjia fetare në përgjithësi, por vetëm mendimi politiko-shoqëror klerikal. Ideologjia fetare përbën një objekt më vete që kërkon një studim të veçantë. Natyrisht, pikëpamjet politike-shoqërore të klerit mbështeteshin në ideologjinë fetare. Por ne e kemi trajtuar atë aq sa ishte e nevojshme të bëhej lidhja e dogmave dhe doktrinave fetare me platformën politike-shoqërore. Këtu është e nevojshme të sqarojmë që në fillim një problem me rëndësi. Në luftën ideologjike të periudhës për çështjet politike-shoqërore, jo i gjithë kleri u angazhua njësoj. Madje, kleri ortodoks nuk trajtoi çështjet politike-shoqërore të kohës por u mor me anën dogmatike të ideologjisë fetare. Në këtë predikim dogmash reaksionare kishte aluzione për çështjet e kohës por mungonte shtjellimi i hapur i ideve që na interesojnë.

Në ballafaqimin me rrymat e tjera, sidomos me ato revolucionare e përparimtare, më aktivi ishte kleri katolik, i cili ishte mjaft i organizuar, i përgatitur dhe me përvojë. Në polemikë mori pjesë në një farë shkalle edhe kleri mysliman. Por ky nuk i trajtoi aq gjerësisht e si duhej çështjet në fjalë. Ai u mor më shumë me anën dogmatike. Kleri ortodoks nuk mori pjesë fare në diskutim të problemeve politiko-shoqërore. Ai u kufizua me propagandën fetare në popull, e cila natyrisht si çdo propagandë fetare kishte karakter reaksionar e synonte të përjetësonte shfrytëzimin e sundimin e klasave reaksionare.

Në kohët e reja dhe moderne kleri ka luajtur një rol shumë negativ në Shqipëri. Ka bërë herë më pak e herë më shumë lojën e pushtuesve, të fuqive imperialiste e shoviniste, është munduar ta përçajë popullin, i ka bërë qëndresë e luftë të ashpër përpjekjeve për forcimin e konsolidimin e kombit, të shtetit kombëtar shqiptar dhe për vendosjen e demokracisë.

Rolin më negativ e ka luajtur sidomos kleri katolik, i cili prej kohësh u vu në shërbim të fuqive imperialiste.

Në vitet 30-të ai ishte agjenturë e Italisë fashiste dhe e Vatikanit që kishte për mision të ndihmonte në përgatitjen e agresionit fashist dhe të kundërshtonte lëvizjet revolucionare e përparimtare dhe luftën për demokracinë. Ai ishte një Kalë Troje që i krijoi telashe të mëdha popullit e kombit. Kleri katolik, kishte zhvilluar një veprimtari të gjatë në Shqipëri, kishte grumbulluar përvojë të madhe, ishte mjaft i përgatitur dhe, siç thotë shoku Enver Hoxha: «Feja katolike është më e rrezikshme, traditat i ka më të thella, ka ndërtesa monumentale, si katedralet, ka njerëz me shkollë...»[1]. Klerikët katolikë kishin mbajtur «... nga njëqind flamure në xhep, që nga ai i Habsburgëve deri te flamuri i reaksionit i fashizmit...» dhe i kishin shërbyer «.... merimangës së madhe të Vatikanit...»[2].

Veprimtarinë dhe ideologjinë e vet kleri katolik u mundua ta kamuflojë. Ai shquhej për aftësinë për t'iu përshtatur kushteve e rrethanave historike, për të ndryshuar ngjyrën si kameleoni. Hierarkia e lartë katolike (Vatikani), në kushtet e forcimit të lëvizjeve revolucionare të proletariatit dhe rritjes së ndikimit të marksizëm-leninizmit në botë, u mundua t'i bëjë ballë rrezikut që i kanosej rendit shfrytëzues kapitalist e fesë, të forcojë demagogjinë sociale e kombëtare dhe t'u kushtojë vëmendje problemeve shoqërore në doktrinën katolike.

1) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 26, f. 92.
2) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 36, f. 239.

Në përputhje me këtë veproi edhe kleri katolik shqiptar. Kleri mysliman e ai ortodoks, më pak të përgatitur e të organizuar, me një nivel të ulët kulturor, nuk ishin fort aktivë. Natyrisht, edhe këta u munduan të forcojnë pozitat e obskurantizmit fetar në masat e paditura, përkrahën regjimin reaksionar zogist dhe kundërshtuan përpjekjet për demokracinë.

Feja në këtë periudhë të sundimit të reaksionit dhe të obskurantizmit luante një rol mjaft negativ, prandaj forcat demokratike të atëhershme iu kundërvunë asaj.

Ajo, siç ka theksuar shoku Enver Hoxha: «... i ka hedhur rrënjët gjatë shekujve, ka ditur ta kombinojë punën e saj me ideologjinë. Ka gjetur momentet më të rëndësishme të jetës së njeriut dhe me anën e shpirtit, me anën e ndjenjave të njerëzve është orvatur të dominojë në epoka të ndryshme, natyrisht në mënyrë relative, se kjo ka ardhur duke u dobësuar.. Ajo ka ditur të organizojë rrjetin e vet dhe të krijojë një traditë të thellë, duke u përpjekur të shpjegojë çdo gjë në mënyrën idealiste»[2/1].

Mbi këtë ideologji fetare u mbështetën edhe pikëpamjet politike-shoqërore klerikale. Por, ndërsa propaganda fetare, ky opium dehës, u drejtohej masave të paditura e të shtypura, pikëpamjet politike-shoqërore të klerit kërkonin të ndikonin në rrethet intelektuale dhe në brezin e ri të shkolluar. Pikëpamjet më të përpunuara e më të rafinuara, të maskuara me demagogji kombëtare e shoqërore dhe të mbështetura në doktrinën teologjike të formuluar prej kohësh, ishin pikëpamjet katolike.

Ideologët katolikë e hoqën veten si eruditë, u munduan të përzihen me çdo polemikë e diskutim për çështjet themelore të kohës, t'i paraqitin të gjitha arritjet e kulturës kombëtare shqiptare si kontribut të katolicizmit, u treguan prepotentë, intolerantë ndaj ideve të kundërshtarëve dhe shpesh, për mungesë argumentesh, përdorën një gjuhë vulgare e fyese kundër tyre, madje dhe kërcënime.

Ideologjia katolike ishte një helm i rrezikshëm për kombin i përgatitur në laboratorët e «etënve dinakë».

I. PIKËPAMJET E KLERIT KATOLIK

Kleri katolik kishte kohë që zhvillonte në Shqipëri një veprimtari të dendur e aktive ideologjike.

Qendrën e kësaj veprimtarie, ashtu sikurse të veprim-

2/1 Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 26, f. 90.

tarisë politike antikombëtare, e kishte në Shkodër prej nga kërkonte ta shtrinte pëlhurën e vet të merimangës në të gjithë vendin, sidomos në Veri. Por Shkodra ishte një qytet me tradita të fuqishme patriotike e revolucionare dhe si gjithë Shqipëria i bëri qëndresë reaksionit klerikal. Kleri prej kohësh nxirrte këtu një sërë revistash, si «Hylli i Dritës», «Leka», «Kumbona e së Dielës», «Zani i Shnandout» etj. Ai dispononte shtypshkronjat e veta dhe botoi dhe libra në frymën klerikale. Për këtë subvencionohej nga Vatikani, Italia fashiste, madje dhe nga regjimi zogist.

Pikëpamjet e klerit katolik, siç thamë, kishin karakter antikombëtar dhe antidemokratik. Por ato në mjaft raste e kamufluan këtë me demagogji.

Me anë të saj kërkoheshin të arriheshin disa synime kryesore. Në radhë të parë synohej të maskohej veprimtaria antikombëtare dhe bashkëpunimi i tij me Italinë fashiste për kryerjen e agresionit, duke i krijuar klerit një aureolë patriotike. Një synim tjetër ishte mbrojtja e interesave partikulariste të katoliçizmit, përpjekja për të rritur autoritetin e kishës katolike dhe për të zgjeruar ekspansionin e saj. Përveç kësaj synohej të mbroheshin e të ruheshin marrëdhëniet e institutet shoqërore reaksionare si bazë me rëndësi e fesë dhe e kishës dhe të kundërshtoheshin prirjet e progresit si prirje erozive për të dhe për rendin reaksionar. Pikëpamjet katolike e drejtuan tehun e tyre, në radhë të parë, kundër ideve dhe lëvizjeve komuniste e përparimtare që konsideroheshin armiku kryesor i fesë dhe i rendit shfrytëzues.

1. Platforma antikombëtare

Kleri katolik përpara opinionit publik u paraqit si mbrojtës i zjarrtë i kombit, i vlerave dhe kulturës kombëtare. Në organet e shtypit dhe në literaturën katolike ai bëri mjaft përpjekje për t'i krijuar vetes një aureolë të tillë. Ndërsa veprohej kështu në sy të opinionit, në fshehtësi, në prapaskenë, zhvillohej një veprimtari antikombëtare dhe shfaqeshin pikëpamje kundër kombit shqiptar, kundër lirisë e pavarësisë.

Për të analizuar dhe për të nxjerrë në pah platformën antikombëtare të tij, do të shqyrtojmë jo vetëm pikëpamjet e shprehura në shtyp, por edhe ato që u pasqyruan në dokumentet sekrete të periudhës.

Po të studiohen me vëmendje pikëpamjet katolike dhe

të kihen parasysh parimet e tezat doktrinare që i frymëzuan, do të formohet bindja se kjo ideologji është në kundërshtim me kombin, idealet e proceset kombëtare, me sovranitetin kombëtar, me lirinë e pavarësinë kombëtare. Filozofia zyrtare katolike kombin dhe çështjet kombëtare nuk i ka objekt të drejtpërdrejtë por i trajton ato në mënyrë të tërthortë. Doktrina sociale katolike mban qëndrim negativ ndaj kombit. Ky qëndrim mohues nuk është shprehur në mënyrë të hapur.

Kjo doktrinë merret vetëm me njeriun abstrakt që konsiderohet shembëlltyrë e zotit, me njerëzimin në përgjithësi si shumë individësh me prejardhje hyjnore dhe nuk interesohet për bashkësitë shoqërore historike konkrete, për njeriun konkret të vendosur në kushte të caktuara historike. Si rrjedhim i këtij trajtimi, kombi si bashkësi konkrete historike nuk njihet nga doktrina. Zbatimi i këtij parimi doktrinar shpie në qëndrimin nihilist ndaj kombit dhe atdheut, në zëvendësimin e tyre me «atdheun» kozmopolit që ka si bazë fenë. Natyrisht, në rrethanat konkrete të zhvillimit të kombeve dhe të proceseve kombëtare, të lëvizjeve nacionale, feja katolike nuk ka mundur të mos marrë parasysh formën kombëtare të bashkësive shoqërore. Megjithatë, qëndrimin negativ doktrinar nuk e ka braktisur. Ajo në kushtet e ekzistencës së kombit është përpjekur ta mistifikojë natyrën e thelbin e tij. Ky mistifikim është një formë e mohimit të kombit si bashkësi konkrete historike.

Premisa më e përgjithshme teorike e doktrinës katolike për interpretimin e kombit dhe të zhvillimit kombëtar në frymën teologjike, është koncepti kristian i së drejtës natyrore hyjnore. Sipas tij, jeta kombëtare dhe në përgjithësi jeta shoqërore kanë burim hyjnor. Me këtë mohohet baza konkrete historike e kombit. E drejta natyrore hyjnore e mohon kombin edhe me anë të pohimit të pandryshueshmërisë së natyrës njerëzore. Në qoftë se njeriu dhe shoqëria njerëzore janë produkt hyjnor që jepen një herë e përgjithmonë e nuk pësojnë asnjë ndryshim thelbësor, atëherë edhe kombet e shoqëritë kombëtare, nuk kanë ndonjë bazë konkrete dhe historicitet dhe as arsye të të qenit. Këto kthehen në fiktive. Mbi këto teza doktrinare katolike mbështetej ai pohim i bërë në «Hylli i Dritës» se veprimtaria konkrete njerëzore dhe bashkësitë e ndryshme shoqërore nuk ishin aspak sfera autonome me bazë të vetën, por produkt i veprimit të ligjit hyjnor. Këtij ligji moral hyjnor i nënshtroheshin, sipas revistës, jeta ekonomike, shoqërore, politike, kulturore dhe jeta kombëtare në përgjithësi[3].

3) «Hylli i Dritës», 1935, nr. 7-8, f. 338-340.

Koncepti i së drejtës natyrore hyjnore i jep ideologjisë katolike një karakter konservator. Ai e bën atë të kundërshtojë proceset përparimtare shoqërore e kombëtare, ta paraqitë shoqërinë e kombin si diçka të galvanizuar e statike. Kjo pikëpamje kundër progresit që kërkon ta mohojë progresin e vërtetë dhe ta zëvendësojë atë me progresin moral kristian të vetëpërsosjes fetare, është kundër zhvillimit të kombit e shoqërisë[4]. Mirëpo po mohove zhvillimin kombëtar, ke mohuar vetë kombin.

Me këtë lidhet ngushtë edhe parimi fetar i hierarkisë apo i shkallëzimit të vlerave, i cili ka për synim të mohojë proceset kombëtare e shoqërore si vlera substanciale me rëndësi dhe t'ia nënshtrojë ato fesë. Sipas këtij parimi, në krye të hierarkisë së vlerave është feja. Ajo është vlera më e lartë prej së cilës varen të gjitha të tjerat. Vlerat ekonomike, politike, shoqërore, si dhe ato kombëtare konsiderohen sekondare. Në qoftë se ato nuk i nënshtrohen fesë dhe nuk njohin parësinë e epërsinë e saj, atëherë zhvleftësohen krejt. Kështu edhe kombi shqiptar e vlerat kombëtare nuk mund të kuptoheshin jashtë fesë.

E gjithë ideologjia katolike në Shqipëri përshkohej nga kjo frymë. Në shkrimet e ndryshme të botuara në revistat katolike nënvizohej me forcë se vlera supreme ishte feja; të gjitha sferat e tjera shoqërore duhet t'i nënshtroheshin asaj[5].

Sipas parimit katolik të shkallëzimit të vlerave, rezultonte një kundërthënie e dyfishtë e vlerave në shoqërinë njerëzore (pra dhe atë kombëtare): vlerat shpirtërore, morale, u kundërviheshin vlerave materiale-ekonomike, ndërsa vlerat e individit i kundërviheshin vlerave të bashkësisë historike-shoqërore. Në ideologjinë katolike i kushtohet më shumë vëmendje zhvillimit të individit, përsosjes së tij morale-fetare, sesa zhvillimit të kombit dhe shoqërisë. Kjo është një pikëpamje reaksionare kundër progresit të vërtetë, një prirje për ta vënë fenë mbi kombin e shoqërinë. Nxjerrja në pah nga kisha katolike e problemit të njeriut mundohet të krijojë në dukje humanizmin. Por kjo ishte një përpjekje për të maskuar antihumanizmin. Mohimi i vlerave shoqërore e kombëtare dhe reduktimi i zhvillimit në zhvillimin individual moralo-fetar është antihumanitar e antihistorik.

Historiografia kristiane nuk e njeh kombin si subjekt të historisë. Kjo vjen qoftë për arsye të parimit eskatologjik të zhvillimit individual moralo-fetar të vetëpërsosjes individuale për t'u bashkuar me Zotin, që ia mohon njerëzimit të

4) Po aty, 1935, nr. 12, f. 569-574.
5) Po aty, 1934, nr. 6, f. 268.

qenët subjekt i vërtetë, ashtu edhe për faktin që subjekte të zhvillimit historik konsiderohen jo popujt e veçantë, por njerëzimi në tërësi.

Revistat katolike shqiptare në këtë periudhë bënë zhurmë të madhe që në jetën kombëtare të shqiptarëve nuk po respektohej hierarkia e vlerave dhe mbi vlerat fetare, që mbaheshin kryesore, viheshin ato materiale, politike e të tjera, të cilat nuk kishin aq rëndësi[6]. Kjo konsiderohej si një shenjë e rënies, e degradimit shoqëror e kombëtar. Shqipërisë gjoja i kanosej dukuria negative e mbizotërimit të lëndës mbi shpirtin (mbi fenë). Pra, këtu vihet re ajo prirje e kundërvënies së jetës materiale asaj shpirtërore që është antikombëtare e antishoqërore.

Kleriku reaksionar Anton Harapi e shihte si një gjë mjaft negative që «qytetërimi i sotëm është material» dhe që feja nuk kishte atë fuqi e vlerë, sa kishte më parë[7].

Vënia e fesë në krye të shkallëzimit të vlerave ishte jo vetëm një minimizim e mohim i vlerave e proceseve kombëtare, por edhe një përligjje e gjendjes negative të ekzistencës së 3 feve në Shqipëri.

Në vitet '30 kleri katolik u mundua të hiqej se qëndronte në pozita patriotike, se ishte gjoja mbrojtës i flaktë i kombit dhe i vlerave kombëtare. Në mënyrë demagogjike ai pohoi se dhe në çështjen kombëtare si kudo i përmbahej rrugës së mesme: nuk ishte as me nacionalizmin ekstrem e shovinizmin dhe as me nihilizmin kombëtar, i cili i atribuohej marksizmit[8]. Në fakt ideologjia katolike ishte kozmopolite dhe nihilizmin kombëtar e kishte në thelbin e saj. Edhe në ideologjinë katolike përcaktimi i kombit bëhej në frymën idealiste-fetare. Me kombin kuptohej vetëm shuma e faktorëve shpirtërorë të jetës së një populli. Por në krye të tyre, siç thamë, ishte feja, e cila duhej të futej në të gjitha poret e jetës kombëtare dhe duhej të ishte faktori drejtues e organizues[9]. Këtu nuk kemi ndërmend të përsërisim me hollësi ato përcaktime të kombit që janë dhënë dhe nga rrymat e tjera. Edhe në ideologjinë katolike u ngrit çështja e bashkimit kombëtar, rreth së cilës u bë gjithë ajo zhurmë. Kjo tingëllonte si një paradoks në kushtet e afirmimit të vlerave të fesë e të përligjjes së përçarjes fetare. Natyrisht, kleri katolik përpara opinionit publik pati kujdes të paraqitej se ishte gjoja për forcimin e bashkimit kombë-

6) Po aty, 1932, nr. 10, f. 491-492; 1934, nr. 6, f. 268; 1934, nr. 11, f. 501; 1936, nr. 6, f. 270.
7) «Leka», 1934, nr. 25, f. 146.
8) «Leka», 1935, nr. 6, f. 172-173; «Hylli i Dritës», 1935, nr. 3, f. 128.
9) «Hylli i Dritës», 1930, nr. 1, f. 2; «Leka», 1930, nr. 3, f. 74.

tar. Por në dokumentet sekrete zbulohej fytyra prej tartufësh dhe jezuitizmi i ideologëve katolikë, të cilët pohonin ekskluzivitetin e fesë katolike, prirjen e saj për ekspansion, denigronin popullsinë myslimane dhe shpreheshin kundër kombit, lirisë e pavarësisë. Këto do t'i shpjegojmë më poshtë.

Ideja e bashkimit kombëtar e shprehur në shtyp, në radhë të parë, synonte të maskonte veprimtarinë antikombëtare dhe partikularizmin fetar. Por klerikët katolikë as në revistat e tyre nuk mundën ta maskojnë dot mirë këtë partikularizëm, si dhe qëndrimin antikombëtar të tyre.

Ideologët e klerit katolik bashkimin kombëtar e lidhnin me parimin e solidarizmit, i cili, nga ana e tij, rridhte nga e drejta natyrore hyjnore. Harmonia e interesave dhe bashkëpunimi e bashkëveprimi në shoqërinë njerëzore ishte gjoja rezultat i ligjit hyjnor. Solidarizmi i duhej ideologjisë katolike për të bashkuar me anë të fesë besimtarët e vet dhe për të zhdukur kundërthëniet klasore.

Solidarizmi katolik nuk mund të përputhej me bashkimin kombëtar në kushtet e ekzistencës së tri feve kur vetë kleri katolik i luftonte elementët e besimeve të tjera dhe kërkonte të ruante përçarjen fetare.

Termi i bashkimit kombëtar përdorej për qëllime demagogjike. Por, nga ana tjetër, pohimi nga ideologët katolikë i solidarizmit synonte të sigurohej bashkëpunimi klasor.

«Kleri katolik, — shkruhej në «Hylli i Dritës», — i frymëzuem prej mësimeve t'Ungjillit, nuk njeh klasa ose kastë, por përfshin në një dashtni universale të gjithë njerëzit e deri anmiqtë»[10].

Zhdukja e përçarjes klasore e shoqërore dhe sigurimi i solidaritetit duhej të bëheshin mbi bazën e moralit, të drejtësisë hyjnore. Çdo gjë në shoqëri, sipas ideologjisë katolike, pra edhe solidariteti, mund të përmbushej jo mbi bazën e së drejtës pozitive, e cila nga pikëpamja doktrinare nuk njihej, por mbi bazën e drejtësisë morale. Mirëpo në shoqërinë me klasa, ku bazë ishin marrëdhëniet ekonomike-shoqërore klasore dhe ku e drejta pozitive ishte një rregullator e sanksionues i tyre, drejtësia morale ishte fiktive dhe nuk kishte forcë të zgjidhte asnjë çështje me rëndësi. Predikimi i solidarizmit bëhej për qëllime kryesisht fetare.

Instanca primare ku kërkohej të zbatohej parimi i solidarizmit konsiderohej familja. Gjoja kështu mund të realizohej më mirë bashkimi kombëtar. Kleri katolik është munduar gjithnjë ta shpjegojë kombin në një nivel sociologjik me familjen, ta paraqitë atë si një familje me përmasa të mëdha. Këtë nuk e ka bërë për arsye të interesave kombëtare. Për të kjo kishte rëndësi nga pikëpamja teologjike e politike-shoqërore.

10) «Hylli i Dritës», 1938, nr. 9, f. 498.

Familja i duhej, në radhë të parë, për ta shpjeguar kombin (këtë «familje të madhe») me anë të legjendës biblike të prejardhjes, së farës njerëzore, për të mohuar bazën e vërtetë historike të tij.

Por ky shpjegim nuk kishte asnjë bazë. Kombi, si nga prejardhja, ashtu dhe nga përmbajtja, nuk përputhej me familjen. Këtu nuk mund të kishte as ngjashmëri historike dhe as logjikë.

Ideologët e klerit katolik pohuan se në Shqipëri ekzistonin, gjoja, një varg faktorësh të përbashkët shpirtërorë, si: gjuha, doket, zakonet, historia, letërsia, arti etj., që përbënin një bazë të shëndoshë për solidaritetin shoqëror. Por këto nuk mjaftonin. Përveç tyre, duhej edhe feja, e cila ishte forca themelore bashkuese[11]. Feja në fakt ishte faktor përçarës. Në një kohë kur thuhej kjo për konsum të opinionit publik, kleri katolik kishte mendimin se nuk ekzistonte një komb shqiptar me një kulturë dhe një fizionomi të veten, por ekzistonin popullsi me besime dhe me mentalitete të ndryshme që nuk pajtoheshin aspak njëra me tjetrën[12].

Klerikët katolikë, si Fishta e të tjerë, në prapaskenat e kurdisura prej tyre, mbrojtën tezën se populli shqiptar nuk kishte njësi etnike, ishte një popull me heterogjenitet të theksuar. Ai në pjesën më të madhe përbëhej sipas tyre prej popullsisë myslimane që cilësohej si një turmë e egër «aziatike», pa ndjenja kombëtare e shoqërore, pa zhvillim e qytetërim dhe e padenjë të përfshihej në kombin shqiptar.

Këto ide u shprehën në disa vërejtje të Gjergj Fishtës mbi një projektrregullore për shkollat e përziera ku u shfaq kundër përfshirjes në këto shkolla të elementëve të ndryshëm fetarë dhe mbrojti pikëpamjen e papajtueshmërisë së tyre në shumë aspekte[12/1]. Pra, faktori fetar në mënyrë jezuite publikisht jepej si faktor bashkues, ndërsa në fshehtësi si faktor kryesor për përçarjen e popullit shqiptar.

Urrejtja e papërmbajtur e klerit katolik kundër popullsisë myslimane dhe fryma e intolerancës fetare përshkonte të gjitha radhët e vërejtjeve mbi shkollat e përziera. Fishta e të tjerë kërkonin që myslimanët të trajtoheshin në Shqipëri si të huaj, si element inferiorë, që kultura, arsimi e gjithçka të mbështeteshin mbi «mentalitetin» dhe elementin e krish-

11) «Hylli i Dritës», 1932; nr. 2-3, f. 62; 1935, nr. 9, f. 425.

12) *Arkivi Qendror i Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë* (më tej: *AQSH*). Fondi i Gjergj Fishtës, dosja 9, dok. 844. Vërejtje të Gjergj Fishtës të hartuara mbi një rregullore për shkollat e përziera.

12/1) *Po aty.*

terë, gjoja «eksponentin e qytetërimit dhe të kulturës krishtero-perëndimore». Aty nënvizohej se nuk mund të lejohej që kjo masë «aziatike» të zotëronte mbi të krishterët[13].

Atëherë përse i duheshin klerit katolik predikimi mbi bashkimin kombëtar dhe pohimi se kombi shqiptar përbënte një njësi shpirtërore? I duhej pra, siç thamë, për të maskuar veprimtarinë antikombëtare.

Pohimi se kleri katolik kërkonte një «Shqipëri Zonjë në vedi me shqiptarë të zot të vedit ndër tanë lamijet e jetës mendore, morale e landore në vështrim të fjalës», me «individualitet kombëtar» ishte një pohim prej jezuitësh që bëhej për të mashtruar opinionin publik[14].

Në kohën kur kërkohej të krijohej përshtypja se kleri katolik ishte për një Shqipëri të pavarur dhe për zhvillimin e lulëzimin e kombit, prapa shpinës së tij zhvillonte veprimtari të gjallë për shpejtimin e agresionit fashist dhe vendosjen përfundimtare të Italisë fashiste në Shqipëri.

Dokumentacioni sekret i viteve 20-30 hedh dritë mbi një sërë pikëpamjesh fashiste dhe antikombëtare të hierarkisë katolike shqiptare. Në një sërë promemoriesh drejtuar zyrtarëve italianë, si dhe në bisedat e fshehta të zhvilluara me ta, zbulohet plotësisht e vërteta mbi pozitën antikombëtare të klerit katolik.

Që në vitin 1925 Gjergj Fishta shprehu mendimin se Shqipëria nuk mund të ishte një shtet i pavarur kombëtar dhe nuk mund të bënte pa ndihmën e tutelën e Italisë[15]. Fishta pohonte se Italia fashiste nuk mund të mos kishte «interesa, bile interesa jetësore në Shqipëri». Ky shtet «plot vitalitet e gjallëri», mendonte ai, të cilit i mungonin tokat dhe kishte nevojë të eksportonte kapitalet e veta, duhej të zgjeronte ekspansionin ekonomik e politik në Shqipëri e në Ballkan. Kjo, gjoja, ishte në interes të Shqipërisë që të mos gllabërohej nga serbët[16]. Fishta gjykonte tamam si një apologjet i fashizmit dhe e nxiste imperializmin italian të kryente agresionin.

Në këtë frymë u shprehën edhe klerikë të tjerë katolikë, si Frano Karma me shokë. Ata theksuan nevojën e kolonizimit të Shqipërisë nga Italia, të vendosjes së regjimit fashist, në mënyrë që «të qytetërohej» gjoja vendi dhe kleri katolik të forconte pozitat e veta, të zgjeronte sferën e ndikimit e të bëhej elementi sundues fetar.

Frano Karma, në një letër që u drejtonte nga Parisi

13) *Po aty.*
14) «Hylli i Dritës», 1935, nr. 4, f. 179.
15) *AQSh.* Fondi i cit. Promemorje e drejtuar Qeverisë së Romës, mars 1925 (përkth. nga italishtja).
16) Po aty.

arqipeshkve dhe ipeshkve të Shqipërisë, i ftonte ta përkrahnin pa rezervë aksionin italian kundër popullit shqiptar. Ai u thoshte se «është gabim të përfytyrohet Shqipëria absolutisht e pavarur. Shtete më të mëdha se Shqipëria, për rrethana të domosdoshme janë detyruar të varen në një farë mase nga shtete të tjerë»[17]. Të gjitha paktet e marrëveshjet skllavëruese të lidhura me Italinë konsideroheshin prej tij një gjë krejt normale dhe e domosdoshme dhe thuhej se marrëdhëniet ekzistuese duhej të forcoheshin më tej në mënyrë që të kryhej bashkimi i plotë i Shqipërisë me Italinë dhe kolonizimi i vendit[18].

Në periudhën e acarimit të përkohshëm të marrëdhënieve midis qeverisë zogiste dhe asaj të Romës (1931-1935), Italia fashiste bëri presion mbi regjimin zogist që ai të kapitullonte, t'i hapte dyert në dy kanatet imperializmit fashist.

Kleri katolik, i pakënaqur dhe nga masat që mori qeveria zogiste në këtë kohë për mbylljen e shkollave katolike, shpresoi në ndryshimin e gjendjes dhe mendoi se po afronte dita që Italia të vendosej në Shqipëri. Këtë e shprehu Frano Karma në letrën e mësipërme «Ndërrimi i situatës, nuk duhet të na gjejë me duar kryq. Papërgatitja do të ishte baraz me izolim dhe kjo do të ishte për ne shkatërrim i paripaprueshëm... Është me Italinë që ne duhet të ruajmë miqësinë tonë. Por jo një miqësi ironike dhe rrenacake si ajo e «bufonëve» që sot qeverisin Shqipërinë»[19]. Pra, aluzioni ishte i qartë. Aleanca e regjimit zogist me Italinë fashiste nuk e kënaqte klerin katolik. Ai ishte për bashkimin e plotë të Shqipërisë me Italinë, për vendosjen e një regjimi fashist me në krye një princ nga shtëpia e Savojës. Kleri katolik duhej të vepronte me energji, si element kryesor i kolonës së pestë. Lazër Mjeda i tha ministrit italian Koch në vitin 1933 se Italia nuk duhej t'i besonte një «mbreti mysliman», siç ishte A. Zogu, dhe s'duhej ta përkrahte atë. Regjimi i tij gjoja nuk kishte as synime «qytetëruese» dhe, çka ishte më e keqe, donte të shkatërronte kinse katolicizmin në Shqipëri që ishte e vetmja forcë për zhvillimin e vendit dhe e vetmja shpresë dhe mbështetje e Italisë për përmbushjen e synimeve të saj[20]. Kleri katolik, i verbuar nga urrejtja për myslimanët edhe regjimin zogist e gjykoi nga kjo pikëpamje, si një

17) *AQSh.* Fondi i Arqipeshkvisë së Shkodrës. Letër e priftit F. Karma drejtuar arqipeshkve dhe ipeshkve të Shqipërisë nga Parisi, 17.7.1933.
18) *Po aty.*
19) *Po aty.*
20) *AQSh.* Fondi i Legatës italiane, dosja «çështje politike», 1933, Raport i ministrit italian Koch dërguar Ministrisë së Jashtme në Romë, korrik 1933.

«regjim mysliman», por jo si një regjim që merrte nëpër këmbë interesat e popullit e të kombit.

Kleri katolik dëshironte që një ditë ta shihte Shqipërinë jo vetëm nën fashizmin, por edhe të shndërruar gradualisht në një vend në mos krejt katolik, së paku ku katolicizmi të sundonte dhe të kishte privilegje e liri të pakufizuara.

Hëpërhë në këtë periudhë u shpreh pikëpamja e përsëritur nga Fishta e të tjerë që Shqipëria «të ndahej në tri kantone: veriu katolik, qendra myslimane dhe jugu ortodoks»[21]. Dhe këta predikues të bashkimit kombëtar që hiqeshin sikur digjeshin e piqeshin për Shqipërinë, kërkonin ta copëtonin kombin shqiptar, ta asgjësonin atë, ta kthenin shoqërinë shqiptare prapa, në mesjetë.

Mohimi i kombit, i vlerave dhe traditave kombëtare nga kleri katolik arriti kulmin në ditët e agresionit fashist kundër Shqipërisë dhe gjatë pushtimit fashist.

Tezat dhe pikëpamjet e mësipërme të shprehura në dokumentet sekrete ishin më demaskueset. Por idetë partikulariste, përçarëse e antikombëtare u shfaqën edhe në revistat katolike. Përpara opinionit publik, kleri katolik përpiqej të krijonte përshtypjen se i përfillte edhe besimet e tjera, se ishte kundër nxitjes së armiqësisë midis tyre për hir të sigurimit të bashkimit kombëtar. Ai deklaronte se ishte për zhvillimin e një diskutimi fetar, por nuk dëshironte gjoja që ky diskutim të nxiste fanatizmin dhe armiqësinë, të fyente ndjenjat e besimtarëve të tjerë[22]. Këto ishin sofizma dhe pohime hipokrite. Në kundërshtim me faktet historike, thuhej se feja nga natyra e saj nuk ishte burim fanatizmi e konfliktesh. E keqja, gjoja, qëndronte te padija, te mendësitë e ndryshme. Dhe këtu në fakt bëhej aluzion për mospërputhjen midis mendësisë së krishterë e myslimane, siç thuhej në dokumentet sekrete. Dhe padija e mendësia primitive natyrisht i vishej popullsisë së besimit mysliman.

Teza se feja nuk ishte burim fanatizmi e konfliktesh kërkonte të përligjte dhe të maskonte veprimtarinë përçarëse antikombëtare të klerit katolik.

Përvoja historike ka dëshmuar në mënyrë të pakundërshtueshme se feja dhe veprimtaria reaksionare e klerit i kanë fryrë zjarrit të fanatizmit dhe kanë mbjellë përçarje në popull, përçarje që është kapërcyer nga masat popullore në saje të patriotizmit të tyre.

«Hylli i Dritës», duke polemizuar me gazetën «Besa» për problemin e përçarjes fetare, pohonte se kjo do të ekzistonte derisa të ekzistonin doke e mendësi të ndryshme.

21) *Po aty.*
22) «Hylli i Dritës», 1930, nr. 4, f. 259.

Koncepti mbi jetën, gjoja, ndryshonte «si dita me natën» tek elementët e besimet e ndryshme të shoqërisë shqiptare[23]. Pra, ideologët katolikë me këtë tezë vinin në kundërshtim me atë pohim demagogjik të bërë prej tyre në shtyp, se kombi ishte një, ishte tërësia e dokeve e traditave e faktorëve të ndryshëm të jetës shpirtërore. Kjo tregonte se propaganda kombëtare ishte një maskë.

Në këtë kohë, sikurse e theksuam në kapitullin e mëparshëm, kleri katolik polemizoi edhe me Branko Merxhanin për çështjen e përçarjes fetare. Ndërsa Brankoja ishte i mendimit se formimi i kombit të vërtetë parakuptonte përzierjen e elementëve të ndryshëm fetarë, Gjergj Fishta me shokë e kundërshuan këtë pikëpamje duke thënë se «asnjë fe nuk permeton trazimin e gjakut midis njerëzve me fe të tjera»[24]. Sipas Gjergj Fishtës, kombi mund të ekzistonte edhe duke ruajtur përçarjen fetare. Por Gjergj Fishta, siç thamë, e mohonte krejt qenien e kombit të pavarur.

Ideologët katolikë me gjithë maskën dhe frazeologjinë kombëtare u përpoqën edhe publikisht ta denigrojnë kombin shqiptar, ta bëjnë atë të paqenë. Sipas tyre kombi shqiptar në kuptimin e vërtetë të fjalës nuk ekzistonte.

«Me u shoqënue mund të shoqënohen edhe hajnat, por nuk përbajnë as komb, as shtet», shkruante revista «Hylli i Dritës»[25]. Shqiptarët gjoja mund të bashkoheshin sipas shprehjes së saj, sa dhe «kokrrat në një grumbull rane«[25/1]. Kleri katolik, duke u mbështetur në doktrinën katolike, ekzistencë substanciale e reale, i njihte vetëm fesë dhe kishës, por jo kombit e shoqërisë kombëtare.

Ky mish i huaj në trupin e kombit kishte interesa kozmopolite e partikulariste dhe mendonte se këto do të përmbusheshin plotësisht vetëm në regjimin fashist.

Ideali i klerit katolik në përgjithësi ishin kombet katolike ku katolicizmi sundonte si një fe e vetme duke u njësuar me kombin dhe zhvillonte një veprimtari të hapur reaksionare në dëm të interesave kombëtare.

Atje ku feja katolike nuk kishte pozita të tilla si në Shqipëri, kleri katolik aspironte për ekspansion dhe bënte përpjekje për të forcuar ndikimin ideologjik dhe institutet e organizatat katolike. Gjatë regjimit zogist, duke pasur përkrahjen e Vatikanit dhe të Italisë fashiste, ai zhvilloi një veprimtari të dendur me anë të organizatave të ndryshme fetare, shkollave, kurseve e të tjera.

23) Po aty, 1936, nr. 3, f. 109.
24) Po aty, 1930, f. 653.
25) Po aty, 1930, nr. 4, f. 182.
25/1) Po aty, 1933, nr. 11, f. 490.

Ideologët katolikë i veshën katolicizmit rolin kryesor në Shqipëri për formimin e kombit, të kulturës dhe qytetërimit të tij. Ata thoshin në mënyrë falsifikuese se gjithçka më e mirë që ishte krijuar gjatë shekujve dhe të gjitha arritjet kryesore të kulturës, ishin produkt i katolicizmit. Kjo synonte të mohonte rolin e popullit e të forcave përparimtare e laike në formimin e kombit e të kulturës shqiptare, gjithashtu të njesonte proceset kombëtare e kulturore me fenë.

Natyrisht, në historinë shqiptare pati dhe klerikë përparimtarë e patriotë katolikë e të tjerë që dhanë një ndihmesë me vlerë në fushën e kulturës dhe në luftën për liri e pavarësi. Por veprimtaria e tyre nuk ishte produkt i fesë siç paraqitej nga ideologët katolikë, por në radhë të parë i patriotizmit të tyre, i ndjenjës së kombësisë dhe asaj kombëtare. Pjesa reaksionare e klerit iu kundërvu kombit e kulturës kombëtare, u shërbeu interesave të huaja dhe të fesë.

Për të provuar erudicionin dhe monopolin në fushën e kulturës klerikët katolikë botuan në revistat e tyre një sërë artikujsh mbi gjuhësinë, historinë, folklorin, etnografinë etj. Këto ishin, natyrisht, punime diletante dhe që përshkoheshin nga idetë tendencioze të katolicizmit. Me anë të tyre kërkohej të provohej se faktori kryesor i zhvillimit ishte feja dhe se rolin më të rëndësishëm në zhvillimin e kombit shqiptar e luante kisha katolike.

Një çështje tjetër që dëshmoi për pozitën antikombëtare dhe partikularizmin fetar të klerit katolik, ishte çështja e shkollave, e arsimit. Kleri katolik u shpreh kundër arsimit kombëtar e laik.

Siç përmendëm edhe më sipër, hierarkia katolike ishte kundër shkollës laike kombëtare në të cilën përziheshin elementët e ndryshëm fetarë. Ajo pretendonte se në shkollat laike elementi i «qytetëruar» katolik gjoja vihej në një plan e madje në pozita inferiore në krahasim me elementin mysliman «aziatik», prandaj ishte për ruajtjen e statusit të shkollave fetare dhe të privilegjeve të tyre.

Laiçizmi jo pa qëllim në mjaft raste njësohej me ideologjinë revolucionare, në mënyrë që t'i pritej rruga atij dhe kudo të sundonte ideologjia fetare. Shkolla kombëtare laike ishte e dëmshme sipas pikëpamjes katolike. «Zhdukja prej librave të shkollës e fjalës Zot, asht ma e madhja dhunë që i bahet edukatës kombëtare, — thuhej në «Hylli i Dritës». — Edukata kombëtare kthehet atëhere në liberale»[26].

Kleri katolik bëri zhurmë të madhe kundër masave që mori qeveria zogiste në vitet 1932-1933 për qëllime politike

26) Po aty, 1937, nr. 2-3, f. 65-67.

koniunkturale, për mbylljen e shkollave private fetare dhe shtetëzimin e shkollave. Këto masa u miratuan nga rrethet përparimtare, pavarësisht nga synimet që kishin, dhe u konsideruan si në të mirë të forcimit të arsimit kombëtar e laik. Por kleri katolik iu kundërvu atyre dhe u shpreh me zemërim kundër kufizimit të ekspansionit të lirë të kishës katolike, kundër «robërimit shpirtëror».

Ideologët katolikë pohuan «se duhej të ndreqej «gabimi fatal» i identifikimit të kombit me shtetin»[27]. Kjo donte të thoshte se shteti nuk duhej të përzihej në punët private të kishës, nuk kishte të drejtë ta kufizonte veprimtarinë e klerit katolik, ta pengonte atë të krijonte një shtet brenda shtetit dhe interesat fetare t'i vinte mbi ato kombëtare. Masat kundër shkollave fetare u krahasuan me politikën e dikurshme të Bismarkut dhe u quajtën si masa të «kulturkampfit». Kleri donte të kishte monopolin në fushën e arsimit e të kulturës dhe që «religjioziteti» në çdo gjë të ishte «kryet e punës».

Synimin antikombëtar për monopolizimin e shkollës e të kulturës kleri katolik e maskonte gjoja me kujdesin për zhvillimin e vlerave shpirtërore në një kohë kur vlerat materiale kinse u kanoseshin atyre. Nevoja e kulturës dhe e arsimit fetar kërkohej të përligjej edhe me nevojën e luftës kundër ndikimeve të jashtme të dëmshme për kulturën. Me këtë bëhej aluzion për idetë revolucionare e përparimtare. Por në realitet ishin pikërisht shkollat fetare, sidomos ato katolike, që ishin përçuese e përhapëse të ndikimeve të huaja e të ideve fashiste dhe që dëmtonin kulturën kombëtare.

Ideologët katolikë u shprehën kundër shkollës kombëtare e laike, e cilësuan atë si çerdhe të «anarkisë» dhe «imoralitetit», si faktor negativ që shpinte gjoja në rënien e kulturës. Këto arsyetime sofistike e reaksionare drejtoheshin kundër kombit e çdo gjëje të mirë kombëtare. Demagogjia dhe denigrimet që përdori kleri katolik kundër kombit ishin mjete ideologjike për përgatitjen e agresionit fashist kundër Shqipërisë.

2. Konservatorizmi dhe antidemokratizmi i ideologjisë katolike

Një tipar tjetër me rëndësi i ideologjisë katolike shqiptare ishte konservatorizmi dhe antidemokratizmi i saj i theksuar.

27) Po aty, 1935, nr. 2, f. 574.

Në pikëpamjet politike-shoqërore të ideologëve katolikë vihej re idealizimi e zbukurimi i formave primitive e të ngurtësuara të jetës shoqërore kombëtare.

Ideologjia katolike ishte kundër përparimit në të gjitha fushat, sidomos kundër përparimit ekonomiko-shoqëror dhe politik. Në kohët moderne urrejtja ndaj përparimit, e cila i kishte rrënjët në doktrinën katolike u forcua shumë si rezultat i forcimit të proceseve dhe të luftës revolucionare. Këto ishin të rrezikshme për fenë dhe rendin shfrytëzues mbi të cilin mbështetej ajo. Sipas doktrinës katolike, si kombi, ashtu dhe shoqëria në përgjithësi janë të dhëna njëherë e përgjithnjë nga fuqia hyjnore dhe nuk mund të pësojnë ndryshime thelbësore. Çdo ndryshim i tillë në marrëdhëniet dhe institutet shoqërore konsiderohet si një gjë që vjen në kundërshtim me të drejtën hyjnore, me rendin natyror hyjnor. Kjo është dhe arsyeja që feja katolike i është kundërvënë kurdoherë progresit. Ideologëve katolikë u pëlqente t'i referoheshin frazës latine «natura non procedit per saltus» (natyra nuk zhvillohet me hope). Kjo donte të thoshte, sipas tyre, se natyra e shoqëria nuk njihnin progres të vërtetë, ato përbënin një det përjetësisht të vdekur.

Katolicizmi njeh vetëm një progres, progresin eskatologjik-finalistik, d.m.th. përsosjen e individit nga pikëpamja morale-fetare për të merituar bashkimin me Zotin në jetën e përtejme. Ky mohim i përparimit të vërtetë synonte të afirmonte misticizmin fetar dhe sundimin e kishës.

Sa herë që kisha katolike konstatonte përpjekje për përparim u binte kambanave të alarmit dhe u kujtonte njerëzve se çdo përparim jashtë sferës së fesë, ishte shkelje e ligjit hyjnor. Përparimi material ekonomiko-shoqëror, si dhe ai politik e kulturor ishin të rrezikshëm, sepse gërryenin truallin e fesë.

Ideologët katolikë shprehën nostalgjinë dhe admirimin për periudhën feudale, për marrëdhëniet feudale, patriarkale. Kjo periudhë, në të cilën kisha kishte kryet e vendit, ishte ideali i tyre.

Ajo paraqitej me ngjyra idilike e romantike si një kohë e begatshme dhe e lumtur kur «shqiptari me pak gja jetonte i lumtur dhe i lirë»[28]. Shfrytëzimi i egër feudal dhe sundimet e huaja që rënduan mbi popullin dhe penguan zhvillimin, nuk merreshin parasysh. Marrëdhëniet anakronike shoqërore, mbeturinat e fuqishme feudale e patriarkale që ruheshin nga klasat reaksionare, konsideroheshin si «palca» e jetës shqiptare, si qytetërimi i vërtetë dhe «i thellë» i kombit.

Kleri katolik u shpreh se askush nuk kishte të drejtë, të

28) Po aty, 1930, nr. 3, f. 129.

vinte dorë mbi institutet ekonomike-shoqërore e politike të trashëguara nga e kaluara. Ato gjoja ishin rrjedhim e produkt i përpjekjeve të brezave dhe nuk mund të zhvleftësoheshin e të mohoheshin[29].

Marrëdhëniet e institutet shoqërore të rendit shfrytëzues, sipas revistës «Leka» që kishte ideolog kryesor jezuitin Pater Valentini, kishin vlerë gjoja për të gjitha kohët, prandaj mohimi i tyre ishte baras me rrënimin e popujve, me degradimin e shoqërisë dhe të kombit[30].

Lumturia dhe mbarëvajtja e shoqërisë, e një populli, konsiderohej konservimi e galvanizimi i marrëdhënieve e i traditave primitive dhe reaksionare[31]. Kjo prirje e mohimit të progresit maskohej me anë të demagogjisë kombëtare, me dëshirën gjoja për të ruajtur vetitë e qenësishme të etnosit, të «racës» shqiptare.

Klerin katolik kozmopolit nuk e interesonte aspak ruajtja dhe forcimi i tipareve kombëtare, mbasi ai, nën maskën e idealeve kombëtare dëshironte të përmbushte synimet e fesë. Përveç kësaj, galvanizimi i proceseve shoqërore e kombëtare drejtohej në thelb kundër kombit të cilit kërkohej t'i mohohej përparimi.

Ideologët katolikë ankoheshin se «lava e kulturës», «fenomenalizmi dhe utilitarizmi», egoizmi dhe varfërimi shpirtëror gjoja po «i vinin kazmën jetës shqiptare»[32]. Kleri shqetësohej nga çdo përparim sado i vogël, sidomos nga lëvizjet përparimtare e revolucionare. «Tue i modernizue shqiptarët, — pohonte «Hylli i Dritës», — i qesim karakterit e burrnijet, ua ndrrojmë zakonet»[33].

Me këtë përligjej prapambetja e madhe e vendit dhe politika reaksionare e klasave sunduese, e cila i kundërvihej zhvillimit.

Ideologët katolikë ishin të mendimit se në kohën kur në Veri marrëdhëniet shoqërore rregulloheshin në bazë të normave të kanunit të Lekë Dukagjinit, gjithçka shkonte mbarë, ndërsa tashti kur e drejta zakonore po zëvendësohej me të drejtën pozitive po i lëshonte vendin marrëdhënieve të reja borgjeze, u prish ekuilibri dhe shoqëria po merrte të tatëpjetën. Filluan të humbasin gjoja tiparet e racës shqiptare, filloi çoroditja shoqërore dhe feja, e cila dikur luante rol me rëndësi, tashti nën ndikimin e rrymave ateiste e «bolshevike» e humbi vlerën që kishte. Nga të gjitha këto tirada pesimiste, nga të

29) Po aty.
30) «Leka», 1931, nr. 2, f. 41; 1934, nr. 5, f. 145-154.
31) «Hylli i Dritës», 1931, nr. 10, f. 58.
32) Po aty, 1932, nr. 2, f. 59-64.
33) Po aty.

gjitha këto ankime pafund për faktin që po dobësoheshin pozitat e fesë, kuptohej se kleri katolik do të dëshironte që shoqëria shqiptare të kthehej edhe një herë në mesjetë.

Idealizimi i mesjetës feudale patriarkale kërkohej të përligjej edhe me faktin se gjoja atëherë kishte një ideal të qëndrueshëm shoqëror, nuk kishte luftë klasash dhe sundonte harmonia shoqërore. Për këtë u referohej korporatave mesjetare, të cilat gjoja kishin vendosur bashkëpunimin klasor[34]. Por paraqitja e mesjetës si një kohë e artë ishte jo vetëm një zbukurim, por edhe një falsifikim i saj.

Shoqëria mesjetare ishte një shoqëri ku sundonte shfrytëzimi i egër i fshatarësisë e i masave punonjëse qytetare. Ajo periudhë «e artë» dhe e qetë siç kërkonte ta paraqiste kleri, ishte e mbushur me luftëra kundër pushtuesve të huaj, si dhe, me luftëra klasore.

Në revistat katolike iu thurën lavdërime Fishtës me shokë që përligjnin në veprat e tyre letrare mbeturinat feudale e patriarkale dhe prapambetjen e vendit, që lavdëruan normat reaksionare të kanunit dhe ngritën në qiell krerët feudalë e bajraktarë, që tiparet e traditat kombëtare i panë të ngurtësuara.

Ideologjia katolike përshkohej jo vetëm nga fryma e konservatorizmit, por kishte edhe karakter të theksuar antidemokratik. Këto lidheshin ngushtë njëra me tjetrën. Natyrisht, antidemokratizmin e saj në disa raste ajo e maskoi me demagogji. Ajo mbrojti rendin shfrytëzues çifligaro-borgjez dhe interesat e klasave sunduese. Në çdo kohë feja ishte për status kuo-në e shfrytëzimit. Por ideologjia katolike, duke përdorur demagogjinë shoqërore, u paraqit si ithtare e «vijës së tretë», e të mesmes së artë. Ajo hiqej se ishte si kundër individualizmit ekstrem, egoizmit dhe pasurimit të tepruar, ashtu edhe kundër kolektivizmit e barazisë. Pra, gjoja, ishte për pronën private dhe për fitimin e moderuar. Kjo thuhej me fjalë, por në praktikë ishte krejt ndryshe. Ekzistenca e rendit shfrytëzues konsiderohej e domosdoshme dhe në përputhje me ligjin hyjnor. E drejta e njeriut për të pasur pronë private mbahej si një e drejtë hyjnore e pacenueshme dhe e përjetshme. Kjo nuk hynte gjoja në sferën e së drejtës pozitive, ajo ishte e drejtë morale që zhvillonte lirinë dhe personalitetin njerëzor. Por ajo si atribut lirie thuhej se nuk duhej të absolutizohej e të keqpërdorej për qëllime egoiste.

Në katolicizëm nuk ekistonin kurrfarë sanksionesh e ligjesh juridike që të ndalonin e pengonin abuzimin me këtë të drejtë. Ekzistonin vetëm normat morale-fetare që gjoja

34) «Leka», korrik 1934, f. 230.

duhej të kufizonin egoizmin e njeriut, por këto ishin fiktive dhe pa asnjë forcë.

Ideologët katolikë e zbukuronin pronën private. Në bazë të doktrinës shoqërore katolike ajo nuk ishte burim shfrytëzimi e të këqiash për punonjësit, por vetëm burim të mirash, përfitimesh individuale e shoqërore dhe faktor themelor për zhvillimin e personalitetit. Prona private cilësohej si «pushteti i natyrshëm» i njeriut mbi sendet dhe jo si pushteti i njeriut mbi njeriun. Ky përcaktim kërkonte ta zhvishte atë nga karakteristika thelbësore e saj si burim shfrytëzimi e pabarazie. Prona private mbi të gjitha është pushteti ekonomik i njeriut mbi njeriun, është burim pasurimi i një pjese në dëm të të tjerëve falë marrëdhënieve të nënshtrimit e shfrytëzimit që krijohen midis tyre.

Pronës private i njiheshin dy funksione: funksioni individual dhe shoqëror. Funksioni individual kërkonte që prona të shërbente si burim të mirash për atë që e zotëronte dhe të mos cenohej e drejta e pushtetit të njeriut mbi sendet, ndërsa funksioni shoqëror qëndronte në shërbimin dhe të mirat që gjoja kjo i sillte shoqërisë[35].

Dobësimi i funksionit individual të pronës thuhej se krijonte rrezikun e «kolektivizmit», ndërsa dobësimi i funksionit shoqëror atë të «individualizmit» dhe «egoizmit». Kleri katolik pretendonte se marrëdhëniet ekonomike-shoqërore e pronësore mund të rregulloheshin e të normalizoheshin me anë të normave morale-fetare. Çdo përdorim i metodave të tjera, sidomos i dhunës, konsiderohej i padrejtë. Por praktika ka vërtetuar se feja nuk është e aftë të zgjidhë asnjë problem. Ajo vetëm ndihmon në ruajtjen e status kuo-së shoqërore.

Ideologët katolikë, duke shtrembëruar e denigruar idealet komuniste, pohonin se «kolektivizimi» gjoja i «barazonte të gjithë në skamje», duke i privuar njerëzit nga prona private. Kështu, «kolektivizmi mbahej si më i rrezikshëm nga «individualizmi» apo «kapitalizmi ekstremist».

Prona private e mbështetur gjoja në respektimin e normave morale siguronte lirinë e njeriut, ndërsa heqja e pronës private e kthente njeriun në rob e pa personalitet[36]. Ky ishte një nga mitet më të përhapura të klasave reaksionare, të cilit kleri i dha vulën fetare.

Ideologët katolikë pohonin se nëpërmjet pronës private realizohej lidhja e njeriut me natyrën dhe në shkallë të fundit lidhja e njeriut me zotin.

Njerëzit që nuk kishin pronë private, privoheshin nga

35) «Hylli i Dritës», dhjetor 1936, f. 594-595.
36) Po aty.

kjo lidhje, nga morali dhe humanizmi. Kështu karakteri antihumanitar i pronës private paraqitej si humanitar.

Klerikët katolikë u munduan ta vizatonin me ngjyra të errta fizionominë klasore të proletariatit, i cili nuk kishte pronë, duke e paraqitur si «klasën më të ulët shoqërore», pa ideale shoqërore e kombëtare[37]. Kjo shpifje kundër klasës më përparimtare të kohëve moderne kërkonte të godiste edhe ideologjinë e saj.

Ata për demagogji kritikuan ekstremitetet dhe grumbullimin e pasurive të shumta prej disave në dëm të pjesës tjetër të shoqërisë, e cila varfërohej. Këto teprime dhe kontraste duhej të zhdukeshin me anë të moralit fetar (këtij morali prej farisenjsh). Të pasurit duhej të bindeshin vetë se pasuria e shumtë e dëmtonte interesin shoqëror. Ata vetë duhej të tregoheshin altruistë dhe t'u jepnin ndonjë lëmoshë të varfërve, ndërsa të varfrit nga ana e tyre nuk duhej të tregoheshin egoistë e ziliqarë dhe nuk duhej të vinin dorë në mënyrë të paligjshme mbi pronat e pasanikëve.

Sipas së drejtës hyjnore, të gjithë duhej të pajiseshin me pronë, në mënyrë që të forcohej funksioni shoqëror i saj dhe të vendosej një farë drejtpeshimi.

Ideologët katolikë hiqeshin sikur u dhimbseshin fshatarësia që nuk kishte tokë dhe punonjësit e tjerë dhe kritikonin sa për sy e faqe ata pronarë që kishin grumbulluar shumë toka, si dhe kapitalistët që nuk ngopeshin me fitime[38]. Ata i këshillonin që të ishin gjoja më të moderuar dhe ta mënjanonin «individualizmin» e tepruar.

Të gjitha këto tirada prej tartufësh bëheshin në një kohë kur vetë kleri katolik ishte një kastë shfrytëzuese e parazitare, kishte prona dhe pasuri të mëdha e shfrytëzonte pa mëshirë fshatarët e masat e tjera. Fshatarët e rrethit të Shkodrës në këtë periudhë u kishin drejtuar ankesa autoriteteve se trajtoheshin keq e rripeshin prej klerikëve të pashpirt. Por krahas demagogjisë, nuk mungoi dhe apologjia e hapur e rendit shfrytëzues. Revista «Leka» në mënyrë të veçantë i mori në mbrojtje klasat shfrytëzuese. Ajo pohonte se gjoja në këtë periudhë nuk kishte klasa shfrytëzuese në Shqipëri dhe se koha e bejlerëve që jetonin në kurriz të popullit kishte kaluar[39]. Kjo thuhej në një kohë kur bejlerët çifligarë ishin klasë sunduese dhe bënin ligjin. Organi jezuit lavdëroi koncesionarët kapitalistë, tregtarët, spekulatorët e fajdexhinjtë. Sipas tij, nuk kishte kundërthënie midis punëtorëve e kapitalistëve dhe interesat e tyre «deridiku përputheshin». Fajdexhinjtë, sipas «Lekës», ishin elementë pozitivë që punonin

37) Po aty, 1934, nr. 6, f. 272-276.
38) Po aty, 1937, nr. 2-3, f. 122-128; 1937, nr. 6, f. 271-273.
39) «Leka», 1936, nr. 8, f. 340-341.

për të mirën e vendit. Revista u shpreh kundër moratoriumit të borxheve nën pretekstin se ai do të dëmtonte kredinë. Le t'u rripnin fajdexhinjtë punonjësve disa lëkurë, mjaftonte që fajdeja të mbrohej.

Edhe krizën e rëndë ekonomike që po bënte kërdinë në vend dhe që i kishte rrokullisur masat punonjëse në greminën e varfërisë e të mjerimit, klerikët katolikë e shpjegonin me mohimin e Zotit[40]. Klasat sunduese e rendi shfrytëzues nuk mbanin gjoja asnjë përgjegjësi për të. Nga kriza mund të dilej, sipas tyre, me anë të moralit kristian.

Në këto vite të varfërisë së padëgjuar, kur zia e bukës bënte kërdinë, kur ishin vërtetuar dhe raste vdekjeje për shkak të urisë, kleri katolik predikonte se më e rëndësishme ishte buka e shpirtit (feja) se ajo e barkut. Dhe këtë, popullit të mjerë e të cfilitur ia thoshin ata që mbyteshin në të mira dhe në luks, që edhe në fshatrat më të mjeruara të malësive ku qarkullonin legjendat e misrit nuk u mungonte asgjë, që pinin në vend të ujit verë austriake dhe italiane («gjakun e Krishtit»).

Ata i këshillonin të varfrit me fjalët e Krishtit mitik «beati pauperes» (lum të varfrit). Kjo shprehje e ungjillit kishte kuptim të dyfishtë: ajo përligjte varfërinë materiale dhe padijen.

Karakteri antidemokratik i ideologjisë katolike u shpreh dhe në pikëpamjet mbi shtetin e regjimin politik. Kjo ideologji ka mbajtur gjithnjë një qëndrim të dyfishtë ndaj shtetit. Si çdo ideologji fetare, edhe ideologjia katolike, ishte e interesuar për ruajtjen e forcimin e shtetit shfrytëzues, në mënyrë që të siguroheshin pozitat e fesë dhe të mbahej populli i nënshtruar. Por kleri katolik në shtetin sheh edhe një rival të kishës. Kisha katolike ka dashur gjithnjë të ketë liri ekspansioni dhe të mos kufizohet prej shtetit në veprimtarinë e saj. Ajo ka dashur të ketë monopolin në sferën shpirtërore e shpesh ka pasur prirje të kthehet në një shtet brenda shtetit. Këto prirje i shfaqi dhe kleri katolik shqiptar, i cili siç thamë, u përkrah edhe nga Vatikani dhe Italia fashiste. Në përcaktimin që i jepej shtetit nga ideologjia katolike shfaqeshin të dyja prirjet e mësipërme. Shteti konsiderohej si vullnet i përbashkët i të gjithë njerëzve, si institut që qëndronte mbi interesat e klasave e grupeve shoqërore dhe që kishte burim hyjnor[41].

Kjo donte të thoshte se shteti duhej të kryente funksionin e tij laik të sigurimit të interesave të klasave shfrytëzuese, të mbajtjes së popullit në fre, por ai në të njëjtën

40) Po aty, 1935, nr. 12, f. 504.
41) «Hylli i Dritës», 1933, nr. 4, f. 153-160.

kohë duhej të njihte autoritetin e kishës dhe të drejtat e saj ekskluzive në sferën shpirtërore.

Pohimi i burimit hyjnor të shtetit rrihte të nënvizonte jo vetëm atë që ai duhej të pranohej e respektohej nga populli si diçka pozitive dhe e domosdoshme e dhënë nga providenca, por edhe faktin që kisha si zëvendësja e zotit në tokë, i cili krijoi shtetin, nuk kishte më pak të drejtë se ai, por ndofta dhe më shumë. Ideologët katolikë i thurën elozhe shtetit shfrytëzues në përgjithësi, duke e paraqitur si «bamirësin më të madh» për shoqërinë dhe kërkuan nga populli që të respektohej si forcë me rëndësi për sigurimin e rregullit e të solidaritetit. Por, nga ana tjetër, theksuan se shteti përfaqësonte dhunën, ndërsa morali fetar kishte epërsi mbi dhunën. Rrjedhimisht, kisha qëndronte më lart nga shteti. Ky është një parim doktrinar i katolicizmit, i cili lidhej edhe me interesat konkrete e veprimtarinë praktike klerikale.

Gjatë gjithë historisë, në vende të ndryshme kisha, edhe pse i ka shërbyer rendit shfrytëzues, ka pasur raste që ka rënë në konflikt me shtetin pikërisht për arsyet që thamë më sipër. Në Shqipëri kisha katolike pati fërkime në ndonjë rast me regjimin zogist. Ndaj këtij regjimi ajo mbajti qëndrim të dyfishtë që kushtëzohej me konjunkturën politike, me marrëdhëniet italo-shqiptare. Kur marrëdhëniet me Italinë fashiste ishin normale, kleri katolik mbajti deri-diku formalisht anën e regjimit. Kur këto marrëdhënie u acaruan për një farë kohe, ai hyri në konflikt me të sidomos për çështjen e shkollave. Por duhet thënë, siç vumë në dukje në fillim, se kleri katolik në përgjithësi ishte kundër regjimit zogist dhe për zëvendësimin e tij me një regjim fashist. Ai e konsideronte atë një regjim «mysliman», i cili ishte një farë pengese për ekspansionin dhe veprimtarinë katolike në shkallë të gjerë. Regjimi zogist nën presionin e Italisë, në përgjithësi nuk e pengoi veprimtarinë katolike. Por kleri katolik donte të kishte liri të pakufizuar dhe privilegje më të mëdha. Këto mund t'ia siguronte më mirë regjimi fashist. Në shtypin katolik u bënë një sërë kritikash ndaj qeverisë zogiste, sidomos në periudhën e acarimit të marrëdhënieve për çështjen e shkollave. Këto ishin si kritika të hapura, ashtu edhe me nënkuptime. Ato flisnin kundër «robërimit shpirtëror» të kishës nga shteti[42]. Në to theksohej se shteti nuk kishte të drejtë të përzihej në punët private, shpirtërore të kishës dhe të cënonte të drejtat e liritë e saj. Ai shtetëzimin dhe mbylljen e shkollave private e fetare e konsideronte si një cenim të autonomisë kishtare[43]. Feve, sipas ideologëve katolikë, nuk mund t'u imponoheshin doktrina politike, shoqërore, filozofike e pedagogjike që nuk përputheshin me përmbajtjen e tyre. Çdo kishë e besim duhej të ruante autonominë e vet. Ndërhyrja në liritë e të drejtat e tyre cilësohej si politikë etatiste.

Në këtë kohë u ndez një polemikë e ashpër midis klerit dhe ministrit të Arsimit, Hilë Mosi. «Hylli i Dritës» më 1932 sulmoi organet qeveritare duke folur për korrupsionin e tyre. Kjo kritikë nuk lidhej drejtpërdrejt me çështjen e shkollave, por ishte në stilin dhe metodën e klerit, i cili kur polemizonte me kundërshtarin, i vinte në veprim të gjitha mjetet, mjaftonte që të bënte zhurmë. Kësaj kritike Hilë Mosi iu përgjigj me anë të gazetës «Besa», më 4 nëntor 1932, duke e cilësuar artikullin klerikal një «invektivë», një artikull denigrues[44].

«Hylli i Dritës» iu përgjigj se nuk kishte pohuar ndonjë gjë jo të vërtetë, por kishte folur për plagët e shoqërisë në përgjithësi e jo për regjimin[45].

Në të vërtetë tehu i kritikës drejtohej kundër qeverisë zogiste. Një kritikë e tillë u bë në një kohë kur marrëdhëniet e qeverisë së A. Zogut me atë të Romës ishin të tendosura. Kështu që kritika e klerit ishte në të mirë të politikës italiane dhe e nxitur prej Romës.

Kur konflikti italo-shqiptar po merrte fund dhe në fuqi erdhi qeveria «liberale» e M. Frashërit, e cila i dha koncensione të reja të rëndësishme Italisë fashiste dhe më pas i hapi edhe shkollat e klerit, kleri katolik kërkoi nga qeveria e re që të korrigjohej qëndrimi që u mbajt ndaj tij dhe të «shlyheshin gjurmët e robërimit shpirtëror»[46]. Në fakt, kështu u veprua dhe marrëdhëniet midis klerit e regjimit u normalizuan disi.

Klerikët katolikë, duke dhënë mendime për formën e regjimit politik në përgjithësi, pohuan në mënyrë mashtruese se gjoja nuk u interesonte forma e regjimit politik, mjaftonte që ai të siguronte të mirën e përbashkët dhe bashkimin kombëtar. Por çështja nuk ishte kështu. Kleri parapëlqente regjimet më reaksionare, si regjimin fashist dhe e urrente regjimin demokratik qoftë dhe në formën e demokracisë borgjeze. Sistemet demokratike i quante të papërshtatshme për Shqipërinë. Liritë demokratike urreheshin për shkak se gjoja nxisnin prirjet centrifugale e anarkike dhe cilësoheshin «liri popujsh të egër»[47]. Populli paraqitej ende i papërgatitur

42) Po aty, 1935, nr. 12, f. 574.
43) Po aty, 1935, nr. 9, f. 435-436.

44) «Besa», 4 nëntor 1932.
45) «Hylli i Dritës», 1932, nr. 12, f. 594-602.
46) Po aty, 1935, nr. 12, f. 569-574.
47) Po aty, 1930, nr. 11, f. 521-523.

për të gëzuar të drejtat qytetare. Në vend gjoja nuk ekzistonte opinioni publik. Ky gjoja manipulohej kinse nga njerëzit «sharlatanë e reklamaxhinj». Një pohim i tillë tingëllonte në mënyrë paradoksale e ironike, po të kihet parasysh fakti që klerikët katolikë ishin ndër të parët që duhej të përfshiheshin në këtë kategori. Kleri katolik, ashtu si dhe ai mysliman e ortodoks, ishte armik i betuar i të drejtave dhe i emancipimit të gruas. Ai përpiqej të ruante marrëdhëniet patriarkale në familje dhe, në bazë të konceptit antihumanitar fetar gruan e mbante për qenie të ulët që duhej të shlyente përjetësisht mëkatin fillestar të kryer, sipas legjendës biblike, mëkatin e Evës.

Gruaja gjoja ishte krijuar nga zoti vetëm për jetën familjare, për përmbushjen e funksionit biologjik dhe për punët e shtëpisë[48]. Ideologët klerikalë kritikuan elementët përparimtarë që kërkonin çlirimin e gruas dhe në këtë mënyrë vepronin kundër ligjeve hyjnore që gruan e kishin paracaktuar gjoja vetëm për sferën e familjes dhe për një pozitë të nënshtruar. Ata që kërkonin ta bënin atë nga «robneshë» në «mbretëreshë», thoshin ata, kalonin gjoja nga një ekstrem në tjetrin.

Kështu, sistemi demokratik, sipas këtyre arsyetimeve, nuk i përshtatej Shqipërisë. Shqipëria duhej të mbetej gjithnjë nën diktaturën dhe populli i saj nuk duhej të gëzonte të drejta demokratike. Parapëlqimi për diktaturën fashiste maskohej para opinionit publik. Por në dokumentet sekrete ky shprehej hapur. Në «Hylli i Dritës» u pohua në mënyrë jezuite, ashtu siç bëri dhe Vangjel Koça, se fashizmi gjoja ishte një lëvizje shoqërore e politike me ideale të larta, e cila në Gjermani dhe në Itali i kishte bërë turmat për vete. Shqiptari gjoja «nuk ishte i gatshëm të sakrifikohej për kolektivitetin si këmishëzinjtë»[49]. Kjo në fakt ishte një lëvdatë që i bëhej fashizmit dhe që tregonte parapëlqimin për të.

Dhe ishte pikërisht revista «Hylli i Dritës» ajo që kur vendi u shkel me egërsi nga pushtuesit fashistë, u thuri ditirambe këmishëzinjve që vendosën regjimin fashist në vend, duke përmbushur më në fund aspiratën e klerit katolik[50].

Vendosja e regjimit fashist konsiderohej prej tij si një barrierë kundër komunizmit të cilin e mbante për kundërshtarin kryesor të tij.

48) Po aty, 1930, nr. 9, f. 474.
49) «Hylli i Dritës», 1930, nr. 9, f. 461.
50) Po aty, 1939, nr. 3-4, f. 148.

3. Lufta e klerit katolik kundër ideologjisë dhe lëvizjes revolucionare

Kleri katolik ushqente një urrejtje të thellë për idetë dhe lëvizjet revolucionare. Lufta ideologjike e tij u drejtua në mënyrë të veçantë kundër tyre.

Kjo është e kuptueshme, çdo ideologji fetare është në pozita krejt të kundërta me idetë e lëvizjet përparimtare. Urrejtja e klerit dhe lufta kundër tyre lidhej me doktrinën shoqërore katolike, e cila i konsideronte ato mjaft të dëmshme e të rrezikshme për fenë dhe për rendin shfrytëzues. Lufta revolucionare për zhdukjen e shfrytëzimit dhe të pabarazisë shoqërore, përdorimi i dhunës revolucionare për përmbysjen e rendit shfrytëzues ishin të papajtueshme me fenë, e cila përpiqej ti përjetësonte ato.

Lufta kundër ideologjisë e lëvizjes revolucionare diktohej dhe nga orientimet që i jepeshin herë pas here kishës katolike nga Vatikani dhe Qeveria e Romës. Sidomos në qendër të kësaj lufte ishin idetë dhe lëvizja komuniste.

Vatikani, në enciklikat e tij drejtuar kishave katolike në të gjitha anët e botës, tërhiqte vëmendjen për rrezikun komunist dhe theksonte domosdoshmërinë e luftës me të gjitha mjetet kundër tij.

Që nga fundi i shekullit të kaluar, kur papa Luani XIII me anë të enciklikës «Rerum Novarum», vuri në dukje gjithë shqetësim daljen në skenë të proletariatit, varrmihësit të sistemit borgez dhe forcimin e luftës revolucionare duke bërë thirrje që t'i bëhej ballë këtij rreziku, kisha e pati gjithnjë në qendër të vëmendjes çështjen e luftës kundër lëvizjeve e ideve revolucionare.

Kleri katolik shqiptar, që nga fillimi i shek. XX kur u dukën idetë e para socialiste në Shqipëri si dhe klasa punëtore, u ra kambanave të alarmit mbi rrezikun që po lindte. Më pas, me forcimin e luftës së klasave dhe rritjen e klasës punëtore e daljen në skenë të lëvizjes komuniste, shqetësimi u rrit akoma më shumë. Në vitet 30 Vatikani bëri zhurmë të madhe për rrezikun e «komunizmit ateist». Në enciklikën e papës Piu XI të vitit 1937 «Divini Redemptoris» u bëhej thirrje kishave katolike të bënin një luftë të vendosur kundër tij.

Dhe pikërisht në këto vite kleri katolik shqiptar ndërmori një fushatë të gjerë e të egër kundër lëvizjes komuniste dhe çdo lëvizjeje përparimtare. Ai vuri në veprim të gjithë arsenalin e tij ideologjik e doktrinar, të gjitha sofizmat, pseudoerudicionin e frazeologjinë banale e vulgare për

të shpifur kundër komunizmit e për ta denigruar atë. Madje, për të penguar e luftuar çdo ide e lëvizje përparimtare e për të bërë shantazh, kleri me metodën e tij jezuite vuri shenjën e barazisë midis ideve laike e përparimtare dhe ideve komuniste. Në këtë kohë kundër komunizmit u vërsulën klerikët fashistë që mbaheshin si autoritete të hierarkisë katolike në Shqipëri, siç ishin Fulvio Kordinjano dhe Zef Valentini. Këta agjentë të fashizmit e të Vatikanit denigruan jo vetëm idetë e lëvizjes përparimtare, por në përgjithësi gjithçka të mirë që kishte populli shqiptar. Ishte pikërisht ky klerik fashist, Kordinjano, që e cilësonte komunizmin me fjalët e Piut XI «murtaja e kohës»[51] dhe që hidhte baltë edhe mbi shqiptarët në përgjithësi duke i paraqitur si një popull të egër e primitiv. Kordinjanos në këtë kohë i dhanë përgjigjen e merituar elementët përparimtarë. Për këtë do të flasim në kapitullin mbi idetë revolucionare.

Si kriter bazë për vlerësimin e ideve revolucionare merreshin kriteret e aksiologjisë katolike (shkallëzimit të vlerave) sipas së cilës këto ide bënin pjesë në vlerat më të ulëta duke qenë antipodi i fesë. Atyre u vihej vula e egoizmit, pragmatizmit e moralit të ulët. Këto ide gjoja ishin një shmangie nga ligjet e rendit hyjnor, të cilat e shpallnin rendin shfrytëzues të përjetshëm dhe nuk lejonin që të cënohej e të përmbysej ai.

Parimet e lirisë, të barazisë, të drejtësisë shoqërore, të shpallura nga revolucionarët dhe që kërkoheshin të përmbusheshin me rrugë revolucionare, konsideroheshin anarkike e antishoqërore. Feja nuk mund t'i pranonte ato, sepse shkelte gjoja ligjet hyjnore. Feja njihte vetëm drejtësinë morale, e cila duhej të vendosej me dëshirën e njerëzve, pa dhunë. Por kjo ishte fiktive dhe mashtruese. Pragmatizmi dhe egoizmi i ideologjisë revolucionare, sipas ideologjisë katolike, qëndronte në faktin që ajo ishte për ndryshimin me dhunë të marrëdhënieve shoqërore ekzistuese gjoja të pandryshueshme e të përjetshme dhe vendosjen e marrëdhënieve shoqërore pa shfrytëzim[52]. Zëvendësimi i sistemit shfrytëzues me një sistem pa shfrytëzim gjoja ishte një «egoizëm kolektiv». Kjo ishte një apologji e hapur e rendit shfrytëzues dhe dëshmonte se sa falso ishte predikimi demagogjik katolik për një rrugë të mesme dhe për mënjanimin e grumbullimit të pasurive të tepërta në duart e një pakice dhe të rritjes së varfërisë në popull. Kleri katolik nuk ishte aspak kundër rendit çifligaro-borgjez. Ai ishte kundërshtar i betuar i demokracisë, i socializmit dhe i komunizmit.

51) Po aty, 1933, nr. 7-8, f. 305.
52) Po aty, 1936, nr. 1, f. 7.

Kjo u vërtetua jo vetëm nga lufta e tij e vendosur kundër ideve komuniste e demokratike në vitet 30, por u provua edhe më vonë nga veprimtaria reaksionare që zhvilloi kleri katolik kundër pushtetit popullor dhe rendit socialist pas Çlirimit.

Revista jezuite «Leka», me Zef Valentinin në krye, u shpreh gjithë urrejtje kundër sistemit komunist, «drejtue prej hyjit barazim». Ajo në mënyrë falsifikuese kërkonte ta paraqiste sistemin komunist sikur gjoja donte «t'i barazonte njerëzit në skamje» dhe t'i vinte «kazmën jetës shqiptare.» Dhe këtë e pohonin agjentët e Italisë fashiste, këta njerëz pa atdhe, që pas shpinës së kombit po përgatitnin zhdukjen e lirisë e të pavarësisë së tij.

Kleriku katolik, Anton Harapi, në vitin 1936 mbajti disa leksione në Korçë e në Elbasan për të denigruar idetë komuniste. Në këto qytete me tradita revolucionare, ashtu si dhe gjetkë, idetë komuniste kishin fituar truall dhe po përhapeshin në popull. Klerin e shqetësonte kjo gjendje. Ai u përpoq t'i neutralizonte ato. Anton Harapi deshi ta bënte gogol komunizmin dhe deklaroi se «bolshevizmi, si la njeriun pa perëndi, don të lejë edhe pasunit pa zotërues»[53].

Jezuiti Valentini, duke përsëritur idetë e njohura të marra nga arsenali i propagandës antikomuniste, teorizonte se gjoja komunizmi nuk kishte asnjë «postulat të provuem» dhe s'bënte gjë tjetër veçse kopjonte rezultatet e shkencave të aplikuara[54].

Atë çka ishte meritë e rëndësishme e marksizëm-leninizmit, i cili diti të shfrytëzojë arritjet e mëdha të shkencave dhe të dijes njerëzore për të ardhur në përfundime të thella dhe për të krijuar një vizion të qartë mbi botën, jezuiti Valentini e paraqiste si të metë të tij.

Nga i njëjti arsenal ishin marrë dhe shpifjet për komunizmin si mohim gjoja i personalitetit njerëzor, i familjes etj. Sistemi komunist gjoja nuk kujdesej për mirëqenien e popullit[55]. Kleri katolik këtë falsifikim të idealit komunist u mundua ta mbështeste në trillimet mbi gjendjen në Bashkimin Sovjetik. Në revistat katolike jepeshin gjithnjë lajme dhe historira të falsifikuara të kopjuara nga shtypi reaksionar botëror që shtrembëronin realitetin sovjetik dhe që kërkonin të provonin se sistemi socialist u solli gjoja vuajtje e mjerime punonjësve dhe ishte i dështuar. Gjithë synimi ishte që komunizmi t'u paraqitej shqiptarëve në dritë të zymtë, t'u bëhej gogol. Kështu veproi jo vetëm kleri, por i gjithë reaksioni.

53) A. Harapi, *Vlerë shpirtërore* (broshurë), viti 1936, f. 12.
54) «Leka», 1936, nr. 3, f. 98-100.
55) Po aty, 1936, nr. 5, f. 193.

Një problem rreth të cilët u vërtit kritika klerikale kundër ideve komuniste, ishte ai i dhunës. Komunistët paraqiteshin si elementë të zhveshur nga humanizmi dhe shkatërrimtarë, pse kërkonin përmbysjen e rendit reaksionar me dhunë. Dhuna e egër dhe shfrytëzimi që ushtronin klasat sunduese mbi popullin konsideroheshin normale. Ato i parashikonte ligji hyjnor. Vetëm dhuna revolucionare ishte anormale dhe nuk pajtohej me të. Kishte raste, siç shpjeguam më parë, që kleri për demagogji pohonte se nuk miratonte asnjë lloj dhune.

Por këtij arsyetimi i mungonte koherenca, përderisa pranohej rendi shfrytëzues që mbështetej mbi dhunën e shfrytëzimin. Ideologët e klerit katolik u referoheshin mësimeve fetare dhe deklaronin se të gjitha problemet, marrëdhëniet e mosmarrëveshjet në shoqëri nuk duhej të zgjidheshin me anë të dhunës, por me anë të moralit fetar. Dhuna revolucionare, si dhe dhuna në përgjithësi, gjoja nuk kanë zgjidhur asnjë problem, sepse prej dhunës lindte vetëm dhuna.

Revista «Leka» bënte lojë fjalësh dhe kërkonte t'i mbushte mendjen opinionit publik për dëmin e dhunës me anë të sofizmave. Ajo shkruante: «disa duen t'i shërojnë plagët të sëmurit tue i premë kryet»[56].

Edhe ideologët katolikë, ashtu si të tjerët, u përpoqën të provojnë se luftërat klasore e revolucionare ishin dukuri që mund të mënjanoheshin. Ato ishin rezultat i lënies pas dore të edukatës fetare. Prandaj, po të forcohej kjo edukatë dhe të ruhej ndikimi i fesë në popull mund të eliminoheshin idetë dhe lëvizjet revolucionare.

Këtu u përsërit teza e njohur se për komunizmin nuk kishte kushte në Shqipëri, sepse vendi ishte kinse i prapambetur, nuk kishte kapitalistë e proletarë. Ideologët e klerit, përveç kësaj, shtonin se fshatarësia shqiptare, që përbënte shumicën e popullit, ishte gjoja kundër socializmit, sepse nga natyra e saj ajo ishte lidhur gjoja me pronën private.

Megjithatë, klerikët katolikë tek idetë komuniste, të cilat mendonin se më shumë hynin nga jashtë, shikonin një rrezik shumë të madh.

Ky rrezik mendohej të përballohej jo vetëm me anë të fesë, por në radhë të parë me anë të fashizmit. Dhe kjo ishte një nga arsyet kryesore, siç thamë, që kleri katolik po bënte përpjekje të mëdha që të vendosej regjimi fashist në Shqipëri.

Në këto vite të shfrytëzimit të egër, të varfërisë e të mjerimit të thellë, popullit e besimtarëve u predikohej të

56) Po aty, 1934, nr. 3, f. 77-78.

duronin me përulësi vuajtjet e padrejtësitë shoqërore, për hir të vendosjes së drejtësisë hyjnore e vëllazërimit kristian. Atyre u thuhej të vetëpërsoseshin moralisht dhe të besonin në mësimet e Krishtit mitik se do të vinte një kohë që të «zbuteshin zemrat e të pasunve dhe të egoistëve dhe do të thaheshin lotët e të varfërve»[57].

Kleri katolik u predikoi besimtarëve kultin e vuajtjes e të vdekjes. Duke u mbështetur në doktrinën kristiane, ai i shikonte vuajtjet si një forcë të madhe pastruese për rritjen e përsosmërisë morale, si shkallë drejt lumturisë transcedentale, ndërsa vdekjen si synimin më të lartë për t'u çliruar nga kotësia e jetës tokësore dhe për të arritur lumturinë e bashkimin me Zotin.

Tartufët e kohëve moderne që vetë nuk njihnin vuajtje e privacione, që jetonin në të mira e në bollëk, që «parajsën» tokësore e kishin monopolizuar për veten e tyre, popullit i premtuan parajsën qiellore si kompensim për vuajtjet në tokë. Ky ishte një kompensim iluzor për ferrin tokësor, ishte një kurth. Këtu fshihej ajo dinakëri prej jezuitësh, ai synim dhelparak, të cilin e vuri në dukje bukur shkrimtari revolucionar Migjeni, synimi për t'i bërë «skyfterët pëllumba», për të nënshtruar e robëruar masat popullore të shumëvuajtura, për të shuar çdo revoltë të tyre.

II. *IDETË POLITIKE-SHOQËRORE TË KLERIT MYSLIMAN*

Siç theksuam në hyrje të kapitullit, në këtë periudhë edhe kleri mysliman mori pjesë në trajtimin e problemeve politike-shoqërore të periudhës. Por ai nuk kishte përgatitjen dhe nivelin e klerit katolik dhe polemika e tij nuk pati atë gjerësi e thellësi. Ideologët e klerit mysliman nëpërmjet organit të tyre, revistës «Zani i Naltë», që kishte vite që botohej në fillim në Shkodër e pastaj në Tiranë, trajtuan më shumë probleme thjesht fetare e doktrinare të islamizmit. Ata u morën më shumë me komentimin e verseteve të Kuranit dhe me shpjegimet teologjike të ulemave (të teologëve myslimanë). Shpjegimet thjesht teologjike zënë një vend të madh në revistë dhe në ndonjë broshurë që u botua në këtë kohë.

Kjo synonte të zhvillonte deri diku propagandën fetare në besimtarët, por jo aq këtë, sepse besimtarët siç dihet ishin analfabetë, sesa pajisjen e klerit të ulët mysliman

57) A. Harapi, vep. cit., f. 74.

me njohuritë teologjike. Kleri i ulët mysliman nuk i kishte këto njohuri, prandaj hierarkia e lartë u kujdes që ta ngrinte nivelin e tij.

Shoku Enver Hoxha, duke vlerësuar klerin reaksionar në Shqipëri, forcën dhe rolin e tij, ka vënë në dukje disnivelin që ekzistonte midis klerit katolik, ortodoks e mysliman. Në një vepër të tij thuhet lidhur me këtë: «Priftërinjtë kanë kulturë më shumë se hoxhallarët. Në këtë drejtim ata i ka ndihmuar përkthimi i ungjillit. Ndërsa hoxha di vetëm një bejt me të cilën gënjen dhe ai diçka, prifti ka dhe bejtin dhe ritet, liturgjinë...»[58].

Duke komentuar Kuranin dhe mësimet teologjike islame, ideologët e klerit mysliman u ndalën në disa raste edhe në problemet politike-shoqërore të kohës. Është e kuptueshme që ata nuk mund t'i injoronin ato në këtë periudhë të forcimit të luftës së klasave, edhe pse nuk i preken gjerësisht. Idetë e klerit mysliman, ashtu sikurse ato të klerit katolik, kishin karakter antidemokratik, konservator, bënin apologjinë e rendit shfrytëzues dhe të regjimit zogist. Edhe ato natyrisht shprehnin pozitat partikulariste fetare dhe në këtë kuptim nuk përputheshin me interesat kombëtare. Por kleri mysliman në këtë periudhë, me përjashtim të ndonjë elementi të veçantë, nuk u vu në shërbim të të huajve dhe nuk zhvilloi veprimtari antikombëtare ashtu si kleri katolik.

Idetë politike-shoqërore të klerit mysliman si të klerit në përgjithësi ishin anakronike e idealiste-fetare. Ato të gjitha dukuritë shoqërore dhe ngjarjet e jetës shqiptare i shpjeguan me anë të dogmave kuranike dhe të mësimeve të tjera të fesë islame.

Si çdo fe, edhe kjo kërkonte të theksonte universalitetin dhe ekskluzivitetin e saj, t'i bindte besimtarët dhe në përgjithësi opinionin publik se i vetmi shpjegim i drejtë i jetës shoqërore dhe metodat e sakta për zgjidhjen e problemeve sociale mund të gjendeshin vetëm në mësimet e besimit islamik. Në këtë kuptim ajo thuhej se kishte epërsi ndaj besimeve të tjera. Pranimi i epërsisë dhe ekskluzivitetit nga çdo besim fetar lidhet me karakterin dogmatik dhe frymën e tij të intolerancës që ka për qëllim t'i kundërvënë besimet njëri ndaj tjetrit dhe të përçajë masat popullore, të dobësojë ndjenjën kombëtare duke e vënë fenë gjithnjë mbi kombin. Ideologët myslimanë pohonin se besimi mysliman ishte më i arsyeshmi, më i përsosuri që përputhej më tepër nga të gjithë me aspiratat njerëzore.

«Zani i Naltë» theksonte se feja myslimane gjoja nuk

58) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 26, f. 92.

ishte dogmatike dhe se pranonte që çdo besimtar t'ia nënshtronte kritikës çdo dogmë.

Shtjellimi i mëtejshëm i këtij arsyetimi fshihte një sofizëm, një mashtrim. Thuhej se besimtari mund të dyshonte në dogmën derisa të gjendej një «filozof» (një ulema ose teolog) që ta zbërthente dogmën për të cilën dyshohej, dhe ta qartësonte atë[58/1]. Pra, dyshimi në dogmën dhe mospranimi i saj duhej të kishte kufi, duhej të ishte relativ dhe jo absolut. Ai, më tepër sesa një dyshim, interpretohej si një moskuptim për mungesë njohurish të plota fetare. Shpjegimi i dogmës duhej t'i jepte fund çfarëdo dyshimi pra, rrjedhimisht, edhe çfarëdo kritike. Në këtë mënyrë kërkohej të argumentohej se gjoja besimi islamik edhe pse kishte burim hyjnor, dhe përbëhej nga të vërteta absolute e të përjetshme, ishte në të njëjtën kohë racionalist. Racionalizmi i tij qëndronte gjoja në të drejtën për të vënë në dyshim dhe për të kritikuar dogmat fetare si dhe në aftësinë shpjeguese teologjike për t'i bërë dogmat të qarta, për të shpërndarë mjegullën e dyshimit. Por, në realitet nuk ishte kështu. Ky ishte një pohim demagogjik. Besimi mysliman si çdo besim nuk pranon asnjë kritikë ndaj dogmave fetare. Përveç kësaj, vetë shpjegimi i teologëve myslimanë ishte dogmatik.

Teza se problemet e mëdha të islamizmit zgjidheshin gjoja me anë të intelektit e të diturisë[59], nuk dështmon për një racionalizëm të vërtetë në fenë islame, po për faktin që racionalizmi duhej të bëhej shërbëtor i fesë, të mbështeste dogmat e saj. Të gjitha fetë kanë nevojë për një «racionalizëm» të tillë. Në shekullin e dijes dhe të përparimit është e pamundur t'u servirësh njerëzve dogma të thata e të paqarta pa i shpjeguar ato, pa u gjetur një farë arsyetimi. Por, në shkallë të fundit, çdo «racionalizëm» fetar është një pseudoracionalizëm, është një apologjizëm i fesë.

Apologjizmi nuk duhet ngatërruar me kritikën. Karakteri universal i fesë islame shpjegohej me faktin se ajo rridhte kinse nga arsyeja e kulluar hyjnore. Ai provohej, gjithashtu, me aftësinë që kishte gjoja feja myslimane, për t'iu përshtatur rrethanave konkrete historike[60], dhe për t'i modeluar ato sipas botëkuptimit të vet.

Me këtë lloj universalizmi dhe mënyra të të përshtaturit ndaj mënyrës së jetesës së çdo populli kërkohej të mbrohej teza se feja ishte mbi kombin dhe se gjoja feja islamike ishte në gjendje t'i kthente të gjitha kombet e po-

58/1) «Zani i Naltë», 1931, nr. 1, f. 33.
59) Po aty, 1933, nr. 9, f. 642-643.
60) Po aty, prill 1928, f. 552-554.

pujt islamikë në një botë islamike të veçantë, e cila kishte vulën e fesë dhe para së cilës zhdukeshin të gjitha veçoritë origjinale kombëtare e klasore.

Kjo tezë qarkullon deri në ditët e sotme në vendet islamike. Por kjo është krejt pa bazë. Realiteti historik ka treguar dhe tregon se si vendet islamike, ashtu edhe vendet me fe të tjera, pavarësisht nga feja e përbashkët, kanë pasur e kanë veçori të ndryshme dhe shkallë të ndryshme zhvillimi që përcaktohen nga niveli i forcave prodhuese, marrëdhëniet në prodhim e gjithë kompleksi i marrëdhënieve të tjera, duke përfshirë dhe ato etnike.

Pikëpamja e të përshtaturit të fesë myslimane kushteve të çdo vendi kishte edhe një synim tjetër. Me anë të saj kërkohej të provohej se islamizmi u përhap në Shqipëri, ashtu si dhe gjetkë në mënyrë paqësore e të natyshme dhe jo me anë të dhunës. Pra, feja myslimane, gjoja nuk u fut me dhunë në vend nga pushtuesi i huaj[61]. Madje fesë myslimane i atribuohej merita e bashkimit të shqiptarëve dhe e krijimit të kombësisë shqiptare. Në këtë mënyrë shtrembërohej e vërteta mbi rolin negativ të kësaj feje (ashtu sikurse dhe feve të tjera), si faktor përçarës e pengues në formimin e kombit shqiptar. Shoku Enver Hoxha ka theksuar, se feja musulmane iu imponua shqiptarëve, ashtu si dhe popujve të tjerë, me dhunë nga pushtuesit osman. Kjo u përdor për ta mbajtur popullin në errësirë, të nënështruar e të bindur ndaj pushtuesit e bejlerëve vendas[61/1].

Një tezë tjetër që u parashtrua këtu ishte edhe pohimi se feja myslimane ishte përparimtare, ecte gjoja gjithnjë në një hap me kohën dhe u përgjigjej nevojave e kërkesave të kohëve moderne. Por as kjo nuk i përgjigjej së vërtetës. Pavarësisht nga modifikimet që pësoi feja nën presionin e kushteve historike, ajo është gjithnjë konservatore e anakronike dhe i kundërvihet zhvillimit e përparmit. Ajo e ka frikë progresin dhe, siç pohohej dhe në revistat klerikale, kohët e reja përfytyroheshin si periudha dekadence e regresi dhe ideali i fesë ishte mesjeta. Kjo ishte periudha e artë për të. Progresi kundërshtohej nga vetë fryma e theksuar fataliste e besimit islamik. Zoti në besimin islamik ka paracaktuar dhe rregulluar gjithçka në mënyrë absolute e të hollësishme, ai është i plotfuqishëm e ka përcaktuar në mënyrë të prerë fatin e njeriut dhe nuk i ka lënë atij kurrfarë lirie e fushë veprimi. «Njeriu, — thuhet në Kuran, — e ka të varur në qafë fatin e tij». Prandaj çdo veprimtari për të ndryshuar gjendjen e sendeve dhe marrëdhëniet njerëzore është e kotë, çdo hap drejt përparimit është një endje në shkretëtirë, një humbje e kotë e energjive. Klerikët myslimanë donin të bindnin besimtarët se bota materiale dhe jeta shoqërore nuk kishin ligje të vërteta e të shëndosha, por ligje mjaft të kufizuara e të pafuqishme. Ligjet e vërteta, sipas tyre, duheshin kërkuar në fenë islame që ishte vetë «inspiracioni i marrë prej zotit»[62]. Me anë të pohimit të epërsisë së besimit mbi jetën shoqërore e materiale, të parësisë së tij, në hierarkinë e vlerave, kërkohej të afirmohej pushteti i klerit mbi masën e besimtarëve.

Ashtu sikurse dhe ideologët katolikë, edhe ata myslimanë jetën shpirtërore ia kundërvënë asaj materiale. Bosht të jetës shpirtërore konsideronin fenë. Sipas tyre, lënia pas dore e dogmave të fesë dhe përqafimi i ideve përparimtare e laike ishte arsyeja kryesore e çoroditjes shoqërore që po vihej re në Shqipëri[63].

Dehumanizimi i rendit shfrytëzues paraqitej si dehumanizimi i shoqërisë në përgjithësi.

Rendi shfrytëzues çifligaro-borgjez, si dhe regjimi zogist, merreshin në mbrojtje dhe zbukuroheshin. Ideologët myslimanë vunë në qarkullim teorinë e njohur reaksionare organike, sipas së cilës klasat e grupet e ndryshme shoqërore ishin gjymtyrët apo pjesët e një trupi të vetëm që përbënin një unitet. Kjo donte të theksonte nevojën e solidaritetit shoqëror, të ekzistencës së një shoqërie pa kundërthënie klasore. Nga ana e tyre, u pohua se bashkimi kombëtar mund të realizohej edhe në kushtet e ekzistencës së tri feve[64]. Kjo thuhej për demagogji. Për vendosjen e bashkëpunimit klasor, faktor me rëndësi konsiderohej zbatimi i moralit mysliman që predikonte dashurinë ndaj «mikut dhe armikut» dhe «të mos jetuarit në armiqësi me njerëzit e shtetit». Lufta e klasave cilësohej si dukuri shoqërore negative që provonte gjoja natyrën mëkatare e egoiste të njerëzve, të cilët kishin braktisur moralin hyjnor.

Kusht i domosdoshëm për vendosjen e bashkimit kombëtar konsiderohej, gjithashtu, ekzistenca e një «qeverie të fuqishme» dhe «të drejtë», siç ishte gjoja ajo e A. Zogut, e cila vendosi qetësinë dhe i dha popullit «liri të plota ashtu siç predikonte feja islame»[65].

Thuhej se për islamizmin nuk kishte rëndësi forma e regjimit politik, kryesore ishte që ai të vendoste paqen klasore.

Me një fjalë, çështja ishte që t'i krijohej qendrueshmëri

61) Po aty, nr. 3, f. 441, 1931, nr. 3, f. 58.
61/1) Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 35, f. 193.

62) «Zani i Naltë», 1928, nr. 5, f. 524-525.
63) Po aty, 1929, nr. 1, f. 744.
64) Po aty, 1936, nr. 4, f. 101-105.
65) Po aty, gusht 1935, f. 237.

rendit ekzistues dhe regjimit në fuqi. Bashkimi i besimtarëve, gjoja nga ana e fesë myslimane, pa dallim klase dhe përpjekja e saj për t'i bërë ata të bindur e të nënshtruar ndaj regjimit paraqitej si një veçori dalluese e saj[66].

Ideologët myslimanë i vishnin fesë islame një karakter demokratik. Atje ku ekzistonte kjo fe, sipas tyre, realizohej demokracia e vërtetë. Në saje të saj edhe rendi shoqëror e regjimi në fuqi kishin një karakter demokratik.

Demokratizmi islamik kërkohej të interpretohej me anë të Kuranit ku flitej për barazimin e mundësive dhe barazimin e të gjithëve përpara ligjit, si të myslimanëve dhe të jomyslimanëve. Në fakt në Kuran kishte pohime mjaft kontradiktore dhe vetëm pohimi i intolerancës fetare kundrejt besimeve të tjera përjashtonte çfarëdo barazie. Edhe përsa i përket besimtarëve myslimanë, nuk pranohej barazia në planin shoqëror, por vetëm barazia përpara zotit, barazia për të fituar të drejtën e lumturisë hyjnore. Pra, edhe këtu jepeshin të drejta iluzore e aspak reale.

Të drejtën pozitive si çdo fe edhe feja myslimane nuk e kishte objektin e saj. Ajo njihte të drejtën hyjnore, prandaj barazia përpara ligjit ishte kryesisht barazia përpara ligjit hyjnor. Natyrisht, për demagogji shoqërore pohohej formalisht, siç u tha më lart, se ajo përmbushte edhe barazinë e mundësive reale dhe barazinë para ligjit pozitiv (të së drejtës pozitive). Por kjo ishte vetëm me fjalë, sepse asnjë fe, duke përfshirë dhe atë myslimane, nuk ka luftuar ndonjëherë kundër zhdukjes së pabarazisë ekonomike, shoqërore e politike, por përkundrazi e ka përligjur dhe përjetësuar atë. Këtë do ta shpjegojmë konkretisht më poshtë.

Tipar i karakterit demokratik të fesë islame konsiderohej përpjekja për të përmbushur bashkëpunimin klasor, për t'i «vllazëruar» njerëzit pavarësisht nga besimi, kombësia, prejardhja shoqërore, duke i konsideruar si njerëz të një familjeje, të familjes së madhe të krijuar nga zoti[67].

Por as kjo nuk ishte e saktë. Feja myslimane donte të realizohej bashkëpunimi klasor, por në të njëjtën kohë ishte edhe për ekskluzivitetin fetar dhe ruajtjen e përçarjes fetare. Ajo nuk ishte aspak për vëllazërimin e besimtarëve të feve të ndryshme, siç pohonte në mënyrë demagogjike. Vetë pohimi i ekskluzivitetit fetar, i epërsisë së një feje mbi një tjetër, i kundërvënies së saj feve të tjera, nxit përçarjen fetare. Kështu feja, megjithëse e dëshiron bashkëpunimin klasor në shkallë kombëtare, me përmbajtjen e saj dogmatike dhe praktikën e saj, e bën atë të parealizueshëm. Kjo nuk ka fuqi ta

66) Po aty, 1936, nr. 12, f. 371.
67) Po aty, 1928, nr. 12, f. 717.

realizojë atë as edhe te besimtarët e vet, sepse interesat dhe kundërthëniet klasore janë thelbësore dhe nuk ka ideologji fetare që t'i zhdukë. Sidoqoftë, fetë si opium për popullin, në momente të caktuara, duke i vënë në gjumë masat me anë të predikimeve mashtruese, kanë pasur një farë suksesi në këtë drejtim. Por, në shkallë të fundit, interesat dhe lufta klasore kanë dalë më të forta se feja.

Ideologjia myslimane pretendonte t'i realizonte parimet e barazisë e të demokracisë jo me anë të dhunës, por me anë të moralit fetar. Me anë të këtij morali do të edukoheshin gjoja njerëzit me ndjenjat e dashurisë e të nderimit për njëri-tjetrin, do të kultivohej altruizmi dhe do të zhdukej urrejtja e përdorimi i dhunës. Të gjitha problemet do të zgjidheshin në këtë mënyrë, me dashuri e mirëkuptim. Ideologët myslimanë u drejtoheshin të pasurve që të tregoheshin altruistë, të kishin mëshirë për të varfrit «kreaturat e perëndisë», ndërsa të varfërve u thoshin se «pasuria fitohet me punë» e jo në mënyrë të paligjshme, prandaj ata nuk duhej të vinin dorë mbi pasuritë e pronat e të pasurve[68].

Pra, predikimi i altruizmit merrte një karakter fiktiv. Ky nuk ishte altruizëm, por një mashtrim, një apologji e pabarazisë dhe e shfrytëzimit.

Në besimin islamik, si në çdo besim tjetër, koncepti i drejtësisë juridike nuk ekzistonte. Me drejtësi kuptohej vetëm drejtësia hyjnore-morale. Por në marrëdhëniet reale njerëzore kjo lloj drejtësie ishte ireale dhe nuk kishte forcë. Sipas pikëpamjes fetare mbi drejtësinë vetëm zoti mund të ishte deri në fund i drejtë, ndërsa koncepti njerëzor i drejtësisë ishte i ngushtë dhe shumë larg përsosmërisë. Njeriu, duke qenë vetë prej natyre qenie e kufizuar, nuk mund ta përfshinte gjoja të gjithë drejtësinë. Por lindte pyetja: Si atëhere kjo qenie e kufizuar do të zbatonte drejtësinë hyjnore, aq më tepër kur atë as vetë zoti nuk e kishte zbatuar? Në qoftë se pranohej nga klerikët se zoti ishte përsosmëria e drejtësisë dhe i plotfuqishëm i kësaj bote, atëherë pse lejoi të sundojë në të pabarazia, shfrytëzimi, vuajtjet e mjerimet? Por të gjitha këtyre pyetjeve asnjë fe nuk ka qenë në gjendje t'u japë përgjigje. Në këtë çështje feja është ngatërruar së tepërmi dhe nuk ka mundur ta shpleksë lëmshin e kundërthënieve.

«Zani i Naltë» arriti deri aty sa të pohojë se feja myslimane është në gjendje të realizojë madje barazinë e vërtetë socialiste. Me këtë u thuhej besimtarëve: «Ç'kërkoni ju tek idetë revolucionare e komuniste? Socializmin e ka vetë faja islame dhe mund ta realizojë dhe në praktikë».

68) Po aty, 1936, nr. 12, f. 378-379.

Socializmi «islamik» ishte socializmi fiktiv e demagogjik i barazisë dhe i drejtësisë morale. Ai nuk i prekte aspak marrëdhëniet shoqërore ekzistuese dhe pronën private[69]. Pra, ishte krejt iluzor, i paqenë. Disa ideologë myslimanë pohuan se gjoja islamizmi i kishte përmbushur gjoja prej kohësh idealet socialiste, gati që në kohën e fiseve beduine, prandaj nuk kishte nevojë për ndonjë eksperiment të ri.

Ndonjëri nga këta ideologë reaksionarë si Bexhet Shapati që vinte shenjën e barazisë midis islamizmit e socializmit, më vonë në kohën e pushtimit fashist e krahasoi islamizmin me fashizmin e nacional-socializmin.

Për të argumentuar demokratizmin dhe përmbajtjen socialiste të fesë myslimane, ideologët e saj thoshin se «ajo kishte karakter antikapitalist»[70]. Dhe për këtë i referohej Kuranit në të cilin kishte një shprehje të tillë: «Mjerë ai që peshon gabim». Këtu është fjala për vënien e një farë rregulli në tregtinë primitive të fiseve beduine. Por kjo nuk kishte të bënte aspak me kapitalizmin dhe luftën kundër tij. Ç'hynte kapitalizmi në periudhën kur sapo kishin filluar të lindnin marrëdhëniet feudale? «Zani i Naltë», i cili kërkonte t'i jepte fesë myslimane karakter antikapitalist, po me anë të kësaj feje u mundua të përligjte edhe shfrytëzimin kapitalist. Pra, në arsyetime lindte një kontradiktë e thellë. Ideologët myslimanë në thelb e pranuan kapitalizmin dhe shfrytëzimin në përgjithësi. Ata thoshin se nxjerrja «e fitimit të arsyeshëm» si në industri e në tregti ishte gjë normale. Këtë nuk e konsideronin shfrytëzim. Këtu, sipas tyre, vepronte ligji universal i punës, në bazë të të cilit gjoja njeriu me anë të punës së vet i sillte dobi shoqërisë dhe fitonte dhe për vete[71].

Ishte i njëjti arsyetim si dhe ai i ideologëve katolikë. Kapitalizmi shqiptar hiqej si humanitar e bamirës, pa karakter shfrytëzues. Dhe kapitalistëve bamirës u bëhej thirrje që «të kishin mëshirë për fukarenë, të grumbullonin në vend disa miliona e të merrnin një iniciativë të gjerë, për t'i gjetur punë këtij populli dhe në mënyrë të arsyeshme të fitonin dhe për vete»[72].

Besimi islamik thuhej se siguronte të gjitha të drejtat politike. Ndërsa ideologjia katolike i mohonte hapur këto, ajo myslimane në mënyrë demagogjike e formale i pranonte. Por për përmbushjen praktike të tyre nuk jepte asnjë garanci. Në «Zani i Naltë» thuhej se në fenë islame,

69) Po aty, tetor-nëntor 1936, f. 314-315.
70) Po aty, mars-prill 1932, f. 192.
71) Po aty, janar-shkurt 1933, f. 536; 1936, nr. 2, f. 38-41.
72) Po aty, 1936, nr. 2, f. 38-41.

njerëzit që qeverisnin shtetin ishin njerëzit e drejtë, me ndërgjegje e moral të kulluar dhe me kulturë. Me këtë kërkohej të zbukurohej regjimi reaksionar zogist dhe të përligjej çdo diktaturë reaksionare.

Tezën mbi karakterin demokratik të fesë myslimane ideologët e «Zanit të Naltë» donin ta mbështesnin dhe në arsyetimin pabazë se në besimin islamik gjoja nuk kishte kler në kuptimin e vërtetë të fjalës, por kishte shërbyes të kultit që ishin njerëz të dalë nga gjiri i popullit dhe që shprehnin interesat e tij. Por kjo nuk i përgjigjej së vërtetës. Në myslimanizëm nuk kishte një hierarki klerikale të organizuar mirë si ajo e katolicizmit, por kleri dhe hierarkia klerikale nuk mungonin.

Ashtu si kleri katolik, edhe ai mysliman kishte detyrë kryesore të tij luftën kundër ideologjisë e lëvizjes revolucionare dhe nuk i kurseu shigjetat kundër tyre. Por kleri mysliman nuk qe aq aktiv sa keri katolik në këtë drejtim. Megjithatë, edhe ai i sulmoi idetë komuniste, i shpalli të papajtueshme me fenë e idealin «nacionalist» dhe të rrezikshme[73].

Ideologjia revolucionare luftohej si për faktin se nxiste luftën e klasave e pengonte bashkëpunimin klasor, ashtu dhe për faktin se krijonte rrezik për rendin ekzistues ekonomiko-shoqëror. Prirjet revolucionare thuhej se vinin në kundërshtim me Kuranin, sidomos lidhur me çështjen e pronës private. Kurani i këshillonte besimtarët që «të mos hanin pasurinë e njëri-tjetrit padrejtësisht», ndërsa ideologjia revolucionare vepronte në kundërshtim me këtë dhe kishte si parim themelor «eksproprimin e pronës private»[74].

Klerikët myslimanë, sikurse dhe ata katolikë, u përpoqën ta paraqitnin ideologjinë komuniste në sy të besimtarëve si diçka të përbindshme, shkatërrimtare dhe antihumanitare. Ata përdorën kundër komunistëve dhe elementëve përparimtarë epitete denigruese[75]. Besimtarët u paralajmëruan në mënyrë kërcënuese që të qëndronin sa më larg ideve komuniste dhe të mos merrnin pjesë në lëvizjen revolucionare. Në një thirrje që komuniteti mysliman u drejtonte myslimanëve shqiptarë thuhej: «Ju myslimanë shqiptarë, edhe sikur të tjerët të kërkojnë komunizëm, luftoni me gjithë zemër dhe me shumë rreptësi (komunizmin — V.K.), përndryshe keni me kenë tradhtarë ndaj atdheut dhe kombit tuaj të dashtun»[76].

Në kohën kur masat revolucionare shpërthyen në ma-

73) Po aty, janar-shkurt 1938, f. 58.
74) Po aty, 1938, nr. 8, f. 231-232.
75) Po aty, maj 1936, f. 142-149; qershor-korrik, f. 169.
76) Po aty, tetor-nëntor 1936, f. 331.

nifestime e demonstrata politike kundër dhunës dhe arbitraritetit të regjimit policor zogist dhe shfrytëzimit të egër çifligaro-borgjez, kundër politikës antipopullore e antikombëtare të klasave sunduese, klerikët myslimanë i dënuan këto veprime si akte të paligjshme nga pikëpamja e moralit fetar dhe në përshtatje me gjendjen e krijuar, formuluan një farë «kodi moral» e disa rregulla që kërkonin t'i ndalnin besimtarët të merrnin pjesë në lëvizjen revolucionare. Një nga këto rregulla ishte formuluar si vijon:

«Mos merr kurrë pjesë në demonstrata e manifestime që mund të bëjnë shokët e pasjellshëm kundër rregullit e disiplinës në shkollë, ose kundër qetësisë publike, jashtë shkollës. Një vepër e tillë bëhet shkak që të merresh nëpër gojë të popullit si i lehtë nga mendja»[77].

Këto thirrje bëheshin në një kohë kur lëvizja komuniste dhe lufta për demokracinë e kundër rrezikut fashist po zgjeroheshin në Shqipëri. Në këtë luftë po hidheshin gjithnjë e më shumë masat popullore pa dallim feje. Masat myslimane, sidomos të rinjtë që ëndërronin për një jetë më të mirë, nuk vepruan sipas kodit të fesë, por u hodhën dalngadalë në radhët e lëvizjes revolucionare dhe luftuan për përmbushjen e kërkesave demokratike.

Kleri mysliman mbajti një qëndrim antidemokratik dhe ultrareaksionar edhe në çështjen e emancipimit të gruas. Ai ishte kundërshtar i rreptë i lëvizjes për emancipimin e saj.

Klerikët myslimanë, konservatorë deri në palcë dhe armiq të betuar të përparimit, nuk donin as të dëgjonin për këtë çështje. Gruaja, sipas besimit mysliman, ishte një qenie tepër inferiore, negative, e padenjë për të gëzuar të drejta të barabarta me burrin. Ajo ishte një skllave e vërtetë, një send që burri mund ta përdorte si të donte. Besimi mysliman, ashtu si dhe besimet e tjera për shekuj me radhë kishin mbajtur qëndrim përbuzës ndaj saj, e kishin trajtuar në mënyrë çnjerëzore. Ai te gruaja e skllavëruar e pa të drejta, te familja patriarkale, te qëndrimi konservator ndaj saj, shihte një bazë të fuqishme të ndikimit të vet. Kleri mysliman nuk i duronte as idetë e vagëlluara borgjeze të emancipimit të gruas që ishin për një emancipim tepër të kufizuar, e aq më tepër idetë revolucionare. Ai u vërsul me tërbim kundër kërkesave të ligjshme të elementëve përparimtarë e revolucionarë për emancipimin e gruas[78].

«Zani i Naltë» zhvilloi një polemikë të ashpër me revistën demokratike «Bota e re» për problemin e gruas. Në këtë polemikë kërkohej të përligjej pozita inferiore e gruas, gjendja e saj e rëndë ekonomike, shoqërore e politike. Prirjet për emancipimin e gruas shqiptare cilësoheshin si shfaqje «imoraliteti» që synonin të «shkatërronin bazat e shtetit»[79].

«Bota e re» i demaskoi ashpër pikëpamjet reaksionare të «Zanit të Naltë» që binin erë mesjetë dhe që kishin karakter antihumanitar.

Ideologjia myslimane shqiptare, ashtu sikurse edhe ideologjia katolike, u kundërshtuan nga opinioni publik përparimtar, sidomos nga komunistët.

Ideologjia e klerit në përgjithësi në vitet 30 ndeshi në kundërshtimin e ideologjisë demokratike e komuniste, si dhe të pikëpamjeve ateiste, të cilat u zhvilluan më tej në Shqipëri mbi bazën e traditave ateiste të së kaluarës.

Pikëpamjet politike-shoqërore të klerit reaksionar në vitet 30 dështmonin për faktin që klerikët reaksionarë të Shqipërisë, ishin nga shtyllat më të forta të rendit çifligaro-borgjez dhe të reaksionit. Ideologjia klerikale ishte një nga degëzimet më të rëndësishme e më të fuqishme të ideologjisë reaksionare. Ajo, sidomos ideologjia katolike, kishte karakter antipopullor e antikombëtar.

77) Po aty, prill 1938, f. 111.
78) Po aty, tetor-nëntor 1936, f. 237.
79) Po aty, maj 1936, f. 145.

KREU V

PIKËPAMJET POLITIKE-SHOQËRORE TË KOMITETIT TË ÇLIRIMIT NACIONAL

Në studimin tonë, në trajtimin e ideve revolucionare të vendit kemi përfshirë, në radhë të parë, idetë e emigracionit revolucionar shqiptar, të cilat nga pikëpamja kohore u shfaqën të parat. Një rrymë e rëndësishme dhe përfaqësuese e këtij emigracioni është ajo e Komitetit Nacional Revolucionar (KONARE) ose e Komitetit të Çlirimit Nacional, siç u quajt më pas.

Emigracioni revolucionar shqiptar në këtë periudhë dha një ndihmesë me rëndësi në luftën kundër regjimit antipopullor zogist dhe imperializmit fashist. Ai kontribuoi si me anë të veprimtarisë politike, ashtu edhe me anë të ndriçimit të shqiptarëve, sidomos në mërgim, me idetë e revolucionit popullor dhe ato antifashiste. Një meritë e shquar në këtë drejtim u përket komunistëve shqiptarë të mërguar, të cilët zhvilluan veprimtari revolucionare në vende të ndryshme të Evropës, si në Bashkimin Sovjetik, në Austri, në Zvicër, në Francë, në Gjermani e gjetkë. Një bërthamë komuniste ekzistonte edhe në vetë organizatën demokratike të Komitetit të Çlirimit Nacional.

Përpara se të japim idetë e kësaj organizate, e shohim

të nevojshme të themi dy fjalë si u krijua kjo organizatë dhe çfarë synimesh kishte ajo.

Pas dështimit të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Qershorit të 1924 dhe të vendosjes së diktaturës reaksionare zogiste në Shqipëri, me ndihmën e imperializmit dhe të shteteve fqinje-shoviniste, sidomos të Jugosllavisë, shumë revolucionarë dhe elementë të tjerë antizogistë emigruan jashtë vendit. Emigrantët revolucionarë e patriotë u drejtuan në një sërë vendesh, si: në Itali, në Austri, në Bashkimin Sovjetik e gjetkë.

Një pjesë e mirë e tyre me Fan S. Nolin në krye, u grumbulluan në Vjenë të Austrisë. Një pjesë tjetër nga radhët e organizatës «Bashkimi» që luajti një rol me rëndësi gjatë Revolucionit, ku bënin pjesë Ali Kelmendi, Selim Shpuza e të tjerë, shkuan në Bashkimin Sovjetik për t'u edukuar me idetë marksiste-leniniste dhe për t'u përgatitur si kuadro të ardhshëm të lëvizjes komuniste shqiptare. Atje krijuan më vonë dhe një nga celulat komuniste shqiptare në mërgim.

Pjesa kryesore e emigracionit revolucionar e grumbulluar në Vjenë, në mars të vitit 1925, me nismën e Fan S. Nolit dhe demokratëve të tjerë patriotë, themeluan organizatën demokratike antizogiste e antifashiste Komiteti Nacional Revolucionar (KONARE). Në të u grumbullua në fillim edhe një pjesë e elementëve antizogistë të moderuar borgjezë, të cilët më vonë, duke mos u pajtuar me platformën revolucionare të saj, e braktisën dhe krijuan një organizatë më vete.

Në krye të organizatës ishin patriotë revolucionarë të shquar, si: Fan S. Noli, Riza Cerova, Halim Xhelo, Omer Nishani, Lano Borshi e të tjerë.

Domosdoshmërinë e krijimit të një organizate të tillë, për të vazhduar luftën për demokracinë dhe për të përmbushur ato synime e objektiva që nuk i përmbushi dot Revolucioni i Qershorit, e shprehu Fan S. Noli në emër të të gjithë revolucionarëve sa vuri këmbët në Vjenë, në një letër që i drejtonte bashkëpunëtorit të tij të ngushtë e patriotit të shquar demokrat, Luigj Gurakuqi, në Itali. Në atë letër theksohej se ishte e nevojshme të nënshkruhej nga revolucionarë një «deklaratë luftëvazhdonjëse» dhe t'i shpallej menjëherë luftë regjimit satrap të Ahmet Zogut për ta shpëtuar popullin e Shqipërisë nga tirania e tij dhe për të rivendosur demokracinë[1].

1) P. Tako. *Fan Noli në fushën politike dhe publicistike*, Tiranë, 1975, f. 156.

Edhe themelimi i KONARE-së ishte konkretizimi i menjëhershëm i kësaj ideje.

KONARE-ja vazhdoi më tej traditat më të mira përparimtare të organizatës demokratike «Bashkimi» dhe të lëvizjes demokratike shqiptare. Ajo u orientua që në fillim nga lëvizjet dhe idetë më të përparuara të Evropës. Nëpërmjet udhëheqësit të saj Fan S. Nolit dhe elementëve të tjerë revolucionarë mori kontakte e bashkëpunoi menjëherë me Internacionalen Komuniste dhe ushqeu simpati për Bashkimin Sovjetik, shtetin e parë të punëtorëve në botë. Organizata kishte lidhje me personalitete revolucionare në zë, si Gjergj Dimitrovi e të tjerë. Idetë e lëvizjet revolucionare të Evropës, ushtruan ndikimin e vet pozitiv. Por faktori kryesor që përcaktoi drejtimin e ideve të saj ishte zhvillimi me sukses i luftës klasore revolucionare në Shqipëri dhe grumbullimi i përvojës revolucionare në luftë e sipër.

Në korrik të vitit 1925, KONARE-ja filloi të botojë në Gjenevë të Zvicrës, organin e saj luftarak, gazetën revolucionare «Liria Kombëtare» që gjatë një dhjetëvjeçari shërbeu si tribunë e shquar dhe propaganduese e flaktë e ideve antizogiste dhe antiimperialiste. Më 5 maj të vitit 1925, organizata botoi programin e saj të parë me anë të një shpalljeje që i drejtonte popullit shqiptar, e cila përmbante këto pika:

1) Përmbysja e regjimit të A. Zogut dhe e bashkëpunëtorëve të tjerë çifligarë që ishin vënë në shërbim të imperializmit;

2) vendosja e një regjimi demokratik republikan;

3) zbatimi i reformës agrare rrënjësore në interes të fshatarësisë punonjëse;

4) rivendikimi i kufijve etnikë të Shqipërisë[2].

Ky program ishte në vija të përgjithshme po ai program demokratik që, për rrethanat që dihen, nuk mundi të vihej në jetë gjatë Revolucionit Demokratiko-Borgjez të vitit 1924 dhe që më vonë u përsos e u pasurua më tej, sidomos nën ndikimin e drejtpërdrejtë të komunistëve të organizatës e të lëvizjes komuniste shqiptare në përgjithësi.

Dalja e «Lirisë Kombëtare» krijoi mundësi që pikëpamjet politike-shoqërore e demokratike të shtjelloheshin gjerësisht e të propagandoheshin në shqiptarët.

Prej kësaj kohe KONARE-ja kishte tribunën e saj, një organ të fuqishëm për përpunimin dhe propagandimin e mendimit të vet revolucionar.

Vetë emri i gazetës, si dhe programi i shpallur, tre-

2) *Historia e Shqipërisë*, vëll. 3, Tiranë 1984, f. 340.

gonin se kujdesi kryesor i organizatës ishte lufta kundër armiqve të lirisë dhe pavarësisë kombëtare të popullit shqiptar, kundër regjimit antipopullor e antikombëtar të A. Zogut dhe imperializmit. Kjo detyrë u vu në dukje që në numrin e parë të gazetës, ku pohohej se qëllimi i saj ishte të shërbente si «një tribunë e lartë dhe e vërtetë për mbrojtjen e të drejtave të popullit shqiptar», «të mbante të gjallë përpara syve të popullit të mjerë faktin e hidhur të shkeljes së tij prej fuqive të huaja, të zhdukjes absolute të lirisë së tij dhe shitjes së pasurive arbërore»[3].

Në përpunimin e platformës revolucionare, dha ndihmesë jo vetëm organi i mësipërm, por edhe botimi herë pas here i shpalljeve të ndryshme, protestave drejtuar Fuqive të Mëdha dhe Lidhjes së Kombeve, si dhe i dy broshurave programatike me përmbajtje të ngjeshur e koncize mbi gjendjen ekonomike-shoqërore e politike të Shqipërisë dhe detyrat revolucionare për përmbysjen e regjimit çifligaro-borgjez e të ndërhyrjes imperialiste dhe shndërrimin demokratik të vendit. Këto broshura, të cilat u botuan në Gjenevë të Zvicrës në vitet 1934-1935 ishin: a) «Nga triumfi i «legalitetit» në revolucionin popullor» (broshura nr. 1); b) «Mbi shpëtimin e fshatarësisë» (broshura nr. 2).

KONARE-ja, në fillim, siç thamë, kishte një përbërje heterogjene dhe kjo ndikoi në idetë e saj. Në të morën pjesë edhe bashkudhëtarë të përkohshëm, elemente borgjezë që nuk pajtoheshin me qëllimet e saj. Pas pak ata u shkëputën nga organizata dhe u bashkuan me organizatën reaksionare në mërgim, «Bashkimi Kombëtar». Kjo shkëputje ndihmoi në revolucionarizimin e KONARE-së, i cili ishte një proces që erdhi gjithnjë duke u thelluar.

Në vitin 1927 organizata botoi një deklaratë të hartuar me dorën e kryetarit të saj, Fan S. Noli, në të cilën analizohej gjendja e ndërlikuar dhe e rëndë e Shqipërisë dhe bëhej thirrje për përmbysjen e zgjedhës bejlere-imperialiste dhe ardhjen e masave në fuqi. Platforma dhe idetë e përvijuara në Deklaratë shënonin një moment me rëndësi për radikalizmin e organizatës. Që prej kësaj kohe KONARE-ja filloi të quhej Komiteti i Çlirimit Nacional (KÇN).

Gjatë një dhjetëvjetori jete dhe veprimtarie (1925-1936), KÇN shtjelloi mjaft ide interesante dhe bëri analiza të arritura e të pjekura për kohën, të gjendjes së Shqipërisë e të detyrave të lëvizjes demokratike.

Analizat e tij i kalonin caqet e propagandës së zakonshme. Kjo vinte edhe nga fakti që në krye të Komitetit ishin

3) «Liria Kombëtare», 29 korrik 1925, f. 1.

mendimtarë e ideologë të shquar, si dhe pena të njohura, si: Fan S. Noli, Halim Xhelo, Riza Cerova e të tjerë.

KÇN i dha mjaft rëndësi përpunimit të mendimit teorik, të ideologjisë dhe propagandës revolucionare. Ideologjia u konsiderua me të drejtë prej tij si faktor shumë i rëndësishëm për organizimin dhe drejtimin e lëvizjes revolucionare të popullit shqiptar. Mungesa e një ideologjie të tillë mbahej nga komunistët e KÇN, si një nga arsyet kryesore të moskurorëzimit me sukses të plotë të lëvizjeve popullore në të kaluarën. Kjo mangësi duhej të kapërcehej në të ardhmen. Prandaj ishte e domosdoshme, siç pohonin komunistët, të krijohej në Shqipëri Partia Komuniste, e cila do ta ndriçonte popullin me idetë revolucionare dhe do ta organizonte e drejtonte në luftën e tij për përmbushjen e aspiratave demokratike.

KÇN, duke vlerësuar drejt anën teorike, nuk arriti t'i kushtojë po aq rëndësi edhe veprimtarisë praktike revolucionare. Në këtë drejtim ai nuk u tregua i aftë dhe u kufizua kryesisht me propagandën. Këtu ishte për të thembra e Akilit. Mirëpo revolucionarët e vërtetë nuk janë vetëm propagandistë, por edhe veprimtarë të palodhur e të zotë. Organizata të vërteta revolucionare janë ato që i bashkojnë mirë si ideologjinë, ashtu dhe organizimin. Këtë mund ta bënte si duhej vetëm Partia Komuniste. KÇN edhe propagandën e zhvilloi në një mjedis të kufizuar, kryesisht në shqiptarët e mërgimit. Masa e madhe e popullit shqiptar dhe rrethet demokratike e përparimtare mbetën jashtë sferës së kësaj propagande. «Liria Kombëtare» dhe materialet e KÇN nuk u përhapën gjerësisht. Ato ranë në duar të disa elementëve të pakët. Në KÇN pati dhe elementë militantë komunistë që bashkuan mendimin me veprimin revolucionar si Halim Xheloja e Riza Cerova.

Me gjithë boshllëqet e të metat, ndihmesa e KÇN për përpunimin e problemeve ideologjike të lëvizjes demokratike dhe demaskimin e regjimit zogist, imperializmit dhe shovinizmit, ishte e rëndësishme. Ajo përbën një trashëgimi të çmuar në thesarin e ideologjisë revolucionare dhe të kulturës përparimtare shqiptare.

Demokratët revolucionarë, dhe sidomos komunistët, u përpoqën të bëjnë analizën klasore të dukurive ekonomike, shoqërore e politike, e panë historinë bashkëkohore dhe atë të kaluar, nën prizmin e luftës së klasave, të interesave të masave popullore dhe të revolucionit demokratik.

Ata i demaskuan klasat reaksionare të Shqipërisë dhe imperializmin e shovinizmin jo thjesht me mjetet e propagandës, por me anë të një analize të shëndoshë e objektive për kohën.

Një premisë e rëndësishme për kuptimin e drejtë të gjen-

djes së Shqipërisë dhe të detyrave revolucionare të periudhës, ishte vlerësimi i përvojës së Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Qershorit të 1924-s dhe nxjerrja e mësimeve prej tij.

I. MËSIMET E REVOLUCIONIT TË QERSHORIT 1924

Çdo lëvizje revolucionare që i vë detyrë vetes të ecë përpara, nuk mund të mos kthejë shikimin nga e kaluara dhe të mos studiojë përvojën e saj. Këtë bënë edhe revolucionarët e KÇN që ishin lidhur me këtë të kaluar me fije të gjalla dhe ishin përzhitur në flakët e Revolucionit nga i cili dolën. Revolucioni i Qershorit ishte për ta një shkollë e rëndësishme. Ai u mësoi atyre deri-diku sesi duhej të veprohej në të ardhmen që të mos përsëriteshin gabimet e tij dhe që populli të siguronte fitoren e vërtetë. Sigurisht nxjerrja e mësimeve nga Revolucioni u bë me një reflektim të thellë nga ana e revolucionarëve, nën ndikimin e evolucionit të ideve e situatave.

Disfatat e lëvizjeve revolucionare dhe revolucioneve janë gjithnjë instruktive në histori, sepse ato të mësojnë për atë që duhet bërë dhe atë që nuk duhet bërë. Ato janë pjesë e spirales së progresit. Dështimi i një lëvizjeje për revolucionarët nuk është humbja e gjithçkaje, por një hap prapa për të bërë hapa më të mëdhenj e më të sigurt përpara, në mënyrë që të arrihen objektivat e caktuar.

Militantët e KÇN-së që në ditët e para të veprimtarisë në mërgim reflektuan seriozisht për këtë problem dhe ky reflektim zgjati me vite.

Nxjerrja e mësimeve nga Revolucioni i 1924-ës duhej jo vetëm për ta çuar më tej luftën popullore, por edhe për të demaskuar propagandën reaksionare zogiste që kërkonte të hidhte baltë mbi këtë revolucion, duke e paraqitur si diçka regresive e si një aventurë që nuk kishte gjoja asnjë bazë reale. Apologjetët zogistë e paraqitën Revolucionin si diçka të paligjshme e arbitrare, ndërsa kundërrevolucionin si shfaqje «të legalitetit» të rivendosjes gjoja të pushtetit të ligjshëm të klasave çifligare-borgjeze.

Ideologët e KÇN-së i kundërvunë kësaj pikëpamjeje idenë se revolucioni, edhe pse dështoi, ishte një nga shfaqjet më përparimtare e më pozitive të historisë sonë dhe detyrat që ai nuk mundi t'i plotësojë ishin në rendin e ditës në Shqipëri.

Dështimi i tij, sipas tyre, nuk dështmonte për faktin se ishte një aventurë e kotë, por për mungesën e një sërë faktorëve kryesisht subjektivë, të cilët kur të plotësoheshin, do

të bënin të mundur kryerjen e detyrave kryesore demokratike-borgjeze që nuk u përmbushën prej tij.

Një sërë personalitetesh revolucionarë, si: Fan S.Noli, Halim Xhelo, Riza Cerova, Omer Nishani etj., dhanë mendime të vlefshme për Revolucionin. Nga të parët që u mor me këtë ngjarje dhe që i pa ato me syrin kritik e autokritik njëherazi ishte Fan S.Noli, kryetari i së parës qeveri demokratike të Shqipërisë që doli nga Revolucioni.

Duhet thënë se Noli në këtë periudhë ishte një demokrat revolucionar që evoluoi nga pozitat e përparshme. Pas Revolucionit, ai përvetësoi disa ide më të përparuara për të cilat do të flasim më poshtë dhe problemet e situatat e Shqipërisë i pa ndryshe. Megjithatë, ai nuk u çlirua krejt nga idealizmi i tij dhe nuk i kapërceu caqet e demokratit revolucionar edhe kur arriti kulmin e ideve përparimtare (1930-1932).

Në këto vite ai si njeri me përvojë politike, i mprehtë dhe me kulturë, i kuptoi gradualisht «lajthitjet» kryesore të Revolucionit, hyri më në thellësi të ngjarjeve dhe nxori përfundimet e duhura.

Revolucioni i Qershorit në fillim u konsiderua prej tij si një fitore e «nacionalëve» (nacionalistëve demokratë) mbi «antinacionalët» (çifligarët e reaksionarët e tjerë -V.K.).

«Nacionalët» përfaqësonin demokracinë dhe interesat kombëtare, «antinacionalët» feudalizmin dhe shkeljen e lirisë e të pavarësisë. Pra, revolucioni kuptohej si fitore e intelektualëve demokratë borgjezë që konsideroheshin forca kryesore e tij. Masat popullore konsideroheshin si forcë e dorës së dytë e jo forcë themelore lëvizëse.

Noli e pati të vështirë të depërtonte menjëherë në arsyet e vërteta ekonomike-shoqërore dhe të dallonte faktorët vendimtarë e forcat lëvizëse të revolucionit. Ai ia veshi meritën kryesore «nacionalistëve» këtyre sizifëve modernë» të «ferrit shqiptar» (shoqërisë çifligare-borgjeze shqiptare — V.K.) që herë pas here kishin bërë gjoja mrekullira dhe e kishin shpëtuar Shqipërinë nga rreziqet e brendshme dhe të jashtme[4].

Në këtë shpjegim ai nuk çlirohej ende nga pikëpamja idealiste e kultit të heronjve dhe të elitës.

Noli mori në mbrojtje qeverinë demokratike-borgjeze që u bë objekt i sulmeve të reaksionit. Ai nënvizoi veprën e rëndësishme të saj për përparimin e Shqipërisë dhe përmirësimin e gjendjes së popullit.

«Qeveria e qershorit 1924, — theksoi ai, — nuk qe ide-

4) F.S. Noli, *Rron or rron dhe nuk vdes shqiptari,* (botuar nga P. Tako), Tiranë, 1976, f. 196-201.

ale, e vërtet. Mungesat e saj nuk mund t'i dijë askush më mirë se i nënshkruari që ka parë makinën e saj të punojë për së afërmi. Po, pasi t'i ngarkojmë mbi kurriz kritika, duhet t'i numërojmë në favor të saj ca të mira për faqe të bardhë...»[5].

Noli numëroi ato më të rëndësishmet, të cilat ia kundërvuri anëve negative të regjimit reaksionar zogist. Qeveria e Qershorit konsiderohej si një qeveri patriotike e demokratike që erdhi në fuqi, «me dëshirën e popullit dhe pa asnjë ndihmë të jashtme», që nuk sakrifikoi interesat kombëtare siç bëri qeveria zogiste, por i mbrojti ato. Ajo mori një sërë masash për përmirësimin e gjendjes ekonomike të vendit, vendosi rregullin e qetësinë, mbrojti të drejtat qytetare dhe liritë demokratike të popullit. Ndryshe nga qeveria demokratike, qeveria zogiste, pohonte ai, përbëhej prej tradhtarësh që erdhën në fuqi me ndihmën imperialiste dhe të Pashiqit, të cilit ia shpërbleu këto ndihma duke i dhënë copa toke nga të Shqipërisë. Kjo ishte qeveri e «kusarëve» që rropën dhe grabitën popullin, e «kriminelëve» dhe «tiranëve» që e shtypën dhe e morën nëpër këmbë. Ajo i vuri kazmën demokracisë dhe e terrorizoi popullin me anë të mercenarëve e bashibozukëve[6].

Këto shpjegime u dhanë në një letër të hapur ku polemizohej me gazetën reaksionare «Dielli» të Faik Konicës që mbronte regjimin. Letra u botua në gazetën «Imigranti» të Amerikës dhe në organe të tjera.

Disa vjet më vonë (më 1928) kur mendimi u poq, demokrati revolucionar shpjegoi edhe arsyet kryesore e gabimet «fatale» të «nacionalistëve» që shpunë në dështimin e Revolucionit.

Ndër to, dy ishin më kryesorët: «me tradhtarët e brendshëm, me klasën e bejlerëve, kemi mbajtur një politikë oportuniste në vend që t'i luftonim me sistem, pa mëshirë e pa pushim. Klasën e katundarëve s'jemi përpjekur aspak ta organizonim e ta kishim si bazë. Ndofta do të ishim mundur edhe pa këto lajthime, po me këto lajthime kemi vrarë vetveten»[7]. Kjo ishte një e vërtetë dhe autokritikë me rëndësi jo vetëm e Nolit, por e gjithë lëvizjes demokratike. Aty argumentohej se «nacionalistët» e njihnin mirë klasën e bejlerëve që luftonte për «privilegjet feudale» dhe që donte t'i bënte varrin Shqipërisë, e njihnin forcën e saj të organizuar, por nuk mundën t'i kundërvinin asaj «një grup kompakt dhe homogjen në bazën e një klase, një grup nacionalist dhe antifeudal, me fjalë të tjera një parti katundare», por luftuan kundër bejlerëve me një grup heterogjen e të paorganizuar[8].

Noli shprehte habinë sesi «tabori i prishur i nacionalistëve

5) *Po aty*, f. 204.
6) *Po aty*, f. 204-206.
7) «Liria Kombëtare», 28 nëntor 1928, f. 1.
8) Po aty.

i kishte shtypur disa herë bejlerët e organizuar» dhe mendonte se «këto çudira shpjegoheshin prej faktit që bejlerët s'i ka dashur populli dhe jo prej zotësisë së nacionalistëve»[9].

Të gjitha këto arsye ishin të drejta, por këtu nuk shpjegoheshin arsyet më të thella ekonomike, shoqërore e klasore, si dhe ato arsye objektive që e bënin klasën borgjeze, nga e cila dolën nacionalistët, të dobët, të pavendosur për veprime të vërteta revolucionare e të prirur për kompromis me reaksionin. Këtu e kishte burimin edhe ajo mungesë e aftësisë për organizim dhe inkosenkuencë e politikës dhe veprimtarisë së qeverisë. Por në këto gjëra Noli nuk mundi të hynte thellë, sepse mbeturinat e botëkuptimit idealist përbënin një pengesë. Pasiviteti i qeverisë dhe moszbatimi i reformave prej saj nuk ishin çështje që lidheshin me mungesën e vullnetit, por me faktorët ekonomikë, shoqërorë e politikë klasorë.

Më pas Noli shpjegoi edhe arsyen tjetër më me peshë të këtij dështimi, atë që qeveria nuk e «shkuli klasën e bejlerëve nga rrënjët», nuk zbatoi «reformën agrare për të qenë» dhe nuk i kënaqi aspiratat e fshatarësisë. Po të kishte vepruar drejt «katundarët do të kishin luftuar kundër Ahmet bej Zogollit dhe bejlerëve fare ndryshe dhe mund të kishin evituar katastrofën, ose të paktën do të ishin ritiruar më bukur nga fusha e betejës...»[10].

Këtë deklaratë të rëndësishme, ai e bëri pas një pohimi të dy muajve më parë, në të cilin shpreheshin justifikime për moszbatimin e reformës agrare dhe ku arsyeja themelore e këtij moszbatimi i atribuohej papërgatitjes e mosinteresimit të pjesës kryesore të fshatarësisë, si dhe pavendosmërisë e frikës së pjesës së vogël të interesuar[11]. Natyrisht, edhe këtu qeveria nuk lihej pa përgjegjësi dhe thuhej se në një qeveri ku mbizotëronte mendimi kundër reformës, vështirë që të përmbushej ajo. Por reforma nuk u vu në jetë gjoja për shkak të «regjionalizmit», për reformën agrare ishin të interesuar, sipas Nolit, vetëm bujqit e çifligjeve që nuk kishin tokë të tyren, ndërsa «Shqipëria katundare e malësore», nuk e shtronte këtë problem. Por, edhe bujqit të terrorizuar nga bejlerët, pohonte ai, nuk donin t'ia hynin kësaj pune dhe i paskëshin thënë atij kur ishte kryetar qeverie «aman mos na vini në bela»[12]. Kjo dëshmonte për mosnjohjen ose mosekzistencën e bindjeve të shëndosha tek ai për luftën revolucionare që bëri fshatarësia në të kaluarën për tokën, për zgjidhjen e problemit agrar. Po të mos ishte kjo luftë e fshatarësisë, asnjë grup

9) Po aty.
10) Po aty, 2 maj 1929, f. 2.
11) Po aty, 1 mars 1929, f. 3.
12) Po aty.

përparimtar nuk mund ta shtronte për zgjidhje këtë çështje.

Dëshmi për këtë ishte, veç të tjerave, ajo lëvizje e fuqishme e Shqipërisë së Mesme, e cila e shtroi në mënyrë të qartë çështjen shoqërore, sidomos çështjen e tokës.

Dalngadalë Noli filloi ta kuptonte se pa fshatarësinë dhe masat popullore në përgjithësi, asgjë serioze nuk mund të bëhej në Shqipëri. Dhe lajthimet mund të ndreqeshin vetëm kur të organizohej populli, siç thoshte ai, të pajisej me ideologji dhe të hidhej në luftë kundër bejlerëve.

Mësime akoma më të pjekura nxorën nga përvoja e Revolucionit të Qershorit, revolucionarët komunistë, si Halim Xheloja, Riza Cerova e të tjerë.

Ata, me anë të një analize më të thellë, e shpjeguan këtë ngjarje në radhë të parë me faktorët objektivë dhe kushtet ekonomike-shoqërore të vendit.

Kështu, Halim Xheloja, duke analizuar më hollësisht shkaqet dhe pasojat e kryengritjes së 1924-s, në disa artikuj të tij të botuar te «Liria Kombëtare», ku polemizonte me elementët reaksionarë, kishte mendimin se «Kryengritja e Qershorit 1924, s'qe e shkaktuar prej ambicjeve t'atij ose këtij personi. Ajo qe rezultat i një evolucioni»[13] të shoqërisë shqiptare pas pavarësisë dhe forcimit të luftës së klasave. Pasi u plotësuan në përgjithësi kushtet objektive dhe u «mbush» «kazani» i kësaj lufte dhe i urrejtjes popullore, shpërtheu kryengritja e qershorit.

«Revolucioni i Qershorit do të bëhej medoemos», sepse, sipas tij, plagët e shoqërisë «feudale» ishin mahisur së tepërmi dhe kundërthëniet shoqërore ishin forcuar. Ai e krahasonte rendin reaksionar çifligaro-borgjez me një trup të sëmurë. Shoqëria shqiptare kishte nevojë të çlirohej nga prangat e «feudalizmit» e të ecte përpara.

Kjo domosdoshmëri vuri në lëvizje, sipas Halimit, fshatarësinë shqiptare dhe e hodhi në luftë. Kuptimi i saj hodhi në veprim edhe pjesën më të përparuar të intelektualëve shqiptarë, sidomos krahun më revolucionar të saj ku bënin pjesë dhe ai me shokë[14].

Sipas Halim Xhelos, në vitin 1924, fitoi vetëm lëvizja revolucionare, por jo qëllimi i saj[15]. Ajo nuk i përmbushi aspiratat e popullit për demokracinë dhe këtu qëndronte dhe arsyeja kryesore e dështimit. Programi demokratik i qeverisë së Nolit nuk u vu në jetë për shkak të pavendosmërisë së saj që nuk ishte thjesht pavendosmëri personash, por e klasës së dobët borgjeze, e cila nuk ishte në gjendje ta çonte

13) Po aty, 1 qershor 1928, f. 1.
14) Po aty.
15) Po aty, 1 korrik 1929.

Revolucionin deri në fund dhe ishte e prirur për kompromis me reaksionin.

Nga Revolucioni i Qershorit Halimi e revolucionarët e tjerë nxorën këto mësime me rëndësi:

a) Revolucioni i ardhshëm duhej të ishte më i thellë e të mos ndalej në gjysmën e rrugës si ai i 1924-s, por të plotësonte një për një kërkesat e popullit;

b) udhëheqja e revolucionit demokratik nuk duhej t'i besohej më borgjezisë, e cila po pushonte së qeni përparimtare, por klasës punëtore dhe partisë së saj revolucionare që do të krijohej, të cilat ishin në gjendje ta shpinin revolucionin deri në fund;

c) pas fitores së revolucionit demokratik (popullor) duhej të vendosej regjimi i punëtorëve e fshatarëve dhe jo një regjim borgjez si ai i qershorit të 1924-s, i cili kishte falimentuar qysh atëherë[16].

Te «Liria Kombëtare» Halimi theksonte se nuk ishte tashmë interesi i popullit shqiptar të rivendosej regjimi borgjez në Shqipëri si ai i qershorit të 1924-s, por ishte e domosdoshme të vinin masat në fuqi. Pra populli duhej të përgatitej për një revolucion popullor dhe jo për një revolucion demokratiko-borgjez të zakonshëm[17].

Për Halimin rëndësia e revolucionit qëndronte dhe në faktin që ai e forcoi më tej luftën klasore dhe tashti ishte e nevojshme që kjo luftë për demokracinë të ngrihej në një shkallë më të lartë.

Në artikullin «Revolucioni nacional i 1920 dhe revolucioni social i 1924», të cilin ai e shkroi në Bruksel, i bënte thirrje popullit: «Ruani fort zjarrin dhe besimin që kishit në zemrat tuaja në vitet 1920 e 1924. Revolucioni i juaj i tretë që do të bëni tok me shokë të Shqipërisë e të Ballkanit, s'do të jetë sa për të hedhur kapitalistët italianë në det, por edhe për të çrrënjosur e për të shkulur nga fundi rrënjët dhe bimët e bejlerëve me agallarë»[18].

Një interpretim interesant që tërheq vëmendjen i bëri revolucionit, komunisti Riza Cerova. Gabimi i parë, sipas tij, ishte që «kryengritja nuk u bë në kohën e saj»[19]. Me këtë formulim lë të kuptohet se disa prej kushteve e faktorëve socialë të Revolucionit konsideroheshin të papjekur. Por, duke gjykuar nga një artikull tjetër i Rizait i botuar më parë te «Liria Kombëtare» ku flitet për këtë problem dhe ku thuhet shprehimisht se plaga e «feudalizmit» ishte mjaft e mahisur[20],

16) Po aty, 28 nëntor 1928.
17) Po aty,
18) Po aty, 1 korrik 1929.
19) Po aty, 1 mars 1928, f. 4.
20) Po aty, 1 gusht 1927, f. 2.

duhet të mendohet se ai më të papjekur konsideron faktorët subjektivë. Gabim tjetër me rëndësi konsiderohej mosmbajtja e premtimit nga ana e udhëheqjes demokratike[21].

Momenti kërkonte vendosmëri e masa rrënjësore kundër klasave reaksionare, populli kërkonte vepra konkrete e jo fjalë. Qeveria nuk duhej «të rrinte duarlidhur në Tiranë», po duhej t'i jepte bujkut «tokën e grabitur nga klasa feudale» dhe masave të tjera t'u plotësonte kërkesat, se populli për këto u hodh në luftë.

«Fitimi i luftës», arsyetonte Rizai, varej nga qëndrimi i vendosur për plotësimin e detyrave revolucionare, nga taktika e drejtë, nga disiplina dhe organizimi[22]. Qeveria demokratike, sipas tij, mbajti një qëndrim të pavendosur e oportunist.

Po ta kish përmbushur Qeveria programin e premtuar, revolucioni nuk mund të mposhtej lehtë. Riza Cerova kishte mendimin se populli, kur të shihte feudalizmin të shtrirë përdhe dhe mbi gërmadhat e tij rendin demokratik, ai nuk do të lejonte të zhdukeshin fitoret revolucionare.

Rizai pohonte se, po ta kishte marrë fuqinë pjesa e majtë, punët do të kishin shkuar ndryshe. Ajo do të kishte organizuar «partinë» dhe «ushtrinë revolucionare», do të kishte plotësuar detyrat demokratike e do të kishte bërë të mundur të përballohej reaksioni e kundërrevolucioni[23]. Por ne do të thoshim se në këtë kohë kjo ishte gjë e vështirë. Me gjithë radikalizmin e saj, edhe pjesa e majtë në këtë kohë nuk ishte aq e organizuar dhe e fortë sa të kryente këto detyra. Elementët më të përparuar revolucionarë, me gjithë aspiratën e luftën e tyre për ta parë Shqipërinë me të vërtetë demokratike, nuk kishin forcë e mundësi ta merrnin situatën në dorë. Kushtet e rrethanat objektive të Shqipërisë bënë që udhëheqjen e revolucionit ta merrte borgjezia kombëtare. Kur roli progresiv i kësaj borgjezie të shteronte dhe luftën për demokracinë në të ardhmen ta drejtonin revolucionarët e vërtetë, komunistët, atëherë do të mund të përmbushej ajo për të cilën ëndërronin Rizai me shokë.

Në organin e KÇN u kritikua dhe ai mendim që ekzistonte se gjoja Qeveria demokratike nuk pati mundësi të bëjë reforma në një periudhë aq të shkurtër që qëndroi në fuqi.

Arsyeja e vërtetë në fakt, thuhej aty, nuk qëndronte te koha e shkurtër, por te përbërja heterogjene e qeverisë demokratike, te ekzistenca në gjirin e saj e elementëve antidemokratikë që e minuan revolucionin[24].

Megjithatë, edhe me këto të meta, revolucioni i la popu-

21) Po aty, 1 mars 1928, f. 4.
22) Po aty.
23) Po aty.
24) Po aty, 28 nëntor 1928, f. 1.

llit një trashëgim pozitiv. Ai «zgjoi masat katundare dhe ngjalli në to vullnetin e çlirimit nga zgjedha e bejlerëve, u tregoi rrugën që duhet ndjekur për të fituar të drejtën të gëzojnë vetë pemët e punës së tyre...»[25].

2. DIKTATURA ZOGISTE – DIKTATURË E KLASAVE REAKSIONARE ÇIFLIGARE-BORGJEZE

Një vend me rëndësi në pikëpamjet politike-shoqërore të KÇN zinte kritika kundër diktaturës reaksionare zogiste. Ai i bëri një demaskim të fuqishëm dhe me argumente bindëse regjimit reaksionar që u vendos në Shqipëri me ndihmën e ndërhyrjes së jashtme. Kriter themelor për vlerësimin e tij, ashtu sikurse të të gjithë gjendjes së Shqipërisë, ishte kriteri klasor. Analiza klasore e bërë sidomos nga komunistët, shërbeu për të zbuluar natyrën klasore të regjimit si pjesë me rëndësi e superstrukturës që mbështetej mbi një bazë adekuate ekonomike-shoqërore, për të shpjeguar evolucionin e bazës shoqërore të tij, thelbin klasor të politikës së vet, për të demaskuar metodat politike e ideologjike që përdori regjimi që nga dhuna e terrori policor e deri te demagogjia. Ndryshe nga ideologët reaksionarë në mërgim, si ata të «Bashkimit Kombëtar» e të tjerë që regjimin zogist e paraqitnin si diktaturë personale terroriste të Ahmet Zogut, si një grup të ngushtë politik apo klikë të shkëputur nga klasat e bejlerëve, agallarëve e kapitalistëve, që vepronin gjoja në kundërshtim me interesat e tyre e të gjithë popullit, ideologët e KÇN kishin mendimin se diktatura zogiste ishte shprehje e interesave, e fuqisë ekonomike dhe politike kolektive të klasave e grupeve reaksionare, e politikës së tyre antidemokratike e antikombëtare. Këtë pikëpamje kishin përfaqësuesit më të shquar të kësaj organizate, si: Fan S.Noli, Halim Xheloja, Riza Cerova etj.

Kjo ide u shpreh në materialet programatike të organizatës si dhe nga revolucionarë të veçantë. Halim Xheloja pohonte se regjimi zogist ishte «ekspresioni i interesave dhe fuqisë kolektive të klasave sunduese»[26].

Ai, në mënyrë ironike, duke aluduar njëkohësisht edhe për kaosin që kishte shkaktuar regjimi, nënvizonte se «populli shqiptar nuk çqeveriset prej një njeriut d.m.th. prej kryekatilit si kuptohet përgjithësisht prej opinionit», po prej klasave e grupeve reaksionare[27].

25) Po aty, 10 prill 1929, f. 2.
26) Po aty, 1 gusht 1927.
27) Po aty.

«Klasat e pasura, — thoshte ai, — sot kanë Zogun në krye, nesër do pjellin një tjetër të tyre ose, në iu mungoftë, do të blejnë një prej popullit që tradhton klasën e vet. Kush sinqerisht ia hedh krejt e gjithë fajet Zogut, bën hata e faj të rëndë se lë nënë hije krejt klasat që nxjerrin të tjerë zogjër»[28]. Me anë të këtij arsyetimi luftohej jo vetëm teza e ideologëve reaksionarë se klika zogiste nuk përfaqësonte gjoja asnjë klasë, por edhe kundër atyre iluzioneve që ekzistonin te disa të tjerë që kujtonin se po të hiqej A.Zogu, punët do të shkonin mbarë. Kjo nuk mund të ishte zgjidhje. Për ta shpëtuar popullin nga tirania e të gjitha të këqiat, duheshin përmbysur, në radhë të parë, klasat reaksionare. Po të mos veprohej kështu, regjimit zogist mund t'ia zinte vendin një regjim tjetër bejlerësh dhe në fuqi mund të vinin një ditë reaksionarë të tjerë nga radhët e «Bashkimit kombëtar». Kjo s'do të ishte gjë tjetër veçse një «ndërrim samari»[29].

Mbështetja shoqërore e regjimit që u përmend më sipër, në të cilën thuhej se ishte «koncentruar errësira e shekujve», trashëgimia mesjetare»[30], ishte mbështetja kryesore e tij.

Por kjo nuk ishte e mjaftueshme për një regjim të kalbur si ai, nga çdo pikëpamje, ekonomike, shoqërore e politike. Prandaj qeveria zogiste kishte nevojë edhe për një mbështetje e përkrahje tjetër, për atë të imperializmit italian që i siguroi atij të gjitha mjetet për të ardhur edhe qëndruar në fuqi e për të shtypur popullin[31].

Klasat reaksionare dhe Italia fashiste ishin të interesuara që vendi të sundohej nga një diktaturë terroriste si e A. Zogut. Vetëm një diktaturë si kjo mund të siguronte shfrytëzimin deri në palcë të popullit e të pasurive të vendit dhe qetësinë.

Këtë pikëpamje kishte pak a shumë për këtë problem edhe udhëheqësi i KÇN, Fan S.Noli. Ai u shpreh që në fillim se ishin pikërisht «antinacionalet» ose klasat reaksionare dhe fuqitë e huaja ato që sollën në fuqi në Shqipëri forcat e regjimet politike më antidemokratike. Këta «djaj të brendshëm» dhe «të jashtëm» nxorën në skenë në fillim Esad Pashën dhe esadizmin dhe më pas Esadin nr. 2, A. Zogun dhe klikën e tij[32]. Ai pohonte se e kishte të qartë prej kohësh se «bejlerët luftonin të lidhur bashkë për privilegjet e tyre feudale» dhe përbënin një grup kompakt e të organizuar që në saje të kësaj kompaktësie vendosën disa herë diktaturën reaksionare. Për Nolin ishte e kuptueshme se A.Zogu nuk erdhi në fuqi në saje të zo-

28) Po aty.
29) Po aty, 25 janar 1934.
30) Po aty, 28 nëntor 1928.
31) Po aty, 21 shkurt 1930.
32) Po aty, 7 tetor 1925.

tësisë së tij të rrallë, por, në radhë të parë, në saje të klasave reaksionare që ishin të interesuara për një dorë të fortë.

Duke iu përgjigjur kritikës së një lexuesi në gazetën «Republika», që Noli e botoi vetë në Amerikë, i cili thoshte se duhej të kritikoheshin në gazetë dukuritë negative të shoqërisë shqiptare, por nuk duhej të viheshin në shenjë persona të caktuar, Noli theksoi se nuk mjaftonte të luftohej sistemi «feudal» në përgjithësi, po duhej të luftoheshin edhe krerët reaksionarë, si Ahmet Zogu, Shefqet Vërlaci e të tjerë, të cilët ishin pjellë e këtij sistemi, mbrojtësit besnikë e shtyllat e tij[33].

Noli bëri fajtorë për vendosjen në Shqipëri të kësaj diktature të egër edhe imperialistët e shovinistët, sidomos imperializmin fashist. Musolini thoshte se ai i vuri Shqipërisë mbi shpinë një «sulltan aziatik» që e bëri atë një «Turqi të vogël», më të keqe se Turqia e sulltan Hamitit[34].

KÇN, duke analizuar hollësisht regjimin zogist, sidomos në broshurën nr. 1 «Nga triumfi i «legalitetit» në revolucionin popullor», vinte në dukje se kufizimi i pushtetit personal të çifligarëve dhe likuidimi deri në një farë shkalle i prirjeve të tyre centrifugale dhe i anarkisë politike në shtet nuk çonte në dobësimin e klasave çifligare-borgjeze, po përkundrazi i forconte pozitat e tyre[35].

Edhe në këto kushte, kur klasat reaksionare e ushtronin fuqinë e tyre politike kolektivisht dhe e përqendronin në diktaturën zogiste, nuk përjashtohej mundësia e ekzistencës së prirjeve separatiste në shtetin shqiptar, prirje që e kishin burimin në pronën çifligare dhe në përpjekjet e klasave reaksionare apo grupeve të veçanta për të siguruar monopolin e sundimit dhe të shfrytëzimit të masave popullore[36].

Baza shoqërore e regjimit, thuhej me të drejtë, ishte mjaft e ngushtë dhe me kalimin e kohës ngushtohej gjithnjë e më shumë, prandaj ai ishte i detyruar të forconte aparatin e dhunës, ushtrinë, xhandarmërinë, si dhe të mbështetej vazhdimisht tek imperializmi italian pa të cilin nuk mund të mbahej[37].

Grupi politik kryesor ku mbështetej regjimi konsiderohej grupi «Besa» i përbërë nga çifligarët dhe borgjezia e lartë. Ky grup kishte pozita me rëndësi në qeveri dhe në parlament dhe dallohej sipas «Lirisë Kombëtare» për politikën e tij ultrareaksionare.

Përfaqësuesit e grupit «Besa» mbaheshin si «baballarë të

33) «Republika», 4 dhjetor 1930.
34) Po aty, 1 nëntor 1930, 10 shtator 1931.
35) Broshurë nr. 1, «Nga triumfi i «legalitetit» në revolucionin popullor».
36) Po aty.
37) «Liria Kombëtare», 19 qershor 1931.

kombit». «Liria Kombëtare» i demaskoi ata si kundërshtarë të vendosur të shndërrimit demokratik dhe armiq të pavarësisë.

Ideologët e KÇN nënvizuan mjaft karakterin antidemokratik të diktaturës zogiste. Kjo diktaturë terroriste, edhe pse në fillim u maskua me rroben republikane, ishte mohimi i drejtpërdrejtë i sovranitetit të popullit, i të drejtave dhe lirive të tij demokratike[38].

Noli e shkurorëzoi legjendën e «legalitetit» që e paraqiste qeverinë zogiste si qeverinë e ligjeve, të rregullit e të qetësisë. Kjo legjendë e vjetër në botë që nga koha e Noes, ironizonte ai, ka shërbyer gjithnjë e kudo, për të përligjur sundimin e klasave reaksionare. Në një letër të hapur të tij, botuar në shtyp, numëroheshin të këqiat e mëdha që kjo qeveri i solli Shqipërisë dhe ajo cilësohej si qeveri «e hurit dhe e litarit»[39].

Republika ishte një perde pas së cilës fshihej dhuna, grabitja dhe arbitrariteti e korrupsioni.

I gjithë aparati shtetëror me kastën e privilegjuar, me administratën e fryrë burokratike, me xhandarmërinë dhe bandat mercenare, me gjyqet dhe organet policore rëndonte mbi popullin me të gjithë peshën e tij.[40].

Për të forcuar diktaturën reaksionare dhe për të bërë fashistizimin e regjimit politik, u pa e nevojshme, thuhej, të shndërrohej republika në monarki. Për këtë ishin të interesuara si klasat reaksionare, ashtu edhe imperializmi fashist, i cili donte të kishte një dorë të fortë në Shqipëri për të siguruar e forcuar pozitat e veta.

Me këtë rast «Liria Kombëtare» botoi një sërë artikujsh ku demaskohej gjithë forcë ky akt i dhunës i drejtuar kundër popullit. Fan S.Noli, Halim Xheloja e të tjerë stigmatizuan, si ambicien e madhe të A. Zogut, për t'u bërë gati një «Skënderbe» apo «Napoleon», ashtu edhe egoizmin pa fre të klasave reaksionare. Noli theksonte se ambicia e A.Zogut për pushtet dhe shndërrimi i republikës në monarki i kushtoi shumë Shqipërisë, sepse forcoi «kërbaçin e legalitetit» dhe shpejtoi kolonizimin fashist[41].

KÇN theksoi se klasat reaksionare kishin frikë nga lëvizjet revolucionare të popullit dhe kërkonin ta rrethonin sundimin e tyre me një mur mbrojtës. Ato e panë «se në popullin shqiptar po formohej ideja e klasit, e panë që vetëm s'i bënin dot ballë. Këtë e provuan në revolucionin e qershorit 1924...»[42].

38) Po aty, 11 maj 1927. Deklaratë e KÇN, «Liria Kombëtare», 22 korrik 1932.
39) «Imigranti», 10 tetor 1925.
40) «Liria Kombëtare», 1 maj 1928, f. 1.
41) Po aty, 11 shtator 1928: «Republika», 10 shtator 1931.
42) «Liria Kombëtare», 11 shtator 1928, f. 4; 30 shtator 1928, f. 2.

Noli me shokë vunë në dukje gjithë mprehtësi e forcë stigmatizuese tragjikomedinë monarkike që u luajt mbi shpinën e kombit, pasojat e rënda që kishte kjo ngjarje për popullin dhe pavarësinë. «Ky karagjozllëk sulltanor prej hajdutësh të dehur», thoshte Noli, ndodhi në një kohë «kur mbretërit kanë hyrë si mumje në muze a të shumtën paradojnë si kukulla dhe dordolecë...»[43]. Mbretërit në këtë kohë, konstatonte ai me të drejtë, ishin «kleçka e lodra» të kapitalizmit. Imperialistët ndiqnin gjithnjë një taktikë djallëzore e makiavelike dhe, kur donin të skllavëronin një vend, vinin në krye një vegël të bindur të tyre. I tillë ishte edhe Ahmet Zogu.

Kryetari i KÇN, ashtu sikurse vetë organizata, kishin bindjen se «monarkia feudale» jo vetëm që e shtypi, e terrorizoi popullin dhe e la të vdesë urie, por, çka ishte akoma më keq, po ia shiste Shqipërinë Italisë dhe po e kthente në koloni italiane[44]. Monarkia «feudale» e shpuri Shqipërinë në varr[45].

Me gjithë tragjizmin e situatës, Noli e të tjerë besonin me optimizëm se koha punonte për popujt e jo për tiranët e imperialistët.

Pikërisht në këtë kohë të vështirë e të ndërlikuar Fan S. Noli nën ndikimin e ideve e të forcave më revolucionare të Evropës dhe nën përshtypjen e thellë të kontaktit të parë me atdheun e punëtorëve, Bashkimin Sovjetik (1927), iu drejtua gjithë optimizëm popullit të vet. «Koha e gjakpirësve imperialistë ka për të shkuar ashtu si shkoi koha e hajdutëve feudalë. Punëtorët e katundarët revolucionarë anembanë botës po përgatiten për sulmin final kundër tiranëve të tyre shekullorë, që t'i korrin me drapërin e t'i shtypin me çekanin, që t'i shuajnë një herë e mirë nga faqja e dheut. Gatituni e lidhuni me ata e me ne që, porsa të vijë koha, të bëjmë pjesën e detyrës që na bie dhe ta përsëritim në një shkallë më të lartë epopenë e Vlorës. Dita e çlirimit nuk është larg»[46]. Kjo ishte periudha kur demokrati i shquar revolucionar pësoi një rritje dhe përvetësoi ide socialiste e materialiste. Ishte koha e apogjeut të tij që zgjati vetëm disa vjet. Në këto vite ky patriot demokrat dhe erudit i kuptoi drejt situatat dhe pati një kthjellim e besim në fitoren e popullit[46/1]. Por nga ai, siç e thotë me të drejtë studiuesi Pirro Tako, s'mund të pritej që të bëhej marksist, sepse siç e kish pohuar vetë «i pëlqente metoda e dialek-

43) Po aty, 11 shtator 1928.
44) «Republika», 10 shtator 1931.
45) Po aty.
46) «Liria Kombëtare», 11 shtator 1928.
46/1) P. Tako. *F.S. Noli në fushën politike e publicistike,* Tiranë, 1975, f. 183.

tikës së Marksit» e megjithatë vazhdonte «të ndiqte shkollën idealiste».

Për problemin e monarkisë, Noli polemizoi edhe me ideologët reaksionarë e apologjetët e regjimit, këta «laro» siç i quante ai, që nuk pushonin kurrë «me lehjet, me shfryrjet e me ulurimat barbare e groteske»[47]. Ai u thoshte atyre se ai dhe bashkëpunëtorët e tij të Çlirimit Nacional ishin kundër monarkisë feudale zogolliane për të gjitha ato arsye që u përmendën më sipër, se ishin republikanë të bindur, për një republikë të popullit punëtor dhe se vetëm një republikë e tillë do ta shpëtonte popullin nga zgjedha feudale, fashiste dhe nga varfëria[48]. «Republika për ne, — theksonte demokrati revolucionar, — nuk është çështje mode e doktrine... por një çështje jete dhe vdekjeje për Shqipërinë e për popullin shqiptar»[49].

KÇN kishte mendimin se shpallja e monarkisë ishte një hap me rëndësi drejt diktaturës fashiste e kolonizimit të mëtejshëm të vendit[50].

Fashistizimi i regjimit thuhej se kishte filluar që më parë me ndihmën e organizatorëve italianë, por tashti ai duhej të bëhej me ritme më të shpejta.

Vlerësimi që KÇN i bënte diktaturës zogiste si diktaturë fashiste, lidhej edhe me vlerësimin që u bëri Internacionalja Komuniste në këtë kohë si dhe vetë Gjergj Dimitrovi regjimeve reaksionare ballkanike, të cilat në kushtet e forcimit të krizës së përgjithshme të kapitalizmit kishin prirje të shkonin drejt fashizmit.

Komiteti i Çlirimit Nacional demaskoi edhe pikëpamjen prej bejlerësh të Ali Këlcyrës me shokë që A. Zogun e luftonin si person, duke mos prekur klasat reaksionare. Ata synonin që klikën zogiste ta zëvendësonin me një klikë tjetër bejlere-agallare dhe mbi qafën e Shqipërisë të vinin kularin e Jugosllavisë.

3. DEMASKIMI I POLITIKËS ANTIKOMBËTARE TË REGJIMIT DHE I IMPERIALIZMIT E SHOVINIZMIT

Në idetë revolucionare të KÇN një vend të dukshëm dhe me rëndësi zë demaskimi i politikës antikombëtare të regjimit dhe i synimeve grabitqare imperialiste e shoviniste, sidomos

47) «Republika», 10 shtator 1931.
48) Po aty.
49) Po aty.
50) «Liria Kombëtare», 19 qershor 1931; 29 shtator 1932.

të imperializmit fashist. Politika antikombëtare e regjimit, krahas asaj antipopullore, ishte ana tjetër e medaljes. Kjo shpjegohej me natyrën klasore të tij, me kushtet e këqia ekonomike e politike të tij, me bazën e kalbur e të ngushtë shoqërore. Klasat reaksionare të Shqipërisë, nënvizonte KÇN, gjatë gjithë historisë i kishin tradhtuar interesat kombëtare. Ato u kanë shërbyer pushtuesve e fuqive të huaja. Ishin pikërisht ato klasa apo «antinacionalët», siç i quante Noli, që e kishin shitur disa herë Shqipërinë. Populli e patriotët e kishin fituar lirinë e pavarësinë me përpjekje e sakrifica të shumta, ndërsa bejlerët e borgjezia reaksionare i shkelën ato dhe ua shitën të huajve, sidomos Italisë fashiste[51].

Politika antikombëtare e regjimit lidhej edhe me faktin që ai erdhi në fuqi me ndihmën e huaj dhe nuk bënte dot pa të. Ai u detyrua t'ua shpërblente ndihmën që i dhanë dhe po i jepnin imperialistët dhe shovinistët dhe zhvilloi politikën e «dyerve të hapura», ndaj tyre, u dha koncesione të shumta në të gjitha fushat, madje shkëputi deri copa toke nga trualli i Shqipërisë e ia dha Jugosllavisë.

Regjimi zogist konsiderohej jo vetëm pjellë e klasave reaksionare dhe e fuqive të huaja, por edhe vegël i imperializmit e shovinizmit për të kolonizuar vendin. Ai, siç thoshte Noli, e shiti në fillim Shqipërinë «copa-copa» për ta shitur pastaj «toptan»[52].

Në deklaratën e KONARE-së të 14 gushtit 1925, u dënua botërisht tradhtia e klikës zogiste, e cila i cedoi Jugosllavisë si shpërblim për ndihmën e madhe që i dha gjatë kundërrevolucionit, tokat e Vermoshit dhe të Shën Naumit. Ky ishte një copëtim i vendit me vullnetin e klasave reaksionare, nxjerrja e interesave të tij në ankand.

Në deklaratë thuhej: «Ahmet Zogolli ka nisur që tashti të presë copa prej trupit të gjallë të atdheut për t'u shpërblyer të mirën zotërinjve që e prunë në fuqi»[53]. KONARE-ja e kuptoi drejt se, si pasojë e koniunkturës së disfavorshme që u krijua në Ballkan e në Evropë për popujt sidomos të vegjël, gjithashtu të vendosjes në Shqipëri të një regjimi antikombëtar, për vendin u krijua një situatë mjaft kritike. Shqipëria u përfshi në vorbullën e rivalitetit imperialist e shovinist. Rreziku kryesor për të vinte nga imperializmi fashist, i cili duke marrë miratimin e imperializmit anglez për shtrirjen në Ballkan e në zonën Danubiane, në mënyrë të veçantë në Shqipëri, filloi të aktivizohej shumë dhe t'i kërcënohej asaj e vendeve të tjera ballkanike.

51) Po aty, 28 nëntor 1928; «Republika», 27 nëntor 1930.
52) «Liria Kombëtare», 11 shtator 1928.
53) Po aty, 19 gusht 1925.

Në këto rrethana klika zogiste, që shkonte nga të frynte era e politikës dhe e koniunkturave, e braktisi padronin jugosllav dhe u orientua nga Italia fashiste, u vu nën mbrojtjen e saj. «Kush shitej në Beograd, mund të shitej edhe në Romë e kudo që ta blinin më shtrenjt», theksonte «Liria Kombëtare» disa muaj përpara se të nënshkruhej pakti i parë italo-shqiptar i Tiranës, që e vuri Shqipërinë në protektoratin italian[54].

Ajo hodhi poshtë me përbuzje propagandën demagogjike të regjimit që filloi të fliste për «miqësinë» midis Shqipërisë dhe Italisë, duke arsyetuar sesi mund të kishte miqësi midis dy vendeve kur më i vogli robërohej dhe kur marrëdhëniet midis tyre ishin si ato të «shërbëtorit me të zonë»[55].

Përfundimi i paktit të Tiranës dhe vendosja e protektoratit italian mbi Shqipërinë e bëri KONARE-në të parashikojë drejt se Shqipërisë, e cila ra nën protektoratin italian, një ditë do t'i kërcënohej agresioni fashist[56].

Ideologët e saj e dënuan këtë veprim të tradhtisë kombëtare nga ana e qeverisë zogiste, si dhe dhunën imperialiste. Ata stigmatizuan dhe analizuan në mënyrë të drejtë karakterin imperialist të të gjitha pakteve e marrëveshjeve të lidhura me Italinë fashiste e fuqitë e tjera. KÇN dënoi «Perëndimin e qytetëruar» që kërkonte të vendoste mbi popujt skllavërinë kapitaliste dhe që mbështetej mbi klikat reaksionare të vendeve të ndryshme. Një nga ata që ngriti zërin me të gjithë fuqinë kundër pakteve e protektoratit italian të vendosur mbi Shqipërinë ishte Fan S.Noli.

Ai e cilësoi paktin e parë të Tiranës të vitit 1926, si «një krim jo vetëm kundër Shqipërisë së pambrojtur, por edhe kundër njerëzimit të tërë».

Noli thoshte se ai ishte «parathënia e një lufte ballkanike të re, e cila doemos ka për ta zvarritur Evropën në një katastrofë më të keqe se ajo që dëshmuam ca vjet më parë. Situata e krijuar prej paktit është aq delikate, sa një hiç gjësendi mund të shkaktojë tmerret dhe mjerimet e një lufte të përbotshme»[57].

Demokrati revolucionar i shquar e kuptonte se imperialistët e pangopur nuk e kishin për gjë t'i merrnin popujt nëpër këmbë, t'u kërcënonin lirinë e pavarësinë e tyre dhe të ndiznin luftërat. Ata nuk bënin dot pa luftëra e grabitje. «Sa kohë që një kalorës shëtitës, çorbë-turbullonjës si Çamberleni dhe një xhambaz imperialist si Musolini bëjnë qejf duke luajtur me zjarrin, — shkruante ai, — Evropa nuk është një vend i sigurtë për jetesë»[58].

Noli u bëri thirrje popujve të Ballkanit të bënin një front të përbashkët kundër rrezikut imperialist dhe kritikonte ata që e nënvleftësonin atë dhe kërkonin të bënin «gjumë» të rehatshëm në kohën kur digjej shtëpia e fqinjit. «Ata që quajnë paktin një gjë të padëmshme, flenë në parajsën e të marrëve, thoshte ai, dhe do të zgjohen nga gjumi me një tronditje shumë të rreptë»[59].

Këtu ai bënte përgjegjës për krimin kundër Shqipërisë jo vetëm rrethet imperialiste të Evropës, por edhe qeveritë reaksionare ballkanike që me lakmitë dhe rivalitetet e tyre e nxitën edhe më shumë imperializmin fashist t'i vërsulej Shqipërisë. Ai e stigmatizoi ashpër Ninçiçin, ministrin e jashtëm jugosllav, që donte të mashtronte opinionin publik dhe të maskonte shovinizmin e politikën antishqiptare duke thënë se me politikën e tij ndaj Shqipërisë dhe me ndihmën që i dha A. Zogut, nuk kishte qëllim tjetër veçse të luftonte bolshevizmin në Ballkan, e në Evropë. Ninçiçi, thoshte Noli, nuk pati sukses me këtë version «sipas modës që duartrokitej» dhe ai me politikën e tij nuk bëri gjë tjetër veçse shpuri ujë në mullirin e Italisë[60].

Kritika e Nolit dhe e KÇN kundër imperializmit në përgjithësi dhe atij italian në veçanti, erdhi duke u forcuar. Ajo fitoi një përmbajtje më të thellë klasore. Demokrati revolucionar goditi tezën e elementëve antikombëtarë që kërkonin ta përligjnin bashkëpunimin me imperializmin italian nën pretekstin se kështu mbronin Shqipërinë nga rreziku i fqinjëve ballkanikë. Kjo, sipas Nolit, ishte teza e bejlerëve, të cilët thoshin: «për të shpëtuar nga gurmazi i skyllave dhe kuçedrave ballkanike, serbe e greke, duhet të vërvitemi në gurmazin e Karybdës, dhe mëmë-lubisë italiane»[61]. Një tezë e tillë sipas tij, ishte në kundërshtim me interesat kombëtare dhe i shërbente imperializmit. «Teza e jonë, — shtonte ai, — është kjo: as në gurmazin e skyllave, as me gurmazin e Karybdës, se aq kjo sa edhe ato janë vdekje për popullin shqiptar»[62].

Në shtjellimin e mëtejshëm të kësaj pikëpamjeje thuhej gjithashtu se në këtë kohë tepër të vështirë, populli shqiptar në luftën e tij për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë kishte jo vetëm armiq të egër e të rrezikshëm, por edhe miq. Miqtë për të ishin «popujt demokratikë, liridashës e paqedashës të botës së tërë».

54) «Liria Kombëtare», 11 gusht 1926.
55) Po aty.
56) Po aty, 8 dhjetor 1926.
57) Po aty, 16 shkurt 1927.
58) Po aty.
59) Po aty.
60) Po aty, 9 mars 1927.
61) «Republika», 1 nëntor 1930.
62) Po aty.

Kryetari i KÇN botoi edhe një artikull polemik kundër Faik Konicës, njeriut të «njëqind flamurëve», i cili me metodën e tij të të bërit të së zezës të bardhë dhe anasjelltas, kishte lavdëruar shpesh në gazetën «Dielli» politikën imperialiste të Musolinit në Shqipëri duke e paraqitur si një politikë të ndershme, pa interes, qytetëruese e shpëtimtare për vendin.

Noli i demaskoi pa mëshirë falsifikimet e Konicës, si dhe lëvdatat e tij në adresë të fashizmit.

Ai hodhi poshtë versionin e tij të huajtur nga arsenali i propagandës fashiste se gjoja fashizmi dhe Musolini bënë kthesë rrënjësore në politikën dhe qëndrimin ndaj Shqipërisë, se gjoja ata, ndryshe nga San Xhuliano dhe Xholiti, mbajtën një qëndrim mirëdashës, humanitar dhe e ndihmuan Shqipërinë në mënyrë të sinqertë të zhvillohej e qytetërohej, duke e përfillur për herë të parë që nga koha e Skënderbeut si komb duke i «bërë vend në tryezën e popujve të qytetëruar.».

Falsifikimit të këtij përfaqësuesi të bejlerëve Noli u kundërvuri faktet dhe logjikën dërrmuese. Ai iu përgjigj Konicës se Italia fashiste e Musolinit i shkaktoi mjerime e fatkeqësi të panumërta vendit, i rrëmbeu lirinë e pavarësinë, e zhyti në «robëri» e në «varfëri»[63].

Me argumente bindëse e goditën imperializmin dhe politikën antikombëtare zogiste edhe Halim Xheloja me shokë. Halimi me artikujt e tij të zjarrtë plot ide patriotike e revolucionare i shikonte rrënjët e tradhtisë kombëtare të klasave sunduese, tek egoizmi i tyre i verbër klasor.

«Bejlerët e agallarët, — thoshte ai, — për të shpëtuar çifligjet e tyre e bënë Shqipërinë teslim tek Italia»[64].

Një rol me rëndësi në skllavërimin ekonomik e politik të Shqipërisë nga Italia fashiste, i atribuohej imperializmit anglez, i cili kishte hegjemoninë në Evropë dhe zhvillonte pazarllëqe në kurriz të popujve.

Sipas Halimit, Shqipëria u kthye në «provincë italiane», «Zogu ishte prefekt i Musolinit në Shqipëri», ndërsa vetë «Musolini ishte xhandar i Anglisë në Ballkan»[65]. Shqipëria e lidhur «pas qerres së prishur të imperializmit italian» rrezikonte dalngadalë ta humbiste krejt pavarësinë dhe të kolonizohej plotësisht. Laku u shtrëngua akoma më fort, gjatë krizës ekonomike botërore.

Ideologët e KÇN vunë në dukje se gjatë kësaj krize u forcuan shumë kontradiktat ekonomike e politike kapitaliste, u mahisën e u keqësuan plagët e kapitalizmit. Nga kjo krizë u kapërthyen si vendet e mëdha, ashtu edhe të voglat. Vendet

63) «Republika», 6 nëntor 1930.
64) «Liria Kombëtare», 15 tetor 1929.
65) Po aty, 15 dhjetor 1927.

e prapambetura e të nënshtruara si Shqipëria i ndjenë më shumë pasojat e saj.

Arsyetime interesante e bindëse për krizën kapitaliste gjejmë te Fan S.Noli, i cili me mendjen e tij të mprehtë po depërtonte gjithmonë e më mirë në kuptimin e realitetit historik. Ai vuri re se kriza po e dobësonte mjaft sistemin kapitalist dhe po tregonte hapur natyrën e tij. Peshku i madh, thoshte ai, po e hante pa mëshirë të voglin.

Si rezultat i krizës, edhe vendet e zhvilluara, si Gjermania e të tjera, ishin dobësuar dhe kishin rënë nën varësinë e imperializmin amerikan. Ky imperializëm i majmë e grabitqar po shfrytëzonte pa mëshirë popujt dhe kishte marrë përsipër rolin e xhandarit kryesor të reaksionit botëror. Noli i kuptoi drejt dukuritë e krizës së sistemit kapitalist, si: superprodhimi i mallrave, papunësia, varfërimi tej masës i popullit, falimentimi ekonomik e financiar. Ai u thellua edhe në pasojat politike të krizës, duke dalluar dukurinë e rëndësishme se forcimi i saj çonte në forcimin e reaksionit politik, dhe në vendosjen e diktaturave fashiste në mjaft vende, për të mbrojtur pushtetin e borgjezisë nga revolucioni që po afrohej dhe për të zhvilluar një politikë agresive kundër popujve[66]. Noli shkruante:

«Miliona punëtorë pa punë dhe miliona katundarë të mbytur nga zia po pyesin kur ka për të marrë fund kjo tragjedi. Diku populli e humbet durimin dhe merr masa kundër qeverisë. Fashizma dhe diktatura nga ana e qeverisë. Revolucioni nga nga ana e popullit»[67].

Noli ndoqi me vëmendje çdo ndryshim në koniunkturat dhe e pa se kohë të këqia kishin ardhur për popujt, sidomos për ata të vegjël. Imperialistët nuk e kishin për gjë të shkelnin të drejtat e tyre. Në traktatet e marrëveshjet e tyre, thoshte ai, kishte plot deriçka të hapura që shpinin drejt agresioneve e luftërave.

Në këto rrethana edhe imperializmi italian forcoi ekspansionin ekonomik e politik në Shqipëri e gjetkë. Ideologët e KÇN e ndoqën me vëmendje procesin e kolonizimit të vendit. Për mendimin e tyre një etapë me rëndësi e skllavërimit të Shqipërisë, pas marrjes së koncesioneve të «Bankës Kombëtare», huas së SVEA-s, koncesioneve minerare e të tjera dhe lidhjes së pakteve të Tiranës, konsiderohej akordimi i huas prej 100 milion fr. nga Italia Qeverisë zogiste. Kjo ishte huaja e parë me synime të deklaruara politike.

«Liria Kombëtare» deklaronte se Musolini me anë të saj kërkonte tapitë e Shqipërisë dhe se «regjimi i hajdutëve, është

66) «Republika», 11 qershor 1931.
67) Po aty.

myflis e myflis me bajrak. Po s'mori para nga jashtë, e ka vdekjen të sigurtë e të shpejtë»[68]. Këtu u hodhën poshtë pohimet e shtypit reaksionar zogist që thoshin se huaja e vitit 1931 ishte akorduar gjoja pa interes dhe për të përmirësuar gjendjen e popullit shqiptar dhe thuhej se ajo e cenonte drejtpërdrejt sovranitetin dhe pavarësinë e vendit. Si mund të ndodhte, thoshte gazeta, që Italia fashiste, «shteti më i varfër në Evropë» që ishte «mbytur në borxhe» tek imperializmi amerikan, «t'i jepte Shqipërisë hua pa fajde» ose «t'i hidhte paratë në erë» e të tregohej «shpirtëmirë»[69].

Këtu u kritikua pikëpamja reaksionare e Ali Këlcyrës se Italia «humbiste para kot në Shqipëri dhe s'fitonte gjë», se «rezultatet e politikës së saj në Shqipëri ishin hiç», se gjithë këtë politikë ajo e bënte gjoja «vetëm për të shpëtuar prestigjin»[70]. Me shpërthimin e krizës së përkohshme në marrëdhëniet politike midis qeverisë fashiste dhe asaj zogiste (1931-1935), që e kishte burimin te forcimi i politikës agresive të imperializmit italian ndaj Shqipërisë dhe te pazarllëqet midis Musolinit dhe Zogut, KÇN u përpoq të zbulonte thelbin e saj dhe parashikoi drejt përfundimin e kësaj krize në të mirë të Italisë.

Që në fillim të krizës u tha se A.Zogu donte të shkëputste «ryshfete nga imperializma italiane» në këtë situatë kritike dhe të bënte tregti me Italinë në dëm të Shqipërisë[71].

Një arsye tjetër që e detyroi mbretin të merrte pozën e mbrojtësit të sovranitetit dhe të pavarësisë së vendit dhe të bëhej «trim me pahir» kundrejt Italisë «ishte zemërimi i madh i popullit kundër kolonizimit italian». Organi luftarak i KÇN e paralajmëronte popullin që të mos mashtrohej nga kjo manovër zogolliane dhe parashikoi se klika zogiste do të kapitullonte. Qeveria e A. Zogut, e cila «kishte mbetur si peshku pa ujë», nuk mund të bënte «pa ndihmën e Italisë», do të pranonte kërkesat italiane dhe do të sakrifikonte më tej lirinë e pavarësinë[72].

Dhe ngjarjet rrodhën, ashtu siç u parashikua. KÇN e parashikoi drejt se «poza patriotike dhe demagogjia antiitaliane» e A. Zogut do të merrnin fund[73]. Ai theksoi gjithnjë e më shumë rrezikun e madh të agresionit fashist që i kërcënohej vendit, i cili favorizohej edhe nga politika profashiste e qeverive perëndimore.

KÇN dënoi jo vetëm imperializmin, por mbajti qëndrim

68) «Liria Kombëtare», 13 qershor 1931.
69) Po aty.
70) «Liria Kombëtare», 30 janar 1932; 30 prill 1932.
71) Po aty.
72) Po aty, 25 janar 1934
73) Po aty, shkurt 1935

edhe ndaj politikës reaksionare të shteteve shoviniste ballkanike kundrejt Shqipërisë dhe bashkë me Komitetin e Kosovës mori në mbrojtje popullsitë shqiptare dhe ato të Ballkanit që terrorizoheshin nga qeveritë reaksionare.

Në materialet e ndryshme të organizatës, në thirrjet, shpalljet, në broshurat dhe në «Lirinë Kombëtare» u theksua vazhdimisht se çështja kombëtare e Ballkanit ishte ndërlikuar shumë keq nga shovinistët dhe nuk po gjente asnjë zgjidhje. Borgjezia reaksionare ballkanike që kishte vendosur kudo diktaturat fashiste, po merrte nëpër këmbë egërsisht të drejtat e pakicave kombëtare dhe ndiqte një politikë barbare shkombëtarizuese që arrinte deri në genocid[74].

KÇN kishte mendimin se klasat reaksionare ballkanike ishin të verbuara nga nacionalizmi e shovinizmi që ishin akumuluar në këto vende që kur lindën shtetet ballkanike. Borgjezia ballkanike kërkonte ta kompensonte prapambetjen e saj historike edhe me anë të shfrytëzimit të kombësive e pakicave kombëtare. Ajo bënte në të njëjtën kohë lodrën e fuqive imperialiste që ishin të interesuara për të mbjellë përçarjen në Ballkan e për të sunduar dhe për të shfrytëzuar popujt e kësaj zone.

Parulla e borgjezisë reaksionare ballkanike «Ballkani për ballkanasit» thuhej prej tij, ishte një parullë mashtruese e demagogjike që kërkonte të fshihte dhunën imperialiste e shoviniste kundër popujve të Ballkanit.

Kështu militaristët serbë e grekë nuk u kënaqën me copëtimin që i bënë Shqipërisë në të kaluarën, po kërkonin ta copëtonin më tej. Ata s'lanë gjë pa bërë për të ndalur konsolidimin e asaj pjese të vogël të atdheut tonë të sakatosur që u njoh prej Fuqive të Mëdha si shtet i pavarur, gjithashtu u sollën në mënyrë shumë të egër me popullsitë shqiptare të Kosovës e Çamërisë, në mënyrë që t'i zhdukin apo t'i asimilonin krejt një ditë[75].

Te «Liria Kombëtare» u përshkruan mizoritë serbe në Kosovë, si dhe masat shkombëtarizuese të qeverisë greke ndaj shqiptarëve dhe u protestua me energji kundër tyre. Këto protesta iu drejtuan edhe Lidhjes së Kombeve[76].

Aty theksohej se qarqet shoviniste serbe, nën maskën e reformës agrare, po kryenin një shpronësim të shfrenuar në Kosovë, po merrnin masa drakoniane për shkombëtarizimin e shpërnguljen e shqiptarëve. Tokat e shqiptarëve u konfiskuan dhe iu dhanë serbëve e malazezve.

Xhandarmëria dhe policia përdorën dhunën më të egër

74) Broshura nr. 1 «Nga triumfi...».
75) «Liria Kombëtare», 11 maj 1927, Deklarata e KÇN.
76) Po aty, 15 gusht 1927, f. 1.

kundër tyre[77]. Shqiptarët shpërnguleshin nga vendi i tyre dhe detyroheshin të shkonin në Turqi e gjetkë.

Gjendja e popujve të Ballkanit cilësohej si tepër e rëndë. Regjimet reaksionare të mbrojtura nga imperialistët e të nxitura prej tyre e kishin kthyer atë në kasaphanë, në burg për popujt[78].

Politikën shoviniste dhe genocidin e dënoi me forcë dhe elokuencë edhe kryetari i KÇN, Fan S.Noli, i cili e cilësoi atë një «tragjedi me 3 akte (ç'pasurim, shpërngulje, shfarosje» për popujt e Ballkanit[79].

Noli në mënyrë sintetike e bindëse përshkroi tragjedinë e popujve të shtypur ballkanikë e në mënyrë të veçantë të shqiptarëve, nën diktaturat fashiste të Jugosllavisë e Greqisë. Ai nënvizoi sesi «afro një milion shqiptarë» të Kosovës u privuan nga të drejtat më elementare, përshkroi skenat rrënqethëse të tragjedisë së tyre[80]. Shqiptarët nuk kishin asnjë shkollë në gjuhën shqipe, asnjë deputet në Skupshtinë. Përveç kësaj, me anë të terrorit e të gjithfarë presioneve, atyre u kanosej shkombëtarizimi, serbizimi dhe shpërngulja e shfarosja. Noli konstatonte se si pasojë e politikës shfarosëse, popullsia shqiptare në Kosovë u pakësua nga 1 milion në 700 000[81]. 300 000 shqiptarë, serbët i hoqën qafe me metodat e tyre të egra tradicionale, thoshte ai. Dhe ky proces barbarie e genocidi nuk kishte ndërmend të merrte fund. Përpara Evropës po përsëritej «tragjedia e armenëve në Azinë e Vogël». Dhe Fan S.Noli i revoltuar nga ky fakt tragjik i bashkatdhetarëve të tij dhe i popujve të tjerë që shkeleshin pa mëshirë nga imperialistët e shovinistët, thoshte se për këtë gjendje askush «s'e çante kokën në kancelaritë evropiane», sepse imperialistët ishin mësuar me kasaphana më të mëdha dhe përveç kësaj ishin aleatët e shovinistëve[81/1].

Në këtë situatë kritike, që ish krijuar për popujt e shumëvuajtur të Ballkanit, nuk kishte rrugëdalje tejtër përveç luftës revolucionare të përbashkët të tyre për të përmbysur zgjedhën imperialiste dhe diktaturën fashiste.

---

77) Po aty, 20 prill 1928, f. 4.
78) Po aty, 31 korrik 1928, f. 3.
79) F.S. Noli, *Rron or rron dhe nuk vdes shqiptari*, f. 249-251.
80) *Po aty.*
81) *Po aty.*
81/1) *Po aty.*

4. GJENDJA EKONOMIKE-SHOQËRORE E SHQIPËRISË DHE LUFTA E KLASAVE

Ideologët e KÇN i kushtuan një rëndësi të dorës së parë analizës së gjendjes ekonomike-shoqërore, të Shqipërisë, strukturës klasore të saj dhe problemit të luftës së klasave. Kjo analizë ishte e domosdoshme si për të pasqyruar drejt tablonë historike të vendit e për të vlerësuar mirë situatat, forcat e përparimit dhe regresit, ashtu dhe për të përpunuar një program demokratik-revolucionar që synonte në përmbysjen e rendit çifligaro-borgjez dhe në vendosjen e demokracisë popullore. Një analizë të tillë të shëndoshë e bënë sidomos komunistët e KÇN, të cilët nxorën dhe dy broshurat sintetike që përmendëm më lart.

Shqyrtimi i realitetit shqiptar merrte deri-diku një karakter historiografik dhe dukuritë sociale nuk trajtoheshin thjesht nën prizmin e propagandës.

Natyrisht, në këtë analizë kishte edhe boshllëqe e të meta dhe konceptime nganjëherë jo të sakta. Por, në përgjithësi, thellimi në anën ekonomike-shoqërore e klasore të historisë sonë moderne ishte një arritje e rëndësishme e mendimit tonë demokratik të kësaj periudhe.

Analiza kritike e marrëdhënieve ekonomike-shoqërore e klasore të Shqipërisë u bë jo vetëm për arsyet e lartpërmendura, por edhe për t'iu kundërvënë apologjizmit të klasave sunduese që kërkonte t'i maskonte plagët e rendit çifligaro-borgjez dhe ta zbukuronte realitetin.

KÇN parashtroi pikëpamjen se shoqëria shqiptare po kalonte një krizë të rëndë ekonomike-shoqërore e politike që i detyrohej ekzistencës së marrëdhënieve gjysmëfeudale të gërshetuara me marrëdhëniet borgjeze të zhvilluara dobët[82]. Zotëruese konsideroheshin marrëdhëniet feudale që nënkuptonin ato çifligare, të cilat thuhej se kishin një peshë të rëndësishme sidomos në fshatin shqiptar. E gjithë terminologjia e përdorur nga ideologët e KÇN për marrëdhëniet ekonomike-shoqërore flet në të mirë të kësaj teze. Marrëdhëniet kapitaliste, padyshim, nuk mohoheshin, por ato thuhej se ishin në formë rudimentare dhe zhvillimi i tyre pengohej nga marrëdhëniet feudale. Në broshurën nr. 1 pohohej se Shqipëria ishte në fazën e akumulimit fillestar kapitalist[83].

Ideologët e KÇN e patën të vështirë të dallojnë qartë në kushtet e prapambetjes së Shqipërisë dhe ekzistencës së mbeturinave të shumta feudale, shkallën e zhvillimit të marrëdhë-

---

82) Broshura nr. 1.
83) Broshura nr. 1.

nieve borgjeze. Ata kishin përshtypjen se rendi feudal ishte ende sundues, sidomos në fshat, në një kohë kur marrëdhëniet borgjeze, edhe pse të zhvilluara dobët, ishin bërë sunduese kudo.

Nganjëherë përdorej edhe termi «mbeturina feudale» që linte të kuptohej se pranohej edhe tërthorazi ekzistenca e marrëdhënieve borgjeze. Por më shumë flitej për marrëdhënie dhe klasë feudale. Kjo, natyrisht, bëhej edhe me qëllim që të stigmatizoheshin ato forca reaksionare që ishin pengesë serioze në rrugën e progresit, të demaskohej klasa e bejlerëve, e cila ishte shfrytëzuese e tiranizuese e popullit, shtylla e çdo regjimi reaksionar dhe e politikës antipopullore e antikombëtare.

KÇN kishte mendimin se «feudalizmi» bashkëkohor i përfaqësuar nga bejlerët çifligarë i kishte rrënjët në feudalizmin e periudhës së sundimit osman. Pema e feudalizmit shqiptar thuhej se në të kaluarën ishte shartuar me atë të feudalizmit osman, ashtu sikurse në periudhën e tanishme mbi këtë trung të kalbur kishin filluar të shartoheshin filizat e sistemit borgjez. Nën hijen dhe mbrojtjen e këtij sundimi u krijua kasta parazitare e pashallarëve, bejlerëve e të tjerë, të cilët u pasuruan me anë të grabitjeve të shumta, me anë të dhunës së egër kundër fshatarëve, me anë të dhuratave e privilegjeve të Portës së Lartë. Kjo kastë parazitare vazhdoi të ekzistojë dhe pas pavarësisë. KÇN konstatonte atë dukuri specifike të Shqipërisë, ndryshe nga vendet e tjera ballkanike, ku klasa sunduese gjatë sundimit të huaj ishte në një pjesë të mirë shqiptare. Ajo për hir të rrethanave historike e fatin e keq të vendit, u ruajt edhe më vonë dhe ndikoi negativisht në zhvillimin e tij. Edhe pse zhvillimi nuk qëndroi në vend dhe historia bëri të sajën duke i përfshirë dhe çifligarët në vorbullën e zhvillimit borgjez, megjithatë klasa e bejlerëve, si mbartëse e mbeturinave të feudalizmit, ishte gjithnjë faktor regresiv dhe mbështetje e reaksionit. Pikërisht këtë anë konstatonte KÇN dhe këtu e drejtonte tehun e kritikës së vet.

Këtë donin të theksonin Halim Xheloja, Riza Cerova, Fan S.Noli e të tjerë kur sulmonin «oxhakët», «ajkën e feudalizmit shqiptar»[84].

Ata donin të theksonin jo vetëm karakterin reaksionar të kësaj klase e pengesat që i sillte zhvillimit , por të nxirrnin në pah edhe shfrytëzimin e grabitjet që i bëheshin fshatarësisë prej saj. Historia e «oxhakëve» të Shqipërisë konsiderohej histori barbarizmash e grabitjesh të pashembullta të fshatarësisë[85].

Evidencimi i problemit fshatar, i gjendjes së rëndë të fshatarësisë dhe të luftës së saj të pandërprerë për tokën dhe

84) «Liria Kombëtare», 1 gusht 1927, f. 2; 28 nëntor, f. 3.
85) Po aty, 1 gusht 1927.

të drejtat e saj, ishte çështja themelore e analizës ekonomike-shoqërore e klasore të shoqërisë shqiptare.

KÇN, me gjithë që u mor me analizën e çështjeve aktuale, hodhi një shikim edhe në të kaluarën e kërkoi lidhjet gjenetike midis saj, të tashmes dhe së ardhmes.

Duke trajtuar gjëndjen e fshatarësisë në të kaluarën, ideologët e tij vunë në dukje disa momente kryesore e të rëndësishme të luftës së saj kundër «feudalizmit», lëvizjet më të rëndësishme të fshatarësisë. Klasa fshatare nuk u pa vetëm si objekt i shfrytëzimit të egër, i nënshtrimit dhe shtypjes politike, por edhe si subjekt i shndërrimit historik. Në broshurat që përmendëm, sidomos në broshurën nr. 2, «Shpëtimi fshatarësisë» jepet një tablo e shkurtër e luftës së fshatarësisë për liri, pavarësi dhe për të drejtat shoqërore. Aty thuhet se fshatarët me gjithë varfërinë e tyre, shtypjen e robërinë, nuk e përkulën shpinën asnjëherë. Në mes të fshatarëve dhe «klasës feudale barbare», siç theksonte Riza Cerova, ka ekzistuar gjithnjë «një luftë mjaft e rreptë, por e paorganizuar»[86].

Në broshurë mbahej qëndrim kritik ndaj ideologëve reaksionarë që e kishin injoruar luftën e fshatarësisë e nuk kishin shkruar asnjë rresht për të. Por fshatarësia, që luftoi gjithë jetën e saj pareshtur, u kujdes vetë për ta përjetësuar luftën e saj, me anë të këngëve të bukura. Në këto këngë ajo pasqyroi «me ustallëk», «ngjarjet dhe hallet e saj»[87].

Në broshurë përmendeshin një sërë betejash e përpjekjesh të lavdishme të fshatarëve kundër zgjedhës osmane dhe të feudalëve shqiptarë. Këtu shprehej pikëpamja se fshatarësia nuk luftoi vetëm për liri e pavarësi, por edhe për tokën, sepse liria e pavarësia si mund të kuptoheshin pa tokën. Fshatari asnjëherë nuk i ka shkëputur këto dhe nuk i ka përfytyruar dot të ndara. Fshatarësia ka qenë e lidhur drejtpërdrejtë me tokën, e ka vaditur atë me gjak e me djersë gjatë gjithë historisë, prandaj edhe ndjenjat patriotike e shoqërore ishin aq të forta tek ajo.

Këtu flitej për luftërat e trimëritë e suliotëve, të hormovitëve, të kardhiqotëve, për kryengritjet heroike fshatare në veri e në jug kundër Tanzimatit me në krye Gjon Lekën, Rrapo Hekalin e të tjerë.

Gjatë luftërave kundër Turqisë shpërtheu urrejtja kundër bejlerëve e pashallarëve, sepse, siç thuhej aty, «kur i vjen dita vegjëlisë, i qëron hesapet me bejlerët»[88].

Vegjëlia te këta shihte jo vetëm armiqtë e kombit, por edhe shfrytëzuesit e grabitësit e vet. Nuk mbeteshin pa u për-

86) «Liria Kombëtare», 28 nëntor 1927, f. 3.
87) *Arkivi Qendror i Partisë* (më tej: *AQP*), broshura nr. 2.
88) *Po aty.*

mendur edhe kryengritjet e mëdha të Shqipërisë së Veriut, sidomos ato të Kosovës e të Dibrës, për liri e pavarësi e më pas kundër shovinizmit të egër.

Një vend të dalluar në broshurë zinte kryengritja fshatare e Shqipërisë së Mesme e viteve 1914-1915[89]. Fshatarësia e kësaj zone, e shtypur dhe e shfrytëzuar egërsisht, thuhej aty, u ngrit për të drejtat demokratike të mohuara nga bejlerët dhe kundër qeverisë në fuqi që ishte «mbrojtëse e oxhakëve». Bujqit e Shqipërisë së Mesme «kishin urrejtje për bejlerët shpirtëzinj pa din e iman», që u kishin grabitur tokat dhe i trajtonin si skllevër. Pra, rrënjët e «rebelizmit» duheshin kërkuar tek urrejtja kundër bejlerëve. Kjo ishte lufta e «fukarasë» kundër «zengjijve». Dhe fshatarët në këtë luftë shoqërore zgjodhën si të parë «një nga vëllezërit e tyre», Haxhi Qamilin.

Ai natyrisht ishte pa shkollë dhe «nuk ishte i zoti» të udhëhiqte një «lëvizje politike». Lëvizja nuk kishte program, prandaj u mbyt në gjak nga oxhakët. «Rebelët u vunë pishën sarajeve të bejlerëve», zaptuan tokat dhe i detyruan çifligarët të iknin. Oxhakët kërkuan ndihmë te fuqitë e huaja për të shtypur bujqit. Pra, kjo vërtetonte, sipas KÇN, që klasa feudale bashkëpunonte me armiqtë më të egër të Shqipërisë kur ishte puna për të shtypur lëvizjet revolucionare.

Fshatarët luftuan me trimëri kundër bejlerëve, Esadit dhe ushtrive serbe, por më në fund për arsyet që u thanë u mundën dhe Haxhi Qamili u vra prej Esadit. Bejlerët u hakmorën egërsisht kundër bujqve, pohohet në broshurë.

Përshkrimi i lëvizjes fshatare të Shqipërisë së Mesme nga KÇN është nga më interesantët dhe më i saktë në literaturën historike të Paraçlirimit. Analiza e saj e bërë nga komunistët tingëllon mjaft aktuale. Aty është vlerësuar drejt roli përparimtar i fshatarësisë në këtë luftë dhe qëndrimi i saj burrëror.

Një vlerësim pozitiv kësaj lëvizjeje i bëri në shkrimet e tij edhe Halim Xheloja. Ai theksoi se ajo nuk ishte një lëvizje «rebelësh», siç e paraqiste reaksioni dhe, pavarësisht nga padija e fshatarëve dhe paragjykimet e tyre fetare, përbënte një etapë me rëndësi në zhvillimin e luftës klasore të fshatarësisë që dëshmonte se ndërgjegjja e kësaj klase sa vinte forcohej[90].

Këtë çështje Halimi e trajtoi dhe në një letër që i drejtonte nga Gjeneva një shqiptari në Moskë, ku i thoshte se lëvizja e Shqipërisë së Mesme kishte dy anë, si anën pozitive, d.m.th. karakterin e saj social, demokratik dhe antifeudal, ashtu dhe anën negative, antikombëtare, të luftës

89) *Po aty.*
90) «Liria Kombëtare», 1928, 1 gusht, f. 3.

kundër shtetit kombëtar. Por Haxhi Qamili duhej të përshëndetej si njeri që pati «një instikt klasor» dhe kjo konsiderohej mjaft e rëndësishme[91].

Pikëpamja mbi anën negative të lëvizjes evoluoi më vonë, sepse në broshurën nr. 2 të vitit 1935, në hartimin e së cilës mori pjesë dhe Halimi dhe në të cilën ka pjesë të tëra nga shkrimet e tij në «Liria Kombëtare» lufta e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme kundër regjimit të Vidit cilësohej si luftë kombëtare. Kështu u kapërcye ajo pikëpamje e kufizuar mbi këtë lëvizje që kishin dhe të tjerë nga KÇN dhe që e shikonin vetëm si një lëvizje shoqërore. Paragjykimi i mëparshëm se fshatarësia e Shqipërisë së Mesme u ngrit kundër shtetit kombëtar shqiptar, ishte trashëguar nga e kaluara jo e largët. Është ai paragjykim që ka kritikuar dhe analizuar me themel shoku Enver Hoxha në studimin e tij të shquar mbi këtë lëvizje, «Mbi kryengritjen fshatare të Shqipërisë së Mesme».

Në këtë vepër historike të rëndësishme shoku Enver Hoxha bën një analizë të thellë materialiste dialektike të kësaj lëvizjeje progresive e me pasoja të dukshme për Shqipërinë. për zhvillimin e saj shoqëror e politik. Ai vuri pikat mbi *i* si mbi karakterin shoqëror të saj, ashtu edhe mbi përmbajtjen kombëtare. Këtu shoku Enver ndër të tjera pohon se «asnjëherë, me sa di unë, në historinë shekullore të popullit tonë nuk është vërtetuar që grupe të mëdha fshatarësh ose lëvizje fshatarësh të kenë pasur karakter «antikombëtar», «antishqiptar», «proturk» etj. Udhëheqës ka pasur që kanë tradhtuar çështjen e atdheut dhe të fshatarësisë sonë, ka pasur udhëheqës mercenarë që gënjyen për një kohë grupe fshatarësh, por që të arrinin të përdornin fshatarësinë kundër interesave të atdheut, asnjëherë dhe në asnjë periudhë të historisë ata nuk i ka lejuar fshatari ynë patriot dhe revolucionar»[92].

Tani historiografia shqiptare, duke u mbështetur edhe në tezat e thella të shokut Enver Hoxha për këtë çështje, ka krijuar një vizion të qartë për këtë lëvizje. Por në fillim dhe ajo nuk e pati aq të lehtë të depërtojë në përmbajtjen e saj dhe ta analizojë si duhet. Akoma më të vështirë e kanë pasur revolucionarët e periudhës që po analizojmë, të cilët nuk u morën me studime historike. Megjithatë, dhe ata, duke u nisur nga sensi klasor, megjithë ndonjë paragjykim që patën në fillim, erdhën më vonë në përfundimin e drejtë se lëvizja fshatare ishte pozitive në mënyrë tërësore. Në analizën që KÇN

91) *AQP.* Fondi i Grupit komunist të Moskës. Letër drejtuar një shokut shqiptar në Moskë.
92) Enver Hoxha. *Vepra,* vëll. 23, f. 140.

u bënte luftërave të fshatarësisë, në përgjithësi përmendeshin edhe luftëra të tjera si epopeja heroike e Luftës së Vlorës që i zbardhi faqen gjithë kombit, siç thuhej, e në mënyrë të veçantë Revolucioni Demokratiko-Borgjez i Qershorit 1924.

Në këtë revolucion theksohej se fshatarët u ngritën kundër qeverisë së bejlerëve, kundër Ahmet Zogut, Shefqet Vërlacit, Myfit Libohovës e të tjerë. Ata u «kallën tmerrin» bejlerëve dhe i bënë të arratisen e të strehohen te Pashiqi[93].

Por fshatarët nuk qëndruan deri në fund të armatosur dhe nuk i detyruan «zotërinjtë» t'u plotësonin kërkesat, por u gënjyen, i lëshuan armët dhe u kthyen nëpër shtëpira.

«Zotërinjtë» i gënjyen fshatarët dhe vegjëlinë në përgjithësi. Dhe kjo ndodhi pse ata nuk patën një organizatë të tyren që t'i drejtonte dhe t'ua bënte të qartë si të vepronin më tej.

Pas analizës që i bëhej gjendjes në të kaluarën, pasqyrohej edhe situata e tanishme ekonomike-shoqërore e fshatarësisë nën regjimin zogist.

Shqipëria nën regjimin zogist konsiderohej një vend thellësisht agrar, me bujqësi të prapambetur dhe me marrëdhënie gjysmëfeudale, me marrëdhënie kapitaliste të zhvilluara dobët e kryesisht në qytet dhe me një gjendje varësie koloniale.

Në broshurën nr. 1 pohohej se Shqipëria ishte në fazën e akumulimit kapitalist fillestar dhe se procesi i shpronësimit të prodhuesve të vegjël zhvillohej në kushte më të rënda për fshatarësinë sesa në vendet e tjera, sepse ai zhvillohej në rrethanat e grabitjes së dyfishtë nga ana e «zengjinëve» të vendit dhe kapitalistëve të huaj[94].

KÇN mendonte, siç thamë, se në fshat zotëronin më shumë marrëdhëniet feudale dhe nuk i vuri re mirë marrëdhëniet borgjeze, të cilat ishin zhvilluar edhe aty, megjithëqë ishin të ngatërruara me mbeturina të thella të feudalizmit.

Megjithë këtë mangësi të moskuptimit si duhet të përmbajtjes borgjeze të marrëdhënieve ekonomike-shoqërore, e cila ishte e natyrshme në kushtet kur ende nuk kishte studime për këto probleme, KÇN kishte meritën e shqyrtimit të situatës nën prizmin klasor e revolucionar dhe të përshkrimit me hollësi të jetës së rëndë e të mjeruar të fshatarësisë e të popullit, të shfrytëzimit të egër të tyre nga klasat çifligare-borgjeze.

Një farë përpjekjeje për të dhënë tablonë shoqërore të Shqipërisë bëri dhe kryetari i organizatës Fan S. Noli, i cili vuri re në krahinat e ndryshme të vendit apo «regjionet», siç i quante ai, një larmi marrëdhëniesh feudale-borgjeze e madje patriarkale[95]. Këto gërshetoheshin njëra me tjetrën, por në pjesën më të madhe, sipas tij, sundonin marrëdhëniet feudale e patriarkale. Për «gjysmëqytetërimin» borgjez mbetej pak vend. Noli, edhe pse bëri hapa përpara në studimin e realitetit shqiptar, nuk mundi të çlirohej plotësisht nga idealizmi.

Noli «kryeplagë» të të gjitha të këqiave konsideronte «feudalizmin», d.m.th. rendin ekonomiko-shoqëror ekzistues, i cili, sipas tij, mbante kryesisht vulën feudale. Prej tij rridhnin plagët e tjera, në sferat e tjera të jetës politike e shoqërore. Por, kur bënte analizën konkrete të «regjioneve», jo vetëm bënte një vlerësim të pasaktë të marrëdhënieve ekonomike-shoqërore të tyre, duke u dhënë parësinë në pjesën më të madhe atyre feudale e patriarkale, siç thamë, e duke nënvleftësuar marrëdhëniet e reja borgjeze, por edhe mbivlerësonte faktorët ideologjikë, fetarë e kulturorë. Nga analiza e tij krijohej përshtypja se «regjioneve» fizionominë kryesore ua jepnin jo aq marrëdhëniet ekonomike-shoqërore, sesa këta faktorë ideologjikë të trashëguar nga e kaluara[96]. Kjo vinte në kundërshtim dhe me atë që pohohej prej tij, se «kryeplaga» ishte «feudalizmi». Por te Noli përziheshin pikëpamjet e reja materialiste me ato idealiste. Ai nuk mundi të depërtonte në thellësi të ideve materialiste e socialiste. Noli nuk qe në gjendje të analizojë me qartësi e me hollësi sesi i kuptonte ai marrëdhëniet ekonomike-shoqërore të Shqipërisë dhe çka përbënte thelbin e tyre. Ai bëri vetëm disa pohime të përgjithshme lidhur me këtë. Ideologët e tjerë të KÇN, si: Halim Xheloja, Riza Cerova e të tjerë u thelluan më shumë në këto dukuri. Ata analizuan gjerësisht marrëdhëniet ekonomike-shoqërore, çifligare-borgjeze, marrëdhëniet pronësore që përbënin thelbin e tyre, kategoritë e pronave dhe të pronarëve, shfrytëzimin e egër të fshatarësisë si nga çifligarët e agallarët, ashtu edhe nga shteti.

Në këtë analizë u përfshi kryesisht fshati shqiptar, por edhe qyteti nuk u la jashtë vëmendjes. Siç thamë më lart, fshatit i vihej më shumë vula feudale, ndërsa qyteti konsiderohej si më i ndikuar nga zhvillimi borgjez.

KÇN theksonte se e keqja kryesore ekonomike-shoqërore e Shqipërisë qëndronte tek ekzistenca e pronës së madhe çifligare, e cila kishte monopolizuar një pjesë të mirë të fondit tokësor. Pronarët çifligarë me anë të këtij monopoli e lanë fshatarësinë pa tokë[97]. Ata ishin jo vetëm pronarë të tokave

93) Broshura nr. 2.
94) Broshura nr. 1, KÇN (1935), f. 39.

95) Fan S. Noli. *Vep. e cit.*, f. 237.
96) *Po aty.*
97) Broshura nr. 1, f. 39-41.

të gjëra, por edhe të pyjeve, kullotave, ujërave e të tjera. Kjo kishte krijuar një «uri të madhe» për tokën në Shqipëri, prandaj edhe problemi i tokës ishte aq i mprehtë për fshatarësinë e për vendin.

Prej ideologëve të organizatës merrej në konsideratë edhe fakti që prona çifligare kishte filluar të copëzohej e të degradohej e nuk kishte fuqinë e mëparshme. Por prapë çifligarët thuhej se kishin fuqi të madhe ekonomike e politike në Shqipëri.

Pronat e tyre të copëzuara e të jetërsuara nuk binin në duar të fshatarëve të varfër e të mesëm, por në duar të agallarëve e të fshatarëve të pasur që i shfrytëzonin fshatarët me të njëjtat metoda «feudale»[98].

Nga kjo pikëpamje nuk kuptohej si duhej ai fakt që ishin pikërisht marrëdhëniet borgjeze ato që po e gërryenin pronën çifligare dhe se këto marrëdhënie tashmë ishin bërë zotëruese kudo dhe kishin përfshirë në vorbullën e tyre edhe pronat çifligare.

Por, KÇN donte të theksonte më shumë atë që prona çifligare ishte bartëse kryesore e mbeturinave të feudalizmit dhe pengesë për zhvillimin e vendit, burim të këqiash për fshatarësinë dhe popullin dhe mbështetje kryesore e reaksionit politik.

Bejlerët e agallarët, thuhej, ishin të interesuar ta «ruanin sistemin feudal». Ata «kanë ardhur në këtë dynja që të rrojnë në kurriz të fshatarit»[99].

E gjithë e keqja e fshatarëve konsiderohej mungesa e «dherave» (e tokës). Ngaqë nuk kishin «dhera», ata nuk e bënin bukën e tyre. Mospasja e dherave është burimi i të gjitha halleve. «Balta e Shqipërisë ishte bërë si floriri», sepse pronarët e pangopur me anë të grabitjeve e tapive të rreme i kishin bërë të tyret tokat e fshatarëve. Ata i linin fushat e gjera të papunuara ose i kthenin në kullota për të fituar më shumë, duke i dhënë me qira të çelikët. Fshatarët «pa dhera», të cilët nuk prodhonin as bukën e disa muajve në vit, për të siguruar jetesën detyroheshin që të punonin te bejlerët e agallarët në kushte shumë të rënda dhe ktheheshin në skllevër të tyre. Ata shfrytëzoheshin deri në palcë nga bejlerët e agallarët, të cilët u merrnin pjesën më të madhe të prodhimit, me anë të detyrimeve të shumta dhe i detyronin të punonin angari për ta, madje edhe si shërbëtorë në shtëpitë e tyre. Pjesë e rentës «feudale» konsideroheshin edhe taksat e rënda shtetërore, më e rënda e të cilave ishte e dhjeta, që cilësohej me të drejtë si taksa më primitive e më shkatërrimtare për fshatarësinë. Fshatari ishte katandisur në një gjendje të tillë, thoshte KÇN, që nuk mbahej me bukën që prodhonte vetë, por e blente bukën në qytet me sakrifica të mëdha[99/1]. Grabitjet e shumta që i bëheshin fshatarësisë dhe gjendja e saj e mjeruar tregonte se asaj i ra me të gjithë forcën «kopaçja e triumfit të legalitetit». Çifligarët, me Zogun në krye, duke vendosur pushtetin e tyre ekonomik e politik, i katandisën fshatarët të dëshironin bukën e gojës.

Këtu përshkruhej me hollësi gjendja e të gjitha grupeve apo shtresave fshatare, të bujqve të çifligjeve, si dhe të kategorive të fshatarësisë së lirë. Një analizë e hollësishme e gjendjes së tyre, bëhej edhe në një sërë artikujsh të Halim Xhelos me titujt «Fshatari e punëtori» e «Bujku dhe lufta e klasit në Shqipëri», si dhe të revolucionarëve të tjerë.

Çifçinjtë konsideroheshin si pjesa më e shfrytëzuar dhe pa të drejta e fshatarësisë shqiptare. Këtu përshkruheshin kushtet e rënda të punës e të jetesës, trajtimi i keq që u bëhej atyre nga çifligarët, kushtet e mjerueshme të banimit, si dhe ato sanitare. Myzeqarët dhe bujqit e tjerë në çifligjet e Shqipërisë, sipas «Lirisë Kombëtare», pasqyronin tërë «tragjedinë e bujkut shqiptar». Ata nuk kishin as «vend për varr». «Mbi kurrizin e tyre gjëmonte kërbaçi i beut, qahajajt dhe mercenarëve të tjerë»[100].

Bujqit, thuhej, punonin gjithë ditën e deri natën vonë, në shi e në breshër, si dhe në vapën përvëlonjëse të verës, për të nxjerrë bukën e tyre e të fëmijëve; «gjithë jeta e tyre ishte një punë vazhduese dhe pushimi fillonte ditën e vdekjes»[101].

Nga puna e rëndë dhe kushtet e këqia çifçinjtë ishin katandisur si fantazma me «fytyrë të verdhë si dylli, me kalamaj me bark të enjtur, të mbuluar me nga një copë thesi, që u ngjanin të vdekurve që ecnin»[102].

Halim Xheloja thoshte se këta fëmijë «me fytyrë të zeshkur, pranë kënetës, gjolit apo kasolles me baltë» të krijonin përshtypjen se «ndodheshe pranë lumit Kongo në Afrikë dhe kur kujtoheshe që je në Evropë, të ngjethet mishtë e të ngrihet leshtë e kokës përpjetë»[103].

Çifligarët në çifligjet ishin tiranë të vërtetë dhe i trajtonin bujqit si skllevërit e kohës së mesme dhe negrit e sotëm nëpër kolonitë e Afrikës[104].

Krahas gjendjes së çifçinjve përshkruhej edhe ajo e fsha-

98) Po aty.
99) Broshura nr. 2.

99/1) Broshura nr. 2.
100) «Liria Kombëtare», 1927, 15 gusht, f. 2.
101) Po aty, 15 shtator 1927.
102) Po aty.
103) Po aty.
104) Po aty.

tarësisë së lirë. Pjesa dërrmuese e saj thuhej se ishte pa tokë dhe bënte një jetë të varfër e të mjeruar[105].

Këtu paraqitej struktura e klasës fshatare: fshatarësia e pasur, e mesme dhe e varfër.

Fshatarësi e pasur konsiderohej «një shtrat i hollë i klasës fshatare», 4-5 shtëpi në çdo fshat që «kishin tokë dhe gjë të gjallë me shumicë». Në disa raste fshatarët e pasur ishin dhe fajdexhinj dhe jepnin para ose drithë me fajde. Në shumë vise thuhej se fshatarë të pasur quheshin ata që bënin tërë bukën e vitit dhe kishin 300 krerë e lart bagëti[106]. Fshatarët e pasur anonin nga bejlerët dhe agallarët me të cilët bëheshin «ortakë» për të shfrytëzuar fshatarët. Regjimi përpiqej që «këtë shtrat» (shtresë) ta bënte për vete, ta kishte si vegël politike për të mbajtur të nënshtruar fshatarësinë, ndërsa bejlerët u bënin lehtësira që të kishin mbështetje[107]. Në fakt, këta fshatarë të pasur, ashtu si dhe agallarët, bënin pjesë në borgjezinë agrare çka nuk thuhej hapur.

Fshatarësia e mesme përfshinte, sipas KÇN, fshatarët që kishin «një copë tokë dhe ca të holla» dhe që e punonin atë me mjete primitive. Po të krahasohej kjo me fshatarësinë e Evropës, ajo ishte shumë e varfër[108].

Në fshatarësinë e varfër bënin pjesë proletarët, «fshatarët pa mall e gjë», dhe gjysmëproletarët që kishin aq pak tokë e mjete sa mezi arrinin të bënin bukën e 1-2 muajve në vit, prandaj detyroheshin të punonin te çifligarët, agallarët e fshatarët e pasur. Thuhej se nuk dihej sa ishte numri i fshatarëve të varfër në Shqipëri, por mendohej se ishte i madh dhe ky numër sa vinte e shtohej. Fshatarësia e varfër thuhej se shfrytëzohej me metoda «feudale» (çifligare), por krahas tyre nga përshkrimi konkret dilte se nuk mungonte edhe shfrytëzimi borgjez i argatëve, proletarëve e gjysmëproletarëve. Pra, sado që ekzagjerohej ekzistenca e marrëdhënieve «feudale», nuk mohohej edhe prania e marrëdhënieve borgjeze.

Në analizën ekonomike-shoqërore një vend të dukshëm zinte edhe përshkrimi i gjendjes së vajtueshme të krahinave malore të Shqipërisë, sidomos atyre të Veriut. Jeta e malësive paraqitej e zymtë dhe prapambetja shumë e madhe[109].

Në mënyrë disi të hiperbolizuar pohohej se ato nuk kishin dalë «nga stadi i ekonomisë natyrore» dhe bënin një jetë patriarkale. Në fakt, gjendja nuk ishte krejt ashtu dhe marrëdhëniet borgjeze pak të zhvilluara dobët kishin depërtuar

105) Broshurë nr. 1, f. 46-48.
106) Po aty.
107) Po aty.
108) Po aty.
109) Broshurë nr. 1, f. 41-42.

dhe këtu, edhe pse bashkëjetonin me mbeturinat feudale e patriarkale e me varfërinë e tmerrshme. Kështu që për «autarki patriarkale» nuk mund të bëhej fjalë. Malësitë nuk jetonin të izoluara nga qyteti dhe të shkëputura nga tregu. Edhe pse blinin e shisnin «pak gjë», pa tregun s'mund të jetonin. Në libërth stigmatizoheshin me të drejtë institutet ekonomike, shoqërore e politike reaksionare, si: bajraktarizmi, hakmarrja, kisha, etj., si dhe mbeturinat e sistemit feudal e fisnor që e pengonin mjaft zhvillimin dhe u shërbenin klasave sunduese për të mbajtur malësorët të nënshtruar. Megjithatë, nuk mohohej edhe ai fakt që nën ndikimin ekonomik, politik e ideologjik të qytetit kjo strukturë kish filluar të tronditej[110].

Këtu përshkruhej varfëria e madhe e malësorëve që nuk siguroni as bukën e dy muajve në vit, që shkonin në qytet për të shitur «ndonjë plaçkë» e për të blerë bukë, pak kripë e ndonjë palë opinga.

Në kulmin e dëshpërimit e të varfërisë detyroheshin herë-herë të bëheshin «mercenarë për të nxjerrë bukën». Shumë e keqe paraqitej sidomos gjendja e grave malësore. Ato bënin punë të rënda, ishin kthyer në mushka barre. Por edhe burrat nuk e kishin jetën më të lehtë. Atyre u kërcënohej vdekja në çdo hap. Ligji barbar i hakmarrjes i detyronte të mbylleshin në «kullat si burgje» vite të tëra, e mbase gjithë jetën, e të mos bënin asnjë punë.

Kjo i paralizonte forcat prodhuese dhe shtonte varfërinë. Fëmijët lindnin e rriteshin në «kondita higjenike primitive dhe mortaliteti i çiliminjve ishte aq i madh sa popullata e malësisë në vend që të shtohej, pakësohej»[112]. Tuberkulozi bënte kërdinë në malësitë e veriut dhe të jugut. Këtyre njerëzve «fatzinj» shteti kërkonte t'u merrte dhe taksa.

Megjithatë, regjimi zogist ua kishte frikën malësorëve, prandaj shpërndante ndonjë lëmoshë që «tretej në duart» e krerëve e të bajraktarëve. Tani edhe malësorët kishin filluar ta kuptonin se çfarë loje po luhej në kurriz të tyre dhe cilët ishin armiqtë e tyre[113].

Halim Xheloja thoshte se gjendja e prapambetur e malësive tona i kujtonte atë të Druzëve të Sirisë. Klasat reaksionare, theksonte ai, nuk e kishin kaq të lehtë t'i nënshtronin malësorët me dhunë, prandaj përdornin mjete të rafinuara kundër tyre. Ata nuk e kishin kollaj t'i trembnin duke u treguar pushkën, sepse edhe malësorët ishin të zotët e pushkës, prandaj përdorën kundër tyre klerin reaksionar, bajraktarët,

110) Po aty.
111) Po aty.
112) Po aty.
113) Po aty.

traditat fisnore, e përçarëse me anë të hakmarrjes, përdorën mercenarizmin, tarafët etj[114].

Varfëria e mjerimi i malësive kishin arritur në një shkallë të tillë, saqë s'mbante më peri e mund të këputej. Halimi e revolucionarët e tjerë stigmatizuan intelektualët reaksionarë dhe klerikët katolikë, si Gjergj Fishtën me shokë, që përpiqeshin ta idealizonin e ta zbukuronin jetën e mjeruar të malësive dhe thurnin legjenda e «epopera prej jezuitësh»[115]. Ata kërkonin të fshihnin plagët shoqërore të malësive, si dhe faktin që klasat reaksionare donin t'i mbanin malësorët gjithnjë në varfëri, të përçarë e të nënshtruar.

Komiteti i Çlirimit Nacional bëri fajtor për gjendjen e rëndë të fshatarësisë e të popullit, edhe regjimin zogist që me politikën e tij ekonomike në të mirë të klasave sunduese dhe me sistemin e taksave e të detyrimeve të shumta, si e dhjeta, xhelepi, angaria etj., i kishte çuar masat popullore në shkallën e fundit të varfërisë.

Thuhej se regjimi zogist mbante rekord në Evropë për shfrytëzimin e egër të fshatarësisë e të popullit. Gjetkë, me taksat direkte dhe indirekte siguroheshin 30-35 për qind të të ardhurave të buxhetit, kurse në Shqipëri ato arrinin deri në 70 për qind[116]. Këtij shfrytëzimi të pashpirt i shtohej edhe ai i fajdexhinjve që bënin kërdinë mbi popullin «fukara» të Shqipërisë, duke marrë për borxhet edhe deri 150-200 për qind kamatë. «Kudo ku forcat prodhuese ishin prapa si në Shqipëri», «uzura bënte kërdinë», prandaj vetëm kur të zhdukej «sistemi feudal aziatik» do të zhdukej edhe kjo mënyrë shfrytëzimi bashkë me të tjerat[117].

Ku shkonte e gjithë kjo djersë e fshatarësisë dhe e popullit bëhej pyetja në Broshurën nr. 2. Të gjitha këto taksa e detyrime që nxirreshin nga fshatarët e masat qytetare shkonin «në gojë të ujkut» për të mbajtur kastën parazitare të bejlerëve, të kapitalistëve e të mercenarëve[118].

Si rrjedhim i marrëdhënieve «gjysmëfeudale» dhe i ndërhyrjes imperialiste që sa vinte e forcohej, ekonomia e vendit dhe në radhë të parë bujqësia, po merrte të tatëpjetën. Bujqësia nuk ishte në gjendje të ushqente as vendin, as fshatarësinë që dërrmohej gjithë kohën në punë. Fshatarët «kockë e lëkurë», të paushqyer e të paveshur, vetëm sa e gërvishtnin tokën me mjetet primitive. Niveli agroteknik i bujqësisë dhe

114) «Liria Kombëtare», 22 prill 1929, f. 4.
115) Broshurë nr. 1, f. 44-45; «Liria Kombëtare», 22 prill 1929, f. 4.
116) «Liria Kombëtare», 20 korrik 1934, f. 2.
117) Broshura nr. 1, f. 65-66.
118) Broshurë nr. 2.

rendimentet ishin mjaft të ulëta. Shqipëria harxhonte 4-5 milionë fr. ari në vit për të sjellë misër nga jashtë[119].

Kriza ekonomike, thoshin ideologët e KÇN, e tregoi akoma më qartë kalbëzimin e rendit ekonomiko-shoqëror. Ajo ishte një krizë kronike që u shoqërua nga rënia e vazhdueshme e prodhimit, papunësia, rënia e nivelit të jetesës dhe nga zitë e përhershme të bukës që bënin kërdinë. Kudo që të udhëtoje nëpër Shqipëri, në qytete e në fshatra, të zinte syri njerëzit që dukeshin sikur kishin lënguar nga ndonjë sëmundje e rëndë[120]. Në këtë situatë, Ahmet Zogu, për të mënjanuar ndonjë kryengritje, u detyrua të dredhonte, të bënte një politikë demagogjike dhe u hoq sikur ishte i gatshëm të zbatonte reforma shoqërore, ndër to edhe reformën agrare[121].

KÇN analizoi synimet ekonomike, shoqërore e politike të reformës agrare zogiste, thelbin e përmbajtjen klasore të saj, demaskoi falsitetin e demagogjinë.

Shpallja e reformës thuhej se u bë, në radhë të parë, nën presionin e luftës së fshatarësisë e të rretheve demokratike që shtronin me këmbëngulje çështjen e tokës.

Për një reformë liberale borgjeze thuhej se ishte e interesuar edhe vetë borgjezia, e cila donte të zhvillonte marrëdhëniet borgjeze në fshat. «Bujqësia feudale» me burimet e saj të varfra nuk mund t'i përballonte as shpenzimet e shtetit për aparatin burokratik etj.[122] Reforma agrare gjoja u diktua edhe nga interesi i imperializmit italian për një bujqësi të zhvilluar, në mënyrë që të siguronte lëndën e parë e prodhimet bujqësore, si dhe të kishte një treg të gjerë për shitjen e mallrave të tij. Imperializmi italian e regjimi zogist, reformën agrare kinse donin ta përdornin edhe për të trembur bejlerët e pabindur për t'i nënshtruar ata.

Pikëpamja mbi interesimin e imperializmit italian për reformën, nuk na duket e saktë, sepse imperializmi italian, siç e kishin pohuar dhe vetë zyrtarët italianë, nuk ishte i interesuar për zhdukjen e prapambetjes së bujqësisë e të vendit dhe as për dobësimin e pozitave të bejlerëve, që ishin mbështetja kryesore e tij. Po ashtu, nuk na duket i saktë as pohimi se klika zogiste donte të «krasiste» ca interesat e bejlerëve dhe të imitonte vendet borgjeze, duke krijuar mundësi e kushte për lindjen dhe zhvillimin në fshat të marrëdhënieve borgjeze. Kjo hidhej poshtë nga vetë KÇN kur thoshte se reforma agrare zogiste ishte një parodi dhe nuk e ndryshoi aspak strukturën ekonomike-shoqërore të fshatit[123].

119) «Liria Kombëtare», 26 tetor 1932.
120) Broshurë nr. 1, f. 71.
121) «Liria Kombëtare», 10 prill 1929, f. 2; Broshura nr. 2.
122) «Liria Kombëtare», 10 tetor 1930, f. 2.
123) Broshura nr. 1, f. 56.

Edhe mendimi, se po të zbatohej reforma agrare zogiste në fshatin shqiptar do të vendoseshin marrëdhëniet kapitaliste, vuan përsëri nga një farë pasaktësie. Këto marrëdhënie tashmë ekzistonin. Reforma agrare borgjeze, në qoftë se do të zbatohej, do t'i zhvillonte më tej ato e do të forconte borgjezinë agrare.

Me të drejtë vihet në dukje se regjimi nuk e mori me seriozitet reformën dhe luajti një fars me fshatarësinë, por edhe bejlerët e sabotuan atë menjëherë. Shqipëria mbeti ashtu siç ishte:«një mbretëri orientale, gjysmëbarbare me një sulltan të egër në krye», ndërsa «bujqit» vazhduan «të dergjeshin» si gjithnjë «si të mallkuar në baltë e në mizerje...»[124].

Ideologët e KÇN kishin qenë skeptikë që në fillim lidhur me zbatimin e reformës. Noli qysh në vitin 1929 kur u bë fjalë për të, arsyetonte me të drejtë se «nuk është e mundur që bejlerët të bëjnë reforma për katundarët, se nuk besojmë që të jenë aq altruistë sa të vrasin veten e tyre për të mirën e bujqve...»[125].

Reforma e vërtetë e rrënjësore, thoshte ai, është ajo që e çliron bujkun si nga bejlerët çifligarë, ashtu edhe nga shteti që është gjithashtu pronar çifligar. «A është e mundur që bejlerët t'u falin katundarëve arat dhe pastaj t'ua dorëzojnë edhe qeverinë? Jo. Atëherë reformat agrare të bejlerëve do të jenë një komedi. Reformat agrare të vërteta mund t'i bëjnë edhe do t'i bëjnë vetë katundarët për katundarët nën një qeveri të klasës katundare e punëtore. Kjo klasë është i vetmi shpëtim i Shqipërisë. Le ta organizojmë, le të përgatitim triumfin e saj mbi klasën e bejlerëve dhe arhondëve parazitë»[126].

Po sikur të ishte zbatuar reforma dhe të ishte vendosur sistemi kapitalist në fshat, thuhej nga KÇN, bujqësia do të zhvillohej më tej e do të përparonte, por fshatari nuk do të shfrytëzohej më pak, bile akoma më shumë. Shfrytëzimi kapitalist konsiderohej i egër e i pamëshirshëm, por nga forma «modern dhe me ustallëk»[127]. Bujku shqiptar, duke shpëtuar nga zgjedha «feudale» e duke rënë nën zgjedhën kapitaliste, do të binte «nga shiu në breshër».

KÇN i kushtoi një farë vëmendjeje edhe problemit të zhvillimit të marrëdhënieve kapitaliste në qytet. Zhvillimin e tyre (në fushën e industrisë) e pa më tepër si rezultat të «qëllimeve strategjike» që ndiqte imperializmi italian në Shqipëri, sesa si rezultat «të një procesi ekonomik normal»[128]. Por çështja në të vërtetë nuk qëndronte krejt ashtu. «Interesat strategjike» të imperializmit ishin në kundërshtim me zhvillimin kapitalist të vendit dhe atë të forcimit të industrisë kombëtare. Zhvillimi i industrisë kombëtare në Shqipëri gjeti pengesë e vështirësi të mëdha në ndërhyrjen e vërshimin e kapitalit të huaj. Ai u pengua edhe nga politika e dyerve të hapura e regjimit zogist dhe mungesa e një politike proteksioniste në të mirë të industrisë së vendit. Megjithë këto vështirësi e pengesa të mëdha, industria kombëtare në këto vite bëri hapa përpara.

Interesat strategjike të imperializmit kufizoheshin me zhvillimin e disa degëve të industrisë nxjerrëse si ajo e naftës, minerare dhe ndonjë industri të vogël, të cilat i interesonin atij për sigurimin e lëndëve strategjike që i mungonin (si nafta etj.), për shfrytëzimin e fuqisë së lirë punëtore dhe nxjerrjen e fitimeve të mëdha. KÇN shprehu mendimin se marrëdhëniet borgjeze në qytet, sistemi i koncesioneve kapitaliste (duke përfshirë dhe ato të kapitalistëve vendas) të shartuara në «sistemin feudal të kalbur» kishin karakter «antiekonomik», për arsye se çonin në shkatërrimin e «klasave të mesme, dyqanxhinjve, zanatçinjve, esnafit dhe në vend të tyre ngrinte klasën e kapitalistëve, të monopoleve e koncesioneve, klasën më grabitqare dhe parazitare»[129].

Kjo pikëpamje që në procesin objektiv të zhvillimit të kapitalizmit, i cili nuk varej nga vullneti i njerëzve dhe që në përgjithësi ishte një proces përparimtar, shihte më shumë anën negative të shkatërrimit të klasave të mesme e të prodhuesve të vegjël dhe që mendonte se kjo anë negative duhej të mënjanohej, ishte një pikëpamje utopike prej borgjezi të vogël.

Zhvillimi i marrëdhënieve borgjeze në fshat mbahej si dukuri progresive, ndërsa shoqëritë kapitaliste në qytet shiheshin si negative.

Është e vërtetë se shoqëritë kapitaliste të vendit, duke u nisur nga qëllimi i fitimit, nuk i shfrytëzuan si duhej e në mënyrë racionale pasuritë e vendit, dhe forcave prodhuese u dhanë një zhvillim të deformuar, por megjithatë as kjo arsye dhe as ajo e mësipërmja nuk mund të vënë në dyshim karakterin përparimtar të tyre, për zhvillimin e forcave prodhuese dhe të marrëdhënieve në prodhim. Shqipëria vuante më shumë nga zhvillimi i dobët borgjez dhe mbeturinat e feudalizmit, sesa nga dukuritë negative kapitaliste. Vetë KÇN e pranonte në përgjithësi se kapitalizmi ishte më përparimtar se feudalizmi.

Padyshim, vënia në dukje e anëve negative të sistemit shfrytëzues borgjez, si dhe e pasojave të rënda ekonomike-shoqërore të ekzistencës së rendit çifligaro-borgjez për punonjësit e qytetit ishte një gjë pozitive dhe një detyrë e orga-

124) Po aty, f. 59-60.
125) «Liria Kombëtare», 1 shkurt 1929.
126) Po aty.
127) Po aty, 10 tetor 1930, f. 2.
128) Po aty, 1 janar 1931.
129) Po aty, 20 korrik 1934.

nizatës revolucionare. Ajo analizoi gjendjen e keqe e shumë të vështirë të masave punonjëse të qytetit, të punëtorëve, zejtarëve tregtarëve e nëpunësve të vegjël etj. Të gjitha këto klasa e shtresa shfrytëzoheshin pa mëshirë e varfëroheshin. Këtu përshkruhej procesi i pauperizimit e proletarizimit të prodhuesve të vegjël, papunësia e madhe në vend që e keqësonte si situatën e tyre, ashtu dhe të klasës punëtore. Papunësia konsiderohej si një nga plagët më të rënda shoqërore të vendit. Klasa punëtore shfrytëzohej deri në palcë nga kapitalistët e huaj e të vendit. Punëtorët shqiptarë thuhej se trajtoheshin si skllevërit e «Afrikës», sidomos nga imperialistët fashistë[130].

«Liria Kombëtare» jepte fakte të hollësishme mbi kushtet tepër të vështira të punës e të jetës së punëtorëve, të cilët punonin 12-14 orë në ditë, ushqeheshin keq, flinin nëpër baraka e në mjaft raste në shi e në diellin përvëlues. Kapitalistët tregoheshin të pamëshirshëm ndaj tyre, i trajtonin shumë keq, nuk u paguanin në rregull ditët e punës, u shitnin ushqime të prishura, ua pakësonin pagesën me anë të gjobave dhe i fyenin e i përjashtonin nga puna sipas dëshirës.

Klasa punëtore e Shqipërisë ishte më e keqtrajtuara në Evropë. «Shteti modern i hajdutëve nuk ka bërë gjer më sot, dhe as mendon të bëjë një ligj mbi të drejtat e punëtorit në Shqipëri»[131]. Prandaj punëtorët shqiptarë nuk duhej ta prisnin shpëtimin nga diktatura zogiste, por duhej të luftonin deri në fund për të drejtat e tyre. Në historinë e njerëzimit nuk ka ndodhur asnjëherë që klasat shfrytëzuese «t'u kenë falur punëtorëve të drejtat e tyre, por vetë ata, i kanë fituar këto të drejta me luftë të ashpër kundër padronëve të pashpirt... Vetëm një qeveri në botë ua ka siguruar në një mënyrë që s'ka shembull (këto të drejta — V.K.) ... Kjo është qeveria e Unionit Sovjetik»[132].

Punëtorëve u bëhej thirrje që të luftonin me këmbëngulje për të drejtat e tyre, për pakësimin e orëve të punës, shtimin e pagës, për kushte më njerëzore, për liri fjale, shtypi dhe organizimi dhe shprehej besimi se klasa punëtore do të rritej, do të forconte ndërgjegjen e saj klasore dhe do të krijonte organizatat e veta profesionale[133].

Organi i KÇN i këshillonte punëtorët shqiptarë të mos mbeteshin prapa punëtorëve të vendeve të tjera në organizimin e tyre, sepse organizimi ishte «alfa dhe omega e punës që duhej bërë...»[134].

«Liria Kombëtare» demaskoi të ashtuquajturën shoqëri

130) Po aty, 15 janar 1931.
131) Po aty.
132) Po aty.
133) Po aty, 30 janar 1932.
134) Po aty.

punëtore që u krijua në Tiranë më 1932 nën drejtimin e regjimit për të mashtruar punëtorët e për të sabotuar luftën e tyre greviste, si dhe përpjekjet për krijimin e shoqërive të mirëfillta punëtore. Ajo u tërhiqte vëmendjen punëtorëve që të ishin vigjilentë, sepse «organizata punëtore e Tiranës» ishte organizatë reaksionare, vegël e regjimit kundër unitetit të punëtorëve dhe luftës së tyre[135].

KÇN kishte mendimin se kriteri themelor për gjykimin e veprimtarisë ekonomike, shoqërore e politike, të gjithë jetës së vendit, të pozitës e veprimtarisë së grupeve sociale, si dhe të individëve të veçantë, ishte kriteri klasor.

Këtij kriteri klasor në gjykimin e dukurive e situatave iu përmbajtën, si komunistët, ashtu edhe demokratët-revolucionarë.

Në materialet e KÇN dhe te «Liria Kombëtare» theksohej vazhdimisht se interesat klasore dhe lufta e klasave ishin boshti i gjithë historisë, pra dhe i historisë bashkëkohore të vendit.

Të gjitha klasat, me vetëdije ose pavetëdije, luftonin për përmbushjen e interesave të tyre. Kështu, bejlerët i siguruan me vetëdije «privilegjet e klasës së tyre mbi kurrizin e harbutëve», thoshte Fan S.Noli[136]. Çdo gjë që bëhej nga bejlerët me A.Zogun në krye, shkruante ai, «bëhej me një program klase, me një program feudal...»[137].

Përvetësimi i kësaj ideje të rëndësishme materialiste prej tij ishte një provë e forcimit të vetëdijes së tij revolucionare, e pozitave prej demokrati revolucionar. Duke polemizuar me Faik Konicën, përfaqësuesin e bejlerëve, Noli vuri në dukje luftën e papajtueshme midis vegjëlisë dhe bejlerëve e arhondëve, e cila rridhte nga fakti që këta të fundit ishin shfrytëzuesit e egër e tiranizuesit e vegjëlisë dhe i kishin shkaktuar Shqipërisë mjaft të këqia e fatkeqësi[138]. Bejlerët e arhondët ishin armiqtë kryesorë të atdheut, ndërsa «vegjëlia», «opinga» ishte shpëtimi i saj. Noli thoshte se e kishte për mburrje që rridhte nga «harbutët» e jo nga «oxhakët e grerave» dhe shprehte besimin se vegjëlia, duke zhvilluar luftën e klasave e duke forcuar vetëdijen klasore, do të hidhej një ditë në revolucion e do të çlirohej nga «feudalizmi»[139].

Por për këtë duhej përgatitje ideologjike, organizim, duhej stërvitje.

Noli kishte filluar ta kuptonte, duke nxjerrë mësime nga përvoja e Revolucionit të Qershorit të 1924, si dhe duke u

135) Po aty. 18 shkurt 1932.
136) «Republika», 27 nëntor 1930.
137) Po aty.
138) Po aty.
139) Po aty.

thelluar më shumë në faktet e ngjarjet e historisë shqiptare e të vendeve të tjera, se klasat e pasura nuk mund të hiqeshin nga skena historike «me pambuk», me të butë, por vetëm me anë të dhunës revolucionare. Kështu na mëson historia, thoshte ai[140].

Këtë bindje e shprehu dhe në veprimtarinë e tij poetike të kësaj periudhe, ku bënte një farë autokritike që nuk përdori «kërbaçin» siç duhej kundër bejlerëve gjatë vitit 1924.

Noli iu përgjigj mirë dhe me argumente edhe Faik Konicës me shokë, të cilët u përpoqën ta paraqisnin kritikën e tij si një kritikë gjoja që drejtohej kundër myslimanëve në të mirë të ortodoksve. Kjo bëhej me qëllim për ta denigruar udhëheqësin e KÇN e për të mbjellë përçarjen fetare në popull. Ai i kundërshtoi këto shpifje duke pohuar se i urrente njësoj si bejlerët e arhondët myslimanë, ashtu edhe ata ortodoksë, ashtu siç mbronte «harbutët» e të dy feve.

Ne «jemi për vegjëlinë pa ndryshim feje, — thoshte ai, — Jemi për popullin punëtor e kundër parazitëve feudalë. Jemi për shqiptarët kundër bejlerëve të turqizuar edhe kundër ortodoksëve të greqizuar[141].

Ideologët e KÇN mbajtën qëndrim edhe kundër Koço Tasit me shokë, që u përpoqën të krijonin në mërgim organizata me ngjyrë fetare, me qëllim që të përçanin popullin e të pengonin luftën e klasave. Noli e cilësoi Koço Tasin si shërbëtor të bejlerëve dhe agjent të të huajve[142]. Ai, me veprimtarinë e propagandën e tij, u shërbeu si bejlerëve ortodoksë, ashtu dhe atyre myslimanë dhe u mundua ta nënshtronte vegjëlinë e krishterë myslimane e ta përçante atë.

KÇN polemizoi edhe me organizatën reaksionare në mërgim «Bashkimi Kombëtar», e cila mbronte interesat e klasave çifligare e borgjeze dhe ishte kundër demokracisë. «Bashkimi Kombëtar» ishte vetëm kundër klikës zogiste dhe për zëvendësimin e regjimit zogist me një regjim tjetër çifligaro-borgjez. Ideologët e kësaj organizate, si Ali Këlcyra me shokë, ishin kundër lëvizjeve revolucionare, komuniste e demokratike, kundër reformave shoqërore duke përfshirë dhe reformën agrare. Ata e cilësuan luftën e klasave e atë revolucionare si diçka shkatërrimtare e pa bazë objektive, si një shpikje të njerëzve[143].

Këtë pikëpamje KÇN e hidhte poshtë dhe arsyetonte se lufta e klasave ishte forcë kryesore lëvizëse e historisë. Atë nuk e kishin shpikur revolucionarët, por kish lindur nga vetë ligjet objektive të historisë, nga shtypja dhe shfrytëzimi i egër

140) Po aty, 4 dhjetor 1930.
141) Po aty.
142) «Liria Kombëtare», 22 prill 1929, f. 1.
143) Broshura nr. 1.

i popullit, nga kundërthëniet e papajtueshme që ekzistonin midis klasave në shoqëri[144]. Ideologët komunistë të KÇN kundërshtonin pikëpamjen e Ali Këlcyrës me shokë se prona private ishte e shenjtë dhe nuk duhej të cenohej. Kjo ishte një shpikje e bejlerëve, e klasave reaksionare thoshin ata. Lufta e klasave, mendohej se duhej të zhvillohej më tej dhe duhej çuar deri në përmbysjen e rendit çifligaro-borgjez e vendosjen e rendit të demokracisë popullore.

Trajtimi i problemeve të luftës së klasave dhe shikimi i problemeve sociale nën prizmin klasor, meritë kjo në radhë të parë e komunistëve, e bëri edhe gazetën «Liria Kombëtare» një gazetë majft tërheqëse për lexuesit dhe me autoritet. Lexuesit e saj ndienin nevojën të mësonin të vërtetën mbi realitetin shqiptar, të flitej për hallet, vuajtjet e popullit dhe luftën e tij.

Një lexues i shkruante redaksisë së gazetës: «Na arriti këtu «Liria Kombëtare» e 28 nëntorit. Lënda e saj analitike dhe revolucionare na pëlqen shumë. Jemi gjithnjë të mendimit që të zbërthehen dhe të analizohen problemet shqiptare në bazë klase. Se në luftën e klasës qëndron tërë brumi i luftrave sociale-politike»[145]. Gazeta, siç thamë, në fillim u përhap pak në Shqipëri. Sikur të kish pasur atje një përhapje më të gjerë, do të kishte bërë një punë të mirë për demaskimin e klasave reaksionare e të regjimit dhe për edukimin e masave me frymën revolucionare e të luftës së klasave.

5. PËR REVOLUCIONIN POPULLOR DHE REPUBLIKËN KATUNDARE E PUNËTORE

Analiza klasore e KÇN, trajtimi i problemeve ekonomike-shoqërore e politike të vendit, nuk u bë thjesht për të teorizuar dhe as për të zhvilluar një propagandë të zakonshme, por ajo synonte në argumentimin e çështjeve themelore të luftës së masave popullore për revolucionin popullor. Problemi i revolucionit popullor ishte kurorëzimi logjik i të gjitha arsyetimeve dhe tezave të kësaj organizate.

Ky revolucion u konsiderua si shkalla më e lartë e luftës klasore për periudhën që kalonte Shqipëria, si e vetmja rrugë shpëtimi për popullin nga shtypja dhe shfrytëzimi, nga sundimi i reaksionit të brendshëm e të jashtëm.

Komunistët e kishin të qartë se lufta e klasave do të vazhdonte më tej dhe kishte detyra të tjera më pas për t'u

144) Po aty.
145) «Liria Kombëtare», 20 dhjetor 1928, f. 3.

përmbushur, në mënyrë që populli të emancipohej si duhej. Por, kjo çështje ende nuk shtrohej në këtë periudhë, sidomos nga KÇN që ishte një organizatë demokratike.

KÇN erdhi në përfundimin se asnjë reformë e regjimit ekzistues apo e ndonjë regjimi tjetër liberal borgjez nuk mund ta çlironte popullin nga skllavëria «bejlero-agallare» dhe e imperializmit fashist.

Revolucioni popullor do të ishte një revolucion me detyra demokratike-borgjeze që do t'i plotësonte ato si duhej në të mirë të vegjëlisë. Ai nuk do të udhëhiqej nga borgjezia si më parë, por nga revolucionarët, dhe duhej të siguronte pjesëmarrjen e gjerë të masave popullore në luftën për përmbysjen e rendit çifligaro-borgjez.

Programi dhe detyrat themelore të këtij revolucioni janë shtjelluar qartë e me hollësi sidomos në dy broshurat që kemi analizuar. Ky revolucion u quajt nga ideologët e KÇN zakonisht «revolucion agrar dhe social».

Kështu cilësohej shpesh si në broshura, ashtu dhe në një sërë shpalljesh si ajo e vitit 1933 si dhe te «Liria Kombëtare». Me anë të këtij termi kërkohej të nënvizohej detyra themelore e revolucionit, kryerja e reformave me rëndësi shoqërore, në radhë të parë e reformës agrare, e cila për kushtet e Shqipërisë që ishte një vend agrar me një fshatarësi që përbënte pjesën dërrmuese të popullsisë që shtypej e shfrytëzohej deri në palcë dhe aspironte e luftonte gjithë jetën për tokë, ishte çështja kryesore që qëndronte në rendin e ditës dhe kërkonte zgjidhje.

Kërkesa për zgjidhjen rrënjësore të çështjes agrare, për konfiskimin e tokave të bejlerëve, agallarëve, tregtarëve, klerikëve etj., dhe për dhënien e saj pa shpërblim fshatarësisë punonjëse përshkonte si një pe i kuq gjithë programin revolucionar të KÇN. Për këtë do të flasim më poshtë.

Që kur shpalli programin e saj të parë në vitin 1925, KÇN në mënyrë të qartë deklaroi se ky program nuk mund të përmbushej ndyshe veçse me anë të përmbysjes së klasave reaksionare dhe të regjimit në fuqi.

Idetë e revolucionit erdhën duke u pjekur gjithnjë e më shumë dhe kërkesat e detyrat e tij u shprehën për herë e më qartë e më të argumentuara.

Por KÇN, duke e shtruar çështjen e revolucionit si detyrë themelore të lëvizjes demokratike, e kuptonte se revolucioni nuk ishte një gjë e lehtë që mund të kryhej në çdo kohë e moment, por një nga proceset më të vështira e nga ndërmarrjet më serioze që kërkonte përgatitje e energji të shumta. Revolucioni kushtëzohej nga faktorët e brendshëm objektivë e subjektivë, si dhe nga situatat e rrethanat e jashtme ndërkombëtare. Komunistët e KÇN dhe demokratët revolucionarë e kishin të qartë, duke studiuar përvojën e së kaluarës dhe situatën e Shqipërisë e të Evropës, se për të bërë një revolucion popullor të vërtetë duhej kohë dhe përgatitje e madhe, duhej zgjedhur momenti i përshtatshëm për të.

Në periudhën e zbaticës revolucionare në Shqipëri e gjetkë, kur reaksioni i brendshëm dhe i jashtëm u forcua mjaft, nuk mund të flitej për kryengritje revolucionare. Lufta revolucionare me forma të tjera duhej vazhduar, por kryengritja revolucionare nuk mund të vihej ende në rendin e ditës. Kështu, kryetari i KONARE-së Fan S. Noli dhe revolucionarët e tjerë të organizatës, në vitet 1926-1927, madje dhe më vonë, edhe pse ishin për zgjidhjen e halleve të popullit me rrugë revolucionare, mendonin se gjendja e Shqipërisë dhe ajo ndërkombëtare ishin të ndërlikuara e të papërshtatshme për shpërthimin e një kryengritjeje kundër regjimit[146].

Ata ishin kundër çdo aventure që mund ta shpinte vendin në një katastrofë dhe që për mendimin e tyre s'do të bënte gjë tjetër veçse do të forconte pozitat e reaksionit dhe do ta nxiste Italinë fashiste që ta pushtonte Shqipërinë menjëherë.

Revolucionarët, me Nolin, në krye, ishin «për luftë me mend dhe përgatitje papushim»[147]. Duhej punuar me durim, me sistem e me këmbëngulje, gjersa të vinte «dita e shpëtimit dhe e lirisë».

Në deklaratën e vitit 1927 të botuar bashkëristh nga KÇN dhe Komiteti i Çlirimit të Kosovës, të hartuar nga vetë Noli, thuhej me të drejtë se «Lëvizja liberatore e popullit tonë është një punë e vështirë dhe e gjatë, sepse në realitet kemi të luftojmë jo vetëm kundër bandës së bejlerëve feudalë me Ahmet Zogun në krye, por edhe kundër forcave të mëdha që përkrahin regjimin e tij antikombëtar»[148].

Në këto kushte të vështira lufta e popullit shqiptar kundër regjimit duhej bashkërenditur me luftën revolucionare të popujve ballkanikë dhe «duhej mbështetur mbi të gjithë faktorët ndërkombëtarë të përparuar në tërë botën». Kjo deklaratë e kishte më të detajuar edhe programin që duhej të përmbushte revolucioni në të ardhmen. Ai përbëhej nga këto pika:

1) Populli shqiptar, i çliruar nga dominata e huaj, duhet të bëhet zot i fatit të tij në kufijtë e tij etnikë me një regjim republikan me të vërtetë demokratik.

2) Pasuritë e Shqipërisë duhet të gëzohen prej popullit shqiptar dhe jo prej kapitalistëve të huaj.

3) Fuqia politike duhet të jetë në duart e popullit punë-

146) «Liria Kombëtare», 15 dhjetor 1926; «Idealisti», 23 dhjetor 1926; P. Tako. *Vep. cit.*, f. 170-171.

147) Po aty.

148) Po aty, 11 maj 1927.

tor dhe jo në duar të një oligarkie bejlerësh feudalë, vegla të dominatës së huaj.

4) Toka kombëtare duhet të jetë mall i popullit punëtor dhe jo në duar të bandës së bejlerëve feudalë.

5) Lidhja vëllazërore me popujt e tjerë të Ballkanit.[149].

Dalngadalë te revolucionarët e KÇN u poq gjithnjë e më shumë ai mendim i përgjithshëm se «djajtë e brendshëm e të jashtëm» (shprehje e Nolit) nuk mund të hiqeshin veçse me revolucionin e vërtetë, në mënyrë që fitorja e popullit të ishte përfundimtare dhe jo e përkohshme si ajo e lëvizjeve të mëparshme. Kështu, Halim Xheloja në vitin 1927, thoshte se «që të lirohej bujku» dhe gjithë populli «nga zgjedha ekonomike e politike, duhet shtirë e shtrirë poshtë klasa feudale, e cila, e lidhur sot me industrialistët italianë, e mban në robëri»[150].

Halimi theksonte se nuk ishte në interes të vendit e të popullit që të kryhej një revolucion i zakonshëm demokratiko-borgjez dhe të vinte prapë borgjezia në fuqi, por këtë radhë ishte e domosdoshme ta merrte fuqinë populli dhe Shqipëria «nga një Shqipëri borgjezo-nacionale» të kthehej në një «Shqipëri të popullit për popullin...»[151]. Për këtë, vazhdonte, ai, «t'i përvishemi punës, duke patur besim të plotë në triumfin e revolucionit». Revolucioni i ri duhej të bënte pra një hap të dukshëm përpara nga ai i mëparshmi. Ai ishte revolucioni «i masave fshatare e punëtore» që nuk do të luftonte «për një regjim agallarësh e tregtarësh, po për republikën punëtore»[152].

Halimi kritikonte skeptikët që nuk besonin në fitoren e këtij revolucioni dhe u thoshte se ata nuk i kuptonin ligjet e historisë dhe nuk kishin besim në forcat e shëndosha të popullit. Me gjithë skepticizmin e tyre, revolucioni popullor, shprehej me optimizëm Halimi, do të kryhej një ditë në Shqipëri.

Një optimizëm i tillë i përshkoi edhe idetë e Fan S. Nolit e të tjerëve për revolucionin në këtë periudhë. Noli arsyetonte se, sado e vështirë dhe e ndërlikuar të ishte situata në këtë periudhë dhe sado i fortë të ishte reaksioni, koha nuk punonte për ta, po për revolucionin. Qysh në vitin 1925 ai shprehu besimin se nuk do të vononte ajo kohë që klasat sunduese të shporreshin nga fuqia. Duke u nisur dhe nga përvoja, ai thoshte: «... do të shohim prapë sa para u bën lëkura çakajve, që lehin me aq trimëri prapa gunës së Pashiçit. Ua dimë vlerën. Ua pamë kurrizin kur iknin qershorit 1924. Kemi për t'ua parë prapë dhe për herën e fundme. O burra-

149) Po aty.
150) Po aty, 15 gusht 1927.
151) Po aty,
152) Po aty.

ni!»[153]. Në vitin 1926, kur gjendja dukej e turbullt dhe kur imperializmi fashist e vuri Shqipërinë nën protektoratin italian, Noli shprehte besimin se punët nuk do të qëndronin gjithnjë kështu, «gjendja anormale e tanishme e Evropës nuk mund të vazhdonte shumë gjatë», ajo më vonë «do të kthjellohej», prandaj edhe fitorja «do të na vijë përsëri me siguri mathematike...»[154].

Ky optimizëm e besim ishin gjithnjë në rritje. Kontaktet me Kominternin e me organizatat e lëvizjet revolucionare të Evropës, sidomos vajtja e Nolit në Bashkimin Sovjetik në vitin 1927, ku mbeti i mahnitur nga fitoret e arritura në atdheun e punëtorëve e fshatarëve, ia rritën besimin akoma më shumë.

Demokrati revolucionar i shquar po bindej gjithnjë e më tepër në zhvillimin dialektik të historisë, në dinamizmin e saj. Ai po e kuptonte se çdo gjë e vjetër e reaksionare, sado e fortë të ishte në një moment të caktuar, më vonë, në sajë të ligjeve objektive, do t'ia lëshonte vendin së resë e përparimtares, e cila edhe pse ishte e dobët në fillim, do të fitonte. Ky ndryshim e përparim e kishte burimin në radhë të parë te forcimi gjithnjë më shumë i rolit të popullit në luftën revolucionare e në përgjithësi në histori, si rrjedhim i stërvitjes së tij në luftën klasore e sidomos i pajisjes me ideologji e organizim. Noli u ndikua mjaft nga koncepti materialist mbi historinë. Por siç e pati thënë dhe vetë këtë botëkuptim nuk e bëri të tijën dhe nga idealizmi nuk hoqi dorë.

Mbi themelin e kësaj bindjeje, me të përparuar ai mendonte në vitin 1928 se «koha e gjakpirësve imperialistë ka për të shkuar, ashtu si shkoi koha e hajdutëve feudalë...» dhe se punëtorët e katundarët, duke u përgatitur për sulmin final kundër tiranëve, një ditë do të korrnin fitoren përfundimtare mbi ta[155]. Dhe ai besonte se kjo fitore do të arrihej si nga populli ynë, ashtu dhe nga popujt e tjerë revolucionarë që luftonin për liri e drejtësi shoqërore.

Më pas ai me anë të figurave të njohura mitologjike që i shërbyen si mjete shprehëse të ideve të tij të përparuara, pohoi se Shqipëria, kjo «Davidkë» heroike, me luftën e saj të papërkulur e që sa vinte forcohej kundër «Goliathit» të reaksionit, do të siguronte fitoren e do të çlirohej prej tiranisë bejlero-imperialiste. «Sado të vegjël të jenë...» popujt që luftojnë për liri, thoshte ai, duke depërtuar në rolin e tyre vendimtar historik, «janë më të mëdhenj e më të fortë se të gjithë të mëdhenjtë dhe të fortët e botës»[156].

Prandaj «le të dridhen tiranët», shkruante në një artikull

153) Po aty, 7 tetor 1925.
154) Po aty, 15 dhjetor 1926.
155) «Liria Kombëtare», 11 shtator 1928.
156) «Republika», 27 nëntor 1930.

të botuar me rastin e festës së pavarësisë. Dhe në këtë ditë të shënuar për të gjithë shqiptarët, mundohej të shprehte përsëri atë «siguri absolute» se «e sotmja e tiranëve është e shkurtër dhe e nesërmja e madhe është e jona, e luftëtarëve të lirisë»[157].

Por, për të siguruar fitoren përfundimtare, duhej «luftuar me sistem pa mëshirë dhe pa pushim klasi armik i bejlerëve me larot e tyre në Shqipëri e me mbrojtësit e tyre imperialistë jashtë. Vetëm kështu do të çlirojmë prapë Shqipërinë. Dhe do ta çlirojmë pa fjalë se populli është me ne, me ne janë të gjitha klasat e shtypura të botës»[158].

Thirrje plot optimizëm e besim në fitoren e vegjëlisë i drejtoi popullit edhe në poezitë e tij të fuqishme gjithë patos revolucionar, si: «Anës lumenjve» dhe «Rend o marathonomak». Noli arriti një pikë kulmore në botëkuptimin e tij, kur e kuptoi se fitorja e revolucionit popullor dhe përmbysja e regjimit çifligaro-borgjez përbënte një ligjësi historike dhe kërkesë urdhëruese të zhvillimit dhe këtë nuk kishte forcë që ta mposhtte. Por, në përputhje me këtë ligjësi, duhej «gatitur» populli për luftë.

Përpjekjet për organizimin e luftës revolucionare u bënë si brenda, ashtu dhe jashtë Shqipërisë, por ky organizim ishte në fazën fillestare e plot mangësi. Komiteti i Çlirimit Nacional kishte mjaft të meta në këtë drejtim dhe nuk u tregua në lartësi. Ai qëndroi pothuaj i shkëputur nga Shqipëria dhe nga populli dhe u kritikua më vonë për këtë dobësi nga komunistët shqiptarë.

Në mërgim në këtë kohë kishte një pështjellim të madh në shumicën e të arratisurve, në pikëpamjet dhe metodat dhe ishte e vështirë të organizohej një front i përbashkët për luftën kundër reaksionit zogist e imperialist. Komunistët ishin ende në fillim të veprimtarisë së tyre dhe nuk mundën ta drejtonin e ta organizonin këtë punë me rëndësi. Megjithatë, disa përpjekje në këtë drejtim nuk munguan.

Komunistët e Çlirimit Nacional zhvilluan një propagandë aktive në të mirë të revolucionit dhe bënë disa përpjekje për t'i përhapur idetë e tyre në punëtorët e patriotët shqiptarë të mërgimit e në ndonjë rast edhe në Shqipëri. Ata e kuptonin se revolucioni nuk ishte një punë e lehtë, por nga më të vështirat. Ishte një art më vete që kërkonte përgatitje serioze, veprimtari teorike e praktike. Ai duhej përgatitur me kujdes që të mos degjeneronte në puç.

Kështu, Halimi, Rizai e të tjerë në këtë kohë theksuan rëndësinë e madhe të ideologjisë e të organizimit, si kushte kryesore për përgatitjen e kryengritjes revolucionare. Sigurimi i këtyre faktorëve, thoshte Halim Xheloja, ishte i domosdoshëm, në qoftë se synohej për shndërrime të thella e vendimtare. Pa organizimin dhe ideologjinë nuk mund të arrihej suksesi[159]. Iku koha e luftërave me çeta të vogla, theksonte ai, dhe nuk mund të fitohej vetëm «me pallën e Çelo Picarit», por duheshin vënë në lëvizje masat e gjera të popullit, prandaj për këtë ishte e nevojshme të siguroheshin faktorët e mësipërm[160]. Komunistët e KÇN ishin kundër metodave puçiste e lëvizjeve të papërgatitura mirë që ishin në praktikën e elementëve borgjezë e reaksionarë si brenda, ashtu edhe jashtë Shqipërisë. Konceptet dhe veprimtaria e tyre puçiste lidheshin me faktin që ata nuk luftonin për shndërrime të rëndësishme shoqërore e politike, por kërkonin të zëvendësonin një klikë reaksionare me një tjetër. Ata kritikuan pikëpamjet puçiste të «Bashkimit Kombëtar», si dhe ato iluzione të dëmshme që u përhapën para dhe pas atentatit kundër A. Zogut në Vjenë (1931), se me zhdukjen e tij gjoja populli e Shqipëria do të shpëtonin.

Edhe vetë Noli në këtë kohë kishte mendimin se «situata e Shqipërisë» nuk mund të përmirësohej «me vdekjen e Ahmetit», por për këtë duheshin marrë masa rrënjësore, duhej përmbysur rendi çifligaro-borgjez dhe sundimi italian në Shqipëri[161].

Vdekja e Ahmet Zogut për Shqipërinë, thoshte ai në mënyrë figurative, ishte një «dasmë e vogël», por populli kishte nevojë të kremtonte «dasmën e madhe» (të revolucionit — V.K.), se vetëm atëherë do të shihte ditë të bardha.

Edhe «Liria Kombëtare» shprehu pikëpamjen se popullin nuk mund ta çlironte «heroizmi i disa njerëzve» e zhdukja e një tirani, por vetëm lufta e masave të gjera popullore «për të zhdukur nga rrënjët tërë klasën parazitare të bejlerëve çifliksahibinj e të fajdexhinjve» dhe për të «hedhur në det gjithë agjentët kolonizatorë të Musolinit»[162].

Komunistët e KÇN shprehën mendimin se udhëheqësja më e mirë dhe më e sigurt revolucionare që mund ta drejtonte, ta organizonte popullin dhe ta çonte atë në revolucionin demokratik ishte Partia Komuniste[163]. Por kjo ende nuk ishte krijuar në Shqipëri dhe një ditë, siç thoshte Halimi, do të krijohej me siguri nga radhët e punëtorëve e fshatarëve. Prandaj mendohej se, derisa të krijohej Partia, udhëheqjen duhej ta merrte KÇN, e cila duhej të krijonte organizatat e saj

157) Po aty.
158) «Liria Kombëtare», 28 nëntor 1926.

159) Po aty, 15 prill 1927, f. 2.
160) *AQP*. Fondi i Grupit Komunist të Moskës. Letër e Halim Xhelos drejtuar një shoku shqiptar në Moskë në vitin 1929.
161) «Republika», 19 shkurt 1931.
162) «Liria Kombëtare», 20 mars 1931.
163) Broshura nr. 1.

në vend. Ajo do të zhvillonte propagandë e agjitacion në popull, do të mobilizonte e drejtonte masat në luftë, në fillim për plotësimin e të drejtave elementare ekonomike e politike e pastaj për përmbysjen e regjimit. Por, deri sa të arrihej këtu, duhej të bëhej një punë e mirë përgatitore[164]. Në të vërtetë KÇN nuk e vuri në jetë këtë ide, nuk zhvilloi asnjë veprimtari praktike në Shqipëri, kështu që mbeti gjithnjë në fushën e teorisë dhe nuk u tregua i aftë ta lidhë teorinë me praktikën. Edhe kjo mangësi thelbësore e organizatës dështmonte se pa u krijuar Partia Komuniste, ishte e vështirë të përmbushej programi i revolucionit demokratik.

Në vitin 1932 KÇN bëri një deklaratë në «Liria Kombëtare» se ai nuk duhej të konsiderohej një organizatë komuniste[165]. Kjo u bë me qëllim që të përballoheshin sulmet e reaksionit, i cili, për ta luftuar më lehtë, atë, e njësoi me organizatën komuniste. KÇN dha një sërë arsyesh për këtë, duke thënë se ai i vinte vetes detyra me karakter thjesht demokratik.

Organizata u mundua të forconte radhët e saj dhe të ruante prestigjin e vet në mërgim. Por këto radhë kishin filluar të dobësoheshin. Në vitin 1932 ndodhi një ngjarje me rëndësi për KÇN e lëvizjen demokratike në mërgim. Kryetari i KÇN Fan S. Noli vendosi të braktisë radhët e saj dhe u largua në SHBA ku vazhdoi tashmë jo veprimtarinë politike, por atë letrare-artistike e kulturore. Ai u mundua të shpjegojë edhe arsyet e largimit të tij në një mbledhje të gjatë që u zhvillua në organizatë.

Ky largim pothuaj i papritur i këtij demokrati revolucionar nga fusha e betejës dhe varia e «këllëçit të politikës» nga ana e tij në muze, siç deklaroi vetë[166], pas gjithë asaj veprimtarie dhe atij apogjeu të ideve të tij të përparuara, kishte një sërë arsyesh për të cilat nuk është vendi të ndalemi me hollësi.

Arsyeja kryesore për mendimin tonë ishte ajo se ai e kuptoi dhe vetë që ishin të tjerë ata që duhej të drejtonin lëvizjen revolucionare në këtë situatë shumë të ndërlikuar të Shqipërisë e të Evropës dhe se demokratët revolucionarë si ai, që nuk ishin në gjendje të bashkonin mendimin me veprimin dhe që ruanin në botëkuptimin e tyre pikëpamje idealiste, e kishin të vështirë ta vazhdonin luftën më tej. Në këtë qëndrim ndikuan dhe zhgënjimet që pësoi në mërgim, gjendja jo e mirë e shëndetit, mosha dhe situata e vështirë financiare etj., Kjo kthesë rrënjësore dhe luhatjet që pati më pas dëshmojnë se Noli nuk mundi të qëndrojë deri në fund si demokrat revolucionar konsekuent dhe i vendosur. Megjithatë, idetë e tij përbëjnë një trashëgimi të çmuar të demokracisë shqiptare.

164) Po aty.
165) «Liria Kombëtare», 29 janar 1932.
166) P. Tako, *Vep. e cit.*, f. 218.

Komunistët e KÇN e vazhduan luftën më tej. Ata vazhduan të zhvillojnë propagandën për revolucionin dhe të kenë besim në vegjëlinë e në luftën e saj revolucionare. Ata e mbrojtën organizatën jo vetëm nga sulmet e reaksionit, por edhe prej shpifjeve e sulmeve të trockistëve si Llazar Fundoja me shokë. Komunisti Halim Xhelo zhvilloi një polemikë të ashpër me Fundon, këtë element djallëzor e përçarës, këtë intrigant, i cili nuk pushoi asnjëherë të thurë intriga kundër revolucionarëve të vërtetë e të zhvillojë veprimtari sabotuese kundër lëvizjes. Fundoja hodhi baltë mbi KÇN duke e cilësuar si organizatë borgjeze dhe kishte mendimin se komunistët duhej të largoheshin prej saj. Halim Xheloja i demaskoi me gjakftohtësi e argumente pikëpamjet e tij trockiste dhe shpjegoi domosdoshmërinë e pjesëmarrjes së komunistëve në këtë organizatë për ta drejtuar e radikalizuar veprimtarinë e saj, për të krijuar dhe zgjeruar frontin e luftës për demokracinë në mërgim e në Shqipëri[167]. Kjo, thoshte Halimi, ishte jo vetëm kërkesë e luftës për demokracinë, por edhe një orientim i Komiternit.

Halimi thoshte se Fundoja e njerëz si ai nuk donin të pranonin se përpara Shqipërisë qëndronin detyrat e revolucionit demokratik e jo ato të revolucionit proletar. Revolucioni demokratik në Shqipëri nuk mund të bëhej pa pjesëmarrjen e patriotëve demokratë e të organizatave demokratike, siç kërkonte Fundoja. Të jesh komunist, i thoshte ai Fundos në një letër, nuk do të thotë të mburresh me fraza komuniste e të mbyllesh në guackën e sektarizmit, por duhet që idetë komuniste t'i përhapësh në popull[168].

Halimi mbrojti me zjarr programin demokratik të KÇN, si dhe platformën revolucionare të «Lirisë Kombëtare», që u bënë gjithashtu objekt i sulmeve të Fundos. Ai e të tjerë shprehën besimin se në luftën revolucionare kundër regjimit zogist dhe imperializmit do të hidheshin masat e gjera popullore si klasa punëtore e fshatarësia, shtresa e zejtarëve, si dhe ato të borgjezisë së vogël e të mesme.

Revolucioni demokratik nuk mund të fitonte pa pjesëmarrjen e gjerë të gjithë atyre që ishin të pakënaqur nga regjimi e imperializmi dhe që ishin të interesuar për përmbysjen e tyre. Por forcat kryesore lëvizëse të tij konsideroheshin

167) *AQP*. Fondi i Grupit Komunist të Moskës, dok. origjinal. Dosja nr. 2, 10.6.1923; Letër e Halim Xhelos dërguar një shoku në Moskë, dt. 20.7.1928; letër e datës 4.11.1928; letër e dt. 5.12.1928; letër e dt. 17.12.1928; letër e datës 24.12.1928; letër pa datë e vitit 1929.
168) *Po aty*. Letër e Halimit dt. 20.7.1928.

klasa punëtore dhe fshatarësia, klasat më revolucionare e më luftarake të shoqërisë shqiptare. Llazar Fundoja me shokë, si elementë trockistë, kërkonin ta mohonin rolin revolucionar të fshatarësisë. Halimi e hodhi poshtë pikëpamjen e tyre. Ai thoshte se nuk ishte me Trockin e menshevikët që e konsideronin fshatarësinë masë reaksionare e të paaftë, por me Leninin e bolshevikët që e mbanin për forcë të rëndësishme revolucionare[169]. Fshatarësia si klasë, edhe pse kishte një farë konservatorizmi dhe paragjykime për shkak të lidhjeve të saj me pronën private, ishte në thelb një klasë revolucionare dhe në sajë të ideologjisë e organizimit mund të kthehej në një «gjigand revolucionar». Prandaj komunistët duhej të punonin me fshatarësinë e ta hidhnin atë në revolucion.

Komunistët, thoshte Halimi, duhej të punonin me të gjitha masat demokratike. Kjo duhej të bëhej edhe nëpërmjet KÇN. Edhe propagandën e «Lirisë Kombëtare» Halimi e gjente shumë të përshtatshme për masat, sepse ajo, sipas mendimit të tij, dinte të fliste me gjuhën e kuptueshme për popullin, dinte t'ia shpjegonte popullit «teorinë scientifike kuqalashe» (revolucionare)[170]. Populli të kupton më mirë, thoshte ai, po t'i thuash «bjeri beut e agait se të kanë marrë arat. Lidhu e puno me fshatarët e punëtorët në Ballkan e në botë»[171].

Parashikohej që në frontin e gjerë antizogist e antiimperialist të tërhiqej edhe një pjesë e elementëve shfrytëzues që ishin të interesuar për përmbysjen e diktaturës reaksionare dhe të sundimit të imperializmit fashist. Por KÇN paralajmëronte se duhej pasur kujdes që të mos lejohej që ata ta shfrytëzonin fitoren e revolucionit për qëllimet e tyre dhe të sillnin në fuqi një qeveri të bejlerëve e agallarëve[172]. «Bashkimi Kombëtar» e të tjerë, thoshin komunistët, përpiqeshin që në çdo ndryshim që mund të bëhej në Shqipëri, të mos cenohej rendi çifligaro-borgjez.

Prandaj pas përmbysjes së regjimit zogist dhe kurorëzimit me fitore të revolucionit duhej të krijohej menjëherë qeveria demokratike e punëtorëve dhe fshatarëve dhe të shpallej republika e lirë e punëtorëve të Shqipërisë[173]. KÇN, kur pa edhe ngatërrimin e grupeve reaksionare në lëvizjet antizogiste, si ajo e Vlorës dhe e Fierit, dhe në ndonjë prej tyre, si e para, edhe dorën e «Bashkimit Kombëtar», e humbi besimin në këto lëvizje. Ai i bëri në mënyrë të padrejtë e të ekzagjeruar një kritikë të ashpër Lëvizjes së Fierit duke vënë në dukje kryesisht anët negative të saj, por pa mohuar edhe ndo-

169) *Po aty*. Letër e Halimit drejtuar një shoku në Moskë, v. 1929.
179) *Po aty*, dt. 3.9.1928.
171) *Po aty*.
172) «Liria Kombëtare», 10 maj 1928.
173) *Po aty*.

një anë pozitive« Këtë e bëri me anë të një deklarate që botoi në tetor të vitit 1935[174]

Në këtë deklaratë u analizuan klasat dhe shtresat, si dhe grupet politike që morën pjesë në kryengritje, prirjet puçiste e gabimet e rënda të krerëve borgjezë «të organizatës së fshehtë», lidhjet e tyre me grupet reaksionare, shkëputja e tyre nga populli dhe organizatat demokratike. Si gjenë e vetme pozitive të kryengritjes KÇN njihte atë që ajo «nxori në shesh lakuriq shkatërrimin e brendshëm të regjimit... u tregoi njerëzve brenda e jashtë Shqipërisë së i gjithë populli është kundër regjimit dhe pruri demoralizim të madh në anëtarët e regjimit»[175].

Ky ishte një vlerësim i njëanshëm dhe jo i plotë. Kryengritja e Fierit pati rëndësi jo vetëm për faktin që tregoi kalbëzimin e rendit çifligaro-borgjez, por edhe sepse ajo vuri në lëvizje gjithë ata elementë përparimtarë, e bashkë me ta dhe komunistë.

Në këtë kryengritje u aktivizuan edhe një pjesë e fshatarësisë dhe e masave qytetare. Kështu kryengritja nuk duhej nënvleftësuar. Udhëheqësi i lëvizjes komuniste Ali Kelmendi e vlerësoi pozitivisht këtë kryengritje. Ai e quajti atë «pagëzimi i parë i zjarrit dhe guri i provës për komunistët shqiptarë, provë të cilën ata e kaluan me nder dhe e treguan veten e tyre si vëllezër të denjë të komunistëve të vendeve të tjera»[176].

Komunistët e arrestuar, përpara torturave të pashembullta të xhandarëve të A.Zogut dhe para gjyqit ushtarak, vazhdonte ai, «e mbajtën veten si heronj të vërtetë dhe i treguan gjithë popullit shqiptar se komunistët janë luftëtarët më të guximshëm dhe më konsekuentë kundër diktaturës së Ahmet Zogut»[177]. Ali Kelmendi e kritikoi qëndrimin sektar të KÇN ndaj Lëvizjes së Fierit dhe nënvleftësimin që i bëhej asaj prej tij.

KÇN duhej t'i kishte vlerësuar lëvizjet antizogiste, edhe pse të dobëta e të shkëputura nga masat e gjera, si një provë e zhvillimit me sukses të luftës klasore në Shqipëri dhe e akumulimit të forcave e përvojës për beteja më me rëndësi.

KÇN si te «Liria Kombëtare», ashtu dhe në broshurat formuloi një sërë pikash të programit demokratik që do të vihej në jetë pas fitores së revolucionit, të cilat ishin pak a shumë ato që u përmendën në fillim[178].

174) *AQSh*. Fondi i MPB. dosja 200. Mentar Belegu. *Kryengritja antizogiste e Fierit e vitit 1935* (disertacion i shkallës II, dorëshkrim në Bibliotekën Kombëtare).
175) *Po aty*.
176) *AQP*. Raport i Ali Kelmendit drejtuar Kominternit, 14.12.1936.
177) *Po aty*.
178) Broshura nr. 1; Broshura nr. 2; «Liria Kombëtare», 30 gusht 1932.

Në qendër të programit, siç thamë, ishte revolucioni agrar dhe zbatimi i reformës agrare rrënjësore. Me zbërthimin e këtij programi agrar merrej në mënyrë të veçantë broshura nr. 2 e komunistëve të KÇN, e cila shpjegoi me hollësi sesi reforma agrare rrënjësore që do të vihej në jetë pas revolucionit, do të konfiskonte të gjitha tokat e pasuritë e tjera të bejlerëve, agallarëve, tregtarëve, klerikëve, dhe këto toka e pasuri do t'ua shpërndante pa shpërblim fshatarëve pa tokë e me pak tokë proletarëve e malësorëve, madje dhe kurbetlinjve që dëshironin të ktheheshin në vendin e tyre[179]. Për herë të parë, thuhej aty, fshatari i shtypur dhe i shfrytëzuar deri në palcë, që gjithë jetën e tij kish dëshëruar bukën e gojës dhe që nuk kish pasur tokë «as për varr», do të bëhej zot i «dherave» dhe do të punonte për të gëzuar punën e tij dhe jo për t'ia rrëmbyer të tjerët frutin e punës së vet.

Edhe «Liria Kombëtare» nuk pushoi së propaganduari rëndësinë e reformës agrare revolucionare. Ajo thoshte se, kur revolucionarët të merrnin pushtetin, nuk do të vepronin siç veproi regjimi zogist që nxori një ligj me 87 nene për të mashtruar fshatarësinë dhe nuk bëri asgjë, por do t'i binin fare shkurt dhe do të plotësonin me vendosmëri kërkesat e ligjshme të fshatarësisë[180].

Regjimi demokratik që do të vendosej, «nuk do të mjaftohej vetëm me reformën agrare, por do t'i ndihmonte fshatarët e varfër edhe financiarisht për të blerë plugje, farë, gjë të gjallë... Ky do të jetë çlirimi i vërtetë i fshatarësisë. Këtë gjë s'e ka bërë asnjë shtet kapitalist»[181]. Një program i tillë, thuhej, ishte përmbushur vetëm në Bashkimin Sovjetik.

Përveç shndërrimit agrar, do të kryeheshin edhe reforma të tjera me rëndësi. Republika punëtore e katundare do të garantonte me ligj të drejtat dhe liritë qytetare, si liria e fjalës, e shtypit, liria e organizimit në organizata të ndryshme etj. Një pikë me rëndësi e programit ishte anullimi i traktateve italo-shqiptare dhe i të gjitha koncesioneve e monopoleve imperialiste dhe të kapitalistëve të mëdhenj shqiptarë. Klasës punëtore do t'i siguroheshin të drejtat politike e profesionale dhe, në radhë të parë, e drejta e grevës, për ta mbrojtur nga fuqia arbitrare e punëdhënësve; do të kufizoheshin orët e punës në ndërmarrje, do të rritej paga, gjithashtu do të sigurohej ajo në raste fatkeqësish e sëmundjesh. Për të përmirësuar jetën e popullit do të merreshin edhe masa të tjera ekonomike. Do të anuloheshin menjëherë borxhet që punonjësit u kishin fajdexhinjve. Të ardhurat e shtetit do të përdoreshin

179) Broshura nr. 2.
180) «Liria Kombëtare», 10 tetor 1930; 8 gusht 1932.
181) Po aty, 10 tetor 1930, f. 2.

për nevojat e tij, për ngritje spitalesh, shkollash, ndërtim rrugësh e tharje kënetash. Këto jo vetëm do të krijonin front pune për popullin, por edhe do ta vinin vendin në rrugën e përparimit. Një masë e rëndësishme konsiderohej reformimi i arsimit mbi baza demokratike, kombëtare dhe laike.

Ky program, siç shihet, nuk i kalonte caqet e revolucionit demokratiko-borgjez. Por komunistët thoshin se këto nuk ishin caqet e fundit dhe më vonë do të kalohej në shndërrime të thella shoqërore për t'i çliruar punonjësit plotësisht nga shfrytëzimi.

KÇN propagandoi krahas ideve të revolucionit edhe idetë e vëllazërimit dhe të bashkërenditjes së luftës me popujt e tjerë revolucionarë, sidomos me popujt e Ballkanit. Duke qenë nën ndikimin e drejtpërdrejtë të Kominternit dhe të Fedaratës Komuniste Ballkanike, përhapi idenë e krijimit të një fronti të përbashkët antiimperialist e antishovinist në Ballkan dhe të shfrytëzimit të faktorit revolucionar botëror. KÇN në këtë periudhë, ashtu si shumë organizata revolucionare të Ballkanit, bënë të vetën edhe parullën e krijimit të Federatës së popujve ballkanikë pas çlirimit të tyre nga zgjedha imperialiste e shoviniste. Kjo ide për shumë revolucionarë të kohës, siç ka thënë shoku Enver Hoxha, «ishte më tepër një parim lidhur me bashkëpunimin luftarak të klasës punëtore dhe të popujve të Ballkanit kundër regjimeve monarkiste feudale. Perspektiva e kësaj çështjeje ishte e paqartë dhe e mbyllur»[182].

Koha vërtetoi se teza e Federatës Ballkanike ishte utopike, e parealizueshme dhe ajo u shfrytëzua më vonë nga «komunistët» jugosllavë ose titistët për qëllime shoviniste e aneksioniste.

KÇN mbështetjen kryesore të popujve të vegjël për liri e pavarësi konsideronte Bashkimin Sovjetik, i cili thuhej se «frymëzonte popujt e robëruar, ngjallte dhe forconte shpresën e çlirimit në zemrën e çdo të shtypuri»[183].

Në kohën kur fuqitë fashiste e imperialiste po përgatiteshin për luftë dhe po u kërcënoheshin popujve në mënyrë të hapur me anë të ndërhyrjeve dhe agresioneve, KÇN demaskoi me ashpërsi fashizmin dhe imperializmin në përgjithësi. Fashizmin e konsideronte rrezikun kryesor të lirisë e të pavarësisë së popujve. Komunistët e KÇN në vitin 1935 e vlerësuan fashizmin si pjellë të kapitalizmit në fazën e krizës së rëndë, si prirje të borgjezisë reaksionare për të sunduar mbi proletariatin e masat punonjëse me anë të dikta-

182) Enver Hoxha. *Titistët* (Kujtime). Tiranë, 1982, f. 260.
183) «Liria Kombëtare», 30 gusht 1932.

turës së egër terroriste, pasi u pa se metodat liberale borgjeze nuk patën sukses.

«Klasa kapitaliste (fabrikantët, bankierët dhe zengjinët e tjerë), — thuhej në «Liria kombëtare», — e panë që këtej e tutje nuk ishte e mundur më t'i mbajnë popujt nën grushtin e tyre me metoda demokratike dhe zunë të ngrenë diktatura»[184].

Fashizmi, thuhej aty, nuk ishte kudo njësoj, ndryshonte sipas kushteve e rrethanave të çdo vendi. Sipas Halim Xhelos, të gjitha regjimet fashiste kishin dy tipare të përbashkëta: shovinizmin e nacionalizmin dhe demagogjinë shoqërore.

KÇN përkrahu të gjitha nismat e lëvizjet evropiane e botërore përparimtare të luftës kundër rrezikut fashist dhe të luftës imperialiste në përgjithësi.

Kështu ai përshëndeti nismën e Romen Rolanit, Anri Barbysit e të tjerëve për thirrjen e një kongresi botëror kundër luftës[185]. Në këtë kongres mori pjesë vetë kryetari i KÇN Fan S.Noli.

Halim Xheloja në këtë kohë lavdëroi qëndrimin burrëror të Gjergj Dimitrovit me shokë në gjyqin e Laipcigut, të cilët demaskuan hapur regjimin gjakatar nazist dhe mbrojtën me dinjitet idetë komuniste.

Për Halimin e komunistët e tjerë Dimitrovi ishte jo vetëm «hero i proletariatit të përbotshëm», por edhe një njohës i mirë dhe përkrahës i flaktë i lëvizjes revolucionare shqiptare[186].

Në vazhdim të luftës për demokracinë kundër imperializmit fashist, në kohën kur po përgatitej agresioni fashist kundër vendit, komunistët e KÇN bënë përpjekje për t'i bërë ballë këtij rreziku të madh që po i kanosej vendit dhe në vitin 1936 u munduan të organizonin për herë të parë frontin popullor në mërgim. Por kjo përpjekje nuk u kurorëzua me sukses për arsye të divergjencave të thella që kishte në radhët e të arratisurve shqiptarë në mërgim, si dhe të dobësive organizative të Komitetit. Pas kësaj KÇN e ndërpreu veprimtarinë si organizatë, ndërsa komunistët shqiptarë me Ali Kelmendin në krye në këtë kohë, po korrnin sukses në luftën për demokracinë dhe po e çonin luftën më tej.

Propagandën revolucionare në mërgim kundër regjimit zogist dhe imperializmit fashist e vazhduan gazetat revolucionare «Populli» e pastaj «Sazani», që u botuan nga komunistët

184) Po aty, 26 shkurt 1935.
185) Po aty, 30 gusht 1932.
186) Po aty, 25 janar 1934.

shqiptarë të Lionit (Francë). Ndihmesa e tyre për përhapjen e ideve demokratike e antifashiste ishte gjithashtu e rëndësishme.

Veprimtaria e KÇN zgjati një dhjetëvjeçar. Kjo organizatë edhe pse nuk pati suksese të rëndësishme në terrenin praktik revolucionar, u la brezave revolucionarë të Shqipërisë një trashëgimi të vyer ideologjike e kulturore.

KREU V

IDETË KOMUNISTE DHE DEMOKRATIKË NË SHQIPËRI

Vitet 30 bëhen akoma më interesante dhe përbëjnë një etapë me rëndësi zhvillimi, zgjimi e përparimi mendor, po të kemi parasysh sidomos daljen në skenë e përhapjen e ideve komuniste në Shqipëri, si dhe zhvillimin e mëtejshëm të pikëpamjeve politike-shoqërore demokratike. Kjo ishte periudha kur mendimi përparimtar, e komunist, falë kushteve objektive e subjektive të historisë sonë, i dha një ngjyrë dhe fizionomi të re ideologjisë shqiptare dhe luftës klasore në vend. Në kushtet e rënda ekonomike, shoqërore, politike e kulturore lindi ai faktor subjektiv me peshë i zhvillimit progresiv dhe i luftës revolucionare siç ishte ideologjia revolucionare. Ajo ishte antipodi i ideologjisë reaksionare dhe i reaksionit në përgjithësi. Idetë komuniste e demokratike morën zhvillim e përhapje në Shqipëri.

Për lindjen e përhapjen e tyre një rol të dorës së parë luanin kushtet ekonomike-shoqërore e politike të vendit tonë, si dhe forcimi i luftës së klasave.

Gjendja e rëndë dhe e mjerueshme e popullit, shfrytëzimi i egër i tij, mungesa e të drejtave, sidomos të klasës punëtore e fshatarësisë, bënë që të shtohet pakënaqësia e urrejtja e masave ndaj klasave sunduese e regjimit, të rritet lufta e

tyre klasore në forma të ndryshme. Kjo u pasqyrua në aspiratat, mendimet e dëshirat e vetë klasave të shtypura e të shfrytëzuara, por në mënyrën më të përparuar e më të qartë në idetë komuniste e demokratike të kohës.

Rëndësinë e kushteve objektive të vendit tonë për lindjen, zhvillimin e përhapjen e ideve revolucionare në mënyrë sintetike e shumë të qartë e ka shprehur shoku Enver Hoxha, i cili thotë: «Kur analizojmë zhvillimin shoqëror të vendit tonë, shohim se njerëzit dhe klasat (punëtore dhe fshatare) dëshironin që të ndryshonte gjendja e tyre e vajtueshme shoqërore, të ndryshonin marrëdhëniet e vjetra në prodhim. Kjo dëshirë ishte rezultat i vuajtjeve reale, i gjendjes shoqërore materiale, që ata e ndjenin në kurrizin e tyre, ishte rezultat i njohjes së kësaj gjendjeje që solli te ata një ndryshim në ndërgjegje dhe në ide, që u hapte atyre perspektivën e organizimit të forcave për të bërë ndryshime materiale në shoqërinë tonë, e cila zhvillohej ngadalë. Qe pra zhvillimi objektiv që krijoi kushtet për përhapjen e ideve të reja, të cilat gradualisht u konkretizuan dhe hodhën në veprim masat e gjera punonjëse...»[1].

Natyrisht, me këtë proces njohjeje të gjendjes së vet nga ana e klasave përparimtare dhe të formimit të vetëdijes klasore të tyre nuk kuptohet thjeshtë procesi spontan dhe konstatimi i zakonshëm i fakteve të jetës reale e interesave klasore, por në radhë të parë pasqyrimi i gjendjes së tyre në fillim në kokën e përfaqësuesve më të mirë të këtyre klasave, formulimi i ideve më të përparuara nga ana e tyre, pastaj futja e këtyre ideve në mendjen e masave popullore, dhe materializimi i tyre në lëvizjet popullore. Pra, që ideologjia e re të përhapej në Shqipëri e të kthehej në forcë materiale, të përparimit, duheshin si faktorët objektivë, ashtu edhe faktorët subjektivë, si përpunimi i saj nga revolucionarët, ashtu dhe organizimi i luftës revolucionare.

Lufta e klasës punëtore dhe e fshatarësisë, si dhe e masave të tjera punonjëse për të drejtat ekonomike, shoqërore e politike solli përparime si në të gjitha fushat edhe në fushën e mendimit e të ideve. Pa këtë luftë relativisht të ashpër klasore kundër reaksionit të brendshëm e të jashtëm që në këto vite mori përpjesëtime të dukshme, pa acarimin e kontradiktave midis popullit dhe reaksionit çifligaro-borgjez e imperialist, nuk mund të lindte e të forcohej ideologjia revolucionare shqiptare.

Nga ana tjetër, përpjekjet e komunistëve dhe të elementëve përparimtarë për të përpunuar dhe për të formuluar një

1) Enver Hoxha. *Raporte e fjalime 1970-1971*, f. 119-120.

ideologji që t'u përgjigjej detyrave të kohës dhe aspiratave të popullit, synonin pikërisht në ngritjen e lëvizjeve revolucionare të masave në një nivel më të lartë, në forcimin e luftës për shndërrime shoqërore demokratike.

Kështu, me gjithë vështirësitë e mëdha të kohës, prapambetjen e thellë të vendit dhe regjimin e egër tiranik zogist, ata bënë një punë të mirë kritike e teorike dhe gjatë procesit të përpunimit të ideve u munduan të komunikojnë jo vetëm me opinionin publik përparimtar, por edhe me masat popullore. Ideologët revolucionarë ishin kundër teorizimit dhe erudicionit bosh, kundër shkëputjes së teorisë nga praktika revolucionare. Komunistët në mënyrë të veçantë, nuk pritën që t'i përpunonin e t'i rafinonin deri në fund idetë e tyre e pastaj të hidheshin në veprim revolucionar, por u munduan t'i vënë ato në jetë menjëherë.

Një kusht favorizues për përhapjen e ideve komuniste dhe demokratike revolucionare në Shqipëri, siç e kemi vënë në dukje dhe në fillim, ishte mungesa e partive politike të klasave reaksionare, siç ka thënë shoku Enver Hoxha[2].

Kjo e dobësonte deri në një farë shkalle monopolin e klasave sunduese në fushën ideologjike dhe bënte të mundur që idetë revolucionare të përhapeshin më lehtë sesa në kushtet e ekzistencës së këtyre partive. Megjithatë, edhe në këto kushte klasat sunduese nuk e lejuan konkurencën e lirë të ideve. Ideologjia komuniste ishte e ndaluar ashtu si vetë lëvizja që e lindi atë. Ajo vepronte në ilegalitet si dhe në mënyrë të tërthortë duke shfrytëzuar mjetet e organet legale të shtypit. Edhe ideologjia demokratike kishte kushte të vështira. Ajo ndodhej nën mbikqyrjen e vazhdueshme e të rreptë të regjimit, i cili i krijonte vështirësi të shumta e pengesa. Mbi shtypin demokratik qëndronte varur gjithnjë si shpata e Damokleut kërcënimi i censurës zogiste dhe i masave policore. Regjimi i A. Zogut, ky «regjim gjakatar» dhe «satrapësh»[3] siç e ka cilësuar shoku Enver Hoxha, i persekutonte ideologët e veprimtarët revolucionarë dhe shpesh merrte masa drakoniane kundër tyre. Të thoshe të vërtetën revolucionare në atë kohë të rëndë duhej të kishe kurajë, trimëri, dhe mençuri, cilësi këto të rëndësishme e të domosdoshme për përhapjen e saj, siç thotë shkrimtari komunist gjerman Bertold Brehti. Duhej të mos merrje parasysh asnjë rrezik e vështirësi, të qëlloje në shenjë, ta thoshe të vërtetën në një mënyrë të qartë, të thjeshtë që ta kuptonin menjëherë ata për të cilët ajo destinohej.

Dhe në të vërtetë kështu u veprua. Censura e regjimit ishte, ashtu siç thoshte K. Marksi për censurën prusiane, një për-

2) Enver Hoxha, *Vepra*, vëll. 16, f. 237.
3) *Po aty*, vëll. 5, f. 187, Tiranë, 1970.

pjekje për të siguruar monopolin e klasave sunduese në fushën e mendimit, për t'i mbajtur mendjet e njerëzve nën tutelën e këtyre klasave, për të penguar përhapjen e së vërtetës, për ta mbytur atë, për të shpallur si arsye të vetme të shoqërisë arsyen e këtyre klasave[4]. Por kjo, me zellin e saj të tepruar dhe në kundërshtim me kërkesat objektive të zhvillimit, në vend që ta frenonte mendimin e lirë, e nxiste atë për të gjetur një qind mënyra që të depërtonte në opinionin publik. Ajo bëri që ky mendim i lirë të pritej me padurim nga opinioni përparimtar dhe populli e të bëhej si buka, si ajri. Dhe me të vërtetë, në vitet e regjimit zogist komunistët dhe elementët përparimtarë bënë përpjekje jo të pakta për të komunikuar me popullin, duke vënë kryet në torbë, duke kapërcyer rreziqe e vështirësi të panumërta. Përveç kësaj vështirësie që i krijonte ideologjisë revolucionare regjimi policor, një vështirësi tjetër e madhe për të ishte mungesa e një partie të vërtetë revolucionare në Shqipëri në këtë kohë, të pajisur me një platformë dhe organizim të vërtetë revolucionar. Lëvizjet komuniste e demokratike ishin të thërrmuara e të shpërndara, me grupe e platforma të veçanta e të panjësuara. Vetëm Partia Komuniste do të mund të krijonte një sistem të shëndoshë e harmonik të ideve, të përcaktonte si duhej detyrat strategjike e taktike të lëvizjes dhe t'i përhapte idetë revolucionare në gjithë popullin, t'i kthente ato në forcë materiale të vërtetë të shndërrimit shoqëror. Megjithatë, edhe në këto rrethana, komunistët u munduan të formulojnë një farë platforme me kërkesa si demokratike, ashtu edhe komuniste dhe të ndikojnë me pikëpamjet e tyre mbi lëvizjet punëtore, demokratike dhe antifashiste, si dhe mbi ideologjinë demokratike të kohës.

Organet më të shquara të shtypit demokratik të periudhës që ishin nën ndikimin drejtpërdrejtë të ideve komuniste, ishin një mjet i përshtatshëm për përçimin e tyre në popull. E gjithë lufta popullore e periudhës mbante vulën e këtyre ideve.

I. IDETË KOMUNISTE

Idetë e para komuniste në Shqipëri lindën nga fundi i viteve 20 të shekullit tonë. Me krijimin e grupeve komuniste, në fillim të atij të Korçës (më 1929) e pastaj të grupeve të tjera, ato morën dalngadalë zhvillim dhe u përhapën në gjithë vendin. Në vitet '30 idetë komuniste u përhapën në mjaft qytete e krahina qoftë me anë të grupeve, qoftë dhe me anë të elementëve të veçantë me formim marksist-leninist. Shoku

4) Marx-Engels, Werke — Band i Dietz Verlag Berlin, f. 4-39.

Enver Hoxha ka vënë në dukje se faktori themelor objektiv për lindjen dhe përhapjen e tyre ishte ekzistenca e klasës punëtore shqiptare dhe lufta e saj për të drejtat e veta dhe të të gjithë popullit. Kjo vihej re sidomos në Korçë ku kishte një klasë punëtore relativisht më të fuqishme, e cila ndikonte pozitivisht tek rinia dhe inteligencia përparimtare. Kjo ishte një nga arsyet kryesore që Grupi Komunist i Korçës ishte grupi me platformën dhe veprimtarinë më të shëndoshë në Shqipëri. Një arsye tjetër e fortë ishte ndihma e madhe dhe orientimi i drejtë që i dha këtij grupi që në fillim Ali Kelmendi.

Në veprën e tij monumentale «Kur lindi Partia (kujtime)» që përshkohet nga analiza e thellë materialiste-dialektike, nga partishmëria militante proletare dhe historizmi i vërtetë, vepër e shkruar mbi bazën e fakteve dhe të argumenteve të fuqishme, me një stil letrar e lapidar të rrallë e emocionues, shoku Enver Hoxha duke përshkruar burimet e rrënjët e Partisë Komuniste Shqiptare, trashëgiminë e saj shoqërore, ideore e kulturore, përshkruan edhe idetë e para komuniste në Shqipëri, rritjen e fuqizimin e tyre, bazën shoqërore dhe rolin e shquar të këtyre ideve.

Ky problem trajtohet edhe në vepra të tjera të shokut Enver Hoxha. Duke folur për fillimet e lëvizjes dhe të ideve komuniste në vendin tonë, ai thotë në një nga veprat: «Aty nga viti 1928, në shohim shenjat e një lëvizjeje masash që sapo kish filluar të dukej në Korçë, ku elementët përparimtarë punëtorë flisnin më hapët për komunizmin dhe idetë e mëdha të Revolucionit të Tetorit, kurse në vendet e tjera të Shqipërisë elementët përparimtarë të shkëputur dhe sidomos intelektualë që ktheheshin nga jashtë ku kishin shkuar për të mësuar, përhapnin deri në një farë shkalle idetë e Marksit...»[5].

Në veprën «Kur lindi Partia (Kujtime)», vlerësohet pjekuria dhe zgjuarësia e punëtorëve korçarë, të cilët «edhe pse nuk kishin shkollë» «preokupoheshin seriozisht për hallet e problemet e kohës» dhe «ndikimi i punëtorëve te nxënësit, që në atë kohë i quanin studentë, ishte i madh...»[6]. Këtu theksohet ai fakt se klasa punëtore, sidomos në Korçë, ku ishte e zhvilluar, kishte një rol me rëndësi në lindjen e forcimin e ideve komuniste. Punëtorë si Koci Bakoja e të tjerë, thotë shoku Enver, lexonin literaturë marksiste si «Manifesti i Partisë Komuniste» i K. Marksit dhe F. Engelsit, etj, dhe këto libra

5) Enver Hoxha. *Çështje të revolucionit dhe të ndërtimit socialist*, vëll. I, Tiranë, 1978 (Raport në Kongresin I të PKSh), f. 290.

6) Enver Hoxha, *Kur lindi Partia (Kujtime)* Tiranë, 1982, f. 22, 34-35.

ua jepnin dhe nxënësve për t'i lexuar. Klasa punëtore e vendit tonë edhe pse ishte e vogël në numër, ishte klasa më revolucionare e shoqërisë shqiptare. Një meritë të shquar për orientimin e lëvizjes komuniste shqiptare (në fillim të Grupit të Korçës e pastaj edhe të komunistëve të tjerë) me një vijë të drejtë dhe për edukimin e saj me idetë marksiste-leniniste, shoku Enver i atribuon udhëheqësit kryesor të lëvizjes, Ali Kelmendit[7]. Aliu ishte një militant komunist me përgatitje të mirë teorike, një organizator e drejtues i talentuar dhe luftëtar i vendosur për çështjen e komunizmit. Ai së bashku me komunistët e tjerë, si: Mihal Lakon me shokë, punuan me ngulm dhe pa u lodhur duke u mbështetur dhe në orientimet e Kominternit, që të formulohej një platformë e shëndoshë komuniste, që ajo e idetë komuniste në përgjithësi të bëheshin mbështetje për edukimin e komunistëve, si dhe për veprimtarinë e lëvizjen revolucionare në Shqipëri.

Komunistët shqiptarë i përvetësuan idetë marksiste-leniniste në radhë të parë «nëpërmjet praktikës revolucionare» duke «luftuar të gjitha forcat feudale e të borgjezisë, regjimin e tyre reaksionar që shtypte popullin»[8]. Ata nuk u ndikuan, thotë shoku Enver, nga teoritë e rrymat borgjeze «Ne bëmë edhe pa i njohur teoritë e tyre filozofike, bile më mirë që nuk i mësuam, se do të na ngatërronin», thotë shoku Enver Hoxha[9].

Për ta një rëndësi shumë të madhe kishte përvetësimi i ideve marksiste-leniniste. Pa këto ide, nënvizon ai, ata «do të sorollateshin si qorra dhe si skllevër në shekuj»[10]. Pra, përvetësimi dhe përhapja e ideve komuniste, qoftë dhe në formën fillestare e jo të plotë, kishte rëndësi të madhe për fatet e vendit, për perspektivën e luftës revolucionare.

Në vitin 1930 kur Ali Kelmendi erdhi për herë të parë në Shqipëri, vuri re se përhapja e ideve komuniste ishte në fazën fillestare, niveli ideologjik i komunistëve ishte i ulët dhe propaganda komuniste ishte një propagandë e thjeshtë kundër shfrytëzimit të popullit, sidomos të klasës punëtore, kundër regjimit zogist dhe imperializmit fashist, Në raportin që i drejtonte Kominternit në vitin 1932, Aliu e vinte mirë në dukje këtë fakt dhe theksonte se shumë nga shokët komunistë nuk kishin lexuar ende «asnjë broshurë komuniste» dhe nuk kishin «asnjë kuptim të qartë mbi programin dhe taktikën komuniste»[11]. Prandaj ishte e nevojshme, thoshte ai, të botohe-

7) *Po aty. Çështje të revolucionit ...*, f. 293; *Kur lindi Partia*, f. 18-19.

8) Enver Hoxha. *Raporte e fjalime 1970-1971.* f. 103-104.

9) Enver Hoxha. *Raporte e fjalime 1967-1968*, f. 324.

10) *Po aty.*

11) *AQP.* Ali Kelmendi. *Raport mbi aktivitetin e tij dhe të grupeve komuniste në Shqipëri*, dt. 7.3. 1932. Fondi i Kominternit për Shqipërinë, lista nr. 1, dosja 13.

shin me urgjencë disa broshura komuniste nga komunistët shqiptarë në mërgim dhe këto të dërgoheshin në vend për edukimin e komunistëve me njohuritë e para marksiste-leniniste. Në këtë drejtim u bë një farë pune dhe u sollën në mënyrë të fshehtë materiale marksiste-leniniste në gjuhën shqipe e në gjuhë të huaj. Me anë të tyre, si dhe me punën e komunistëve të formuar, si Aliu me shokë, u përhapën idetë komuniste në Shqipëri në punëtorë e zejtarë, nxënës e intelektualë.

Grupet komuniste të formuara në këto vite ishin të shpërndara e pa njësi ideologjike e organizative. Sa grupe kishte, aq kishte edhe platforma e ide të veçanta. Kjo pengoi jo vetëm në gjetjen e një gjuhe të përbashkët dhe në bashkërendimin e veprimit revolucionar, në shkallë kombëtare, por la shteg edhe për infiltrimin e kultivimin në lëvizjen komuniste të pikëpamjeve trockiste e arqiomarksiste. Megjithatë, komunistët më të pjekur e më të vendosur me Ali Kelmendin në krye, arritën suksese në përpunimin e formulimin e ideve të shëndosha dhe të platformës revolucionare që i duhej lëvizjes.

Në këtë kohë dy ishin grupet komuniste më aktive dhe më me peshë në vend: Grupi i Korçës «Puna» dhe ai i Shkodrës. Këto kishin edhe ndonjë degë të tyre në ndonjë qytet tjetër të vendit, por kryesisht veprimtarinë e zhvilluan brenda qytetit e nuk krijuan lidhje në shkallë kombëtare dhe as me fshatarësinë.

Nga pikëpamja ideologjike e organizative, grupi më i shëndoshë me një orientim pak a shumë të drejtë, që përhapi idetë komuniste e demokratike në masat dhe që luftoi për kryerjen e shndërrimeve demokratike, për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë, ishte Grupi Komunist i Korçës. Grupi i Shkodrës kishte në radhët e tij komunistë të shëndoshë e të vendosur që zhvilluan propagandën revolucionare kundër regjimit zogist e imperializmit fashist, por udhëheqja e këtij grupi ishte një udhëheqje trockiste me pikëpamje antimarksiste që e çoroditi grupin dhe mbolli konfuzion në lëvizjen në përgjithësi duke gjetur gjuhë të përbashkët me elementë të tjerë antimarksistë të vendit. Kështu, komunistët e vërtetë shqiptarë, zhvilluan luftën e tyre ideologjike si kundër reaksionit zogist dhe imperialist, ashtu dhe kundër pikëpamjeve antimarksiste në vetë lëvizjen. Për këtë do të flasim gjatë trajtimit të pikëpamjeve komuniste lidhur me problemet themelore të periudhës.

1. Analiza komuniste e gjendjes ekonomike-shoqërore e politike të Shqipërisë

Militantët komunistë me Ali Kelmendin në krye i kushtuan një rëndësi të veçantë analizës së gjendjes ekonomike-shoqërore e politike të Shqipërisë. Njohja e saj ishte e domosdoshme për të kuptuar drejt luftën e klasave që zhvillohej në vend, lëvizjet e ndryshme revolucionare të popullit shqiptar, si dhe për të përcaktuar detyrat e komunistëve në luftën për demokracinë, e për mbrojtjen e pavarësisë nga agresioni fashist.

Çdo organizatë pak a shumë serioze e aq më tepër një organizatë komuniste që udhëhiqet nga idetë marksiste-leniniste, nuk mund të bëjë pa një analizë të tillë. Fundi i viteve 20 dhe fillimi i viteve 30 kur u krijuan grupet e para komuniste, ishte periudha e një krize të rëndë ekonomike, shoqërore e politike për Shqipërinë, që u gërshetua me krizën ekonomike botërore e u ndërlikua akoma më shumë për shkak të saj. Por kriza nuk iu nda Shqipërisë asnjëherë. Ajo në thelb ishte një krizë kronike e rendit çifligaro-borgjez që bëhej edhe më virulente për shkak të politikës antipopullore e antikombëtare të regjimit zogist e për arsye të ndërhyrjes brutale të imperializmit italian në Shqipëri. Që në vitin 1932, kur situata ekonomike e politike e vendit dhe e regjimit, shënoi një keqësim të dukshëm, Ali Kelmendi në një raport që i drejtonte Kominternit në emër të komunistëve shqiptarë, bënte analizën e arsyeve që e kishin shkaktuar dhe të pasojave që rridhnin prej kësaj gjendjeje...[12]. Këtu ai vinte në dukje në radhë të parë krizën e rëndë ekonomike që kishte pllakosur vendin dhe që «po bënte kërdinë me të gjithë fuqinë e saj në Shqipëri». Aty thuhej se gjendja e popullit edhe ashtu mjaft e rëndë, ishte keqësuar tej masës, varfëria e mjerimi po thelloheshin gjithnjë e më shumë. Zia e bukës, bashkudhëtare e pandarë e kësaj krize, i kanosej të gjithë vendit, po në mënyrë të veçantë malësive që nuk kishin me se të ushqeheshin dhe vuanin nga uria. Një plagë shumë e rëndë për popullin thuhej në raport ishte papunësia, e cila po shtohej për ditë. Në këtë gjendje mjerimi e dëshpërimi të thellë, kur mjetet e jetës po shterronin krejt, ngriti krye banditizmi, kjo dukuri negative e lindur nga rendi shoqëror. Aliu thoshte se kriza ekonomike e paralizoi ekonominë e vendit, e cila edhe në kushte të zakonshme mezi mbahej e ishte tepër anemike. «Tregtia ndodhej në stagnacionin e plotë». Ashtu, si tregtia, lihej të nënkuptohej se ishin edhe degët e tjera të ekonomisë. E gjithë kjo situatë rridhte në radhë të parë nga marrëdhëniet çifligare-borgjeze, nga politika e regjimit dhe sundimit imperialist që po ia zinin frymën vendit.

12) *Po aty.*

Kriza ekonomike, e marrë në kuptim të gjerë, nënvizonte Ali Kelmendi, pati pasoja «serioze» në fushën politike». Gjendja e regjimit po bëhej gjithnjë më e vështirë e po keqësohej së tepërmi, pakënaqësia e popullit ndaj tij po shtohej për ditë. Pakënaqësia e masave popullore kishte arritur një shkallë të tillë saqë ato «po prisnin gjithnjë për një shenjë që të ngrihen dhe nuk përjashtohet që në Shqipëri në të ardhmen e afërt të pëlcasë një kryengritje»[13]. Këtë e kuptonte dhe regjimi, pohonte Aliu, prandaj mundohej të «bënte manovrime të mëdha». Me këto «manovrime» kuptoheshin masat që mori qeveria zogiste në kushtet e acarimit të përkohshëm të marrëdhënieve të saj me Italinë, për të bërë «kursime të jashtëzakonshme» në mënyrë që të përmirësonte disi gjendjen financiare tepër të keqe, disa reforma administrative me anën e të cilave A. Zogu donte të paraqitej si «reformator», si dhe poza «patriotike» që mori për qëllime demagjogjike, se gjoja «kundërshtonte kolonizimin italian»[14]. Pra, sado të dredhonte regjimi, pohonte Ali Kelmendi, nuk mund të shpëtonte nga gjendja e rëndë. Lëmshi i krizës ekonomike-shoqërore e politike dhe i kontradiktave sa vinte koklavitej më shumë. Këtë e dëshmonte edhe ekzistenca e një opozite të gjerë antizogiste në Shqipëri. Kontradiktat e thella dhe kalbëzimi i rendit ekzistues, sipas analizës komuniste kishin bërë që baza shoqërore e regjimit të ngushtohej gjithnjë e më shumë. Kjo ishte dhe arsyeja që në lëvizjen opozitare ishin përfshirë përveç përfaqësuesve të masave popullore edhe elementë çifligarë, borgjezë e përfaqësues të tjerë të reaksionit. Natyrisht, synimet e tyre ishin të tjera, ata donin të hiqnin qafe Zogun, për arsye rivalitetesh e interesash partikulariste dhe për ta zëvendësuar me ndonjë person tjetër që t'ishte në gjendje të mbronte si duhej rendin çifligaro-borgjez e regjimin reaksionar. Megjithatë lëvizja e opozitës, drejtohej si kundër regjimit, ashtu dhe kundër italianëve. Kjo lëvizje, e cila përkrahej edhe nga «borgjezia e vogël në qytet dhe shtresat e larta të fshatarësisë», kërkonte të depërtonte dhe në ushtri.

Udhëheqësi i lëvizjes komuniste pohonte që në këtë situatë të ndërlikuar, italianët u përpoqën të ndërhyinë më brutalisht në Shqipëri, të kontrollojnë çdo lëvizje e çdo veprim, dhe të krijojnë grupe politike nën drejtimin e tyre e të aktivizojnë veprimtarinë agjenturore.

Të gjitha këto rrethana së bashku këto kontradikta të thella e kjo krizë e rëndë dëshmonin për atë, pohonte ai, që

13) *Po aty.*
14) *Po aty.*

Shqipëria ndodhej në pragun e një situate revolucionare e të shpërthimit të një kryengritjeje. Lëvizja antizogiste e vitit 1932 e sidomos ajo e vitit 1935, e vërtetuan plotësisht këtë konkluzion e analizë të drejtë të komunistëve shqiptarë.

Komunistët me Aliun në krye, e ndoqën hap pas hapi gjendjen e vendit dhe i analizuan edhe koniunkturat politike që u krijuan më pas. Kështu ata dhanë gjykime të drejta e të pjekura për gjendjen që u krijua në Shqipëri pas kryengritjes së Fierit të 1935. Grushti që i dha regjimit Lëvizja e Fierit, thuhej në një raport tjetër të Ali Kelmendit drejtuar Kominternit më 1936, e detyroi A. Zogun të ndërmarrë një manovër të re demagogjike, duke «larguar» përkohësisht nga «timoni» qeverinë ultrareaksionare të grupit «Besa» që ishte deri në atë kohë në fuqi, për ta zëvendësuar me «qeverinë liberale» të Mehdi Frashërit, e cila i premtoi popullit se do të kryente gjoja «reforma» të rëndësishme[15].

Synimi kryesor i regjimit ishte të konsolidonte pozitat e lëkundura dhe të forconte marrëdhëniet me Italinë fashiste, në mënyrë që të merrte sa më shumë ndihma prej saj. Aty theksohej se «vendi iu nënshtrua imperializmit italian më tepër se përpara konfliktit të 1933--1935»[16]. Zogu, duke forcuar disi pozitat, mendoi se do ta thyente qëndresën popullore. Por pakënaqësitë dhe qëndresa popullore ndaj regjimit sa vinin e shtoheshin. Këtu ai kishte parasysh në radhë të parë betejat klasore të viteve 1935-1936, sidomos lëvizjet greviste e demonstratat antizogiste si Demonstrata e Bukës në Korçë që u drejtua nga komunistët. Në gjithë vendin e në mënyrë të veçantë në Shqipërinë e Jugut, thuhej se masat popullore ishin shumë të pakënaqura dhe kundër regjimit. Pakënaqësia kishte përfshirë dhe ushtrinë e xhandarmërinë me gjithë përpjekjet e regjimit për të forcuar kontrollin mbi to. Kjo pakënaqësi e këtyre të fundit, e kishte burimin te politika e qeverisë zogiste, si dhe te veprimtaria fashiste e antishqiptare e oficerëve italianë në ushtri, që ishin bërë të padurueshme.

Në kushtet e rritjes së pakënaqësisë e të kundërshtimit të popullit, regjimit nuk i mbetej gjë tjetër veçse të forconte diktaturën dhe të lidhej sa më shumë pas qerres së Italisë fashiste. «Ku qëndron fuqia e regjimit?» bënte pyetjen Aliu në raport. Ajo sipas tij qëndronte në këta faktorë: në mbështetjen e tij te fashizmi italian, tek ushtria, xhandarmëria dhe aparati burokratik, te bandat e mercenarëve, si dhe tek ai fakt që «kundërshtarët e regjimit nuk janë të organizuar si duhet sipas gjendjes»[17]. Me analizën e gjendjes së Shqipërisë u mor

15) *AQP*. Ali Kelmendi. *Raport drejtuar Kominternit*, Fondi i Kominternit për Shqipërinë, 14 dhjetor 1936.
16) *Po aty*.
17) *Po aty*.

edhe shtypi klandestin komunist, i cili doli në vitet e fundit në prag të agresionit (1937-1939). Një analizë të mirë kësaj gjendjeje i bënte sidomos revista e Grupit Komunist të Korçës «Përpara». Në revistat komuniste u bënë kritika të forta, si kundër regjimit antipopullor zogist, ashtu edhe kundër imperializmit fashist, i cili e kishte nënshtruar gradualisht vendin dhe i kanosej atij me anë të agresionit fashist.

Revista «Përpara» theksonte se kriza ekonomike-shoqërore e politike në Shqipëri sa vinte thellohej dhe regjimi futej gjithnjë «më thellë nën hegjemoninë e fashizmit italian». Ky proces ishte «rrjedhja fatale» e politikës antikombëtare që ishte ndjekur me vite të tëra[18]. Shqipërisë po i kushtonte shumë «aleanca» me Italinë fashiste. Musolini po mbante në këmbë me ndihmat e tij këtë regjim gjakatar që po «ia thithte gjakun si shushunjë popullit, nga ana tjetër e kishte skllavëruar vendin me të ashtuquajturat Banka Kombëtare dhe banka të bujqësisë, me Agipin, me shoqërinë AIPA...» e të tjera. Krahas kësaj, vihej në dukje politika antipopullore e klasave sunduese dhe e regjimit, të cilat bënin një jetë parazitare dhe kishin si parim kryesor të rripnin e të shfrytëzonin sa më shumë popullin.

Këta e kishin çuar atë, shkruante «Përpara», në gradën e fundit të varfërisë, kur «s'kishte bukë të hante», «s'kishte lekë të blinte kripë» dhe «s'ishte në gjendje t'u bënte ballë taksave të shtetit.» «Mjerimi, uria plakos në vatrat tona, fëmijët mbeten rrugëve, burra në lulen e moshës dënohen të lypin, të asistojnë të pafuqishëm në torturat e çilimijve të pangrënë, ose të vrasin veten prej turpit e dëshpërimit», thuhej aty[19].

Politikën antipopullore e antikombëtare të regjimit e demaskoi edhe revista e Grupit Komunist të Shkodrës «Buletini jeshil»[20]. Edhe ajo theksonte se ky regjim po e ripte «paturpësisht,» popullin e varfër, po i shfrytëzonte e grabiste me shumë mënyra masat popullore, sidomos fshatarët e malësorët. Nga ky regjim nuk vuanin më pak edhe masat qytetare. Ishte pikërisht ky regjim që grabiste popullin e vet, ai që nxori në ankand pasuritë e vendit, që i dha për qëllime egoiste të drejtën Italisë fashiste, të shtjerë në dorë koncesione të shumta, duke i lënë pasuritë e Shqipërisë në mëshirën e «fashistëve grabitës».

Mendimi i përgjithshëm i komunistëve ishte se Shqipëria ishte kthyer në një gjysmëkoloni e Italisë fashiste. Duke

18) *AQP*. «Përpara», Korçë, 1938, nr. 1.
19) Po aty.
20) «Buletini jeshil», Shkodër, 1938, nr. 1.

vlerësuar marrëdhëniet ekonomike-shoqërore e strukturën klasore të vendit, ata ishin të mendimit se Shqipëria ishte një vend agrar me marrëdhënie çifligare-borgjeze, me marrëdhënie borgjeze të zhvilluara dobët që gërshetoheshin e pengoheshin nga mbeturinat e fuqishme të feudalizmit, si dhe ndërhyrja imperialiste. Klasat reaksionare sunduese, çifligarët dhe borgjezia kishin përballë në radhë të parë dy antagonistët e tyre kryesorë, klasën punëtore dhe fshatarësinë, që ishin klasat më revolucionare të shoqërisë shqiptare. Luftë klasore midis këtyre klasave antagoniste ishte mjaft e ashpërsuar.

Mbi bazën e kësaj analize duhej të përcaktoheshin edhe detyrat e lëvizjes e të luftës popullore në përgjithësi. Por këtë pikëpamje e kundërshtoi udhëheqja trockiste e Grupit të Shkodrës me Zef Malën dhe Niko Xoxin në krye, si dhe elementët e tjerë antimarksistë. Këta, në mënyrë të veçantë Zef Mala, që ishte kryetar i grupit dhe e hiqte veten si teoricien, nxorën teorinë se Shqipëria ishte një vend i prapambetur bujqësor, që nuk kishte gjoja marrëdhënie borgjeze në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, as borgjezi e proletariat dhe as luftë klasash[21].

Zef Mala kishte shkruar një sërë artikujsh në gazetën «Arbëria» ku problemin e trajtonte njësoj si ideologët e tjerë reaksionarë[22]. Sipas Zef Malës në Shqipëri ende sundonin marrëdhëniet feudale dhe ekzistonte vetëm një klasë sunduese, pronarët e tokave (pronarët feudalë). Këta shtypnin dhe shfrytëzonin klasën e bujqve dhe të argatëve, e cila sipas tij nuk krijoi kurrë vetëdijen e të drejtave të saj dhe mbeti gjithmonë «pasive në lodrat e të mëdhenjve». Në mes të këtyre dy klasave ai vinte zejtarët që i konsideronte si pjesën më revolucionare të shoqërisë shqiptare.

Këto pikëpamje të gabuara dhe falsifikime të realitetit shqiptar, u shtjelluan edhe në «Buletinin jeshil»[23]. Edhe këtu u tha se proletariati ende nuk kishte lindur në Shqipëri dhe këtë do ta krijonte gjoja më vonë zhvillimi industrial i saj. Ekzistenca e industrisë kapitaliste e borgjezisë dhe e klasës punëtore injoroheshin krejt. Industritë e vogla kapitaliste gati konsideroheshin si zeje, ndërsa punëtorët, zejtarë. Ky ishte një shtrembërim i realitetit shqiptar. Zef Mala e të tjerë «teorizonin» se që të zhvillohej lufta e klasave në vend duhej të krijohej «proletariati i vërtetë», duhej të formoheshin «punëtorët e specializuar»! Tashti për tashti zejtarët ishin më revolucionarët dhe te këta duhej mbështetur. Këto ishin pikëpamje të huajtura nga teoritë trockiste e arqiomarksiste.

21) Enver Hoxha. *Çështje të revolucionit* ..., f. 298; *Dokumente kryesore të PPSh*, vëll. I (rezolucioni i mbledhjes së grupeve komuniste).

22) «Arbëria», 20 dhjetor 1935, f. 3; 8 janar 1936, f. 3; 23 janar 1936, f. 3.

23) «Buletini jeshil», 1938, nr. 1; 1939, nr. 2.

Komunistët e vërtetë, sidomos ata të Grupit të Korçës, i kundështuan këto teza të gabuara. Ata i hodhën poshtë këto jo vetëm me idetë e tyre, por edhe me anë të veprimtarisë praktike, duke luftuar për ndriçimin e klasës punëtore me idetë komuniste, për organizimin e drejtimin e luftës së saj dhe të të gjithë popullit.

2. Pikëpamjet mbi lëvizjet komuniste dhe punëtore

Ali Kelmendi me shokë kishin mendimin që në fillim se lëvizja komuniste në Shqipëri «kishte një terren shumë të favorshëm» për zhvillimin e përhapjen e saj për shkak të «karakterit të gjallë dhe të papajtueshëm të luftës së popullit shqiptar kundër regjimit, nga njëra anë dhe, nga ana tjetër, tradhtisë, pavendosmërisë dhe pasivitetit të politikanëve të drejtimeve të tjera...»[24]. Pra kushtet objektive ekonomike, shoqërore e politike ishin të përshtatshme për të, gjithashtu përvoja historike kishte treguar, siç theksonin komunistët, se këtej e tutje u përkiste atyre ta merrnin në duar flamurin e luftës popullore. Që në fillimet e lëvizjes ishte vënë re se në rrethanat kur organizatat e tjera duke përfshirë dhe KONARE-në, u treguan të paafta për ta drejtuar luftën e masave, thuhej se mjaft elementë përparimtarë dhe simpatizantë të komunistëve «ishin për një organizatë komuniste...» në Shqipëri[25]. Ngjarjet e mëvonshme e vërtetuan plotësisht këtë.

Duke u mbështetur edhe te porosia e Dimitrovit, mendohej të krijohej një qendër organizative komuniste në Shqipëri, e cila të formonte grupe komuniste në të gjithë vendin dhe një lëvizje të fortë komuniste mbi bazën e së cilës do të themelohej Partia Komuniste[26]. Ajo duhej të bashkërendiste veprimtarinë e grupeve në shkallë kombëtare. Qendra organizative do të punonte gjithashtu me klasën punëtore për krijimin e organizatave profesionale, si dhe me masat e tjera demokratike dhe grupet e ndryshme antizogiste, duke i bashkuar ato në një lëvizje të gjerë «nacionale-revolucionare».

Organizatat komuniste që u krijuan dhe do të krijoheshin dhe më pas, u konceptuan jo si organizata të mbyllura e të shkëputura nga masat, por si organizata të vërteta revolucio-

24) *AQP*. Ali Kelmendi. *Raport drejtuar Kominternit*, 14 dhjetor 1936.

25) *Po aty*, raport i dt. 5 mars 1932.

26) *Po aty*, raport i dt. 14 dhjetor 1936.

nare të lidhura me to, sidomos me klasën punëtore. Kjo pikëpamje e shëndoshë e Aliut e të tjerëve, u vu në zbatim më mirë nga Grupi i Korçës. Ideja e komunistëve të përparuar e kishte burimin jo vetëm te mësimet marksiste-leniniste, por edhe te përvoja e Shqipërisë, e cila tregoi se deri në këtë kohë asnjë organizatë tjetër që luftonte kundër regjimit, nuk kishte krijuar lidhje me masat dhe nuk kishte marrë mundimin ta organizonte e drejtonte popullin në luftë. Organizatat reaksionare nuk kishin besim te populli dhe nuk dëshironin ta hidhnin në luftë atë, ndërsa ndonjë organizatë demokratike si KONARE-ja u tregua e paaftë të bashkojë mendimin me veprimin revolucionar.

Organizata komuniste u konceptua në radhë të parë si organizatë e klasës punëtore dhe u luftua që të vihej në jetë kjo ide. Ideja që organizata komuniste ishte organizatë e klasës punëtore, sipas Aliut me shokë kishte dy aspekte, apo dy anë të rëndësishme. Së pari, përbërja e organizatës komuniste duhej të ishte kryesisht nga elementë punëtorë. Kjo kishte rëndësi parimore, sepse baza dhe mbështetja kryesore e lëvizjes komuniste, fuqia dhe gjallëria e saj qëndronte te klasa punëtore, klasa më revolucionare e shoqërisë shqiptare. Si idetë, ashtu dhe veprimtaria komuniste te kjo klasë e kishin burimin kryesor. Kjo nuk përjashtonte pjesëmarrjen e elementëve nga fshatarësia, zejtarët e inteligjencia revolucionare në radhët komuniste.

Së dyti organizatat komuniste duhej të siguronin lidhje të forta me klasën punëtore, të futeshin në gjirin e saj, në ndërmarrjet punëtore, ta ndriçonin atë, të organizonin e drejtonin luftën e saj ekonomike dhe politike. Pa luftën e përpjekjet e klasës punëtore, asnjë shndërrim serioz nuk mund të ndërmerrej në Shqipëri. Por, komunistët, siç thoshte Aliu, duke respektuar këtë parim me rëndësi të ideologjisë dhe veprimtarisë komuniste, nuk duhej të injoronin lidhjet dhe veprimtarinë me masat e tjera të popullit, me masat demokratike, duke përfshirë këtu si masat qytetare, ashtu dhe fshatarësinë e ushtrinë. Ai i porositi komunistët, si ata të Grupit të Korçës dhe të tjerë, që të ruheshin nga sektarizmi, i cili mund të shfaqej qoftë në shkëputjen nga klasa punëtore, qoftë dhe në largimin nga masat e tjera popullore. Sektarizmi nuk pajtohej me ideologjinë e praktikën komuniste. Kështu, ai nuk e quante normale që grupet komuniste në fillim ishin «jashtë ndërmarrjeve industriale që ekzistonin në Shqipëri»[27]. Kjo ishte një e metë jo e vogël, prandaj u këmbëngul që ajo të riparohej dhe që grupet të futeshin në ndërmarrjet. Grupi i Korçës e vuri menjëherë në zbatim këtë porosi dhe ide me rëndësi,

27) *Po aty*, dt. 5 mars 1932.

duke u lidhur me masat punëtore e qytetare e duke zhvilluar veprimtari komuniste e demokratike në to. Aliu nuk e quante normal dhe atë fakt që disa organizata nuk kishin përbërjen e duhur punëtore, por kishin në gjirin e tyre më shumë intelektualë. Punëtorët duhej të ishin shtylla vertebrore e lëvizjes. Klasa punëtore shqiptare thuhej se ishte një klasë e re dhe me përbërje heterogjene. Ndërmarrjet e vërteta industriale në Shqipëri ishin të pakta dhe numri i punëtorëve që punonin në to ishte fare i vogël[28]. Madje, shumica e punëtorëve ishin të rinj në moshë. Në ndërmarrjet e ndërtimit punëtorët ishin sezonalë dhe kryesisht fshatarë. Të gjitha këto ndikonin në nivelin e ulët ideologjik të tyre dhe puna me ta ishte shumë më e vështirë. Po përveç këtyre ndërmarrjeve kishte edhe ndërmarrje të mëdha siç ishin shoqëritë e huaja kapitaliste, si ajo e naftës AIPA e ndonjë tjetër ku ishin grumbulluar shumë punëtorë. Me gjithë këto rrethana e dobësi, Aliu e të tjerë mendonin se shfrytëzimi i egër e i dyfishtë i klasës punëtore, urrejtja e saj e madhe për kapitalistët vendës dhe sidomos të huaj, urrejtja kundër regjimit dhe lufta e saj greviste, lëvizja e protestave dhe demonstratat që sa vinin e rriteshin, e bënin atë klasën më të përparuar e më revolucionare të Shqipërisë.

Por lufta revolucionare për shndërrimin shoqëror, theksonin ata, shtronte detyrën e forcimit të vetëdijes klasore të punëtorëve, e të rritjes së nivelit ideologjik, të organizimit dhe të luftës së tyre për të drejtat ekonomike e politike. Për t'ia arritur kësaj duhej që komunistët të punonin shumë me klasën punëtore në mënyrë legale e ilegale, jo vetëm ta ndriçonin atë me idetë komuniste, ta ndihmonin të krijonte organizatat profesionale, por të shfrytëzonin çdo rast për ta hedhur në greva e demonstrata. Grupi i Korçës i vuri në jetë pak a shumë këto ide dhe pati sukses në organizimin e luftës së punëtorëve. Ai krijoi edhe organizata profesionale të fuqishme për kohën, që zhvilluan veprimtari të gjerë e drejtuan luftën e klasës punëtore. Nën shembullin e tij u krijua një organizatë e fuqishme profesionale dhe në zonën e koncensionit të AIPA-s. Kjo dhe disa të tjera, ishin dhe arsyet që Aliu e çmonte shumë këtë grup me pozita të shëndosha[29].

Por, duhet thënë se jo të gjitha grupet e vlerësuan si duhet idenë se baza e të gjithë punës dhe e suksesit të luftës revolucionare në Shqipëri, ishte organizimi e drejtimi i luftës së klasës punëtore. Siç thamë në fillim, në lëvizjen komuniste kishte elementë që e mohonin qenien e kësaj klase dhe vetvetiu edhe rolin e saj. Qëndrimin më të gabuar në këtë

28) *Po aty*.

29) *AQP*. Relacion i Ali Kelmendit, dt. 14 dhjetor 1936; Enver Hoxha. *Kur lindi Partia (Kujtime)*, f. 36-37.

çështje e kishte, siç u vu në dukje, udhëheqja e Grupit të Shkodrës, për të cilën klasa punëtore në kuptimin e vërtetë të fjalës nuk ekzistonte dhe se pjesa më revolucionare e shoqërisë shqiptare ishin zanatçijtë[30]. Ajo priste kalendat greke që kjo klasë të krijohej sipas mendimit të saj trockist. Ajo arriti deri aty sa të thotë se lëvizja komuniste nuk lindi si nevojë e domosdoshme e klasës punëtore për të luftuar kapitalistët, por si rezultat i ndikimit të jashtëm, u importua nga jashtë[30/1]. Një gjë të tillë pohonin edhe ideologët reaksionarë.

Natyrisht, në këtë grup pati edhe komunistë me ide të shëndosha që vetë kishin dalë nga gjiri i klasës punëtore, si Vasil Shantoja e të tjerë, dhe që e kuptonin rolin e rëndësishëm të saj.

Komunistët e vërtetë të këtij grupi punuan me punëtorët dhe luftuan për ndriçimin e organizimin e tyre. Qemal Stafa e Vasil Shantoja në shkurt të 1939 deklaruan para gjyqit zogist se ishin krenarë që ishin komunistë, sepse vetëm komunizmi do ta shpëtonte masën e madhe të punëtorëve që vuante nga shtypja dhe shfrytëzimi i egër[31]. Ata e treguan veten si përfaqësues të denjë të interesave të klasës punëtore e të gjithë popullit.

Revista komuniste e Grupit të Korçës «Përpara» kritikonte frazeologjinë boshe pseudokomuniste të elementëve antimarksistë në lëvizje, të cilët nën pretekstin se gjoja në Shqipëri nuk kishte borgjezi e proletariat të mirëfilltë industrial dhe luftë klasash midis tyre, qëndronin larg klasës punëtore e nuk donin të punonin me të, duke pohuar se tashti nuk kishte ardhur ende koha e veprimtarisë revolucionare. Komunistët, hëpërhë, duhej të merreshin vetëm me studime e teorizime. Revista «Përpara» i stigmatizonte ata: «duan të kenë organizata qind për qind punëtore dhe me që të tilla është e pamundur të ketë sot (sipas konceptit të tyre — V.K.) meqë qeveria nuk i lejon, ata thonë që është më mirë të rrinë duarkryq...»[32].

Komunistët shqiptarë kishin mendimin se ajo që i dallonte ata nga elementët e tjerë demokratë borgjezë apo edhe demokratë-revolucionarë, nuk ishin vetëm idetë e tyre revolucionare të qarta e konsekuente, por edhe veprimi revolucionar. Pa veprim revolucionar nuk mund të kishte lëvizje komuniste dhe nuk mund të arrihej asnjë sukses në luftën për demokracinë e për sigurimin e pavarësisë kombëtare. Ky aksion duhej të zhvillohej me mjete legale dhe ilegale. Ai duhej të përshkonte të gjitha fushat e veprimtarisë ekonomike, shoqërore, politike e kulturore si dhe të gjitha lëvizjet: komuniste,

30) Enver Hoxha. *Vepra*, vëll. 5, f. 237.
30/1) *Historia e PPSh*. Tiranë, 1982, f. 44.
31) «Drita», 8 shkurt 1939.
32) «Përpara», 1938, nr. 2.

punëtore demokratike e antifashiste. Nuk duhej lënë rast pa shfrytëzuar për të zhvilluar veprimtarinë revolucionare të komunistëve dhe të masave popullore që nga grevat, demonstratat e deri te kryengritjet popullore. Veprimi jo vetëm që i kaliste komunistët, e pasqyronte më mirë drejtësinë e ideve të tyre, por forconte edhe lidhjet e tyre me masat, si dhe besimin e masave në luftën për të drejtat e tyre, rriste vetëdijen e tyre klasore.

Ishte pikërisht kjo arsyeja që Ali Kelmendi e vlerësoi lart pjesëmarrjen e komunistëve në lëvizjet revolucionare, si kryengritja e Fierit e vitit 1935 dhe Demonstrata e Bukës e vitit 1936 në Korçë e lëvizjet e tjera. Gjithashtu, ai i quajti këto lëvizje «pagëzimi i zjarrit dhe guri i provës» për komunistët shqiptarë, «provë të cilën ata e kaluan me sukses dhe e treguan veten e tyre si vëllezër të denjë të komunistëve të vendeve të tjera...»[33] Rëndësinë e madhe të veprimit revolucionar e të shkrirjes nëpërmjet tij me masat, për të zhvilluar me sukses luftën revolucionare, e theksonte drejt revista «Përpara»: «pa popullin neve jo vetëm që s'kemi fuqi të bëjmë gjë, por as na intereson të bëjmë gjë se ç'do gjë që duam të bëjmë është për popullin. Çdo lëvizje që bëhet pa popullin është e dënuar të bëhet për dëm të popullit, në dobi të një grupi të vogël politikanësh... Çdo lëvizje pa popullin është e dënuar të humbasë...»[34]. Por edhe këtë çështje kishte nga ata që e shikonin krejt ndryshe e në mënyrë të shtrembër. Këta ishin trockistët Zef Mala, Niko Xoxi e të tjerë. Ata predikuan se komunistët nuk duhej të vepronin, sepse nuk kishte ardhur koha e veprimit revolucionar. Kjo do të vinte kur të dilnin në skenë proletariati dhe borgjezia, kur të krijoheshin kushtet për revolucionin proletar. Tani ata duhej vetëm të studionin, të ruheshin nga ndjekjet e burgosjet dhe të mos u ekspozoheshin rreziqeve. Kjo ishte teoria e tyre e gabuar e pasivitetit dhe e «ruajtjes së kuadrit» që nuk kishte të bënte aspak me idetë dhe veprimtarinë komuniste[35].

Një nga problemet themelore të lëvizjes, madje kryesori, konsiderohej krijimi i Partisë Komuniste. Pikëpamjet mbi krijimin e Partisë mbështeteshin dhe në orientimet e Kominternit, i cili në këtë periudhë kishte mendimin se edhe në Shqipëri e gjetkë duhej të krijoheshin kushte për krijimin e Partisë në një kohë sa më të afërt. Pa Partinë revolucionare të klasës punëtore, të pajisur me një platformë të vërtetë marksiste-leniniste, që duhej të vihej në krye të luftës popullore, thoshin komunistët, nuk mund të sigurohej suksesi i plotë në luftën për demokracinë dhe kundër agresionit fashist. Për krijimin e

33) *AQP*. Raport i Ali Kelmendit ..., 1936.
34) «Përpara», 1938, nr. 1.
35) *Dokumente kryesore të PPSh*, vëll. I, f. 13; *Historia e PPSh*, f. 44.

Partisë u mendua të zgjerohej e forcohej lëvizja komuniste në të gjithë vendin, të bashkërenditeshin veprimet e grupeve komuniste në shkallë kombëtare, grupet të zhvillonin një punë të mirë me masat dhe të forcoheshin nga pikëpamja ideologjike e teorike[36]. Për vënien në jetë të kësaj ideje, duhej të krijohej një qendër organizative, e cila do të organizonte e drejtonte punën dhe pastaj do të thirrej një kongres kushtetues për krijimin e Partisë Komuniste[37]. Grupi i Korçës e komunistë të tjerë përkrahën këtë ide dhe luftuan për përmbushjen e saj.

Aliu me shokë këmbëngulën gjithashtu që të bëhej edukimi teorik i komunistëve dhe të ngrihej niveli ideologjik i tyre. Për këto u sollën edhe materiale e broshura marksiste nga jashtë. Ali Kelmendi e konsideronte «urgjent» sidomos botimin e disa broshurave në gjuhën shqipe, në mënyrë që komunistët të pajiseshin me njohuritë marksiste-leniniste, sepse diç dihet një pjesë e mirë e tyre nuk dinin gjuhë të huaja.

Këto ide të shëndosha nuk u pritën mirë dhe nuk u vunë në jetë nga të gjitha grupet. Idetë dhe veprimtaria për krijimin e Partisë u kundërshtuan dhe u sabotuan sidomos nga elementët trockistë e arqiomarksistë, si; Niko Xoxi, Zef Mala. Aristidh Qendro, Andrea Zisi, Llazar Fundo e të tjerë. Këta, të mësuar me veprimtarinë fraksioniste e duke pasur një bagazh ideologjik antimarksist, ose e konsideronin krijimin e partisë të parakohshëm për derisa nuk kishte kushte për revolucionin proletar (sikur partia duhej vetëm për revolucionin proletar e jo për revolucionin demokratik) ose shpallnin si Parti Komuniste ndonjë grup antimarksist në mërgim, siç bëri Andrea Zisi në Greqi.

Këto grupe antimarksiste mendimet e tyre të gabuara i kthyen në veprimtari diversioniste kundër krijimit të Partisë. Krijimin e Partisë e penguan edhe konceptet lokaliste e sektare që nuk lejonin që komunistët të zgjeronin veprimtarinë me masat e të bashkërenditnin veprimet në shkallë kombëtare. Pikëpamje e qëndrime të tilla ekzistonin edhe në Grupin e Korçës. Këto pikëpamje u kritikuan në rezolucionin e themelimit të PKSh[38].

Në këtë kohë komunistët më të mirë duke u mbështetur edhe në orientimet e reja të Kominternit, krijimin e Partisë e lanë për më vonë, kur të krijoheshin kushte të përshtatshme dhe kur lëvizja komuniste të kapërcente pikëpamjet e gabuara, veprimtarinë fraksioniste dhe të lidhej si duhej me masat. Këtë detyrë e morën përsipër komunistët e vërtetë dhe e plotësoi ashtu si duhej në momentin e duhur e të rëndësishëm historik plejada e komunistëve militantë shqiptarë me

36) *AQP*. Raport i Ali Kelmendit ..., 14 dhjetor 1936.
37) *Po aty*.
38) *Dokumente kryesore të PPSh*, vëll. I, f. 13.

shokun Enver Hoxha në krye. Themeluesi, organizatori dhe udhëheqësi kryesor i saj ishte vetë shoku Enver Hoxha.

Aliu e komunistët e tjerë mbajtën qëndrim të rreptë e të papajtueshëm ndaj elementëve trockistë e oportunistë. Luftën kundër rrymave oportuniste e antimarksiste ata e konsideruan detyrë kryesore të lëvizjes. Ata i kritikuan me ashpërsi pikëpamjet e tyre. Një rëndësi të madhe Ali Kelmendi i kushtoi demaskimit të pikëpamjeve dhe veprimtarisë armiqësore të Llazar Fundos që ishte armik i rrezikshëm i lëvizjes komuniste. Fundoja kishte pikëpamje trockiste e buhariniste[39]. Ai parapëlqente literaturën e shkruar nga armiqtë e komunizmit dhe e shikoje të bridhte nëpër kafenetë e Parisit me libra trockistë në dorë. Hiqej se ishte për revolucionin proletar dhe i nënvleftësonte luftën për demokracinë dhe lëvizjet demokratike. Elementët demokratë revolucionarë i cilësonte si elementë borgjezë dhe e kundërshtonte bashkëpunimin me ta. Këtë e bënte sa për sy e faqe, sepse ai s'kishte asgjë komuniste, po përkundrazi një mentalitet prej borgjezi.

Fundoja u përpoq të denigronte elementët më të mirë komunistë, si: Aliun, Halim Xhelon, Riza Cerovën e të tjerë.

Fytyrën e këtij renegati të komunizmit e ka zbuluar mirë shoku Enver Hoxha në veprën e tij madhore «Kur lindi Partia (Kujtime)». Këtu thuhet se ai «hiqej si familje arkondësh», e përbuzte popullin e thjeshtë, sidomos pjesën myslimane. Ai ishte i mbrujtur me këtë mentalitet dhe u lidh rastësisht me komunizmin, pa bindje të thella. «Ai e tradhtoi komunizmin, — thotë shoku Enver, — u bë renegat, një trockist i rrezikshëm. Them i rrezikshëm, sepse ishte shumë dinak, i zgjuar dhe me kulturë...»[40].

Në fillim thuhet në vepër, ai ishte një trockist i fshehtë, pastaj e hoqi maskën dhe zhvilloi një luftë të tërbuar dhe të hapur kundër komunizmit, kundër Bashkimit Sovjetik. «Ai luftonte si eksponent në radhët e Internacionales së Katërt trockiste dhe ishte vënë në shërbim të kushedi se të ç'shteteve imperialiste që organizonin sabotimet dhe luftën kundër Bashkimit Sovjetik»[41].

Pikëpamjet dhe veprimtarinë trockiste e arqiomarksiste i demaskoi edhe revista «Përpara» e Grupit Komunist të Korçës, e cila shkroi në disa numra të saj se trockizmi ishte agjenturë e rrezikshme e imperializmit dhe e fashizmit[41/1]. Revista «Përpara» polemizoi edhe me «Buletinin jeshil», dhe hodhi poshtë tezat e gabuara të tij.

Lufta kundër prirjeve oportuniste e trockiste në lëvizje,

39) *AQP*. Raport i Ali Kelmendit drejtuar Kominternit, 15.I.1938.
40) Enver Hoxha. *Kur lindi Partia (Kujtime)*, f. 25.
41) *Po aty*.
41/1) *AQP*. «Përpara», tetor-nëntor 1938.

dëshmonte për faktin që në lëvizjen komuniste shqiptare kishte forca revolucionare, kishte elementë që e kuptonin drejt se komunistët duhej të luftonin në të njëjtën kohë si kundër reaksionit ashtu edhe kundër oportunizmit e prirjeve antimarksiste. Por duhet thënë se pikëpamjet dhe veprimtaria antimarksiste e udhëheqjes së Grupit të Shkodrës dhe e elementëve të tjerë i shkaktuan mjaft dëme lëvizjes, shtuan konfuzionin e çoroditjen ideologjike e organizative në radhët e saj.

3. Platforma demokratike antifashiste e lëvizjes komuniste

Lëvizja komuniste shqiptare, në kushtet e ekzistencës së marrëdhënieve çifligare-borgjeze, të mbeturinave të theksuara feudale dhe të sundimit gjysmëkolonial imperialist, u kushtoi me të drejtë vëmendjen kryesore problemeve të luftës për shndërrimin demokratik të vendit, për ruajtjen e lirisë e të pavarësisë dhe përballimin e agresionit fashist. Vetë logjika e kushteve objektive dhe specifika historike e Shqipërisë bënë që në platformën komuniste idetë demokratike e antifashiste të zinin një vend me rëndësi. Të gjitha programet e idetë që formuluan komunistët shqiptarë në këto vite vëmendjen kryesore ia kushtuan detyrave demokratike e antifashiste. Vetëm elementët antimarksistë nuk deshën ta kuptonin gjendjen e vërtetë dhe specifikën e Shqipërisë dhe shfaqën ide që nuk përputheshin me detyrat historike të periudhës.

Ali Kelmendi e komunistët e tjerë shqiptarë, e bënë të qartë që në fillim se përpara popullit e lëvizjes revolucionare shtrohej në të njëjtën kohë edhe detyra e çlirimit shoqëror nga klasat çifligaro-borgjeze dhe ajo e krijimit të rendit të demokracisë popullore, ashtu dhe detyra e shkundjes së zgjedhës gjysmëkoloniale imperialiste. Pra, krahas problemit shoqëror demokratik qëndronte problemi nacional. Këto të dy anë ishin të lidhura ngushtë dhe zgjidhja e detyrës së parë hapte rrugën për zgjidhjen e së dytës.

Këto ide u parashtruan që në vitin 1932 në relacionin e përmendur që iu drejtua Kominternit[42]. Aty thuhej se masat e gjera të popullit që vuanin nga zgjedha e dyfishtë çifligaro-borgjeze dhe ajo imperialiste, si dhe nga diktatura e egër zogiste, ishin të interesuara për përmbysjen e tyre. Pakënaqësia e tyre kishte arritur kulmin dhe pritnin vetëm një shenjë për t'u hedhur në kryengritje. Ishte pikërisht ky karakter

42) *AQP*. Raport i Ali Kelmendit ..., 5 mars 1932.

demokratik e antiimperialist që kishte bërë që në luftë të përfshiheshin shtresa sa më të gjera të popullit. Këtë karakter nuk e ndryshonte sipas komunistëve as pjesëmarrja në lëvizjen opozitare të organizuar, e disa elementëve nga klasat sunduese, të cilët natyrisht kishin synime të tjera. Po për ta ruajtur dhe forcuar karakterin demokratik e antifashist të luftës popullore dhe që kjo të zhvillohej me sukses, ishte e domosdoshme që komunistët të merrnin pjesë aktive në të dhe ta organizonin e drejtonin brenda mundësive e kushteve të vendit.

Në vitin 1934 komunistët me në krye Ali Kelmendin formuluan edhe programin e parë të tyre, dhe përcaktuan qëndrimin që duhej të mbanin ndaj lëvizjeve kryengritëse që do të shpërthenin në Shqipëri. Kjo u bë në një mbledhje apo konferencë të komunistëve shqiptarë të organizuar në Korçë nën kryesinë e Aliut. Programi përmbante këto pika kryesore:

a) krijimin e republikës popullore demokratike;

b) anulimin e të gjitha marrëveshjeve skllavëruese me Italinë fashiste;

c) likuidimin e monopoleve dhe koncesioneve kapitaliste dhe imperialiste;

ç) shpalljen e amnistisë për të dënuarit politikë[43].

Ky program, siç shihet, ishte një program me kërkesa thjeshtë demokratike e kombëtare dhe i përgjigjej plotësisht situatës historike. Mbi bazën e kësaj platforme iu dha porosi disa komunistëve që të merrnin pjesë në lëvizjen opozitare antizogiste, si dhe në kryengritjen e Fierit, që po përgatitej. Kështu, komunistët Asim Vokshi, Mustafa Kaçaçi, Riza Cerova e të tjerë vepruan pikërisht në përputhje me këtë ide dhe porosi dhe u aktivizuan mjaft në lëvizjen, e cila siç u tha në fillim ishte një gur prove për idetë e veprimtarinë komuniste.

Por, Aliu me shokë e kuptonin se lëvizja antizogiste, e cila kishte një përbërje heterogjene dhe në krye të saj elementë borgjezë, në qoftë se do të fitonte, mund të mos shpinte në vendosjen e një republike të vërtetë demokratike, por thjeshtë të një republike borgjeze. Prandaj përpara komunistëve shtrohej si detyrë, së paku në Korçë ku kishte kushte të përshtatshme të përfitonin nga fitorja e mundshme për ta vazhduar luftën e masave popullore në qytet më tej, për të fituar liri të vërteta demokratike[44].

Vetë vlerësimi i kryengritjes antizogiste të Fierit nga Ali Kelmendi, i cili shprehu me këtë edhe pikëpamjen e shokëve të tij, dëshmonte se komunistët shqiptarë në përputhje

43) *AQP*. Fondi i Kominternit për Shqipërinë. lista nr. 2, d. 10.
44) S. Manushi. *Ali Kelmendi* (broshurë). Tiranë, 1960, f. 11-12.

edhe me udhëzimet e Kominternit ishin të mendimit që të përkrahej e të ndihmohej çdo lëvizje që kishte karakter demokratik e antifashist dhe në lëvizje të tilla të sigurohej pjesëmarrja e masave popullore.

Nga dobësitë serioze të kryengritjes së Fierit, si mungesa e pjesëmarrjes aktive të popullit në të, ekzistenca e një udhëheqjeje të dobët e të tjera, komunistët nxorën mësime dhe forcuan punën më tej. Demonstrata e Bukës në Korçë, e vitit 1936, ky manifestim i shquar popullor antizogist nën drejtimin e tyre si dhe demonstratat e betejat e tjera klasore të vendit, ishin një provë se idetë demokratike e antifashiste po viheshin më mirë në jetë dhe se mësimet e së kaluarës u kishin vlejtur.

Vetë këto beteja klasore, ndihmuan që të piqej e të konkretizohej më mirë platforma komuniste.

Te komunistët u poq akoma më shumë mendimi me rëndësi se lëvizjet demokratike e patriotike të popullit shqiptar këtej e tutje duhej të udhëhiqeshin nga komunistët. Lëvizjet antizogiste të gjysmës së parë të viteve 30 treguan se elementët borgjezë, si dhe ata demokratë, nuk ishin të aftë të drejtonin këto lëvizje. Roli udhëheqës i borgjezisë kombëtare në lëvizjet përparimtare kishte shterur prej kohësh.

Në një mbledhje të komunistëve shqiptarë të organizuar në Moskë në dhjetor të vitit 1936, problemit të luftës për demokracinë e sidomos të organizimit të qëndresës antifashiste, iu kushtua një rëndësi e madhe[45].

Organizimi i lëvizjes nacionalçlirimtare në Shqipëri dhe sigurimi i udhëheqjes së saj nga ana e komunistëve, konsiderohej si një çështje kardinale dhe e një rëndësie të dorës së parë. U mendua që të krijohej një organizatë e bashkuar ilegale mbi një platformë të përgjithshme për luftën kundër regjimit zogist dhe imperializmit italian, për një republikë demokratike dhe për likuidimin e marrëveshjeve skllavëruese me Italinë fashiste[46]. Në këto organizata duhej të merrnin pjesë forca të ndryshme politike të interesuara për luftën kundër fashizmit dhe regjimit zogist. Organizata do të drejtohej nga një Komitet Qendror Organizativ, ndërsa nëpër prefektura dhe krahina do të formoheshin komitete të veçanta për tërheqjen dhe organizimin e forcave nacional-demokratike në luftën kundër fashizmit dhe reaksionit të brendshëm. Parashikohej që të thirrej dhe një kongres që do të pranonte programin dhe do të diskutonte taktikën politike të organizatës[47].

Organizata duhej të ishte shumë konspirative dhe e centralizuar. «Ndryshe nga organizata e fshehtë që përgatiti kryengritjen e Fierit», ajo duhej të punonte me masat duke shfrytëzuar gjerësisht mundësitë legale, si dhe ato ilegale të luftës.

Komunistët kishin mendimin se tashti nuk ishin më kushtet e rrethanat e viteve 20-të. Ato ishin bërë më të vështira e më të ndërlikuara. «Ne kemi të bëjmë, — thoshin ata, — me një shtet të centralizuar, që ka në dispozicion mjete lufte moderne dhe që përkrahet nga fashizmi italian»[48]. Prandaj edhe lufta popullore duhej të ishte më e organizuar.

Organizata nacional-revolucionare duhej të shërbente si bazë për krijimin e një fronti antifashist popullor kundër imperializmit italian dhe diktaturës zogiste[49].

Për zhvillimin e propagandës revolucionare në anëtarët e organizatës dhe në popull u mendua të botoheshin disa broshura: mbi luftën kundër imperializmit italian, mbi frontin popullor, mbi luftën kundër terrorit, mbi moratoriumin e borxheve.

Këto ide të drejta e të shëndosha, po të viheshin në jetë, do ta ngrinin luftën popullore në një shkallë më të lartë. Por në Shqipëri mungonte ende ajo forcë që mund t'i vinte në jetë si duhej ato, mungonte partia marksiste-leniniste. Përveç kësaj, ato u kundërshtuan edhe nga elementët fraksionistë e trockistë që nuk e përfillnin luftën për demokracinë dhe idenë e krijimit të frontit popullor.

Elementë si Niko Xoxi e të tjerë i quajtën me përbuzje si «çlirimistë», Ali Kelmendin me shokë që e kishin orientuar lëvizjen drejt luftës për demokracinë kundër rrezikut fashist. Kjo donte të thoshte sipas tyre se ata gjoja nuk ishin komunistë. Por komunistët shqiptarë, sidomos ata të Grupit të Korçës, u dhanë përgjigjen e merituar këtyre elementëve që nuk kishin asgjë komuniste dhe që pas frazeologjisë komuniste fshihnin qëndrimin trockist e përçarës. Ata ishin sabotues të luftës për çlirimin e popullit.

Komunistë të vërtetë ishin ata që luftonin për çlirimin e popullit nga zgjedha çifligare-borgjeze e imperialiste.

Në vitin 1937, në situatën e rritjes së rrezikut fashist në Shqipëri e në Evropë, kur zgjedha imperialiste po bëhej e padurueshme për vendin dhe pushtimi fashist ishte në prag të derës, erdhën orientimet e reja të Kominternit, të cilat e vinin theksin mbi organizimin e luftës popullore kundër rrezikut fashist dhe krijimin e frontit popullor. Këto orientime të drejta përputheshin plotësisht me vijën dhe praktikën e ndjekur që përpara nga komunistët shqiptarë me Ali Kelmendin në krye, të cilët kishin arritur disa suksese. Orientimet e reja i frymëzuan ata që të luftonin më me vendosmëri për zhvillimin e

45) *AQP.* Raport i Ali Kelmendit ..., 14 dhjetor 1936.
46) *Po aty.*
47) *Po aty.*

48) *Po aty.*
49) *Po aty.*

mëtejshëm, propagandimin e vënien në jetë të ideve të tyre demokratike e antiimperialiste. Ato ishin një mbështetje e përkrahje në përpjekjet e tyre për të gjetur një gjuhë të përbashkët me grupet komuniste, për të formuluar një platformë të njësuar në këtë frymë dhe për ta hedhur popullin në luftë. Por praktika tregoi se kjo ishte gjë shumë e vështirë dhe e parealizueshme në ato kushte.

Grupi Komunist i Korçës e miratoi vijën e re, e propagandoi dhe e shtjelloi këtë vijë me anë të organit të saj «Përpara». Ideja e krijimit të frontit popullor nëpërmjet zhvillimit të një pune paraprake intensive e të gjithanshme me masat në rrugë legale dhe ilegale, zinte një vend qendror në propagandën e këtij grupi. Kjo ide u shpreh qartë edhe nga udhëheqësi i lëvizjes, i cili thoshte: «Duhet nisur nga abeceja. Duhet të gjejmë mënyrën konkrete se si të futemi në popull, si t'i japim ndërgjegje për luftë. Me një fjalë të mësojmë popullin të organizohet e të dijë të kërkojë gjana të vogla, si rivendikacione të vogla që nesër të dijë të kërkojë diçka më tepër. Qysh sot të dijë të organizohet në forma legale, ku të fitojë ndjenjën e bashkimit, të solidaritetit, t'i njohë fytyrat që interesohen për fatin e tij. Bie fjala, katundari të mësohet që të marrë pjesë aktive në jetën sociale ekonomike. Një shoqëri filantropike ia ndërron fytyrën një katundi krejt, e pajis me shkolla, kroje, me rrugë të mira. Shoqëritë kulturore, sportive, të zanatçinjve, jashtë shkollore nëpër qytete mbledhin me mijëra anëtarë në radhët e tyre. Ja një udhë legale ku shokët tanë mund të kenë kontakt me masat, shkurt të edukojnë e të edukohen prej masave... Të fitojmë simpatinë e masave me vepra konkrete. Kjo asht shkolla reale. Ky asht guri që vret dy zogj; me nji anë e ngreh popullin dhe avangardën e tij, nga ana tjetër i ban gropën regjimit, e han përbrenda»[50]. Aliu u propozoi edhe komunistëve shqiptarë të Lionit që të nxirrnin një broshurë dhe një gazetë ku të shpjegoheshin me hollësi detyrat e luftës për demokracinë dhe kundër fashizmit. Ideja e gazetës u vu në jetë. Në Francë doli gazeta «Sazani», e cila luajti një rol pozitiv në propagandimin e ideve demokratike e antifashiste, ndërsa dalja e broshurës u sabotua nga Llazar Fundoja.

Gatishmëria e Grupit të Korçës për të përqafuar orientimet e Kominternit lidhej me faktin që ai ishte edukuar me idetë e shëndosha të Ali Kelmendit dhe qëndronte në pozita teorike e politike, pak a shumë të drejta, ashtu edhe me përvojën që kishte nga puna me masat dhe lufta revolucionare. Kjo përvojë ia mprehu dhe më mirë idetë e veta revolucionare.

50) *AQP*. Raport i Ali Kelmendit drejtuar Kominternit, 15 janar 1938.

Grupi i Korçës, siç thotë shoku Enver Hoxha, e kuptoi mirë situatën që ishte krijuar në Shqipëri dhe në Evropë, e pa «drejt rrezikun e madh të pushtimit fashist», prandaj edhe i kushtoi rëndësi të dorës së parë luftës kundër fashizmit[51]. Kjo luftë përbënte detyrën themelore strategjike të komunistëve. Këtë detyrë strategjike revista «Përpara» u mundua t'ua bënte të qartë komunistëve dhe masave.

Ajo botoi një sërë artikujsh ku demaskohej fashizmi dhe imperializmi në përgjithësi[52].

Këtu theksohej se Italia fashiste, në bashkëpunim me imperialistët e tjerë, i kërcënohej seriozisht lirisë e pavarësisë së vendit. Imperializmi italian, pasi hodhi në dorë pozitat kyçe të vendit në të gjitha fushat, e grabiti popullin dhe e ktheu Shqipërinë në gjysmëkoloni, tani donte të ulej këmbëkryq në truallin e saj, të vendoste sundimin e egër kolonial dhe në vend të qeverisë zogiste të vinte një qeveri kukull të tipit fashist. «Përpara» demaskoi edhe klasat reaksionare e regjimin zogist që me politikën e tyre tradhtare shpunë ujë në mullirin e fashizmit dhe i hapën rrugën agresionit.

Në këtë situatë tepër të vështirë Grupi i Korçës e shihte të domosdoshme që komunistët të futeshin në popull, të punonin me të gjitha mjetet në të duke shfrytëzuar sidomos mundësinë legale, në mënyrë që ta edukonin atë me frymën demokratike patriotike e antifashiste dhe ta bashkonin në frontin popullor. Revista «Përpara» theksonte se «nuk duhej të hiqej dorë» nga «pikëpamja për të krijuar organizata, klube, sindikata, revista...» nën drejtimin e komunistëve[53]. Kjo ishte mënyra për t'u lidhur me masat dhe për t'i organizuar ato në mënyrë që të luftonin më mirë për të drejtat kombëtare e demokratike. «Detyrohemi të veprojmë tërthorazi, thuhej aty, vetëm e vetëm pse duam të mbledhim fuqi që të veprojmë drejtpërdrejt...»[54]. Ajo mundohej të argumentonte duke polemizuar me ata që nuk donin ta kuptonin situatën konkrete të vendit, sidomos me udhëheqjen e Grupit të Shkodrës, se Shqipëria si një vend gjysmëkolonial, që ishte nënshtruar nga imperializmi fashist dhe rrezikonte të humbiste krejt pavarësinë, nuk kishte vetëm një problem shoqëror, por edhe një problem kombëtar dhe ky i fundit dilte në plan të parë[55]. Aty thuhej se lufta e masave popullore për zgjidhjen e problemeve shoqërore demokratike, si dhe lufta e klasës punëtore për të drejtat e saj (lëvizja shoqërore), duhej të lidheshin

51) Enver Hoxha. *Kur lindi Partia (Kujtime)*, f. 21.
52) «Përpara», shtator-tetor 1938.
53) Po aty, tetor 1938.
54) Po aty.
55) Po aty, shtator 1938.

ngushtë me luftën për sigurimin e pavarësisë (lëvizja kombëtare).

Klasa punëtore ishte klasa më revolucionare e shoqërisë shqiptare dhe e vetmja që mund t'i udhëhiqte masat e të mbronte besnikërisht interesat e tyre, «por të kufizoheshe me klasën punëtore, të luftojë vetëm me forcat e saj, pa mobilizuar forcat kombëtare, ishte një aventurë e rrezikshme...»[56]. «Fuqia është populli, theksonte revista, pa turmat popullore s'jemi veç një grusht njerëzish...»[57].

Në përputhje me situatën e re, Grupi i Korçës formuloi edhe platformën e vet demokratike e antifashiste, apo programin minimum, i cili parashikonte këto detyra:

a) Luftën për të drejtat kombëtare të popullit kundër imperializmit;

b) Për të drejtat demokratike kundër shkeljes së statutit kombëtar dhe orvatjeve për të mbjellë fashizmin në Shqipëri;

c) Për paqen kundër luftës;

ç) Për të drejtat elementare të popullit[58].

Këtë vijë Grupi Komunist i Korçës e zbatoi me sukses brenda në qytet. Por pikëpamjet sektariste e lokaliste nuk e lejuan të shtrihej më tej. Grupi i Korçës kishte dhe një të metë tjetër të rëndësishme. Ai e kuptoi shumë ngushtë bazën mbi të cilën duhej të formohej fronti popullor në një vend të prapambetur agrar, siç ishte Shqipëria, ku fshatarësia përbënte shumicën dërrmuese të popullit[59]. Teorikisht ai e kuptonte që klasa punëtore duhej të lidhej me të gjitha masat punonjëse, sidomos me fshatarësinë, për të kurorëzuar luftën me sukses, por në praktikë nuk bëri pothuaj asgjë për të siguruar aleancën e klasës punëtore me fshatarësinë[60]. Megjithëkëto të meta, Grupi i Korçës kishte pikëpamje mjaft të përparuara.

Ndryshe prej tij udhëheqësit e Grupit të Shkodrës e të tjerë, nuk i miratuan orientimet e Kominternit dhe ishin kundër luftës për demokracinë dhe frontit popullor. Zef Mala me shokë u shprehën kundër krijimit të tij[61].

Kjo rridhte siç thamë nga vlerësimi i gabuar i tyre për gjendjen ekonomike, shoqërore e politike të vendit dhe strukturën e tij klasore, nga mungesa e bindjeve të vërteta komuniste. Ata mendonin se komunistët nuk duhej të hidheshin në luftën për demokracinë e kundër agresionit fashist, por duhej të përgatiteshin për revolucionin e ardhshëm shoqëror proletar e socialist kur të krijoheshin gjoja borgjezia dhe proletariati[62].

56) Po aty.
57) Po aty.
58) *Historia e PPSh*, f. 42-43.
59) *Po aty*, f. 43.
60) *Po aty*.
61) *Po aty*.
62) *Po aty*, f. 44.

Këta pseudorevolucionarë kërkonin t'i digjnin fazat. Por edhe për këtë ishin vetëm me fjalë, sepse me vepra ishin në pozita kundërrevolucionare. Këta të ashtuquajtur komunistë mohonin si truallin amtar të lëvizjes komuniste ashtu edhe mundësitë për themelimin e Partisë Komuniste.

Sipas tyre, komunistët do të fillonin nga veprimtaria revolucionare për ndriçimin e drejtimin e masave dhe të revolucionit komunist, kur të krijoheshin kushtet për këtë[63]. Shqipëria për mendimin e tyre duhej të kalonte drejtpërdrejtë në demokracinë proletare duke e mënjanuar fazën e revolucionit demokratik borgjez. Këto teza antimarksiste, të cilat e kishin burimin te teoritë e gabuara trockiste e arqiomarksiste, kërkonin të përligjnin pasivitetin, mungesën e dëshirës dhe paaftësinë e këtyre elementëve për t'u lidhur me masat e për t'i hedhur ato në luftë. Këto pikëpamje e qëndrime e sabotonin veprimtarinë revolucionare demokratike e qëndresën kundër agresionit, duke i shërbyer kështu reaksionit të brendshëm e të jashtëm.

Elementët antimarksistë si Zef Mala e treguan fytyrën e tyre të vërtetë në momentin më kritik, kur komunistët persekutoheshin, gjurmoheshin e burgoseshin nga qeveria zogiste. Zef Mala i tradhtoi shokët e tij komunistë dhe e denoncoi gjithë organizatën e Shkodrës te autoritetet. Si rezultat i kësaj, u arrestuan të gjithë komunistët e grupit dhe u nxorën në gjyq. Pra, platforma dhe praktika antimarksiste e kësaj udhëheqjeje dhe e elementëve të ngjashëm me ta, çoi direkt në sabotim e në tradhti dhe në bashkëpunim me reaksionin.

Por komunistët më të mirë, si: Qemal Stafa, Vasil Shanto, Myzafer Asqeri e të tjerë në çastet më kritike për ta e për vendin, mbrojtën me guxim e dinjitet idetë komuniste deri brenda në sallën e gjyqit zogist. Ata e demaskuan hapur politikën antipopullore e antikombëtare të regjimit. Komunistët e Grupit të Korçës, në kohën kur rreziku i agresionit fashist po trokiste me forcë në derë, i bënë thirrje popullit të ishte vigjilent dhe të ngrihej i tëri në këmbë në rastin më të parë për të mbrojtur lirinë e pavarësinë e atdheut.

Revista «Përpara» në një artikull të saj të botuar në vjeshtën e vitit 1938 u tërhiqte vëmendjen komunistëve dhe masave se kishte ardhur koha «të shtrëngoheshin radhët» dhe të forcohej «solidariteti». «Të jemi gati, thoshte ajo, t'i dalim zot vetes dhe shokëve tanë, që mund të bien viktima të ndonjë agresioni të provokuar ose të ndonjë padrejtësie nga ana e autoriteteve. Të qëndrojmë të patundur me gjithë pengimet, vuajtjet, mjerimet që ndeshim. Të mbajmë lart flamurin e lirisë... Të

63) *Po aty*.

jemi të bindur gjithmonë se liria do të triumfojë një ditë dhe në vendin tonë...»[64].

Në faqet e revistës u demaskua edhe lëvizja fashiste që deshën të krijojnë italianët në Korçë e gjetkë me anë të elementëve aventurierë, si Vasil Alarupi me shokë nga fundërrinat e klasave sunduese, lëvizje kjo që mori goditje të forta e u shpartallua nga komunistët, që pa lindur mirë si me anë të propagandës antifashiste, ashtu dhe me veprimet e guximshme e ndeshjet burrërore me fashistët në rrugët e qytetit.

Efektin e madh të propagandës dhe veprimtarisë antifashiste të komunistëve në Korçë, si dhe atmosferën e zjarrtë patriotike e revolucionare që krijoi në popull e ka përshkruar shumë bukur, me vërtetësi dhe gjithë emocione shoku Enver Hoxha në Veprën «Kur lindi Partia (Kujtime)».

«Në prag të pushtimit fashist të vendit, — thuhet aty, — në Korçë ndihej e fortë atmosfera e rezistencës që po piqej. Në mes të punëtorëve, rinisë, intelektualëve përparimtarë flitej për luftë kundër okupatorit, rinia ishte e zjarrtë dhe në shkollë kishte protesta të hapura antifashiste nga studentët. Ne, komunistët, bënim propagandë dhe në mbledhjet tona të rregullta ilegale diskutonin format e luftës. . .»[65]. «E gjithë kjo punë intensive që bënte grupi komunist dhe masat, thotë shoku Enver, na kishte krijuar bindjen se okupatori dhe bashkëpunëtorët e tij ishin ata që kishin frikë nga ne dhe jo ne nga ata...»[66]. Idetë komuniste e antifashiste që u përhapën në gjithë vendin i krijuan mjaft telashe e shqetësime regjimit zogist.

4. Shqetësimi i regjimit zogist nga idetë komuniste dhe masat kundër tyre

Përhapjen e gjerë të ideve komuniste në Shqipëri, sidomos në qytetet, e dëshmonte jo vetëm zgjerimi e forcimi i lëvizjeve revolucionare, por edhe reagimi i regjimit ndaj këtyre ideve.

Ekziston një dokumentacion i gjerë arkivor që hedh dritë mbi faktin se ekzistenca e përhapja e ideve komuniste në Shqipëri, ishte bërë shqetësuese për regjimin dhe klasat sunduese.

Ky dokumentacion dëshmon se këto ide kishin përfshirë të gjitha krahinat e vendit dhe depërtonin në popull nëpër shumë kanale. Sipas tij, qendra kryesore e lëvizjes dhe e propagandës komuniste ishte Korça. Këtu do të shkonte më mirë

64) «Përpara», shtator 1938.
65) Enver Hoxha. *Kur lindi Partia (Kujtime»*, f. 40-41.
66) *Po aty.*

se kudo ajo thënie e A. Zogut në një qarkore drejtuar prefekturave qysh në vitin 1925, se propaganda antizogiste në Shqipëri kishte arritur një shkallë të tillë sikur të mos ekzistonte fare qeveria e rendi publik.

Kontrollet e bastisjet e autoriteteve zogiste, siç dilte nga raportet drejtuar Ministrisë së Brendshme, kishin zbuluar në Korçë mjaft libra marksiste në gjuhë të huaja si «Lenini për gruan», «Familja dhe sistemi komunist», «Socialistët dhe lufta», «Sulmi i fashizmit dhe detyrat e lëvizjes komuniste...», «Metoda dhe taktika e sindikatave revolucionare» e të tjera[67].

Autoritetet zogiste të qytetit e shihnin ndikimin e ideve komuniste edhe në revistën «Bota e Re»[68]. Në shkurt të 1937, Musa Juka urdhëronte shpërndarjen e shoqërisë «Puna» të punëtorëve të Korçës, për arsye se ajo «ushqente idera komuniste dhe të rrezikshme për interesat tona shtetërore»[69].

Në një raport të prefektit të Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, thuhej se kohët e fundit përhapja e ideve komuniste kishte marrë «një hov të gjerë». Këto ide kishin «infektuar» të gjithë «trupin mësimor», prandaj duhej të merreshin masa kundër tyre[70].

Në një shkresë që Ministria e Punëve të Brendshme i drejtonte Korçës, shprehte pakënaqësinë dhe zemërimin që idetë komuniste qarkullonin hapur para hundës së autoriteteve dhe ato nuk ishin në gjendje t'i zbulonin autorët e tyre e t'i ndalnin ato[71]. Shkollat konsideroheshin vatra kryesore të ideve komuniste. Por nga idetë komuniste ishin të «infektuar», sipas autoriteteve, edhe mjaft nëpunës[72].

Në disa relacione prefekturat e komandat e xhandarmërisë kërkonin ta qetësonin Ministrinë se idetë komuniste gjoja nuk kishin truall të brendshëm, por ishin të importuara nga jashtë.

Prefektura e Korçës, i thoshte më 6 korrik 1937 Ministrisë së Punëve të Brendshme se «ajo inspiratë komuniste sot për sot e pa rëndësishme» nëpër shkollat vinte nga mungesa e një disipline të fortë, nga mosmarrja e masave ndërshkimore kundër nxënësve[73].

Për përhapjen e literaturës komuniste nga liceistët e Korçës u shqetësua deri prefektura e Peshkopisë[74]. Autori-

67) *Dokumente e materiale historike nga lufta e popullit shqiptar për liri e demokraci 1917-1941*, botim i Drejtorisë së Arkivave të Shtetit të RPS të Shqipërisë, Tiranë, 1959, f. 366.
68) *Po aty*, f. 369.
69) *Po aty*, f. 387.
70) *Po aty.*
71) *Po aty*, f. 398.
72) *Po aty*, f. 393.
73) *Po aty*, f. 404-405.
74) *Po aty*, f. 418.

teteve reaksionare e obskurantiste zogiste, kaq shumë iu kishte hyrë frika nga komunizmi, sa ato në listën e librave komuniste kishin futur edhe veprat e Leon Tolstoit, meqenëse ishte rus. Atyre u dukej çdo gjë ruse «bolshevike».

Edhe në Tiranë, siç i raportohej Ministrisë, po zhvillohej një propagandë komuniste. Si propagandist i flaktë përmendej Asim Vokshi[75].

Prefektura e Durrësit raportonte se në port ishin sekuestruar 2 ekzemplarë të «Kapitalit» të K. Marksit. Gjithashtu pohohej se persona «me ndjenja komuniste» zhvillonin diskutime të zjarrta për çështjen e frontit popullor në Spanjë[76].

Edhe për gjimnazin e Shkodrës thuhej se propaganda komuniste ishte e fortë, madje Musa Juka pohonte se puna kishte arritur deri aty, sa nxënësit «të nderonin njëri-tjetrin në mënyrën bolshevike»[77].

Nën mbikqyrjen e vazhdueshme të autoriteteve ishte sidomos komunisti Qemal Stafa. Në një njoftim të Ministrisë së Punëve të Brendshme thuhej se ai kishte ardhur nga Shkodra në Tiranë për të asistuar në një lojë sportive dhe «ka folur kundër veprave të qeverisë dhe ka predikuar indirekt komunizmin»[78].

Relacionet flisnin gjithashtu për propagandë komuniste në Berat, në Fier, Vlorë, Elbasan, Gjirokastër e gjetkë. Këto fakte të dokumenteve zyrtare mbi përhapjen e ideve komuniste përforcohen edhe nga shkrimi i gazetës «Arbëria», i cili është mjaft interesant e kuptimplotë nga kjo pikëpamje. Aty thuhej: «... në çdo qytet, njerëz të vjetër e të rinj nën ndikimin e dialektikës materialiste, nuk lënë rast pa thënë ndonjë fjalë ose pa zhvilluar ndonjë princip nga ata që supozojnë përmbysjen e sistemit shoqëror»[78/1].

Ministria e Brendshme nxori një sërë urdhëresash për ndalimin e sekuestrimin e literaturës revolucionare që vinte nga jashtë, si dhe të filmave përparimtarë.

U dhanë udhëzime që të ushtrohet kontroll i rreptë për zbulimin e literaturës komuniste. Organet policore sekuestruan një sërë gazetash revolucionare shqiptare e të huaja që vinin nga jashtë, si: «Liria kombëtare», «Humanite», «Populaire», «L'education proletarienne» etj.[79]. Në një shkresë thuhej se ishte sekuestruar vepra e V.I.Leninit në gjuhën angleze «Imperializmi faza e fundit e kapitalizmit»[80].

75) *Po aty*, f. 381-382.
76) *Po aty*, f. 378, 381.
77) *Po aty*, f. 414.
78) *Po aty*.
78/1) Gaz. «Arbëria», 1936, 9 maj.
79) *Dokumente e materiale* ..., f. 329, 371.
80) *Po aty*, f. 392.

Musa Juka dha urdhër të merreshin masa urgjente për të shtënë në dorë revistën «Vullnetari i lirisë» që botonin revolucionarët shqiptarë në Spanjë, e cila sipas tij «hynte tinzisht në Shqipëri me anë të Korçës»[81].

Organet zogiste sekuestruan edhe filmin përparimtar «Le combatant» ku flitej për qëndrimin burrëror të Gjergj Dimitrovit në gjyqin nazist të Laipcigut. Ky sekuestrim u bë edhe me kërkesën e legatës gjermane në Tiranë[82].

Regjimin zogist e shqetësoi deri filmi komik i Çarli Çaplinit «Kohërat moderne», për arsye se në këtë film, siç thuhej në shkresën e Ministrisë, «tregohen në mënyrë të imtë mundimet që vuajnë punëtorët e fabrikave, mizerja e të vobektëve, begatia e klasave pasanike...»[83]. Kundër «doktrinës komuniste» u vendos të merreshin masat më të rrepta, sepse siç pohohej, «kjo doktrinë që dënon bazën e shoqërisë së sotme, iniciativën private, nuk mund të pajtohet kurrë me organizimin shoqëror që ka për bazë monarkinë...[84] Në vazhdën e marrjes së masave drakoniane kundër lëvizjes komuniste, Ministria e Brendshme u drejtoi një qarkore prefekturave më 12 shkurt 1937, ku thuhej se ajo kishte vendosur të «shfaroste» e ta «shuante» propagandën komuniste në Shqipëri[85]. Më vonë u miratua dhe ligji, që parashikonte dënime të rënda më burgim prej 5-10 vjetësh për përhapjen e ideve komuniste, të cilat vinin «në kundërshtim të hapët» me regjimin shoqëror dhe atë monarqik.[86]. Regjimi zogist shpresoi se me të gjitha këto masa të egra do t'i ndalonte idetë komuniste. Por idetë komuniste dhe përparimtare nuk kishte forcë që t'i ndalonte. Ndikimi i tyre u rrit gjithnjë e më shumë në popull, në rininë punëtore, shkollore dhe inteligjencien përparimtare.

Kjo u pasqyrua qartë në ideologjinë demokratike të kohës, për të cilën do të flasim në këtë kapitull.

II. PIKËPAMJET POLITIKO-SHOQËRORE DEMOKRATIKE

Krahas ideve komuniste, një zhvillim të dukshëm në këto vite mori mendimi demokratik-revolucionar e përparimtar. Rryma demokratike në Shqipëri ishte nën ndikimin e drejtpërdrejtë të ideologjisë komuniste. Ajo u ndikua

81) *Po aty*, f. 413.
82) *Po aty*, f. 401.
83) *Po aty*.
84) *Po aty*, f. 363.
85) *Po aty*, f. 383.
86) *Po aty*, f. 345.

gjithashtu nga mendimi përparimtar e revolucionar i Evropës. Idetë demokratike përbënin një unitet me mendimin komunist, duke e plotësuar atë në kushtet e me mjetet legale.

Për themelimin e shtypit demokratik të kësaj periudhe që u bë tribuna kryesore e ideve demokratike, u interesuan vetë komunistët shqiptarë, të cilët me gjithë terrorin e egër, ditën të zhvillojnë luftën ideologjike kundër rendit çifligaro-borgjez, regjimit zogist dhe imperializmit edhe me anë të mjeteve legale. Organet publike të shtypit që u krijuan, grumbulluan forcat intelektuale më të mira e më përparimtare të kohës, shkrimtarët e publicistët revolucionarë që ishin të brumosur me idealet e reja.

Kështu, falë përpjekjeve të komunistëve dhe të elementëve përparimtarë të kohës, u krijuan një sërë organesh demokratike me rëndësi që e gjallëruan mjaft jetën mendore të vendit e luajtën një rol militant për edukimin demokratik e patriotik të popullit, sidomos të rinisë. Organet demokratike më në zë dhe më të rëndësishme ishin revistat «Rilindja» (Korçë), «ABC» (Tiranë), «Bota e re» (Korçë). Këto nuk patën jetë të gjatë, sepse censura e egër zogiste i korrte me draprin e saj. Në këtë periudhë, siç thoshte «Bota e Re», organet demokratike «vdisnin si foshnjet e parritura mirë» nga një «sëmundje e përhapur që quhej mungesë e lirisë së shtypit»[1].

Por, edhe në këto kushte, ato bënë një punë të madhe e të frytshme. Shtypi demokratik u mundua t'u bënte ballë masave drakoniane, duke e kaluar stafetën nga një organ në tjetrin. Kështu, sa mbyllej një revistë, hapej një tjetër.

Revistat u munduan ta maskojnë përmbajtjen e tyre politiko-shoqërore duke përdorur herë-herë gjuhën e alegorisë, atë të Ezopit. Por u pat kujdes që alegoria të mos ishte hermetike dhe bëheshin mjaft aluzione të qarta. U pa e arsyeshme që revistave t'u jepej edhe një farë ngjyre kulturore, që të krijohej përshtypja përpara regjimit se ato trajtonin kryesisht këto probleme. Natyrisht edhe trajtimi i çështjeve të kulturës demokratike ishte objekt i këtyre organeve. Por ato megjithatë nuk munguan të trajtojnë me guxim dhe hapur edhe çështjet politiko-shoqërore më me rëndësi të kohës, të vënë gishtin mbi plagët e shoqërisë dhe të demaskojnë me kurajë çdo gjë reaksionare. Vetë trajtimi i problemeve të kulturës nga pozitat e demokracisë synonte t'i kundërvihej obskurantizmit të klasave sunduese dhe ta përdorte kulturën si mjet për emancipimin e popullit, për fitoren e demokracisë.

«Bota e re» e deklaroi që në numrin e saj të parë se popullit nuk i duhej vetëm kultura, por në radhë të parë ajo ideologji e re, e cila do ta ndihmonte të shpëtonte nga prangat e robërisë. Në qoftë se kultura, thoshte ajo, nuk do të kishte një mision të tillë militant e nuk do t'i shërbente interesave të popullit, atëherë populli do të thoshte një ditë, siç shprehej ajo: «Kulturën e hëngërçi me bukë»[2].

Ideologët demokratë patën mjaft kurajë të godasin në shenjë dhe e mprehën mirë armën e kritikës kundër klasave reaksionare e regjimit në fuqi. Kjo ishte edhe arsyeja që revistat ku ata shprehën pikëpamjet e tyre nuk patën jetë të gjatë. Ata depërtuan deri në organet reaksionare, në shtypin zyrtar, si: «Besa», «Drita», «Vatra», «Arbëria» e të tjera. Kjo dëshmonte si për kurajën e tyre, ashtu edhe për atë fakt që ka theksuar shoku Enver se klasat sunduese, duke mos pasur partitë e tyre, nuk ishin në gjendje të ngrinin barriera të pakapërcyeshme për idetë e kundërshtarëve. Natyrisht, merita kryesore u takoi komunistëve dhe elementëve të tjerë revolucionarë që u treguan të mençur e trima dhe ia kaluan regjimit ujët nën rrogoz.

Një ndihmesë me rëndësi për përpunimin dhe përhapjen e ideve demokratike dhanë shkrimtarët e publicistët e shquar revolucionarë, si Millosh Gjergj Nikolla (Migjeni), Nonda Bulka, Kristaq Cepa (Kapa), Andrea Varfi, Dhimitër Shuteriqi, Aleks Çaçi, Shefqet Musarai e të tjerë. Kjo ishte plejada e shquar e viteve 30, e cila, u ndriçua nga idetë më të mira të kohës.

Letërsia dhe publicistika e re i kuptuan mirë detyrat e kohës dhe u rreshtuan në vijën e parë të frontit të luftës ideologjike për demokracinë.

1. Përfaqësues të idealeve të reja, të një «bote të re»

Ideologët e shkrimtarët demokratë ishin plotësisht të ndërgjegjshëm për misionin që u kishte ngarkuar koha dhe shoqëria, si përfaqësues të një rryme krejt të re, të dalë nga gjiri i popullit, të mbrujtur me vuajtjet dhe aspiratat e tij. Ky mision ishte të luftonin për zëvendësimin e «botës së vjetër» të rendit çifligaro-borgjez, me një «botë të re» me rendin demokratik. Ata pasqyronin «Shqipërinë djaloshare», siç thoshte Nonda Bulka, që kishte «filluar të lindte» në vend të «Shqipërisë plakë» që «po hiqte shpirt»[3]. Ishin «bijtë e shekullit të ri», siç thoshte Migjeni, që «plakun e lanë në

1) «Bota e re», nr. 2, 30 prill 1936, f. 13.

2) Po aty, nr. 1, 15 prill 1936, f. 13.

3) Po aty, 15 maj 1936, nr. 3, f. 10-11.

shejtnin e tij» (rendin reaksionar — V.K.) dhe që u hodhën «në lufta t'reja për me fitue»[4].

Vetë emrat që mbanin revistat demokratike ishin dëshmi e idealeve përparimtare e revolucionare të brezit që përfaqësonin.

Termat «të rinj», «qytetërim» «progres» i përdorën edhe ideologët borgjezë e të tjerë. Por ata me ta maskonin interesat dhe qëndrimin reaksionar të këtyre rrymave, siç thoshin ideologët demokratë.

Popullit i duhej një ideologji me të vërtetë e re që të zbulonte plagët e shoqërisë dhe mjetin e shërimit të tyre, të hidhte dritë mbi shumë probleme jetike «të pashoshitura e të pazgjidhura» që prisnin përgjigje dhe kërkonin zgjidhje»[5].

Në Shqipërinë e vogël, të varfër e të prapambetur, thuhej se kishte kaq shumë «punëra për të bërë» dhe kaq çështje për të zgjidhur, saqë «duheshin duzina» të përkohshme si «Bota e re» për të qarë hallet e saj dhe për të mobilizuar «opinionin publik e të gjithë popullin, për ta nxjerrë nga ky labirinth i errët»[6].

Detyrë me rëndësi e shtypit demokratik konsiderohej analiza e vëmendshme e gjithë jetës dhe e marrëdhënieve shoqërore në Shqipëri dhe kritika kundër çdo gjëje reaksionare. Kjo kritikë nuk duhej të kursente të fuqishmit e kësaj shoqërie, të gjithë ata që i shkaktonin vuajtje popullit dhe mbronin rendin në fuqi. «Sytë do t'i drejtojmë nga ana e popullit që të shohim nga se vuan dhe ç'janë nevojat e tij», thoshte «ABC»[7]. Çdo gjë që shkruhet duhet të jetë për popullin, nënvizonte «Bota e re»[8].

Ideologët revolucionarë deklaruan se nuk do të ndaleshin përpara asnjë pengese, nuk do të trembeshin nga sakrificat .Edhe sikur «të ndiqeshin e të burgoseshin» do të luftonin deri në fund për idealet e tyre dhe do të bëheshin «udhërrëfyes të popullit» në luftën për «fitimin e të drejtave qytetare»[9]. Populli kishte nevojë për një ideologji të re me përmbajtje revolucionare që të kuptonte mirë gjendjen e tij dhe të luftonte për përmbushjen e aspiratave të veta[10]. Këtu u shpreh mendimi se ideologjisë reaksionare, ashtu si dhe rendit reaksionar po i kalonte koha. Këto ishin anakronizma ose, sipas shprehjes së Migjenit, «idhuj pa krena» të

4) Migjeni. *Vargje të lira*. Tiranë. 1944, f. 7.
5) «Bota e re», 15 prill 1936, f. 1.
6) Po aty, 1936, nr. 7. f. 11.
7) «ABC», 1 mars 1936. f. 2.
8) «Bota e re». 1936, nr. 10. f. 22.
9) Po aty, f. 21.
10) Po aty.

gjymtuar e të shëmtuar[11]. Do të vinte një ditë që këta «idhuj pa krena» do të «varroseshin» dhe atëherë do të fillonte veprimtaria e vërtetë historike e popullit. Populli edhe kështu ishte krijues i historisë së vet, por kur të pajisej me ideologjinë revolucionare, veprimtaria e tij do të fitonte përmasa të rëndësishme[12]. Komunistët nëpërmjet revistës «Bota e re» shprehën atë pikëpamje të shëndoshë materialiste se idetë revolucionare e përparimtare kur futeshin në mendjet dhe shpirtrat e masave popullore, mund të bënin mrekullira dhe të tundnin dhe malet[13].

Populli konsiderohej shtylla e kombit, «shpirti i vërtetë i çdo aktiviteti shoqëror»[14].

Të gjitha arritjet e zhvillimit historik të vendit, ishin produkt i përpjekjeve të tij. Dhe simbolet më të fuqishme të kësaj krijimtarie shumëshekullore, konsideroheshin pushka dhe parmenda gjithnjë të pandara. «Pushka fitoi atdhenë, — thoshte Nonda Bulka, parmenda e ushqeu»[15].

Historia e masave popullore, shkruante Selim Shpuza (Harbuti), ishte një thesar i madh ende i pazbuluar. Intelektualët reaksionarë, thoshte ai, duke dashur të tregohen eruditë, më shumë interesohen për historinë e asirasve, babilonasve, dhe të egjiptianëve, sesa për historinë dhe hallet e popullit të tyre. Prandaj një detyrë e rëndësishme e demokracisë shqiptare ishte ndriçimi i historisë së masave popullore, nxjerrja në pah sa më mirë e rolit të tyre përparimtar gjatë shekujve[16].

Po, përpara se të vinte puna këtu, duhej bërë historia nga populli ashtu si duhej, duhej që ai ta ndryshonte fund e krye gjendjen e tij. Drejt kësaj synonte edhe demokracia revolucionare me ideologjinë e saj.

2. Kritika kundër rendit ekonomiko-shoqëror dhe klasave sunduese

Zbulimi i plagëve ekonomike-shoqërore të Shqipërisë, ishte një ndër detyrat kryesore. Ideologët demokratë shqiptarë, ashtu si dhe ata të KONARE-së, për të cilët folëm më lart, rendin çifligaro-borgjez e cilësuan si një sistem feudal. Te ky mendim i shpuri ekzistenca e mbeturinave të fuqishme

11) Po aty, 30 korrik 1936, nr. 8, f. 11.
12) Po aty, 15 maj 1936, f. 6.
13) Po aty.
14) «Gazeta e Korçës», 23 dhjetor 1933, (skicë e Nonda Bulkës).
15) «Bota e re», 15 maj 1936, nr. 3, f. 10-11.
16) Po aty, 15 qershor 1936, f. 3-4; nr. 8, 30 korrik 1936, f. 2.

të feudalizmit në Shqipëri. Ky vlerësim nuk ishte aq i saktë, po të kihet parasysh zhvillimi i marrëdhënieve borgjeze në Shqipëri. Marrëdhëniet feudale tashmë ishin kapërcyer prej kohësh.

Ekzistencën e sistemit feudal sipas tyre e dëshmonin varfëria dhe mjerimi i madh i popullit, shfrytëzimi i egër i tij me metodat e vjetra, abuzimet e grabitjet e shumta, si dhe moszbatimi i reformës agrare, atë e dëshmonte prapambetja e madhe e vendit»[17].

Klasat sunduese çifligare-borgjeze që erdhën në fuqi pas pavarësisë, thuhej se ishin të interesuara për ruajtjen e marrëdhënieve të vjetra në mënyrë që ta shfrytëzonin popullin me metodat «feudale». Ato ishin konservatore dhe kundër përparimit. Idealet e Rilindjes dhe të vegjëlisë që vendi të zhvillohej e përparonte, nuk u plotësuan[18]. Natyrisht, nuk mohohej dhe ai fakt që në Shqipëri kishte një farë zhvillimi të marrëdhënieve borgjeze dhe vendi nuk kishte qëndruar në vend numëro, por ky zhvillim konsiderohej tepër i pakët dhe nuk mund ta nxirrte atë nga prapambetja e varfëria.

«Bejlerët, thoshte «Rilindja», kishin nostalgji të fuqishme për kohën e sundimit osman dhe nuk mund të pajtoheshin me kohët e reja. Ata mundoheshin ta ruanin statuskuo-në e feudalizmit, ta kishin Shqipërinë si një «Turqi të vogël»[19].

Ky sistem parazitar i marrëdhënieve «feudale» i paralizoi forcat prodhuese të vendit dhe hoqi dëshirën për punë. Ai u bë burim vuajtjesh të mëdha për popullin. Qëllimi kryesor i këtij sistemi ishte shfrytëzimi dhe grabitja, parazitizmi në kurriz të të tjerëve. Prandaj edhe zhvillimi ecte me hapa breshke. Difekti kryesor i tij konsiderohej ekzistenca e pronës «feudale» (çifligare). Bejlerët kishin grumbulluar toka të shumta për veten e tyre, ndërsa fshatarët nuk kishin toka dhe nuk kishin mundësi të siguronin jetesën. Mungesa e tokës së fshatarësisë thuhej, ishte burim varfërie e mjerimi për të dhe për gjithë vendin. Mbi bazën e ruajtjes së marrëdhënieve «feudale» theksohej se kishte lindur edhe teoria reaksionare e zbukurimit të primitivitetit që thoshte se shqiptarit nuk kishte ç'i duhej zhvillimi e përparimi, se ai gjoja kënaqej me «bukë e kripë»[20]. Kjo ishte apologjia e prapambetjes dhe e varfërisë. Ideologët demokratë vunë në dukje edhe prirjen e zhvillimit të dobët të marrëdhënieve kapitaliste, në Shqipëri. Ata theksuan se kapitalistët shqiptarë kishin interes të investonin kapitalet e tyre më tepër në sferën e tregtisë sesa në industri dhe të merreshin gjithashtu me fajde për

17) Po aty, 1 qershor 1936, f. 4.
18) Po aty, 30 janar 1937, f. 1-2.
19) «Rilindja», 2 nëntor 1935, f.1.
20) «Bota e re», 15 maj 1936, f. 5-6.

të nxjerrë fitime. Ata shikonin më shumë interesat e fitimit sesa të zhvillimit të vendit. Kjo prirje për investime jashtë sferës së industrisë nuk duhej përgjithësuar dhe duhej thënë se zhvillimi borgjez në Shqipëri në këtë periudhë bëri disa përparime si në industri, ashtu dhe në bujqësi. Për zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste, pohohej se në Shqipëri nuk kishte kusht të favorshëm për arsyet që u thanë. Por, prapëseprapë, edhe sikur ato të zhvilloheshin, «organizma ekonomike» e sëmurë dhe e «handakosur» e shoqërisë shqiptare nuk mund të shpëtohej e shërohej me marrëdhëniet borgjeze[21]. Sistemi kapitalist, theksonte «Bota e re», kishte të meta të rëndësishme që nuk lejonin që populli të shpëtonte nga varfëria dhe vendi nga prapambetja. Ai ishte një sistem i bazuar në «përfitimin e pakicës» dhe në shfrytëzimin e vuajtjet e shumicës. Këtu përmendeshin gjithë ai shfrytëzim i egër që u bëhej punonjësve nga sistemi kapitalist, si dhe dukuritë e tij karakteristike negative, si: mbiprodhimi, krizat, papunësia e të tjera. Lihej të nënkuptohej se populli kishte nevojë për shndërrime të thella shoqërore.

Natyrisht, kritika kundër anëve negative të sistemit borgjez, linte disi mënjanë anën përparimtare të këtij sistemi në krahasim me atë feudal.

Kriza e rëndë ekonomike-shoqërore e Shqipërisë, thuhej se mund të shërohej vetëm duke ecur përpara dhe jo duke qëndruar në vend ose duke u kthyer prapa, siç aspironin reaksionarët. Populli gjatë gjithë historisë e ka gjetur lumturinë duke ecur përpara[22]. Po për këtë duheshin përpjekje e sakrifica dhe duhej punuar shumë për një jetë më të drejtë e më të lumtur. Ideologët demokratë nxorën në pah me të gjithë forcën e mendimit dhe të analizës së tyre, gjendjen e rëndë të masave popullore, varfërinë dhe mjerimin që kishte pllakosur vendin. Për këto bënë përgjegjëse klasat sunduese e shfrytëzuese, të cilat i konsideruan autorët kryesorë të tragjedisë shoqërore të popullit.

Kudo që të shkosh në Shqipëri pohonin ata, përpara syve të del tabloja e zymtë e shfrytëzimit, e grabitjeve, varfërisë së popullit e padrejtësive të shumta, vjedhjeve dhe abuzimeve në kurriz të tij e hipokrizisë dhe egoizmit të klasave parazitare[23].

Ferri i Dantes që përshkruhej në Komedinë Hyjnore, nuk ishte gjë hiç në krahasim me gjendjen e rëndë të Shqipërisë, shkruante revista «ABC»[24].

Të njëjtën ide shprehte dhe Nonda Bulka, i cili pohonte

21) Po aty, 15 prill 1936, f. 21-23.
22) Po aty, 30 shtator 1936, nr. 8, f. 1-2.
23) «Rilindja», 6 korrik 1935, f. 2.
24) «ABC», 1 mars 1936, f. 1.

edhe me një nëntekst ironizimi për fenë, se «xhenemi qiellor» nuk ishte ndonjë gjë më tepër se ai i Shqipërisë.

Sa më shumë degradohej rendi ekonomiko-shoqëror ekzistues dhe forcohej kriza e tij, aq më e rëndë, thuhej, bëhej gjendja e popullit dhe aq më shumë binte vlera e njeriut[25].

Kjo ishte një shoqëri e ndarë në dy «botë» të kundërta: në botën e të pasurve, të zhytur në luks, të egër dhe cinike dhe në atë të të varfërve «të rrahur prej urisë, mjerimit dhe dëshpërimit»[26]. «Ca kanë pasuri» dhe «ca kanë uri», theksonte Bulka. Në këtë shoqëri të ndërtuar keq e të padrejtë «fryhej pasaniku dhe thahej fukaraja»[27]. Të pasurit, të cilëve «u priste palla», nuk donin të dinin për «mizat e dheut» që dërrmoheshin në punë, gjithë jetën dhe nuk nxirrnin as bukën e gojës[28]. Një tablo magjistrale e sintetike të mjerimit popullor dha në formë artistike, shkrimtari demokrat revoluucionar Migjeni, në poemën «Mjerimi»[29]. Ai i përfytyronte klasat shfrytëzuese, shkaktarët e mjerimit të popullit, si një qen të pangopur me «bark shekullor». Populli jetonte me mbeturinat e këtij qeni që nuk ngopej kurrë. Ai bënte një punë të rëndë prej Sizifi[29/1] për të fituar një «shpërblim qesharak». Mjerimi sipas tij kishte shkaktuar plagë të rënda në trupin e shoqërisë shqiptare, plagë sociale e morale. Për rendin shfrytëzues ai ishte një gjendje normale dhe pa të cilin nuk mund të bënte. Mjerimi ishte si një «njollë e pashlyeme në ballë të njerëzimit» «që kalonte nëpër shekuj»[30].

Për përjetësimin e tij kishin një rol të rëndësishëm klerikët reaksionarë, këta «etër dinakë», këta farisenj që kishin «zënë myk ndër tempuj» dhe që me synimet e tyre dhelparake i predikonin popullit ta priste shpëtimin prej mëshirës së të pasurve, prej kësaj «bije basdarde», siç thoshte shkrimtari.

Një nga rrathët më të shëmtuar të ferrit shqiptar, sipas demokratëve revolucionarë, e përbënte gjendja e rëndë dhe e mjeruar e fshatarësisë shqiptare[31].

Fshatarësia që derdhte gjithë atë mundim e djersë, thoshin ata, që rropatej gjithë kohën në punë dhe me mundin e saj mbante popullin e kombin, nuk i gëzonte frytet e punës së saj, për shkak të shfrytëzimit të egër nga ana e pronarëve dhe shtetit, për arsye të taksave e detyrimeve të shumta, të grabitjeve të panumërta që i bëheshin nga klasat e pasura[32]. «Këpushët» e pangopura, si: bejlerët, agallarët, tregtarët, fajdexhinjtë, nëpunësit e xhandarët i ishin qepur keq pas lëkurës, i thithnin gjakun e saj dhe ia merrnin krejt fuqinë[33]. «Puno o fatkeq e ha o bark dreq», ky ishte fati i fshatarit shqiptar në këtë shoqëri, thoshte «Bota e re»[34]. Sikur fshatari të kishte tokën e tij dhe të mos ishte skllav i beut, nuk do të katandisej në këtë gjendje. Bujqit e çifligjeve e fshatarët e tjerë nuk dinin nga t'ia mbanin, ata nuk kishin kujt t'i ankoheshin, sepse beu dhe agai përkraheshin e mbroheshin nga organet qeveritare. «Shtypësi shekullor i bujkut (beu e agai, pasaniku) fitonin dhe paratë e gjyqit»[35]. E gjithë struktura dhe superstrukura e rëndë dhe e prapambetur e shoqërisë shqiptare, sipas ideologëve demokratë, rëndonte me të gjithë peshën mbi fshatarësinë e popullin dhe ia zinte frymën. Ata kundërshtuan atë pikëpamje reaksionare se fshatarësia ishte përtace prej natyre dhe nuk donte të punonte. Bujku nuk ishte dembel, pohohej prej tyre, por kur «mejtonte se toka s'ishte e tija dhe që nesër e pasnesër mund të dëbohej prej saj», gjithashtu kur e shihte se nuk fitonte asgjë nga mundi dhe djersa e vet, atëherë e humbiste dëshirën për të punuar dhe demoralizohej krejt[36].

Këtu vihej në dukje edhe se fshatarësia e rrënuar nga shfrytëzimi i egër e varfëria proletarizohej dhe drejtohej nëpër qytete për të siguruar mjetet e jetesës. Kështu lindi «urbanizmi» apo emigrimi i brendshëm, ajo plagë e rëndë, siç thuhej këtu, që dëshmonte për degradimin ekonomik të vendit dhe për faktin që ai nuk po i ushqente dot forcat e gjalla prodhuese të tij[37]. Por, kjo dukuri që në përgjithësi shpjegohej drejt, duhej të lidhej edhe me faktin që fshatarëve të proletarizuar apo gjysmë të proletarizuar, marrëdhëniet borgjeze të zhvilluara dobët e të kapërthyera nga kriza, nuk mund t'u siguronin front pune në qytet. Kështu, në këto kushte, për fshatarët e për të gjithë ata prodhues të vegjël që pësonin fatin e tyre, krijohej një rreth i mbyllur.

Nga ky rend i kalbur dhe prej krizës së tij, vuante së tepërmi dhe fshatarësia e krahinave malore. Ajo e provoi mirë çdo të thoshte varfëri e mjerim. Tragjedinë e malësorëve, të cilët rendi çifligaro-borgjez i dënoi rëndë duke i privuar nga të mirat më elementare, duke i lënë pa bukë, e duke i izoluar dhe nga qytetërimi, e ka përshkruar me ngjyra

25) «Gazeta e Korçës», 10 shtator 1932, (N. Bulka).
26) Po aty, 4 maj 1933, f. 1. (N. Bulka).
27) «Bota e re», 15 qershor 1936, f. 12. (K. Cepa).
28) Po aty.
29) Migjeni. *Vep. cit.*, f. 14-23.
29/1) Hero i mitologjisë greke i dënuar nga Perëndité të bënte një punë tepër të mundishme e pagrat që s'merrte fund kurrë.
30) Migjeni. Vep. e cit.
31) «ABC», 1 mars 1936, f. 7.
32) «Rilindja», 8 janar 1935, f. 6-7.
33) «Bota e re», 15 prill 1936, f. 6.
34) Po aty, 30 shtator 1936, f. 11.
35) Po aty.
36) Po aty, 15 nëntor 1936, f. 9-11.
37) «Vatra», 16 gusht 1936, (Andrea Varfi).

të gjalla realiste dhe rrënqethëse, shkrimtari revolucionar Migjeni në «Legjenda e misrit»[38].

Kjo prozë që pasqyron zinë e bukës në malësitë e Veriut është një përgjithësim i saj dhe i dukurive të mjerimit popullor në shkallë kombëtare. Ajo është një aktakuzë dhe demaskim i rreptë kundër klasave sunduese dhe regjimit zogist që e rrokullisën popullin në humnerën e krizës të urisë e varfërisë. Kjo ishte periudha, thoshte Migjeni, kur në krahinat tona, në këto «çerdhe shqiponjash», nuk kishte më «apotheoza perëndish», por vetëm «apotheoza misri». «Nji kokërr misër asht nji kokërr dhimbje ku ka shumë û e aspak misër», theksonte ai me forcën e sintezës.

«Ushtojnë luginat e maleve nga fjalët e malësorëve t'unshëm që varg njëri pas tjetrit, ecin të ngarkuem pa fund si asht e gjatë e pafund vuajtja e tyne. Mbi kurriz të vet barin perëndinë. Perëndi e vërtetë — misër i dëshiruem ... Misër për fëmi të nximë nga mjerimi, të cilët kur duart shtrijnë, u përngjajnë lugetënve të vocër. Dhe këta fëmi janë dëshmitarët e vërtetë të tragjedisë njerëzore... lumnija e vërtetë asht larg, tepër larg nga këto foletë e shqipeve»[39].

Këtu stigmatizoheshin edhe apologjetët e klasave sunduese e kleri katolik që idealizonin e zbukuronin jetën e malësorëve dhe nuk donin të dinin për vuajtjet e plagët e tyre të rënda.

Vuajtjet pa fund të malësorëve shkrimtari demokrat revolucionar, i pasqyroi edhe në vjershën «Recital i malësorit», në të cilën ata paraqiteshin si «trashëgimtarë të vuajtjes», që «enden mbi bark të malit (rendit ekzistues — V.K.) me ujen e zgjueme dhe me klithma të pakënaquna të instinktit»[40].

Edhe Bulkën e revoltonte fati tragjik i fshatarit shqiptar që mbillte po nuk korrte, që vuante për një kokërr misër në një kohë kur shfrytëzuesit dhe tiranizuesit e tij, i kishin hambarët plot[41]. Fshatarësia shqiptare, thoshte shkrimtari demokrat-revolucionar, nuk e meritonte një fat të tillë, qoftë për faktin që me punën dhe djersën e saj mbante gjallë gjithë kombin, qoftë edhe për ndihmesën e madhe e të shquar që kishte dhënë në luftën për liri e pavarësi. Kur ishte nevoja për të mbrojtur atdheun, fshatarët hidheshin në zjarr e në flakë të parët me pushkë në dorë, ndërsa tashti s'kujtohej njeri për ta dhe ata që dikur fshiheshin nëpër bodrume e që pastaj vrapuan të zinin karriket, nuk donin të dinin për

38) «Bota e re», 15 tetor 1936, nr. 13, f. 14-15.
39) Po aty.
40) «Illyria», 7 mars 1936, (Migjeni).
41) Chri Chri. *Kur qan e qesh bilbili.* Korçë, 1934, f. 26-27.

vuajtjet e tyre[42]. Por Shqipërinë e pavarur që kemi sot, nënvizonte Bulka, e kemi nga fshatarët trima e patriotë dhe jo nga ata që fshiheshin nëpër bodrume.

Jetën e rëndë të fshatarësisë dhe kontrastet sociale në fshat i përshkroi bukur e me një frymë satirike që godiste në shenjë edhe shkrimtari përparimtar K. Cepa (Kapa), i cili botoi një sërë vjershash në «Botën e Re», «Rilindja» e gjetkë. Ai fliste për fshatarin që rropatej në punë, që s'ngopej me bukë e nuk i dilte të blinte as opinga e shajak për t'u veshur, në kohën kur beu dhe arhondi fryheshin me djersën e tij[43]. Fshatarët e raskapitur e të varfëruar, thoshte ai, mbanin një botë të tërë mbi supe dhe gjithë djersën dhe mundimin e tyre e harxhonin për parazitët.

Ideologët demokratë trajtuan edhe çështjen e nivelit të ulët të forcave prodhuese të bujqësisë shqiptare. Thuhej se bujqësia për shkak të marrëdhënieve ekonomike-shoqërore «feudale» kishte një nivel agroteknik primitiv dhe po merrte të tatëpjetën. Ajo nuk ishte në gjendje të ushqente as popullsinë e vendit[44]. Dhe ai pak prodhim që dilte prej saj, nxirrej jashtë nga spekulatorët që donin të fitonin dhe importohej përsëri në kohë zie po për këtë qëllim.

Bujku primitiv, pa mjete prodhimi pune e jetese, dhe i dërrmuar nga sëmundjet, nuk ishte në gjendje ta çonte bujqësinë përpara[45]. Ata kishin mendimin se as kapitalistët nuk dëshironin të investonin kapitalet për këtë qëllim[46]. Po këtu duhet thënë se çështja nuk qëndronte krejt ashtu, sepse në këtë periudhë po bëheshin disa përpjekje për zhvllimin e marrëdhënieve borgjeze në fshat dhe për investim kapitalesh nga borgjezia agrare. Natyrisht, ky proces zhvillohej ngadalë. Fajtor për prapambetjen e bujqësisë bëhej me të drejtë edhe shteti reaksionar, i cili nuk kujdesej për zhvillimin e saj dhe nuk merrte asnjë masë për t'i mbrojtur prodhuesit e vegjël nga konkurenca në tregjet e jashtme. Si përfundim, thuhej se bujqësia nuk mund të nxirrej nga prapambetja veçse me «ndryshime shoqërore», me të cilat nënkuptohej në radhë të parë reforma agrare demokratike[47].

Revolucionarët demokratë, krahas çështjeve të fshatarësisë, i kushtuan vëmendje edhe problemeve e halleve të vegjëlisë së qytetit. Ata pasqyruan vuajtjet e keqësimin e gjendjes së punëtorëve, të zejtarëve, shegertëve e hysmeqarëve, të tregtarëve të vegjël që po rrënoheshin.

42) «Gazeta e Korcës», 9 shkurt 1933, (N. Bulka).
43) «Bota e re», 30 qershor 1936, f. 12; 15 gusht 1936, f. 12-13.
44) Po aty, 15 prill 1936, f. 6.
45) Po aty.
46) Po aty, 30 tetor 1936, f. 5-7.
47) Po aty, 15 gusht 1936, f. 7-8.

Klasa më e shfrytëzuar e më e keqtrajtuar e Shqipërisë, konsiderohej klasa punëtore. Ajo cilësohej si «vegël e domosdoshme e fitimit të të pasurve...»[48]. Vlera e punës në vend, thuhej se kishte rënë shumë, kështu që punëtorit nuk i kishte mbetur gjë tjetër veçse vlera si mjet fitimi. Këtu vihej në dukje ajo dukuri e rendit shfrytëzues siç ishte tjetërsimi që e privonte punëtorin nga produktet e punës së tij dhe atributet e vërteta njerëzore.

Ideologët demokratë thoshin se nuk kishte klasë punëtore në Evropë që të trajtohej më keq, se klasa punëtore shqiptare. Ajo shfrytëzohej pa mëshirë nga kapitalistët, paguhej shumë keq, nuk kishte asnjë kusht të përshtatshëm pune e jetese dhe i nënshtrohej arbitraritetit të pakufizuar të punëdhënësve[49].

Në Shqipëri nuk ekzistonte asnjë legjislacion që të caktonte sasinë maksimale të orëve të punës dhe disa kushte të domosdoshme të punës e të jetës. Punëtori ishte kthyer në kafshë pune, në skllav. Nga kushtet e rënda ai plakej në moshën 30-40 vjeçare[50].

Papunësia konsiderohej plagë e rëndë për klasën punëtore e për popullin. Kjo ishte një tregues i krizës së thellë të rendit shoqëror. «Kërkojnë punë e punë s'gjejnë — pohonte «Bota e re» — as fizike as intelektuale...»[51]. Problemin e mprehtë social të papunësisë e trajtoi bukur edhe Migjeni në prozën «Mollë e ndalueme»[52]. Ai trajtohej si problem shqiptar e botëror. Papunësia dhe uria, si rrjedhim i saj, thoshte Migjeni në mënyrë alegorike, shkaktonin te të papunët që s'kishin bukë të hanin një «revolucion në miniaturë» (zhurmë e urisë në zorrët e tyre). Lihej të nënkuptohej se ky «revolucion në miniaturë» mund të kthehej në një revolucion të vërtetë, po të vazhdonte kjo gjendje. Përshkruhet një punëtor i ri që endej gjithë ditën pa punë nëpër qytet pa një lek në xhep dhe vështronte vitrinat e dyqaneve me mallra, të cilat për të papunin ishin «mollë e ndalueme». Punëtori, përpara vitrinës shtrëngoi grushtet dhe dhëmbët me zemërim për gjendjen e tij tepër të rëndë, por iu kujtua ligji dhe polici dhe i vuri duart prapa. Migjeni e ka përshkruar si sociolog dramën e punëtorëve në shoqërinë kapitaliste, tjetërsimin e dehumanizimin e këtij sistemi.

Demokratët revolucionarë dënuan sidomos shfrytëzimin e punëtorëve të mitur që ishte një dukuri e përhapur në Shqipëri. Shfrytëzimi i egër i punëtorëve të vegjël nëpër fabrika

48) «Bota e re», 15 shtator 1936, nr. 11, f. 6-7.
49) Po aty, 30 prill 1936, f. 10-11; 15 shtator 1936, f. 6-7.
50) Po aty, 30 prill 1936, f. 10-11.
51) Po aty, 1 qershor 1936, nr. 4, f. 5-7.
52) «Jeta dhe kultura», 20 korrik 1935.

dhe i shegertëve ishte i leverdisshëm për kapitalistët e pronarët, sepse i paguanin me mëditjet më të vogla dhe i mbanin në punë 10-12 orë, duke nxjerrë fitime të mëdha nga djersa e tyre. Dukuri e shëmtuar konsiderohej edhe shfrytëzimi i hysmeqarëve nga të pasurit: «Nëpër shtëpiat e këtyre të fundit shkruante «Bota e re» gjeje gjithë ato Kozeta shqiptare që shfrytëzoheshin egërsisht e nuk shihnin ditë të bardhë»[53].

Nga kriza e rëndë e varfëria, pohohej se vuanin edhe shtresat e mesme, zejtarët e tregtarët e vegjël. Edhe këta po proletarizoheshin e po rrokulliseshin në greminën e mjerimit[54].

Fajdexhinjtë e tregtarët e mëdhenj ishin bërë tmerri i popullit. Masat punonjëse u zhytën në borxhe të rënda dhe detyroheshin të shisnin çdo gjë që kishin për shlyerjen e tyre e më në fund mbeteshin pa bukë, pa mjet jetese. «ABC» demaskonte grabitjet legale me anë të spekulimeve dhe kamatës dhe kërkonte shpalljen e moratoriumit të borxheve për të shpëtuar mijëra punonjës që përpëliteshin në kthetrat e fajdexhinjve. Revista kritikoi edhe parlamentin zogist, «shtabin madhor» të fajdexhinjve, që e kundërshtonte me këmbëngulje miratimin e moratoriumit[55].

Klasat e pasura dhe regjimi reaksionar u vunë në qendër të kritikës. Ata u stigmatizuan me epitetet më negative. Një kritikë e ashpër iu drejtua sidomos krerëve të reaksionit apo «baballarëve të kombit» siç quheshin përfaqësuesit e grupit «Besa». Klasat shfrytëzuese cilësoheshin si «parazite», «kusarët e ditës», «shushunja», «adhuronjës të perëndisë së parasë».

«Këta parazitë, — thoshte «Rilindja», — për fatin tonë të keq, qëndruan këtu, bile në shumicë të madhe morën përsëri frenat e këtij shteti në dorë...»[56]. «ABC» shprehte mendimin se të pasurit duke pasur paratë dhe mjetet e tjera të prodhimit në duart e tyre, pinin gjakun e popullit, e rripnin dhe e sundonin atë[57].

Shfrytëzimi dhe grabitjet ishin të legalizuara me anë të ligjeve dhe mbroheshin dhe nga shteti. Ata i merrnin në mbrojtje edhe mercenarët e penës, ideologët reaksionarë[58]. Në shfrytëzimin e egër të popullit thuhej se nuk mbetej prapa as borgjezia shqiptare e etur për para. Paraja dhe fitimi ishin «perëndia» e klasave shfrytëzuese. «Tregtarë, sarafë, fajdexhinj, fetarë, ministra të financave ose tagrambledhës, —

53) «Bota e re», 15 maj 1936, nr. 3, f. 14-15.
54) Po aty, 30 prill 1936, f. 3-4.
55) «ABC», 1 mars 1936, f. 5.
56) «Rilindja», 21 mars 1936, f. 2.
57) «ABC», 1 mars 1936, f. 9.
58) Po aty.

shkruante Bulka, — të gjithë këta luftojnë për paranë»[59]. Në rendin shfrytëzues theksonte shkrimtari, paraja ishte në krye të hierarkisë së vlerave. Ai që kishte para kishte fuqi, nder dhe virtyte të tjera.

Mendohej se borgjezia shqiptare kishte fituar tiparet e një klase të vërtetë grabitqare dhe ishte zhveshur nga skrupujt moralë. Ajo ishte «çmendur» pas fitimit dhe gjithçka e kishte fituar duke «kërcyer mbi skelete». Ajo mundohej të paraqitej përparimtare, e liberale, të vinte maskën e qytetërimit, por në të vërtetë anonte nga konservatorizmi dhe reaksioni dhe ishte e mbushur me paragjykime e mentalitete të vjetra[60]. Këtu bëhej aluzion për lustrën e qytetërimit oksidental që kërkohej t'i jepej rendit të kalbur çifligaro-borgjez.

Kritika e ideologëve demokratë u drejtua edhe kundër shtetit reaksionar, kundër qeverisë çifligaro-borgjeze. Shpeshherë kjo kritikë ishte e tërthortë ose me alegori. Bëhej sikur teorizohej për shtetin ose regjimin në përgjithësi, ose sikur flitej për regjime të tjera. Por në shenjë në fakt ishte regjimi zogist. Megjithatë, nuk mungoi edhe kritika e hapur. Për këtë u shfrytëzua edhe periudha e qeverisjes së M. Frashërit, gjatë së cilës u dhanë ca liri të kufizuara dhe u zhvillua një farë polemike në shtyp.

Revista «Rilindja» përpara se të vinte qeveria e M. Frashërit në fuqi, shtjellonte teorinë e sovranitetit popullor në faqet e saj dhe thoshte se shteti që mbron e përfaqëson interesat e populit, nuk mund të ketë në krye njerëz që vijnë në kundërshtim me këto interesa, që nuk bazohen në ligjet dhe vullnetin e tij. Një shtet që punon për interesat egoiste të atyre që drejtojnë, theksonte ajo plot nëntekst, nuk mund të quhej aspak shtet modern e demokrat por një shtet feudal[61]. Aluzioni ishte i qartë. «Rlindja» u referohej teorive të Rusoit e të tjerëve mbi sovranitetin e popullit, për të goditur regjimin satrap të A. Zogut. Shteti feudal në fakt ishte shteti reaksionar shqiptar. Kundër regjimit pati dhe kritika të drejtpërdrejta.

U tha se fuqinë e kishin marrë në duar njerëzit e «njëqind flamurëve», siç pohonte Bulka, të cilët u kujtuan se kishte Shqipëri, kur deshën ta shfrytëzonin e ta rripnin[62]. Bulka i stigmatizonte «baballarët e kombit» që hiqeshin si atdhetarë të flaktë. Duke përshkruar pemën gjenealogjike të tyre, ai thoshte se ata ishin «stërnipër të pashallarëve

59) «Bota e re», 15 prill 1936, f. 7.
60) Migjeni. *Vepra të zgjedhura*, Tiranë, 1969, f. 139-166.
61) «Rilindja», 4 maj 1935, f. 2.
62) «Arbëria», 1 mars 1936.

e të vezirëve» të Turqisë dhe komandantë të Portës së Lartë që kishin shtypur kryengritjet popullore antiosmane[63]. Ai kritikoi hapur kur erdhi qeveria e M. Frashërit në fuqi ish-ministrin e Brendshëm famëkeq Musa Juka që i kishte mbushur burgjet e vëndet e internimit me elementë përparimtarë.

«Baballarët e kombit» ishin tepër të njollosur dhe kishin një bagazh të madh veprimtarie reaksionare. Ideologët demokratë e cilësuan aparatin burokratik si një makinë shtypëse dhe organizëm parazitar. Kasta burokratike përbëhej nga elementë që rronin në kurriz të popullit, që i pinin gjakun atij dhe i hiqnin kafshatën e gojës[64]. Populli nuk shihte asnjë të mirë dhe asnjë mbrojtje nga shteti, përkundrazi shfrytëzohej, grabitej e shtypej prej tij[65]. Kjo kritikë e ashpër që i drejtonte revista «ABC» regjimit e klasave sunduese, ashtu si dhe kritika të tjera, bënë që Qeveria zogiste të merrte masa të rrepta kundër saj dhe ta mbyllte menjëherë. Dolën gjithsej vetëm dy numra.

Shtypi demokratik i drejtoi kritika edhe qeverisë liberale të M. Frashërit që u përpoq ta mashtronte popullin me demagogji.«ABC»-ja nuk la pa goditur edhe parlamentin zogist, të cilin e quajti «shtabi madhor» i fajdexhinjve dhe i grabitësve të tjerë, për arsye se aty ishin grumbulluar përfaqësuesit kryesorë të reaksionit[66]. Kritika të forta i bëri regjimit edhe revista «Bota e re», e cila përdori më shumë gjuhën e Ezopit.

3. Demaskimi i ideologjisë reaksionare

Një meritë e veçantë e demokracisë revolucionare ishte kundërshtimi e demaskimi i rrymave ideologjike reaksionare. Komunistët dhe demokratët revolucionarë iu kundërvunë menjëherë si rrymave të hapura reaksionare, ashtu edhe atyre që mbanin maskën e përparimit.

Nëpërmjet revistës «Bota e re» e organeve të tjera, u bënë kritika të forta sidomos kundër «neoshqiptarizmës», rrymës së «diktaturës së ndritur», gjithashtu kundër fesë dhe klerit. Krahas këtyre organeve, një ndihmesë me vlerë për demaskimin e ideologjisë reaksionare, në radhë të parë të fe-

63) Po aty, 23 janar 1936.
64) «ABC», 1 mars 1936.
65) Po aty.
66) Po aty.

së, dhanë shkrimtarët demokratë-revolucionarë, si: Nonda Bulka, Migjeni e të tjerë.

«Bota e re» zhvilloi një polemikë të ashpër kundër rrymave reaksionare borgjeze që kërkonin të paraqiteshin si shprehëse të interesave të popullit e të kombit. Ajo i cilësonte përfaqësuesit e këtyre rrymave si demagogë dhe «akrobatë të regjur në punë metamorfozash ideologjike»[67]. Ideologjia e tyre, thoshte ai, nuk kishte asgjë të përbashkët me interesat e popullit, por ishte një ideologji reaksionare antidemokratike. «Neoshqiptarizma» konsiderohej si një rrymë idealiste e metafizike borgjeze që merrej me spekullime teorike, që «endej në sferat eterike» dhe qëndronte larg halleve e problemeve të popullit[68]. «Bota e re» nuk mund të pajtohej me metodën idealiste të «neoshqiptarëve» që e shpjegonte gjithçka me idetë dhe këto ia atribuonte mendjeve të ndritura të një elite të kulturuar. Kjo metodë e shtrembër, sipas saj, nuk merrte parasysh as kushtet reale të jetës, as historinë e vërtetë dhe as veprimtarinë krijuese të masave popullore[69].

Ideologjia elitariste e «neoshqiptarëve», ishte ideologji e intelektualëve borgjezë, arsyetonte revista, e shkëputur nga populli dhe problemet e tij. Popullit i duhej një ideologji përparimtare e revolucionare që të shprehte aspiratat e tij, «të futej në shpirtin e turmave dhe të frymëzonte përpjekjet e tyre»[70].

«Bota e re» nuk pajtohej as me pikëpamjen agnostiçiste «neoshqiptare» sipas së cilës nuk mund të depërtohej në shkaqet e vërteta të dukurive shoqërore dhe prandaj nuk mund të njiheshin sëmundjet nga të cilat vuante populli dhe i gjithë vendi. Kjo pikëpamje përpiqej t'i mbulonte plagët e shoqërisë shqiptare, të paralizonte veprimet e përpjekjet për shërimin e tyre. Ajo shpinte në «fatalizëm». «Sëmundja jonë, — pohonte organi demokratik, — nuk është e panjohur dhe e pashpjegueshme. Ne i dimë arsyet e saj dhe shërimin e saj e kemi vetë në dorë»[71].

Këtu kundërshtohej edhe ideja «neoshqiptare» se ideologjia ishte thjesht kulturë dhe e shkëputur krejt nga politika e interesat klasore. Revista u thoshte «neoshqiptarëve» se as nuk ka pasur, as nuk do të ketë një ideologji apolitike, sepse siç linte ajo të nënkuptohej, çdo ideologji është shprehje e interesave të caktuara klasore dhe, si e tillë, ajo ishte

67) «Bota e re», 30 tetor 1936, f. 16-18.
68) Po aty.
69) Po aty.
70) Po aty.
71) Po aty, 15 janar 1937, f. 1-5.

«ideologji politike par excellence»[72]. E gjithë kultura, sipas saj, kishte përmbajtje politike e klasore. Këtu sillej një shembull i tillë për të mbështetur këtë tezë: «... teatri është vepër kulturore, mirëpo kur hyn Goebelsi në mes dhe e përdor si mjet për të shprehur ideologjinë nacional-socialiste, atëherë bëhet vegël politike»[73]. Por kjo tezë mbështetej edhe në përvojën e vendit. Të gjitha lëvizjet shqiptare, kombëtare e demokratike, ishin frymëzuar e drejtuar nga objektiva të caktuar politikë e shoqërorë. Prandaj konsiderohej absurde përpjekja për të ngritur një mur kinez midis veprimtarisë historike, shoqërore e kulturore dhe politikës[74].

Vetë revista e deklaronte hapur thelbin politik të ideologjisë së saj që ishte krijimi i një Shqipërie demokratike e të qytetëruar ku populli «të gëzonte të mirat e këtij qytetërimi»[75].

Predikimi i apoliticizmit, konsiderohej i dëmshëm për interesat e popullit, sidomos në këto kushte të vështira që jetonte ai. Apoliticizmi synonte në shkëputjen e intelektualëve nga populli, në mbylljen e tyre në kullën e fildishtë të mendimit e të spekulimeve teorike, në largimin e tyre nga veprimtaria praktike.

Këtë prirje e kritikoi edhe shkrimtari demokrat revolucionar Migjeni, i cili ironizonte në «Programi i një reviste» pikëpamjet mbi politikën si një instrument makiavelik, si një «kameleon», që i përshtatej situatave, si dhe pretendimet mbi apoliticizmin[76].

Ideologët demokratë-revolucionarë, thoshin se detyra e intelektualëve të vërtetë ishte të punonin për popullin, për përmbushjen e aspiratave të tij, t'i derdhnin gjithë dijet e energjitë, e tyre në këtë drejtim, por jo të merreshin siç pohonin «neoshqiptarët» me «vetëpërsosjen e tyre», me teorizime abstrakte boshe që nuk i duheshin vendit[77].

«Bota e re» i kundërshtoi edhe teoritë e «diktaturës së ndritur» që binin erë ideologji fashiste.

Mendimtarët demokratë mbajtën qëndrim kritik edhe ndaj idealizimeve e zbukurimeve të «qytetërimit oksidental» si dhe ndaj tezës se e vetmja rrugë zhvillimi për Shqipërinë ishte «oksidentalizimi» i saj.

Ky qytetërim borgjez, i egër dhe cinik, bënte aluzion Migjeni në «Kanga e Perëndimit», i shfrytëzonte në mënyrë

72) Po aty.
73) Po aty.
74) Po aty.
75) Po aty.
76) Po aty 15 qershor 1936, nr. 5, f. 16.
77) Po aty, 15 nëntor 1936, f. 1-3; 15 janar 1937, f. 1-5.

të pashpirt njerëzit e punës, prandaj nuk mund të shërbente si model[78].

Një vend të rëndësishëm në demaskimin e ideologëve reaksionare zinte kritika kundër fesë. Ajo ishte një kritikë e mprehtë që goditi në shenjë dhe i çoi më tej traditat ateiste e antiklerikale të popullit.

Ideologët demokratë demaskuan si fenë, këtë «opium» të dëmshëm e të rrezikshëm për popullin, ashtu edhe klerikët reaksionarë, këta tartufër të kohëve moderne që përhapnin opiumin e fesë e zhvillonin veprimtari antidemokratike e antikombëtare. Kritika kundër fesë ishte racionaliste, e argumentuar mirë për kohën, me përmbajtje klasore e demokratike. Ajo zbuloi karakterin fantastik e iluzor të fesë, synimet e saj antidemokratike e thellësisht reaksionare.

Ky «opium qiellor», siç e quante Nonda Bulka, kishte si funksion kryesor shoqëror të mbante në këmbë rendin shfrytëzues, të përjetësonte shfrytëzimin e nënshtrimin e masave popullore. Masave u thuhej nga klerikët, arsyetonte shkrimtari, ki besim te zoti dhe do të shpëtosh nga vuajtjet e hallet e shumta, por të varfërit që i besonin këtij mashtrimi nuk ishin çliruar ndonjëherë me anë të fesë nga mjerimi e varfëria[79]. Zoti prandaj «ka ndenjun galuc në trut e njerëzimit» (është fjala për fenë — V.K.), aludonte Migjeni, që me anë të robërimit të mendjes së popullit të konsolidojë robërimin ekonomik-shoqëror e politik të tij[80].

Rrënjët klasore e shoqërore të fesë, edhe pse nuk zbuloheshin hapur, me anë të shpjegimit që i bëhej asaj, liheshin të nënkuptoheshin. Një burim e mbështetje e fesë konsiderohej padija, dobësitë e mendjes njerëzore, si dhe «rajallëku i shpirtit» apo frika e njerëzve përpara përrallave shekullore[81].

Rrënjët gnoseologjike të fesë u analizuan gjerësisht, ndërsa ato sociale, siç thamë, më tepër u nënkuptuan, kështu që lindte përshtypja sikur feja mbështetej kryesisht mbi padijen dhe frikën.

Në kohët moderne thuhej me të drejtë se feja nuk kishte forcën dhe autoritetin që gëzonte në mesjetë. Ikën ato kohë, thoshte Bulka, kur feja i kishte lidhur njerëzit me zinxhirë të fuqishëm. Tashti ishte koha e zhvillimit të shkencës, e ndriçimit të mendjeve. Kështu, dobësimi i pozitave të fesë shikohej më tepër nën prizmin iluminist. Por këtu duhej thënë se ishin në radhë të parë proceset sociale përparimtare e

78) «Minerva», qershor 1935.
79) «Arbëria», 9 janar 1936, (N. Bulka).
80) Migjeni. *Vepra të zgjedhura*. Tiranë, 1969 («parathënie e parathënieve), f. 15.
81) «Arbëria», 9 janar 1936, (N. Bulka).

revolucionare ato që ia dobësuan truallin fesë. Edhe për Migjenin, tabloja «ideale e vjetër mijëvjeçare» e fesë, nuk ekzistonte më. Predikimet e priftit e të hoxhës tani kishin filluar të dukeshin si «një këngë e degjeneruar»[82]. Megjithatë, ekzistenca e « kishave dhe xhamijave madhështore» me kambanaret e minaret e larta «në vendet tona të mjeruara» përballë «shtëpive tona përdhecke», dëshmonte se feja ende kishte mjaft fuqi e qëndronte në roje të rendit shfrytëzues.

Ideologët ateistë trajtuan një sërë problemesh gnoseologjike e ontologjike që lidheshin me fenë. Ata nxorën në pah absurditetin, si dhe karakterin iluzor e antihumanitar të fesë, duke hedhur poshtë me argumente legjendat e përrallat mbi ekzistencën e zotit, sofizmat dhe arsyetimet banale të fesë që nuk mund të pranoheshin nga mendja e shëndoshë njerëzore. Këtë e bënë në radhë të parë me anë të gjetjes së kontradiktave e të nonsenseve në predikimet e librave të shenjtë. Kontradikta më e madhe, sipas tyre, që vinte në dyshim ekzistencën e qenies hyjnore, ishte kontradikta midis qenies së saj si një forcë transcedentale gjoja e përsosur dhe e plotfuqishme dhe krijesave e veprave të saj plot të meta e boshllëqe. Ekzistenca e së keqes në përpjesëtime të mëdha në shoqërinë njerëzore (e së keqesë sociale, fizike e morale) nuk mund të përputhej me ekzistencën e një qenieje aq të përsosur, siç pretendohej të ishte providenca, e cila konsiderohej si mishërimi më i lartë i mirësisë, që deshi ta bëjë njeriun sipas fytyrës së vet.

Feja është munduar të dalë nga situata dhe kontradikta, duke pohuar se zoti e bëri njeriun gjoja të gabojë dhe të keq, për ta pajisur me ndjenjën e lirisë dhe që të përsoset moralisht e ta gjejë vetë rrugën që shpie tek e mira. Ky është një arsyetim sofistik që nuk provohej nga praktika njerëzore.

Këtë sofizëm Bulka e ironizonte dhe e hidhte poshtë bukur e me logjikë. Vepra e zotit, thoshte ai, duhej konsideruar e dyshimtë përderisa ai me dashje e me ndërgjegje krijoi njerëzit që të gabojnë, pastaj i mallkoi dhe i dënoi. Mund të dënosh e të mallkosh ato krijesa që veprojnë në kundërshtim me vullnetin hyjnor, por jo ato që veprojnë në përputhje me një plan e synim të paracaktuar të zotit. Zoti në këtë mënyrë ka vepruar pa logjikë. Si mund të quhet e përsosur një qenie pa logjikë?»[83]. Me anë të këtij silogjizmi të shëndoshë që provonte papërsosmërinë e kësaj qeniejeje fantastike e të krijuar, provohej gjithashtu edhe mosekzistenca e saj.

82) Migjeni. *Vep. cit.*, f. 38.
83) «Gazeta e Korçës», 23 qershor 1932, (N. Bulka).

Bulka vuri në dukje shpesh inkoherencën e planit hyjnor dhe u tall me atë përrallë biblike që thoshte se zoti ishte personifikimi i mirësisë. Si mund të ishte i tillë, thoshte ai, kur i bënte njerëzit të vuanin e nuk ngopej me vuajtjet e tyre[84].

Feja për ekzistencën e vuajtjeve kishte një sofizëm të gatshëm. «Zoti mundon ata që don», thoshte ajo. Vuajtjet, sipas saj, kanë një funksion të lartë pastrimi e përsosjeje morale. Në bazë të kësaj pikëpamjeje fetare u krijua rryma fetare idealiste e dolorizmit që kërkonte të përligjte vuajtjet sociale, fizike e morale në botë. Këtë rrymë e përqafuan edhe shkrimtarët reaksionarë si Shatobriani e të tjerë.

Bulka e kundërshtoi sofizmin e dolorizmit me argumentin se t'i bësh njerëzit të vuajnë pa fund, nuk është as provë e përsosmërisë dhe as e mirësisë[85]. Ai e hodhi poshtë edhe përrallën e fesë se Zoti gjoja me anë të sakrificës së lartë të Jezu Krishtit, u përpoq t'i shlyente gabimet dhe mëkatet e njerëzve dhe t'u lehtësonte atyre mjaft vuajtjet. Nga koha e vetsakrifikimit të Krishtit, thoshte shkrimtari, kishin kaluar qindra vjet, e megjithatë, asgjë s'kishte ndryshuar, «njeriu vazhdonte të vuante»[86]. Ky prodhues e konsumator i virtytit nuk e ndryshoi situatën në botë ku vuajtja dhe e keqja sundonin kudo. Kështu që sakrifica i vajti dëm, thumbonte ai. Një argument tjetër kundër ekzistencës së Zotit, konsiderohej mosbindja e moszbatimi i kështillave të tij[87]. Atij nuk po i bindeshin jo vetëm njerëzit e zakonshëm, por as klerikët, «shërbëtorët» e tij. Atëherë, ku qëndronte plotfuqishmëria e tij e padiskutueshme?

Bulka polemizoi edhe me pikëpamjen fetare e idealiste se mendja njerëzore ishte gjoja «një pjesë e shkëndijës hyjnore». Po të ishte kështu, thoshte ai me një ton ironik, njeriu i pajisur me dritën hyjnore do të depërtonte edhe në misteret e fesë, do ta kapërcente «gardhin e pasjetës» do ta shihte diku zotin, këtë qenie misterioze e të paidentifikuar gjer më sot[88]. Bulka u tall edhe me teoritë kosmogonike dhe antropomorfike mbi zotin të cilat thoshin se zoti ekziston diku në kozmos e ka trajtë njeriu.

Të gjitha këto arsyetime për fenë shkaktuan zemërimin e klerit katolik. Revista jezuite e Shkodrës «Lajmëtari i zemrës së Jezu Krishtit» u skandalizua kur shkrimtari shkroi se «duke mbajtur kokën përpjetë, nuk sheh gjë tjetër veç

84) Po aty, 11 janar 1932, (N. Bulka).
85) Po aty.
86) Po aty.
87) «Vatra», 1 qershor 1933, (N. Bulka).
88) «Gazeta e Korçës», 7 shtator 1933.

hapësirës së pamatshme dhe hiçit»[89]. Ajo iu përgjigj me ton fyes, duke përdorur ato trivialitetet e zakonshme të klerit katolik. I thoshte se ateistët e mbajnë kokën poshtë e nuk vështrojnë përpjetë, në mënyrë që të shikojnë «kujtimet» që lë lopa pas duke ecur rrugës. Por,. Bulka ia ktheu revistës jezuite me të njëjtën monedhë e me një arsyetim të fortë: plehurinat ishin më të dobishme për njerëzit se «hiçja enigmatike e qiellit», sepse me plehurinat bujku së paku plehëronte tokën, kurse hiçi nuk i shërbente askujt[90].

Ai i thoshte revistës jezuite se redaktorët e saj përpiqeshin t'i bindnin njerëzit me fraza latine dhe sofizma. Por «moda e argumenteve sofistike shkoi e vajti në mesjetë»[91].

Qëndrim skeptik dhe ateist ndaj fesë mbajti edhe shkrimtari demokrat-revolucionar Migjeni. Ai aludonte në «parathënia e parathënieve» se feja ishte produkt i mendjes njerëzore, i shpjegimit fantastik e të deformuar nga njeriu të botës që e rrethonte[92]. Kështu, nuk e krijoi zoti njeriun, por njeriu zotin arsyetonte ai.

Demokratët revolucionarë demaskuan përrallat e fesë mbi ferrin e parajsën, mrekullitë hyjnore e të tjera. Ata demaskuan pseudohumanizmin e fesë, e cila predikonte me hipokrizi se kujdesej njësoj për të gjithë njerëzit dhe se gjoja kultivonte dashurinë e njeriut për njeriun. Po të qe kështu, arsyetonte Bulka, atëherë pse njerëzit në këto kohë të këqija krizash kushtonin më pak se kafshët, pse pasanikët që vidhnin e grabitnin konsideroheshin njerëz të nderuar prej fesë dhe pse të varfrit trajtoheshin aq keq...?[93].

Ai goditi klerikët, këta farisenj hipokritë që nën maskën e humanizmit e të shenjtërisë punonin njëqind të këqia në kurriz të popullit. Ai shprehej në frymën noliane se këta farisenj e kishin përdhosur tempullin e «shenjtë» të Krishtit[94].

Bulka ashtu sikurse dhe Fan S. Noli dhe elementë të tjerë përparimtarë, deklaronte se njerëzit nuk duhej të gjykoheshin nga feja, por nga prejardhja e tyre klasore. Ai hodhi poshtë predikimet e ideologjisë fetare se njerëzit e të njëjtës fe janë të gjithë vëllezër. Njerëzit lidheshin e bashkoheshin në radhë të parë në bazë të interesave klasore. «Pashë vobekësinë dhe dëshpërimin në botën muhamedane, thoshte shkrimtari, ashtu siç e pashë në botën e krishterë. Dy fe të ndryshme, por jo dy fukarallëke. Fukarallëku është po ai, për muhamedanin, për të krishterin, për çifutin ose

89) Po aty.
90) Po aty.
91) Po aty.
92) Migjeni. *Vep. cit.*, f. 15.
93) «Gazeta e Korçës», 27 prill 1932, 10 shtator (N. Bulka).
94) «Arbëria», 12 prill 1936, (N. Bulka).

për budistin...»[95]. Ai kritikoi veprimtarinë përçarëse të klerit që e kishte ndarë kombin në tri pjesë dhe i trajtonte shqiptarët si «turq» e «kaurë».

Demokratët revolucionarë mbajtën qëndrim edhe ndaj pikëpamjeve e veprimtarisë reaksionare të klerit katolik. Kështu. Bulka kritikoi Gjergj Fishtën e të tjerë që në veprat e tyre përshkruanin «parajsat romantike», idealizonin realitetin dhe fshihnin plagët e shoqërisë. Këta nuk ndienin dhëmbje për vuajtjet e malësorëve[96].

Ai demaskoi qëndrimin antikombëtar të klerit katolik që e vinte fenë mbi kombin duke thënë se «çdo njëri është më parë fetar se atdhetar»[97]. Hodhi poshtë edhe vlerësimet banale e pabazë që i bëheshin ateizmit nga kleri katolik, si prirje që gjoja shpinte në varfërimin shpirtëror. Këtë arsyetim e quante absurd, e qesharak. Ateizmi e zhvishte njeriun nga paragjykimet e besimet boshe, e bënte racionalist, me mendjen esëll, e bënte optimist. Shkrimtari ironizoi bukur klerikët katolikë, që mbaheshin për eruditë dhe që kujtonin se të gjithë ata që përdornin fraza latine kishin arsye e të drejtë. Ata e pësuan, thoshte ai, si doktori i Molierit që kur nuk i kuptonte sëmundjet, përdorte fraza që mbaronin me «us» dhe habiste injorantët e asaj kohe. Injorantë të tillë, thoshte Nonda Bulka, ka edhe në shekullin tonë, të cilët pak nga pak po i hapin sytë, kurse ju, u drejtohej ai klerikëve, s'doni t'i hapin sytë, se «zanati juaj kështu e do»[98].

Me klerin katolik polemizoi edhe revista «Bota e re». Ajo kritikoi leksionet e mbajtura nga patër Anton Harapi në Korçë e gjetkë në vitin 1936, ku ngrinte në qiell fenë kristiane dhe ekzaltonte kultin e vdekjes. Revista e cilësonte këtë si një propagandë të dyshimtë reaksionare[99].

Revista vuri në dukje gjithashtu se kleri katolik me pseudoerudicionin e tij dhe synimet djallëzore, kishte krijuar me qëllim konfuzion midis termave materializëm e idealizëm, duke fshehur përmbajtjen e tyre të vërtetë, duke e njësuar materializmin me qëndrimin e sjelljen vulgare për ta denigruar atë. Me këtë rast «Bota e re» u mundua të jepte kuptimin e vërtetë të tyre, si dhe luftën shumëshekullore të materializmit kundër idealizmit dhe fesë. Ajo pohonte, duke mbrojtur materializmin, se idealizmi ishte një formë e rafinuar e fesë[100].

95) Po aty, 9 janar 1936, (N. Bulka).
96) «Minerva», 1932, nr. 4-5 (N. Bulka).
97) «Rilindja», 17 gusht 1935, nr. 8 (N. Bulka).
98) Po aty.
99) «Bota e re», 15 prill 1936, f. 12.
100) Po aty, 15 shkurt 1937, nr. 21, f. 15-16.

«Bota e re» kritikoi ashpër edhe klerin mysliman si një forcë regresive, anakronike e kundër përparimit të vendit.

Kritika kundër fesë dhe klerit luajti një rol të rëndësishëm në luftën kundër reaksionit, bazë e fortë e të cilit ato ishin, gjithashtu për edukimin e klasave e të forcave përparimtare, sidomos të rinisë, me idetë ateiste.

4. Denoncimi i rrezikut fashist dhe kritika e qytetërimit borgjez

Në ideologjinë demokratike të viteve 30, një vend me rëndësi zënë pikëpamjet antifashiste e antiimperialiste.

Edhe pse Qeveria zogiste i kishte ndaluar kritikat kundër «aleates së madhe», ashtu sikurse dhe kritikat kundër mbretit, idetë antifashiste e antiimperialiste jo vetëm nuk munguan në shtypin demokratik, por shpesh ishin të forta.

Ato, ashtu sikurse dhe idetë e tjera, herë u shprehën në mënyrë të tërthortë e herë të hapur.

Komunistët dhe demokratët revolucionarë u përpoqën ta shfrytëzonin shtypin legal për të vënë në dukje rrezikun e madh që i kanosej Shqipërisë nga fashizmi dhe imperializmi dhe për të forcuar më tej vigjilencën e patriotizmin në popull, në mënyrë që t'i bëhej ballë agresionit që ishte në prag të derës.

Propaganda antifashiste e antiimperialiste ishte një detyrë me rëndësi e kohës.

Politika e Italisë fashiste ndaj Shqipërisë u kritikua jo vetëm direkt apo me nënkuptim, por edhe duke marrë në shenjë e duke e demaskuar hapur politikën imperialiste në përgjithësi.

Vënia në dukje e prirjeve imperialiste të marrjes nëpër këmbë të të drejtave të popujve, të lirisë e pavarësisë së tyre, dhe kritika kundër politikës grabitqare të shteteve imperialiste, ishte në të njëjtën kohë edhe demaskim i imperializmit fashist.

Në shtypin demokratik u tha se Shqipëria ishte një «pikë nevralgjike e Evropës», të cilën Evropa imperialiste e armatosur deri në dhëmbë e kishte vënë në shënjestër dhe kërkonte t'i rrëmbente lirinë e pavarësinë. Aty thuhej se Shqipëria e kërcënuar akuzohej se «turbullonte ujrat»[101]. Nuk thuhej hapur se kush e kërcënonte, por nënkuptohej që kërcënimi kryesor i vinte nga Italia fashiste.

101) «Minerva», 1932, nr. 4-5. (N. Bulka).

Kjo u tha në periudhën kur marrëdhëniet italo-shqiptare u acaruan për një farë kohe dhe kur qeveria e Musolinit bëri presione e përpjekje për skllavërimin e mëtejshëm të vendit. Imperialistët kishin një logjikë të tillë, pohohej aty, sa herë që donin ta pushtonin një vend, e akuzonin si prishës të qetësisë.

Kjo periudhë e acarimit të marrëdhënieve italo-shqiptare, u shfrytëzua nga elementët përparimtarë për kritika të hapura. Nonda Bulka thoshte se për Musolinin me shokë lufta ishte «e nevojshme» dhe e ngutshme, sepse ata ishin të armatosur deri në dhëmbë[102]. Prandaj nuk u duhej zënë besë diplomatëve imperialistë që flisnin për çarmatimin e paqen dhe kërkonin të venin në gjumë popujt. Shqipëria, me këto marrëdhënie, rrezikonte të gllabërohej.

Fati i qytetërimit dhe i vendit tonë në kushtet e imperializmit «varej mbi një pe gjysmë të kalbur». Kjo rridhte nga acarimi i kontradiktave imperialiste, si dhe nga afrimi i fuqive fashiste, Italisë e Gjermanisë[103].

Gjendjen e rëndë që po krijohej për Shqipërinë e për vendet e tjera, Bulka e përshkruante me atë humorin e tij karakteristik që lejonte të dallohej pas tij serioziteti i situatave. Ai pohonte se tratativat Hitler-Musolin për përcaktimin e sferave të ndikimit po ndiqeshin kudo me shqetësim. Ato i mbulonte një fshehtësi e madhe, por megjithatë, kuptohej që ato nuk ndillnin asgjë të mirë. «Udhëtimet e diplomatëve, thoshte ai, janë si dardha: e kanë bishtin prapa...». Pra edhe për Shqipërinë diçka e keqe po përgatitej. Dhe këtë po e dëshmonin jo vetëm ndërhyrjet gjithnjë më brutale të Italisë në Shqipëri, por edhe përgatitjet e saj për agresionin kundër Abisinisë.

Shkrimtari demokrat revolucionar me anë të një skice humoristike «Përralla abisine», përshkruante makinacionet fashiste e imperialiste si dhe atë lodër tragjike që po luhej kundër popullit paqësor e liridashës të Abisinisë[105]. Abisinisë po i trokiste rreziku në derë, por edhe Shqipëria nuk e kishte të keqen larg. Çështja e drejtë e abisinasve dhe qëndresa antiimperialiste e këtij populli, aludohej aty, kishin ngjallur simpati në popullin shqiptar dhe ndiqeshin me vëmendje kudo në Shqipëri. Edhe pse Abisinia ishte larg Shqipërisë, fati dhe aspiratat e përbashkëta i afronin të dy popujt, prandaj, thoshte shkrimtari, me një humor që e theksonte dhe më shumë situatën e rëndë, «kishte gra që Abisininë e dinin këtu afër, dy-tri orë larg Voskopojës...»[106]. Kaq ishte bërë tema e ditës çështja abisine për shqiptarët. Rreziku i agresioneve fashiste u bë dhe më i madh kur doli në skenë regjimi nazist i Hitlerit. «Bojaxhiu gjerman» i vuri flakën traktatit të Versajës dhe e vuri luftën e agresionin në rendin e ditës.[107].

Agresionit dhe luftës imperialiste i vinte në ndihmë ideologjia shoviniste e kolonialiste që përpiqej të përligjte epërsinë e vendeve të mëdha mbi të voglat dhe pushtimet për hir të saj. Kjo ideologji e kishte vënë në shenjë Shqipërinë prej kohësh, pohonte N. Bulka. Në fillimet e shtetit tonë kombëtar e të periudhës së pavarësisë, historianët e politikanët serbë shpikën mjaft teori për asgjësimin e kombit tonë, duke e paraqitur popullin tonë si popull primitiv, të paaftë, për të bërë jetë të pavarur e për t'u qytetëruar[108]. E njëjta histori përsëritej sot nga falsifikatorët fashistë, thuhej prej tij. Edhe këta e paraqitnin Shqipërinë si një vend me fise të egra prehistorike që jetonin pothuaj në shpella, si një popull primitiv që nuk dinte gjë tjetër veç mjeshtërisë së luftës, që kishte nevojë të qytetërohej nga të tjerët e të mbahej nën tutelë. Bulka demaskoi ashpër falsifikimet e «Nuovissima Enciclopedia Italiana» të botuar në Milano më 1936 ku Shqipëria paraqitej si një vend i egër[109]. «Eruditi milanez», i enciklopedisë thoshte Bulka gjithë sarkazëm, ishte jo vetëm falsifikator e armik i shqiptarëve, por edhe një i paditur që «kishte nevojë për mësimin e parë të shkollës fillore» dhe që nuk meritonte ta ushtronte zanatin e tij, por më mirë «të fëlliqte muret» sesa «sedrën e tërë një shteti»[110]. Bulka natyrisht këtu kishte parasysh sedrën e kombit italian, sepse ai e kishte të qartë që redaktori i enciklopedisë ishte mercenar i regjimit fashist, të cilit i interesonte që Shqipëria të paraqitej në këtë mënyrë. Bulka demaskoi ashpër edhe priftin jezuit Fulvio Kordinjano, këtë agjent fashist, që, nën maskën e studimeve shkencore mbi Shqipërinë, denigronte popullin shqiptar. Ai botoi një letër në «Arbëria» kundër tij ku i thoshte ndër të tjera lidhur me falsifikimet e tij. «... Mos u helmo kur populli shqiptar t'i nxjerrë të palarat sektit jezuit (i cili s'është as shqiptar). Krishti ka thënë se, po të hash një dackë, kthe faqen tjetër, po shqipot janë me Moisinë, i cili thotë: po të nxorri tjetri një sy, nxirrja që të dy...»[111].

---

102) «Gazeta e Korçës», 15 korrik. 1934.
103) «Illyria», 15 korrik 1934 (N. Bulka).
104) «Gazeta e Korçës», 27 qershor 1934.
105) Po aty, 1 tetor 1935.

106) Po aty, 15 gusht 1935.
107) Po aty, 17 prill 1935 (N. Bulka).
108) Po aty, 8 tetor 1932.
109) N. Bulka. *Kur qante e qeshte bilbili.* Tiranë, 1967, f. 14.
110) *Po aty.*
111) «Arbëria», 5 prill 1936.

Kundër skllavërimit imperialist të vendit pati dhe mjaft kritika të tjera. Patrioti demokrat Haki Stërmilli vinte në dukje se marrëdhëniet me Italinë kishin prirje të ktheheshin në një zgjedhë për Shqipërinë dhe se fashistët italianë po e robëronin vendin si nga pikëpamja ekonomike ashtu edhe politike[112].

Lidhur me kërcënimin imperialist që sa vinte e shtohej dhe të drejtën e popullit për t'i bërë ballë atij, për të mbrojtur lirinë e pavarësinë, u shfaqën mendime edhe në «Botën e Re». «Bota e Re» kritikoi politikën imperialiste të Fuqive të Mëdha dhe pretendimet e tyre se «kombet e fortë duhet të sundojnë të dobtit», stigmatizoi «nacionalizmin shoven» që përligjte pushtimin imperialist. Popujt kishin të drejtë të mbronin lirinë e pavarësinë, nënvizonte ajo, dhe këtë të drejtë e gëzonte edhe populli shqitpar, që kishte vuajtur shekuj të tërë në robërinë e huaj dhe i kanoseshin përsëri rreziqe të tjera[113]. Me këtë aludohej në radhë të parë për rrezikun fashist. Revista e hodhi poshtë atë tezë, kryesisht të të huajve që thoshte se Shqipëria gjoja e fitoi lirinë e pavarësinë, në sajë të faktorëve të jashtëm e koniunkturës ndërkombëtare. «Kjo do të ishte një fyerje për kujtimin e të gjithë atyre që luftuan për çlirimin e vendit tonë», thoshte ajo[114]. Një tezë e tillë nuk përputhej me realitetin. Shqipëria e pavarur kishte 24 vjet që qëndronte në këmbë dhe shqiptarët treguan se janë të pjekur për t'u vetëqeverisur dhe për të qenë të lirë[115]. Aty u kundërshtuan edhe tezat e historianëve borgjezë si ato të Uellsit e të tjerë që e mohonin rolin e popujve të vegjël në historinë botërore dhe që gjithçka ua atribuonin të mëdhenjve[116]. Ata nuk merrnin parasysh atë fakt, theksonte «Bota e re», që në arenën historike kishin dalë tashmë mjaft popuj të vegjël të cilët me anë të luftës së tyre të drejtë nacionalçlirimtare kërkonin të shihnin dritën e lirisë e të qytetërimit, dhe të njiheshin si kombe e shtete më vete. Popujt e vegjël, thuhej aty, do ta bëjnë vetë historinë e tyre dhe do të çlirohen nga skllavëria koloniale, në bazë të ligjeve të historisë dhe të vullnetit të vet.

Për rrezikun e agresionit fashist që i kanosej Shqipërisë dhe vendeve të tjera, bënte aluzion dhe shkrimtari demokrat revolucionar Migjeni në prozën «Gogoli»[117]. Këtu vihej në dukje një aspekt i rëndësishëm, ai fakt që fashistët dhe imperialistët në përgjithësi, për të përgatitur luftën dhe agresionin, kërkonin të spekullonin me rrezikun e bolshevizmit, të cilin kërkonin t'ua bënin popujve «gogol».

112) H. Stërmilli. *Burgu*, 1935, f. 260.
113) «Bota e Re», 15 gusht 1936, f. 1-2.
114) Po aty, 30 nëntor 1936, f. 1-3.
115) Po aty.
116) Po aty, 30 dhjetor 1936, f. 7-8.
117) Po aty, 30 janar 1937, f. 7-8.

Migjeni konstatoi edhe një dukuri tjetër që i hapte rrugën agresionit fashist kundër Shqipërisë, ardhjen në fuqi të regjimeve fashiste në vendet fqinje. Këto regjime ishin afruar e po bashkëpunonin me Italinë fashiste e Gjermaninë naziste. Fashizmi në vendet fqinje ishte si ai veriu acar, thoshte Migjeni në mënyrë alegorike, që hyri si «hajn në shtëpiat e kojshijve», të cilët i thanë «mir se erdhe». Kësaj ere të ftohtë i duhej mbyllur dera[118].

Shkrimtari sikur donte të thoshte se një fat i tillë mund ta priste Shqipërinë si rrjedhim i politikës tradhtare të regjimit zogist, i cili ia kish hapur prej kohësh derën këtij «veriu» që kish filluar të ngrinte gjymtyrët e kombit.

Komunistët dhe demokratët revolucionarë demaskuan në shtypin e kohës dhe qytetërimin borgjez, rendin kapitalist me të gjitha plagët e tij të rënda. Qytetërimi borgjez konsiderohej i kalbur e i çoroditur, i kapërthyer nga një krizë e ashpër, ekonomike, shoqërore e politike. Ky qytetërim që ngrihej mbi vuajtjet, varfërinë dhe mjerimin e miliona njerëzve, ishte një qytetërim i egër dhe barbar[119]. Në qoftë se lumturia dhe drejtësia kanë pasur ndonjëherë vlerë, — thoshte Bulka, — qytetërimi borgjez perëndimor ua hoqi kuptimin.

Këtu shpjegoheshin dukuritë karakteristike të sistemit borgjez në kalbëzim e sipër. Thuhej se përsosmëria e tij dhe shkalla e lartë e zhvillimit të prodhimit, ishte në përpjesëtim të zhdrejtë me mirëqenien e masave punonjëse. Superprodhimi kishte synim kryesor të rriste fitimet e kapitalistit. Këto fitime të kapitalistëve rriteshin mbi bazën e shfrytëzimit, të varfërisë e të mjerimit të popullit. Kapitalisti, thuhej parapëlqente që një pjesë të mallit ta zhdukte, vetëm e vetëm që të ruante çmimet në nivelin e duhur e të siguronte fitimet. Atë nuk e shqetësonte aspak fakti që punonjësit dëshironin më të nevojshmen[120]. Bulkën e të tjerë i revoltonte ky maltusianizëm ekonomik që bënte suprema lex të kësaj shoqërie superfitimin, që njerëzit i shikonte si mjet për sigurimin e tij dhe i vinte në fund të shkallës së hierarkisë së vlerave. Kjo dëshmonte se kriza e rendit kapitalist po rritej e po thellohej gjithnjë e më shumë gjë që sillte më vete edhe degradimin e përgjithshëm moral të këtij rendi. Një nga simptomat më të rënda të kësaj krize konsiderohej papunësia. Ajo ishte një plagë e pashërueshme e këtij sistemi.

118) Migjeni. *Vepra të zgjedhura*. Tiranë, 1969. f. 53-54.
119) «Gazeta e Korçës», 11 shtator 1932, (N. Bulka).
120) Po aty, 25 gusht 1932.

N.Bulka, ashtu sikurse dhe Fan S.Noli, i kushtoi mjaft vëmendje analizës së krizës ekonomike botërore që e acaroi më shumë krizën e përgjithshme të sistemit kapitalist. Pasojat e saj po ndiheshin edhe në Ballkan[121]. Përpara krizës, thoshte ai, u gjunjëzuan edhe vendet e pasura, si: Amerika, Anglia, Franca, Gjermania e të tjera. Natyrisht, kapitalistët me gjithë humbjet që mund të kishin, prap gjenin një rrugëdalje nga situata duke e hedhur peshën e krizës mbi punonjësit. Për këta të fundit kriza ishte një katastrofë, një kalamitet social, që shtronte pyetjen e Hamletit «Të rrosh a të mos rrosh»[122].

Kapitalizmi konsiderohej jo vetëm shkaktar i varfërisë së popujve, por edhe farkëtues i prangave të një skllavërie të re që quhej kolonializëm. Dhe kjo skllavëri mbante në fytyrën e saj të shëmtuar maskën e qytetërimit.

«... Francezë dhe anglezë sundojnë 5 herë më tepër popuj nga ç'janë vetë, — thoshte Bulka. Me ç'të drejtë? Për t'i civilizuar? Ndoshta. Por më tepër për kauçuk, xhevahire, banane dhe flori»[123].

Kriza e superprodhimit, nevoja për tregjet dhe për kolonitë, shtonte oreksin e imperialistëve për pushtime të reja, forconte rivalitetin dhe luftën midis tyre duke çuar drejt një lufte botërore. Kur të tjerët po grabisnin dhe pushtonin pse të mos ta bënte këtë dhe Italia e Musolinit, pohonte shkrimtari. Luftërat imperialiste ishin pjesë e rendit kapitalist të zvetënuar e në rënie. Ato ishin «dasmat» e tij. Pa këto «dasma» që kërkonin gjithë atë mish njerëzor, kapitalizmi nuk mund të bënte[124]. Luftërat ishin të domosdoshme jo vetëm për pushtime, por edhe që të nxirrte fitime industria e luftës që prodhonte armë pa fund[125]. Këtu kritikohej edhe teoria reaksionare maltusiane që thoshte se nuk dalin burimet ekonomike e mjetet e jetesës për njerëzit në botë që sa venë e shtohen së tepërmi dhe që me këtë donte të përligjte si zhdukjen e tyre me anë të luftërave imperialiste, ashtu edhe privimin e tyre nga këto mjete të jetesës. Me anë të saj inkurajohej kanibalizmi i sistemit kapitalist që s'bënte dot pa luftëra dhe që i konsideronte anormale periudhat e qetësisë[126].

Me forcimin e diktaturave fashiste dhe ardhjen e Hitlerit në fuqi, thuhej se rreziku i luftës u rrit[127]. Hitleri filloi

121) Po aty, 22 mars 1932.
122) Po aty, 15 korrik 1933.
123) Po aty, 30 mars 1933, (N. Bulka).
124) «Besa», 29 janar 1934 (N. Bulka).
125) Po aty, 23 janar 1934.
126) Po aty.
127) «Gazeta e Korçës», 22 mars 1932.

me «kupën e birrës», thoshte Bulka në prag të krijimit të regjimit nazist duke bërë aluzion për «puçin e birrës» në Bavari, dhe përfundoi me «koburen e gangsterit» që po ia drejtonte tashti gjithë njerëzimit[128]. Musolini, Hitleri, Makdonaldi e të tjerë ishin vënë në garë kush ta ndizte luftën më parë. Këtu kritikohej fryma raciste e shoviniste e ideologjisë nacionalsocialiste, antisemitizmi i saj i egër. Por nënvizohej se pas predikimeve për «pastërtinë e racës», fshiheshin synimet grabitqare ekonomike e politike të imperializmit gjerman.

Bashkëpunimi Hitler-Musolini dhe i shteteve fashiste që këta përfaqësonin, konsiderohej rrezik i madh për popujt dhe paqen e botës. Ai e rriste mjaft kërcënimin e luftës dhe bënte që «fati i qytetërimit» të varej akoma më shumë në «një pe gjysmë të kalbur»[129]. Në bodrumet e errëta të diplomacisë, po kurdiseshin plane djallëzore kundër lirisë e pavarësisë së popujve. Shtetet fashiste po i shkelnin klauzolat e traktatit të Versajës që ishte bërë «paçavure», dhe po nxitonin të përmbushnin synimet imperialiste. Diplomacia perëndimore me politikën e saj të pajtimit, po ngrohte «zogjtë e kloçkës fashiste»[130]. Qielli i Evropës po mbushej me re të zeza dhe kurrë «atmosfera e planetit nuk ka qenë kaq e turbullt» si këtë herë, — thoshte Bulka. Lidhja e Kombeve që zbatonte vullnetin e fuqive të mëdha imperialiste, ishte kthyer në «muze».

Megjithëqë në konferencat e çarmatimit derdhej një lumë fjalësh për paqen dhe çarmatimin, imperialistët po armatoseshin deri në dhëmbë, era e barutit po ndihej kudo[131]. Shkrimtari demokrat-revolucionar shprehej gjithë sarkazëm e zemërim kundër cinizmit të mbuluar me demagogji të barbarisë imperialiste: «Dërgo benzinë o zot (po jo nga e Agipit), (se është e përzier me ujë — V.K.), për të përvëluar pallatin e Konferencës së çarmatimit; më mirë të përvëlohet një pallat se e tërë bota...»[132]. Ideja e shkrimtarit dhe e demokracisë-revolucionare në përgjithësi ishte se i duhej vënë fre këtij kanibalizmi të egër, duhej forcuar vigjilenca dhe lufta kundër forcave të errëta që sundonin në botë.

128) Po aty, 31 dhjetor 1934.
129) «Illyria», 15 korrik 1934 (N. Bulka).
130) «Rilindja», 6 prill 1935 (N. Bulka).
131) «Vatra», 1 qershor 1933 (N. Bulka).
132) Po aty.

5. Kërkesat për shndërrimin demokratik të vendit

Demokratët revolucionarë ishin të mendimit se gjendja e rëndë ekonomike, shoqërore e politike e popullit shqiptar, nuk mund të ndryshohej me «mëshirë sociale» dhe pseudoreforma, por vetëm me anë të shndërrimeve të thella demokratike. Formulimi i kërkesave për shndërrimin demokratik të vendit, ishte akoma më i vështirë në kushtet e censurës. Në shtyp u përdor më shumë se kudo gjuha e alegorisë.

Shpesh flitej për ngjarjet dhe luftën revolucionare në vendet e tjera dhe lihej të nënkuptohej se fjala ishte për Shqipërinë. Megjithatë, siç e thamë në fillim, alegoria nuk ishte hermetike dhe gjërat u parashtruan me kurajë dhe guxim. Pati raste kur ato u shprehën krejt në mënyrë të hapur.

Detyra e likuidimit të «strukturës së vjetër» të shoqërisë sonë dhe ecja «përpara me hapa të shpejta», shtrohej si një detyrë urgjente, në mënyrë që të kryhej brenda kohës sa më të shkurtër ajo për të cilën kombeve të tjerë u ishin dashur shekuj[133].

Lufta kundër botës së vjetër «konsiderohej» «etapa e parë» në krijimin e një shoqërie të re. Ishte utopi të mendohej se shoqëria mund të kthehej prapa apo të qëndronte aty ku ishte. Pra, fjala ishte për shndërrimin e rendit çifligaro-borgjez në një rend demokratik. Kërkesa për ndryshimin e gjendjes ekzistuese ishte kërkesë urdhëruese e progresit, duke iu përmbajtur asaj ideje që njihej që nga koha e latinëve «non progredi est regredi» («mospërparimi të shpie prapa»)

Emancipimi i popullit nga shfrytëzimi dhe shtypja, mjerimi, varfëria e padija dhe sigurimi i përparimit shoqëror, konsiderohej si një kërkesë e «ligjeve të paepura» objektive. Ai duhej të realizohej në kundërshtim me të gjitha pengesat e forcave reaksionare[134].

Periudha që po kalonte vendi, konsiderohej një periudhë kalimtare, gjatë së cilës shkatërroheshin «vlerat e vjetra» dhe krijoheshin «vlera të reja». Ky proces nuk mund të zhvillohej në mënyrë spontane, por me luftë revolucionare.

Lufta revolucionare konsiderohej mjeti kryesor për kryerjen e shndërrimeve shoqërore. I riu revolucionar Veli Stafa (Platonicus) shprehej në mënyrë alegorike në «Botën e Re», se, sikur edhe në shoqëri të zbatoheshin metodat kirurgjikale, shumë plagë të saj do të shëroheshin më lehtë[135].

Në këtë gjendje të rëndë për popullin e kombin, lufta revolucionare ishte në rendin e ditës. Kjo ishte kirurgjia për të cilën fliste Veli Stafa. Në revistën «Rilindja», pohohej se sa më shumë të shtypej e shfrytëzohej një popull, «aq më pak njerëzit në fuqi e kanë të siguruar kolltukun dhe aq më shumë është frikë që populli të ngrerë kokë dhe të bëjë revolucion»[136]. Të njëjtën ide shprehte edhe revista «ABC», e cila deklaronte se shfrytëzimi i egër që po i bënin popullit klasat e pasura, do të shpinte një ditë «në kryengritjen e shpirtit dhe të barkut»[137].

Duke iu referuar ngjarjeve të Revolucionit Demokratik-Borgjez të Francës (1789), ideologët demokratë linin të nënkuptohej se për shpërthimin e zhvillimin me sukses të kryengritjes revolucionare kundër rendit reaksionar, nuk mjaftonin vetëm kushtet objektive, por duhej dhe ideologjia.

Në organet demokratike u argumentua e drejta e popullit për t'u ngritur në luftë për të drejtat e veta. Në këtë frymë u përligjën dhe u mbrojtën veprimet revolucionare të masave si ato të Demostratës së Bukës në Korçë më 1936 e të tjera[138].

Demokratët-revolucionarë, duke teorizuar rreth doktrinave sociologjike përparimtare si ajo e Rusoit e të tjera, thoshin se këto doktrina e njihnin të drejtën e popullit për të bërë kryengritje kundër rendit e regjimit që ishte në kundërshtim me interesat e tij[139]. Pra, edhe populli shqiptar, lihej të nënkuptohej, duhej ta gëzonte këtë të drejtë.

Zhan Zhak Ruso, ky filozof dhe demokrat revolucionar i shquar francez, në «Kontratin social» të tij, afirmonte sovranitetin e popullit si të drejtën e tij për vetëqeverisjen dhe për vendosjen e republikës demokratike borgjeze, gjithashtu si një garanci për fitimin dhe ruajtjen e të drejtave demokratike-borgjeze. Doktrina e Rusoit në kushtet e Revolucionit të madh frëng, ishte një armë e fuqishme kundër absolutizmit dhe feudalizmit. Por sovraniteti i popullit, me fitoren e rendit borgjez, donte të thoshte sundimi i borgjezisë. Demokratët revolucionarë shqiptarë idealin rusoist të sovranitetit të popullit e përdorën për të pohuar të drejtat demokratike të masave popullore, kundër rendit çifligaro-borgjez, për vendosjen e rendit të demokracisë popullore.

Në bazë të sovranitetit të popullit, thuhej në shtypin

133) «Drita», 26 mars 1937 (A. Varfi).
134) «Bota e re», 30 dhjetor 1936, f. 1-2.

135) Po aty, 15 janar 1937, nr. 19. f. 14-15.
136) «Rilindja», 14 dhjetor 1935, f. 2.
137) «ABC», 1 mars 1936, f. 9.
138) Po aty.
139) «Rilindja», 20 prill 1935, f. 2; 4 maj 1935, f. 2; «Bota e Re», 30 prill 1936, f. 17-18.

demokratik, populli kishte të drejtë të zgjidhte qeverinë që shprehte interesat e tij dhe që zbatonte një politikë demokratike[140]. Ai, sipas tij, gëzonte të drejtën ta hiqte qeverinë që nuk shprehte interesat popullore. Në rast se kjo qeveri nuk i bindej këtij vullneti, populli kishte të drejtë të bënte kryengritje për përmbysjen e saj me forcë. Këto teorizime rreth «Kontratit social» të Rusoit, ndiqnin synime praktike për Shqipërinë. Ky aluzion bëhej edhe më i qartë kur thuhej se në bazë të këtij «kontrati», monarkia nuk mund të konsiderohej një regjim i përshtatshëm për popullin, sepse ishte një regjim despotik që e privonte nga të gjitha liritë, një regjim «në kundërshtim me natyrën njerëzore»[141]. Në fakt, te Rusoi, nuk ishte formuluar krejt kështu. Rusoi thoshte se në kushtet e sigurimit të sovranitetit të popullit, edhe regjimi monarkik mund të siguronte liritë demokratike. Problemi themelor i Rusoit ishte që populli të ushtronte drejtpërdrejt pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv. Pra, hedhja e një teze të tillë antimonarkike nga demokratët revolucionarë, bëhej tamam për kushtet reale të vendit dhe tregonte kurajë e guxim, sepse regjimi e kishte ndaluar rreptë çdo kritikë kundër monarkisë.

Me anë të një sërë pohimeve të tërthorta vihej në dukje se regjimi zogist, ishte një regjim «feudal» që duhej zëvendësuar me një «shtet modern» konstitucional demokratik, pra me një regjim demokratik borgjez[142].

Rinia shqiptare thuhej «ishte për demokracinë dhe kundër feudalizmit»[143]. Do të vijë një kohë, thoshin ideologët demokratë, që populli do të ngrihej kundër atyre që donin ta mbanin Shqipërinë një vend të prapambetur e të robëruar dhe do të çlirohej nga këpushët që i thithnin gjakun e që i merrnin gjithë fuqinë[144].

Me anë të një proze të Volterit «mbi qeveritë», bëhej aluzion se ashtu si «Mogoli i madh» i Indisë për të cilin bënte fjalë shkrimtari, edhe A. Zogu (mogoli shqiptar) nuk mund të qëndronte gjatë kundër vullnetit e interesit të popullit[145].

Që të plotësohej detyra e shndërrimit revolucionar të vendit, ashtu siç tregonte përvoja e Revolucionit frëng, thuhej se përpara duhej bërë një punë përgatitore ideologjike për edukimin revolucionar të popullit[146]. Idetë e revoltës dhe

140) Po aty.
141) «Bota e Re», 30 prill 1936, f. 17-18.
142) «Rilindja», 4 maj 1935, f. 2.
143) Po aty, 15 shkurt 1936, f. 1-3.
144) «Bota e re», 15 prill 1936, f. 7.
145) Po aty, 1 korrik 1936, nr. 6, f. 7.
146) Po aty, 30 qershor 1936, f. 8-9.

domosdoshmëria e përmbysjes së rendit reaksionar u shprehën dhe nga shkrimtarët përparimtarë të kohës. Migjeni fliste për «vullnetet e ndrydhura» të popullit të shumëvuajtur e të marrë nëpër këmbë që duhej të «shkundte prangat e mbrapshta»[147]. Ai i përfytyronte ato si një lëndë eksplozive popullore të grumbulluar prej kohësh. Shoqëria shqiptare, konstatonte shkrimtari, ziente nga «lufta e ashpër» e dy «taboreve» të kundërta[148]. Dhe kjo luftë do të merrte përpjesëtime të rëndësishme, sipas tij, kur të tërhiqej në të vegjëlia, sidomos fshatarësia që përbënte shumicën e popullit e t'i binte me «grushtin e fuqishëm» «malit që s'bëzan» (rendit reaksionar — V.K.)[149].

Edhe klasa punëtore ziente nga urrejtja e pakënaqësia dhe një ditë do të hidhej në luftë të hapur për çlirim[150].

Revolucionarët, «bijtë e shekullit të ri», thoshte Migjeni, kishin besim se do të vinte ajo ditë që të plotësoheshin aspiratat e tyre dhe të popullit, se koha do t'u sillte patjetër «ngushëllimin»[151]. Dhe ata po e ndienin që tashti ngrohtësinë e rrezeve të «Diellit alegorik» të revolucionit[152].

Migjeni, i mbushur me urrejtje për regjimin satrap të A. Zogut, priste një çast që ky monark i urryer të rrëzohej nga froni dhe, siç shprehej ai, ta shihte sesi atë valle që sot e hiqte mbi shpinën e popullit, ta hidhte mbi «majën e një shpate»[153].

Për shembjen e botës së vjetër shkruajtën me optimizëm edhe shkrimtarët e tjerë përparimtarë të viteve 30. Poeti Aleks Çaçi thoshte se duhej shembur kjo shtëpi e vjetër që «qelbej frymë zotërinjsh» dhe mbi gërmadhat e saj duhej ndërtuar një shtëpi e re[154]. Ai i bënte thirrje rinisë revolucionare «t'i hidhte prangat robërore».

Në ideologjinë demokratike të viteve 30-të u parashtruan një sërë kërkesash me rëndësi për kryerjen e reformave demokratike në të mirë të popullit. Ato synonin zhdukjen e marrëdhënieve çifligare-borgjeze. Problem kryesor, konsiderohej çlirimi i fshatarësisë dhe zbatimi i reformës agrare rrënjësore. Revista «Bota e Re» thoshte se «do të vinte një kohë» që «bujku shqiptar do të sundonte si dhe bujqit e huaj»[155].

Këtu bëhej aluzion për plotësimin e aspiratave të fsha-

147) «Illyria», 26 tetor 1935.
148) «Bota e re», 30 tetor 1936.
149) «Illyria», 7 mars 1936.
150) Migjeni. *Vep. cit.*, (Molla e ndalueme), f. 92-93.
151) Migjeni. *Vargjet e lira*, Tiranë, 1944.
152) *Po aty.*
153) Migjeni. *Vep. cit.*, Tiranë, 1969, f. 69.
154) A. Çaçi. *Vjersha*, Tiranë, 1973, f. 36.
155) «Bota e re», 30 janar 1937, f. 18-19.

tarësisë dhe të popullit në Bashkimin Sovjetik, ku punonjësit ishn bërë zotër të fateve të tyre. Prandaj reforma e parë që duhej të bënte qeveria demokratike thuhej këtu në mënyrë aluzive, ishte reforma agrare[156].

Problemin e mprehtë të tokës dhe dramën e rëndë shoqërore të fshatarësisë pa tokë e preku dhe Migjeni në prozën e tij «Zeneli». Këtu ai përshkruan një episod nga jeta e tij si mësues në Pukë, në këtë krahinë të varfër e të mjeruar të Shqipërisë. Nxënësi i tij kurioz Zeneli e pyeti gjithë dëshpërim një ditë pse Shqipëria ishte aq e vogël në hartën e Evropës, gati si një pikë? Migjeni u mundua t'i shpjegonte se nuk ishte aq e vogël se edhe kjo tokë e Shqipërisë do t'i mjaftonte popullit për të qenë i lumtur, «veç duhet ta punojmë»[157]. Me këtë donte t'i thoshte se po ta gëzonte populli tokën që ia kishin grabitur bejlerët e agallarët, punët do t'ishin ndryshe.

U tha se fshatarësia jo vetëm duhej të pajisej me tokë, por duhej të çlirohej edhe nga barra e rëndë e detyrimeve çifligare dhe e taksave shtetërore[158].

Një problem me rëndësi i shndërrimit demokratik të vendit konsiderohej emancipimii gruas shqiptare. Edhe pse kjo çështje u shtrua disi në mënyrë të përgjithshme, kishte mjaft rëndësi për kohën dhe ishte mjaft e mprehtë. Në këtë periudhë, për herë të parë u shtrua çështja e çlirimit të gruas me anë të çlirimit ekonomik, shoqëror e politik të saj dhe jo siç veprohej në vendet borgjeze ku «lëvizja feministe» e reduktonte çlirimin e gruas në pajisjen e saj me arsim e kulturë.

Demokratët revolucionarë kishin mendimin se pa pjesëmarrjen e gjallë të gruas në jetën shoqërore e politike, nuk mund të kishte demokraci të vërtetë dhe as zhvillim e qytetërim të vendit. Ata përshkruan gjëndjen shumë të keqe e të rëndë të gruas shqiptare, trajtimin çnjerëzor që i bëhej, prapambetjen e saj të madhe[159]. Këtë e shpjeguan në radhë të parë me kushtet ekonomiko-shoqërore e politike të shoqërisë.

Nga skllavërimi ekonomik i gruas, thuhej se vinin të gjitha të keqiat. Kjo dëshmohej nga gjithë historia e vendit dhe e njerëzimit. «Në «Botën e re» jepeshin shpjegime të hollësishme se si në rendin primitiv kur sundonte prona shoqërore, gruaja ishte e barabartë me burrin, madje kishte një pozitë shoqërore zotëruese për vetë funksionet që kryente e

156) Po aty, 30 shtator 1936, f. 12.
157) «Përpjekja shqiptare», 24 dhjetor 1938, nr. 18.
158) «Bota e Re», 1936, nr. 4, f. 6-7.
159) «Rilindja», 2 shkurt 1935, f. 12; «Bota e Re», 15 maj 1936, f. 8-9; «Bota e Re», 30 shtator 1936, f. 17-18.

rolin e saj. Pastaj, me lindjen e pronës private, gjithçka u përmbys dhe gruaja ra nën zgjedhë e u trajtua gjithë jetën si skllave. Kjo gjendje e saj, duhej plotësuar këtu, nuk ndryshoi as në kohët moderne, porse skllavëria e saj u bë më e rafinuar.

Duke qenë se robërimi i gruas u bë mbi bazën ekonomike-shoqërore, edhe çlirimi i saj i vërtetë duhej të bëhej me anë të likuidimit të vartësisë ekonomike e shfrytëzimit të saj[160].

«Bota e Re» e kundërshtoi pikëpamjen se çlirimi i saj mund të bëhej vetëm me anë të arsimit dhe edukatës. Ajo hodhi poshtë edhe teoritë e pikëpamjet e ndryshme reaksionare që kërkonin të përligjnin gjendjen e nënshtruar e pa të drejta të saj dhe që thoshin se gruaja prej natyre ishte inferiore, pa aftësi fizike e mendore që të mund të barazohej me burrin. Pikëpamje të tilla konsideroheshin antishkencore, të shpikura për të përligjur qëndrimin e klasave reaksionare ndaj gruas[161].

Sipas «Botës së Re» inferioriteti i gruas nuk rridhte nga kushtet natyrore, por nga kushtet e faktorët shoqërorë. Ata që thoshin se gruaja është inferiore prej natyre, arsyetonte revista, kishin mentalitet reaksionar prej zotërinjsh. Ata edhe masat e tjera popullore i konsideronin inferiore, në mënyrë që t'i shtypnin e t'i shfrytëzonin[162].

«Bota e Re» kritikoi ashpër klerin reaksionar, sidomos atë mysliman që i bënte qëndresë të fortë emancipimit të gruas. Klerikët, thuhej, mbanin qëndrim antihumanitar ndaj gruas dhe problemin e saj e trajtonin si problem fetar, me qëllim që ta kishin monopol të tyre e ta mbanin gruan përjetësisht në skllavëri[163]. Elementët përparimtarë kritikuan një sërë dukurish negative që flisnin për gjendjen e rëndë të gruas, si martesat me para dhe në mosha të vogla, prostitucionin, mbajtjen e perçes e të tjera. Sterjo Spasse, protestonte në romanin «Pse?» kundër martesave poshtëruese me para, që e kthenin gruan në një send të zakonshëm që mund të shitej e blihej[164].

Tablonë e zymtë e rrënqethëse të gjendjes shumë të rëndë të gruas shqiptare, të marrë nëpër këmbë nga rendi çifligaro-borgjez e mentaliteti prapanik që ishte pjellë e tij, e vizatoi me ngjyra të gjalla në romanin «Burgu» shkrimtari demokrat Haki Stërmilli[165]. Ai e cilësonte trajtimin e

160) «Bota e Re», 30 shtator 1936, f. 17-18; 30 dhjetor 1936, f. 23-24.
161) Po aty, 30 tetor 1936, f. 24; 15 shkurt 1937, f. 3-5.
162) Po aty, 15 shkurt 1937, f. 3-5.
163) Po aty, 15 korrik 1936, f. 5-9.
164) S. Spase, *Pse?* f. 52.
165) H. Stërmilli, *Burgu*, f. 71-73.

